

INSTITUTI PËR HULUMTIME DHE STUDIME ISLAME
RESEARCH INSTITUTE ON ISLAMIC STUDIES

STUDIME

Revistë Fetare, Kulturore, Shkencore
Religious, Cultural, Scientific Magazine

3

Boton: Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame

Kryeredaktor:

Sabri Bajgora

Redaksia:

Sabri Bajgora, Akad. Feti Mehdiu, Dr. Hysen Matoshi,
Dr. Abdullah Hamiti, Dr. Besir Neziri

Sekretar i redaksisë:

Dr. Besir Neziri

email: studime@ihsi-ks.org

Redaktorë gjuhësor:

PhD (c) Besnik Jaha
Bajram Zeqiri

Ballina:

Bashkim Mehani

Redaktor teknik:

Nuhi Simnica

Shtypi:

“Printing press” – Prishtinë

Tirazhi: 200

INSTITUTI PËR HULUMTIME DHE STUDIME ISLAME
RESEARCH INSTITUTE ON ISLAMIC STUDIES

S TUDIME

Revistë Fetare, Kulturore, Shkencore
Religious, Cultural, Scientific Magazine

3



Prishtinë,
2023

PARATHËNIE

Në përputhje me misionin e tij për të hulumtuar, dokumentuar dhe promovuar trashëgiminë islame në hapësirën shqiptare dhe më gjerë, Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame vjen para lexuesve me numrin e ri të revistës së tij shkencore “*Studime*”, në të cilën janë përmbledhur punimet e dy tryezave shkencore të zhvilluara gjatë viteve 2022 dhe 2023. Ky botim përfaqëson një përpjekje serioze për të ndriçuar jetën dhe vepërën e dy personaliteteve të spikatura të mendimit islam shqiptar: myftiut të Shkodrës dhe një pjese të Kosovës, Sali ef. Myftia dhe myderrizit të njohur nga Gjakova, h. Fahri ef. Iljazi, të cilët kanë lënë gjurmë të thella në jetën fetare, arsimore dhe kulturore në trojet shqiptare.

Në kuadër të Tryezës shkencore të organizuar në vitin 2022, vëmendja akademike u përqendrua në ndriçimin e figurës shumëdimensionale të myftiut të njohur të Shkodrës dhe një pjese të Kosovës, Sali ef. Myftia. Ky personalitet përfaqëson një ndër shembujt më të spikatur të lidershit fetar dhe intelektual në periudha tejet sfiduese për komunitetin mysliman shqiptar. Gjatë karrierës së tij të gjatë dhe të frytshme, ai dëshmoi një angazhim të palëkundur për ruajtjen e vlerave islame dhe konsolidimin institucional të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, zonës së Shkodrës, duke kontribuar në ndërtimin e një identiteti të qëndrueshëm fetar, kulturor dhe kombëtar.

Ai nuk ishte vetëm një figurë e njohur fetare, por një simbol i qëndresës intelektuale dhe morale, dhe si i tillë do të mbetet shembull frymëzimi për të gjithë studiuesit dhe udhëheqësit e sotëm fetarë.

Punimet shkencore-akademike që u prezantuan në këtë Tryezë shkencore, kanë ndriçuar segmente të panjohura të biografisë së tij të ndritshme. E për ta kompletuar këtë biografi të tij, që në të njëjtën kohë është edhe shumë e dhimbshme, ne nëpërmjet veprimtarit të palodhshëm shkodran, z. Ferid Lluja, kemi arritur të nxjerrim dosjen e tij komplet të përpiluar nga *Drejtorja e Sigurimit të shtetit*, i regjimit të Enver Hoxhës. Nga

dokumentet e klasifikuara në këtë dosje, mësojmë se ai dhe tërë familja e tij, konsideroheshin si armiq të përbetuar të regjimit komunist, duke u vënë në ballë të lëvizjes së Legalitetit, në përpjekje për të organizuar rezistencën ndaj komunizmit, duke lënë në vendlindje bashkëshorten me të gjithë fëmijët, përveç djalit të madh Fuadit, të cilin e kishte marrë me vete. Këtë ndarje ata e vuajtën shumë, sepse më kurrë nuk u takuan mes vete.

Ndërsa në vitin 2023, u organizua Tryeza tjetër shkencore, e cila iu kushtua figurës së myderrizit të shquar nga Gjakova, h. Fahri ef. Iljazit. Ky personalitet, i njohur për devotshmërinë, dijen dhe përkushtimin në mësimdhënie, ka lënë gjurmë të pashlyeshme në traditën e arsimit islam jo vetëm në Rajonin e Dukagjinit, por në mbarë Kosovën. Në një periudhë kur institucionet fetare dhe arsimore përballeshin me sfida të mëdha nga regjimi komunist, myderrizi Fahri ef. Iljazi u shqua si një nga shtyllat kryesore të ruajtjes së trashëgimisë së ulemave të mëhershëm dhe edukimit të brezave të rinj, në frymën e vlerave islame dhe të atdhedashurisë.

Punimet e përfshira në këtë numër të revistës synojnë të japin një kontribut të çmuar në studimet islame shqiptare, përmes analizës historike, biografike dhe kontekstuale të veprimtarisë së këtyre dy dijetarëve. Ato paraqesin një bazë të rëndësishme për studime të mëtejshme në fushën e historisë së mendimit islam, organizimit institucional të komuniteteve myslimanë në Shqipëri dhe Kosovë dhe të ndërveprimit të fesë me sfidat shoqërore e politike në shekullin XX.

Ky botim, përveçse ofron një pasqyrë të gjerë mbi veprën e këtyre dy figurave të rëndësishme, përbën një thirrje për reflektim mbi rolin e dijetarëve në ruajtjen e identitetit dhe unitetit të komunitetit mysliman në hapësirën shqiptare. Rrënjët e thella të fesë islame në trojet tona nuk janë vetëm pjesë e historisë, por gurrthemel mbi të cilin ndërtojmë të ardhmen. Vlerësimi i veprimtarisë së tyre, është kujtesë e përgjegjësisë kolektive që kemi për ta ruajtur dhe promovuar trashëgiminë tonë shpirtërore dhe kulturore, prandaj të kuptuarit e kontributit të këtyre dijetarëve, ndihmon në fuqizimin e identitetit tonë dhe në ndërtimin e një shoqërie që mbështetet mbi vlera të qëndrueshme.

Në fund, dëshiroj t'i falënderoj të gjithë autorët, studiuesit dhe bashkëpunëtorët që kontribuan me punimet dhe angazhimin e tyre në organizimin e tryezave shkencore dhe përgatitjen e këtij botimi. Lutemi që ky numër i revistës “*Studime*”, të shërbejë si burim i vlefshëm për studiuesit, akademikët dhe të gjithë ata që janë të interesuar për historinë dhe zhvillimin e mendimit islam ndër shqiptarë.

Prishtinë, dhjetor 2023

Sabri Bajgora
Drejtore i Institutit për Hulumtime
dhe Studime Islame

I
AKTET E TRYEZËS SHKENCORE
“SALI ef. MYFTIA
personalitet i shquar fetar dhe kombëtar”



Fjala e hyrëse e drejtorit të IHSI-së në Tryezën Shkencore
“SALI EF. MYFTIA PERSONALITET
I SHQUAR FETAR E KOMBËTAR (1891-1978)”

*I nderuari Myfti i Republikës së Kosovës Naim ef. Tërnavë,
E nderuara familje e Sali ef. Myftisë, - znj. Erjeta Myftia, përfaqësuese e
familjes,
I nderuari myfti i Shkodrës, Muhamed ef. Sytari,
I nderuari prof. Jusuf Zimeri, drejtor i Drejtorisë Fetaro-Arsimore pranë
BFI-së së Maqedonisë së Veriut,
I nderuari dekan i FSI-së, dr. Fahrush Rexhepi me bashkëpunëtorë,
I nderuari veprimtar i shquar nga Shkodra, z. Ferid Lluja,
I nderuari profesor Elez Osmani – veprimtar në ShBA,
Të nderuar anëtarë të Kryesisë,
Drejtorë të Drejtorive të Kryesisë,
Të nderuar anëtarë të KD të IHSI-së,
Profesorë nga FSI-ja dhe Medreseja,
Të nderuar studiues dhe panelistë të kësaj Tryeze shkencore,
Mysafirë dhe kolegë të dashur,
Zonja dhe zotërinj,*

Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame, i cili ka filluar me punë vitin e kaluar, në kuadër të veprimtarisë së tij të gjithanshme shkencore e studiuëse, përveç tjerash, në fokus ka edhe punën kërkimore-hulumtuëse nga fushat e shkencave islame, si dhe nga kultura dhe trashëgimia shpirtërore e popullit shqiptar.

Për t'i realizuar të gjitha këto objektiva të parapara me Statutin dhe Aktet e tjera përcjellëse të themelimit, Instituti organizon sesione, simpoziume, konferenca e tryeza shkencore, në të cilat do të trajtohen çështje të ndryshme nga islamologjia dhe nga kultura jonë shpirtërore e materiale islame.

Prandaj, nisur nga të gjithë këto objektiva, është nder dhe privilegj i veçantë që sot gjendemi në këtë sallë, për një ngjarje të këtillë shkencore, siç është kjo tryezë shkencore e cila i dedikohet një figure emblematike, siç është figura e ndritur e prijësit të shquar fetar dhe kombëtar, Sali ef. Myftisë.

Të nderuar të pranishëm,

S'ka dyshim se Sali ef. Myftija, meriton edhe më shumë se një tryezë shkencore, por le të jetë kjo një nismë e mbarë që figura e këtij fetari dhe atdhetari të devotshëm të trajtohet gjerësisht në ndonjë ngjarje edhe më madhështore, qoftë në Kosovë, qoftë në Shqipëri!

Ç'është e vërteta, ideja për mbajtjen e kësaj tryeze shkencore erdhi natyrshëm, pasi profesori ynë i nderuar Elez Osmani, një veprimtar i dalluar i çështjes kombëtare përtej Atlantikut, na e solli një pjesë të bibliotekës së mbetur prej Sali ef. Myftisë, në mesin e të cilave ishin edhe tri fletore shumë të çmuara shënimesh në dorëshkrim. Në ato fletore ka shënime të vlefshme, të cilat shënime prekin fusha të ndryshme fetare. Në të shihet pedantizmi gjatë mbajtjes së shënimeve, e që zakonisht i nevojitet shumë një teologu gjatë punës së tij të përditshme. Këto shënime përmbajnë citate nga librat e Tefsirit, Fikhut, Historisë islame, Hadithit, Akaidit, rreth fraksionet islame, ngjarje historike, dëshmitar i të cilave ishte edhe vetë protagonistin para dhe pas Luftës së Dytë Botërore etj., për çfarë më gjerësisht do të flasim pak më vonë gjatë kumtesës.

Sigurisht se jemi shumë të lumtur që amaneti i Sali ef. Myftisë, i cili nga nipi i tij z. Ahmeti iu dorëzua profesorit Elez Osmani, pra arriti në Bibliotekën e IHSI-së, dhe tani është sistemuar në sektorin e dorëshkrimeve të veçanta pranë kësaj biblioteke, dhe shpresojmë se shumë shpejt këto fletore, që aktualisht janë vetëm në dorëshkrim, do të jenë të qasshme edhe për studiuesit që mund të shfaqin dëshirë për t'i analizuar edhe më në detaje!

Unë jam thellësisht i bindur se kjo tryezë shkencore do të japë përgjigje në shumë pyetje të ngritura deri më tani rreth figurës së Sali ef. Myftisë, dhe shpresoj se puna e ardhshme kërkimore-shkencore rreth ve-

primtarisë së tij, sidomos në Egjipt dhe Siri, do të duhet të jetë në fokus të studiuesve të rinj e të zellshëm.

E lus Zotin që sot studiuesve të respektuar t'u japë mbarësi e bereqet në këtë tryezë shkencore!

Ju faleminderit!

Ve selamu alejkum!

Sabri Bajgora

Drejtore i Institutit për Hulumtime
dhe Studime Islame

**Fjala e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë
me rastin e Tryezës shkencore**
**“SALI EF. MYFTIJA PERSONALITET
I SHQUAR FETAR E KOMBËTAR (1891-1978)”**

E nderuar familja Myftija

*I nderuar drejtor i Institutit për Hulumtime e Studime Islame, Sabri ef.
Bajgora*

Të nderur drejtues të Institucioneve të BI, Dekan i FSI-së,

I nderuar myfti i Shkodrës

Ju të çmuar studiues, e studentë

Zonja dhe zotërinj

Të nderuar të pranishëm!

Shkenca, dija dhe dijetarët sipas fes sonë Islame kanë një vend të posaçëm të Zotit xh.sh., por edhe të shoqëritë njerëzore, vend i cili assesit nuk mund të mohohet nga askush, dijetarët kanë një meritë dhe respekt të cilin si dhe sa duhet e vlerëson dhe shpërblen vetëm Zoti xh.sh., derisa neve na mbetet që të rikujtojmë kontributin e tyre edhe pas vdekjes së tyre, ti vlerësojmë dhe rikujtojmë me të mirë. Zoti xh.sh thotë:

“Allahu dëshmon, e po ashtu engjëjt dhe njerëzit e dijes , se nuk ka Zot tjetër (që meriton të adhurohet) përveç Tij...” - Ali Imran 18.

Zoti xh.sh. në ajetin tjetër na mëson për vlerën që ka dija dhe nderin e respektin që gëzojnë dijetarët duke ngritur statusin e tyre në ata njerëz që ia kanë frikën Zotit xh.sh.

Zoti xh.sh. thotë:

“Në të vërtetë nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...” Fatir 28.

Andaj Zoti dijetarët i ka ngritur në pozita të larta kur Ai Thotë:

***“Thuaj: A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë” Ez-
zumer -9.***

Nga kjo thënie po mësojmë se Zoti xh.sh. i ka ngritur dijetarët në një shkallë të lartë të gradimit e mirësisë për nderë të dijes dhe kontributit të

dhënë për t'i udhëzuar njerëzit në rrugën e drejt, në rrugën që thirri Zoti xh.sh. dhe Pejgamberët.

Vdekjen e një dijetari nuk guxojmë thjesht ta konsiderojmë si një vdekje të rëndomtë, ngase me vdekjen e dijetarit po vdesin edhe shumë gjëra me vlerë të cilat ecnin mbi tokë bashkë me te. Ndaj dijetarët janë një dritë e cila në vazhdimësi ndriçon tokën dhe shoqërinë.

Duhet ditur se është urdhër fetarë Islam që ne t'i rikujtojmë dijetarët dhe të merren shembull mirësitë dhe kontributi i tyre në edukimin dhe udhëzimin e gjeneratave të reja në rrugën e drejt. Dijetarët vdesin por rikujtimi i tyre sikur ringjall prezencën e tyre, ngase ata me veprat e tyre bënë që emri i tyre të mos harrohet edhe nga gjeneratat e më vona. Gjithçka që duhet bërë është që të vjelim nga frutat e tyre, të marrim e të thithim nektarin e ëmbël të dijes e mirësive të shumta të cilat i lanë trashëgimi, e të cilat nuk përfundojnë deri në Kijamet.

Ata janë trashëgimtarët e Pejgamberëve, bartësit e amanetit të fesë dhe përgjegjës për udhëzim të besimtarëve në rrugën e drejt. I tillë ishte edhe ef. Salih Myftia i Shkodrës.

Të nderuar të pranishëm!

Kam nderin e kënaqësinë që sot të jam bashk me ju në këtë aktivitet shkencor në të cilin kujtojmë e vlerësojmë një ndër prijësit e shquar të popullit tonë në shekullin e kaluar, myftiun e atdhetarin e shquar shkodranin Salih ef. Myftia, i njohur për aktivitetin e tij fetar dhe atdhetar.

Përschendes e përgëzoj Institutin për Hulumtime e Studime Islame që ka ndërmarr këtë hap për të kujtuar e për të na risjellë në vëmendje personalitetin e Salih ef. Myftisë, i cili është shembull i një eruditi e prijësi të dalluar në rrafshin fetar e kombëtarë, shembull i njeriut i cili tërë qenien e tij e vuri në shërbim të Komunitetit Mysliman, të popullit dhe Atdheut të tij.

Salih ef. Myftia i përket brezit të atyre ulemave atdhetar që patën fatin e mirë që të jenë bartës, drejtues dhe të kenë vizionin e duhur për themelimin dhe ngjitjen e institucioneve të mëvetësishme në Shqipërinë e pa-

varur. Qëllim ky, për të cilin ky brez i ulemave nuk kurseu mundin, dijen e as pasurinë.

Shih për këtë, Salih ef. Myftia që në rinin e tij dëshmohej si një personalitet me vizion e qëndrime të qarta. Ai u dëshmuar si arsimdashës i papëpur, si një udhëheqës e myfti i shquar, e mbi të gjitha, si atdhetar me veti të larta shtetformuese.

Zaten, s'ka se si të ishte ndryshe, kur kemi parasysh se ky është nipi i Sali Myfisë së Madh dhe i biri i Adem efendiut të shquar, të cilët zënë vendin e tyre të merituar në historinë shqiptare.

Të nderuar të pranishëm!

Sali ef. Myftia gjatë jetës së tij dëshmoi e tregoi afinitet e përkushtim për t'i shërbyer e për t'i prirë qëllimeve e kauzave të mëdha me karakter kombëtar e fetar. Këto prirje e aktivitete të tij më së miri i dëshmoi në detyrat dhe punët të cilat iu ngarkuan, qoftë si drejtues e mësimdhënës në medresenë e Shkodrës, qoftë më vonë si myfti i Shkodrës dhe prefekturës së Kosovës, detyra këto që i kreu më përkushtim e kompetencë. Gjatë kohës sa drejtoi Myftininë e Shkodrës e shndërroi atë në myftininë më të rëndësishme të vendit.

Si myfti i Shkodës dhe prefekturës së Kosovës Salih ef. Myftia vazhdoi deri më 1939, kur Shqipëria bie nën pushtetin fashistë italian, veprim ky të cilin Salih efendia natyrisht që nuk do ta pranonte dhe nuk do ta miratonte kurrën e kurrës dhe do të angazhohej kundër një pushteti të tillë, ndaj që këtu filloi një periudhë me plotë ecejake e sfida për Salih ef. Myftinë dhe bashkëmendimtarët e tij.

Hiç më mirë se kaq, Salih efendiu nuk u ndie as kur në Shqipëri u vendos sistemi komunist-ateist, i cili e detyroi Salih efendin që ta lërë vendin e tij të dashur dhe të merrte rrugën e mërgimit, fillimisht në Itali e më pastaj në Siri, Liban, Egjipt dhe për t'u vendosur përfundimisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, saktësisht në shtetin e Nju Jorkut.

Të nderuar të pranishëm!

Kudo që u gjend dhe u vendos Salih efendiu ai menjëherë iu përvesh punës dhe angazhimit të tij në organizimin e mërgatës shqiptare dhe për

mbajtën gjallë të idesë për nxjerrjen e Shqipërisë dhe shqiptarëve nga sistemi komunist-ateist.

Deri sa ishte në mërgim në Kajro, Salih efendiu u bë pjesë e Oborrit Mbretërorë të shqiptarëve, përkatësisht të Mbretit Zog, nga i cili përveç që është çmuar e nderuar lartë, për kontributin e dhënë në këtë drejtim u dekorua me Urdhrin Skënderbeu.

Një kontribut të madh dhe domethënës Salih efendiu e dha gjatë qëndrimit të tij në SHBA, përkatësisht në Nju-Jork, ku arriti që të organizonte dhe të aktivizonte komunitetin shqiptar aty dhe të themelonte Qendrën Islame me Xhaminë në mes dhe së bashku me Imam Isa Hoxhën ta drejtonin atë.

Në mesin e mërgatës shqiptare Salih ef. Myftia ishte shumë i respektuar, i çmuar e me ndikim, dhe jo rastësisht njihej si Myftia i Madh i shqiptarëve.

Salih efendi Myftia luajti rol të rëndësishëm në mësimin dhe kultivimin e gjuhës shqipe, ruajtën e traditave fetare e kombëtare të komunitetit shqiptarë të cilit edhe i priu.

Të nderuar të pranishëm!

Salih ef. Myftia u shqua si një personalitet që në SHBA kultivoi frymën e afrimit, mirëkuptimit e tolerancës ndërfaqetare në mesin shqiptarëve, duke bashkëpunuar ngushtë me komunitetet fetare shqiptare dhe duke ndikuar në kalitjen e ndjesisë së përbashkët shqiptare, të përmbledhura në atdhedashuri, besim në Zot, gjuhë, liri dhe bashkim të trojeve shqiptare.

Me gjithë kontributet e mëdha që dha për vendin e për fenë, për mërgatën shqiptare kudo që veproi, për shkak të qasjes ndaj fesë që mbretëroi tek ne për dekada të tëra, figura e Salih ef. Myftisë si edhe e shumë personaliteteve të tjera tonat, mbeti në margjinat e kohës, madje, për më keq edhe u anatemua e u luftua.

Prandaj, organizimin e kësaj tryeze shkencore nga ana e Institutit për Hulumtime dhe Studime Islamem e shoh si shumë të qëlluar dhe në funksion të njohjes dhe vlerësimit meritore të institucioneve tona këndeje e andej kufirit për prijësin tonë të çmuar dhe atdhetarin e dëshmuar Sali ef. Myfinë.

I bindur se referuesit tjerë në këtë Tryezë shkencore do të japin të dhëna më të plota për jetën dhe veprën e Salih ef. Myftisë, më lejoni që edhe një herë t’ju përshëndes dhe t’ju uroj punë të mbarë e suksese!

Prishtinë, 30 qershor 2022

Myftiu i Kosovës
Naim ef. Tërnavë

**Fjala e Myftiut të Shkodrës, Muhamed ef. Sytari
me rastin e Tryezës shkencore**
**“SALI EF. MYFTIJA PERSONALITET
I SHQUAR FETAR E KOMBËTAR (1891-1978)”**

*I nderuari kryetar i Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, hirë-
sia juaj, Naim ef. Tërnavë,*

*I nderuari drejtor i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof.
Sabri ef. Bajgora,*

*Të nderuar pjesëtarë të familjes së myftiut tonë të madh dhe hoxhës
sonë të shtrenjtë, Sali ef. Myftisë,*

*Të dashur të pranishëm në këtë Tryezë shkencor të një prej emrave më
të shquar të trashëgimisë sonë islame në rrafshin kombëtar!*

Teksa flasim dhe përkujtojmë emrin e madh të Sali efendi Myftisë në këtë Tryezë dhe në çdo tryezë tjetër, patjetër që reflektojmë rreth mirësisë së madhe, me të cilën Zoti i Gjithësisë na begatoi ne si shqiptarë me burra të urtë, të cilët në momentet delikate të historisë sonë kombëtare, ditën të mbajnë të lidhur interesin fetar me interesin kombëtar. Ata nuk u bënë pa-lë me pushtuesit dhe nuk ranë në grackat e provokimeve dhe tundimeve të shpeshta dhe të shumta, për ta shitur njëren prej dy kauzave apo të dyja së bashku.

I tillë ishte edhe myftiu i madh i Shkodrës, Sali efendi Myftia, një pi-njoll i një familjeje të madhe dhe të shquar të hoxhallarëve, dijetarëve dhe mësuesve me famë.

Në vitin 2009, në Phoenix të Arizonës, pata rastin të takohem me të nderuarin Remzi Barollin, një aktivist i shquar i çështjes kombëtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili pati mirësinë që të më dhuronte një faksimile të kronikës së famshme që gazeta prestigjioze “The New York Times”, në vitin 1972, shkruante për hapjen e xhamisë së parë të shqipta-rëve në Nju Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Deshi Zoti që në

vitin 1972, hirësia e tij të kishte edhe mirësinë dhe bekimet e Zotit, ta hapte atë xhami, e cila edhe sot e kësaj dite vazhdon aktivitetin e saj.

Të dashur dhe të nderuar të pranishëm,

Në Kuranin famëlartë, ka një ajet kuranor, i cili është me vend që të përmendet teksa përkujtojmë së bashku Sali efendi Myftinë, ku Allahu i Madhëruar thotë: “Burra të cilët qëndruan në besën të cilën ia dhanë Allahut.”

Po ta shohim jetën dhe aktivitetin e Sali efendi Myftisë, do të shohim se përtej ulje-ngritjeve të saj, ai përherë ishte dinjitoz dhe nuk u thye asnjëherë. Ai nuk e shiti veten asnjëherë përballë fashistëve, as përballë komunistëve, e as përballë kujtdo që kishte ardhur apo që kishte për qëllim ta prekte interesin kombëtar.

Si një fetar i madh dhe një atdhetar i shquar, ai ishte, ngeli dhe do të ngelet përherë si një pikë referimi për të gjithë ne.

Teksa lexojmë për largimet-emigrimet e shpeshta të tij, pra edhe për furtunat e jetës dhe sprovat e tij, herë në një vend dhe herë në një tjetër, na del në pah personaliteti i këtij burri të shquar, i cili më ngjan me ata burrat e parë të Islamit, që emigruan nga vendlindja e tyre drejt Etiopisë, për të parë dhe për të dëshmuar në veprën e tij atë që thuhet se të mëdhenjtë nuk përkufizohen me tokën dhe kohën, porse të dyja së bashku i kanë aleatë për të nderuar dhe për të dëshmuar vlerat më të larta fetare, njerëzore dhe kombëtare.

Allahu e mëshiroftë Sali ef. Myftinë, ndërsa juve ju shpërbleftë për këtë Tryezë shkencore, duke ju uruar referuesve mbarësi dhe suksese!

Myfti i Shkodrës
Muhamed ef. Sytari

**Fjala e Erjeta Myftisë, mbesa e Sali Myftisë,
me rastin e Tryezës shkencore**

**“SALI EF. MYFTIJA PERSONALITET
I SHQUAR FETAR E KOMBËTAR (1891-1978)”**

Të nderuara personalitete, prezentë në këtë Tryezë!

Sot, në këtë ditë të veçantë dhe plot emocione, do të doja shumë që të ishin prezentë babai im Xhevati, xhaxhallarët e mi të ndjerë, Fuati, Feriti, Mithati, të cilët tashmë prej shumë vitesh kanë ndërruar jetë, e po ashtu edhe halla ime e ndjerë, Merjemja.

Do të doja të ishin prezentë këtu hallat e mia, Sadija, Neziati, Safetja, të cilat për arsye shëndetësore dhe moshës tepër të thyer, e kishin të pamundur të ishin fizikisht këtu me ne, por që me shpirt dhe me zemër janë këtu mes nesh.

Në emër të të gjithë prindërve tanë, të mbesave dhe nipave të familjes Myftia, unë dua ta falënderoj Bashkësinë Islame të Kosovës dhe Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame për organizimin e kësaj Tryeze shkencore kushtuar Sali Myftisë, gjyshit tim dhe gjyshit tanë.

Jemi shumë të nderuar që jemi sot këtu, në këtë ditë, që veçanërisht për mua, por edhe për të gjithë ne këtu, është një ditë plot emocione.

Unë personalisht nuk e kam njohur gjyshin tim, nuk kam kujtime personale me të, kam pak kujtime të heshtura nga babai im dhe ato të treguara me shumë frikë dhe ndrojtje për shkak të kohës dhe për shkak të asaj që ishim fëmijë.

Ne jemi shumë krenarë që së pari kemi mbiemrin Myftia, jemi krenarë që jemi trashëgimtarë të një figure me vlera të larta njerëzore, të një figure që kishte një besim të devotshëm dhe të fortë në Zotin, Allahun Një dhe në dashurinë për atdheun e tij.

Edhe një herë dua t’ju falënderoj për këtë Tryezë shkencore!

Ju faleminderit!

Erjeta Myftia
Mbesa e Sali Myftisë

TELEGRAMURIMI NGA PRINCI LEKA ZOGU II



Tiranë, më 23 qershor 2022

Z. Sabri Bajgora
Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame

I dashur Sabri,

I nderuar Z. Bajgora,

Ju përgëzojmë për organizimin e kësaj tryeze shkencore kushtuar figurës së Sali eff. Myftisë.

Sali eff. Myftia mban vendin e nderit në mesin e një plejade klerikësh që mishëruan përkushtimin e paepur kundrejt Fesë dhe Atdheut.

Pinjoll i një dinastie ulemash të shfaqur në histori qysh në kohën e Pashallëkut të Bushatllinjve të Shkodrës, Sali eff. Myftia ishte myderriz, kadi dhe, në vitin 1931, u emërua nga Mbreti Zog në detyrën e kryemftiut të prefekturës së Shkodrës dhe, më pas, edhe të asaj të Kosovës.

Shkëlqeu në ushtrimin e detyrës së tij. Kur retë e zeza të fashizmit dhe komunizmit u shkarkuan mbi atdheun tonë, Sali eff. Myftia përzgjedhi rezistencën ndaj së keqes me të gjitha fuqitë e tij. Në Egjipt ishte një nga këshilltarët e çmuar të Mbretit Zog. Në New York themeloi xhaminë e shqiptarëve të Amerikës dhe u mbiquajt Myftiu i Madh i shqiptarëve të Botës së Lirë.

Gëzohemi me të vërtetë që ky përkujtim i organizuar prej Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame përkon me 45-vjetorin e dekorimit të Hirësisë së Tij, Sali eff. Myftisë, me Kordonin e Madh të Urdhrit të Skënderbeut nga babai im, Mbreti Leka.

Duke ju falenderuar për zemërsisht për ftesën dhe mundësinë për të shprehur mirënjohjen e Familjes tonë për figurën e Sali eff. Myftisë, i urojmë suksese dhe mbarësi tryezës shkencore dhe veprimtarisë së Institutit në angazhimet e veta fort të lëvdueshme.

Me respekt,

Leka II i Shqiptarëve

SALIH EFENDI MYFTIA (1891-1978),
MYFTI I ZONËS SHKODËR DHE KOSOVË (GJAKOVË)
PRIJËS I SHQIPTARËVE MYSLIMANË NË SHBA*

Salih Efendi Myftia lindi më 1891 në Shkodër, në një mjedis familjar, intelektual, fetar dhe shoqëror të shquar. Ai u rrit me një edukatë të shëndoshë islame. Mësimet e para i mori në Medresenë e Shkodrës e më pas i plotësoi në Vlorë, tek intelektualit dhe teologu i mirënjohur, Haxhi Vehbi Dibra, myfti i atij qyteti në atë kohë, duke treguar një përkushtim të veçantë ndaj diturisë fetare. Që në moshë të re zotëronte mirë gjuhët orientale: arabishten, persishten dhe turqishten. Shpejt fitoi simpatinë e banorëve të vendlindjes së tij dhe me sjelljen e përkushtimit në punë lartësoi figurën prej prijësi fetar të shquar. Një kujdes të veçantë tregoi për pasurimin e bibliotekës së familjes, që e kishte trashëguar nga paraardhësit. Për këtë bibliotekë është shkruar në mjaft organe shtypi¹, por mund të theksohet se ajo ishte ndër më të vjetrat e më të kompletuarat me vepra fetare, filozofike dhe të shumë degëve të tjera të shkencave, ku Salih Efendiu studionte e plotësonte formimin e tij kulturor e fetar. Për fat të keq, kjo bibliotekë 300 vjeçare është zhdukur plotësisht nga vala e shkatërrimeve dhe përndjekjeve politike ateiste.

Kultura e tij e gjerë dhe aftësitë personale e afirmuan si një drejtues fetar të merituar, prandaj edhe emërohet drejtor i Medresesë së Epërme. Kjo medrese nën drejtimin kompetent të Salih Efendi Myftisë do të bëhej një nga qendrat e rëndësishme kulturore dhe arsimore për fëmijët e të rinjtë e besimit islam në Shkodër.²

Më 14 janar të vitit 1931, Salih Myftia emërohet Kryemyfti i Zonës Shkodër.³ Emërimi i Hirësisë së tij bëhet me Dekretin nr. 19 të Mbretit

* Huazuar nga *Zani i Naltë*, Jan 07, 2020.

¹ Revista “Njeriu”, “Almanaku”, “Shkodra” etj.

² Bushati, Hamdi, “Shkodra dhe motet”, dorëshkrim, f. 535.

³ Dekreti Nr. 19, dt. 14 Kallnuer (janar) 1931, ruhet në arkivin e familjes Myftia.

Zog dhe përveç tij është firmosur edhe nga Kryeministri Pandeli Evangjeli dhe Ministri i Drejtësisë.

Pak kohë më vonë juridiksionit të Salih Efendisë si Kryemyfti, përveç Prefekturës së Shkodrës, i shtohet dhe detyra e Prefekturës së Kosovës, që përfshinte zonën Kukës, Krumë, Has, Gjakovë (Tropojë). Kjo që një detyrë me rëndësi jo vetëm për shtrirjen e gjerë, por për vetë problemet administrative, fetare, kulturore dhe ekonomike. E duhet theksuar se këtë detyrë e kreu me përkushtim të veçantë dhe u shqua si një drejtues i aftë e kompetent.

Gjatë kësaj periudhe mund të vëmë në pah disa veprimtari, ku u përqendrua puna e Salih Efendi Myftisë:

- Kryemyftinia e Zonës së Shkodrës dhe Kosovës riorganizohet dhe funksionon më mirë si institucion fetar.
- Zëri i kryemyftinisë, i hoxhallarëve të nderuar dhe i intelektualëve të shquar myslimanë dëgjohet i qartë e i fuqishëm në të gjitha strukturat organizative të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe në veprimtaritë që organizohen prej tij.
- Për të gjithë hoxhallarët e shquar krijohet një klimë e shëndoshë pune.
- Ka një lëvizje të madhe kuadrosh nga qytete të tjera në Shkodër.
- Meremetohen shumë xhami dhe emërohen kuadrot më të aftë për shërbimet fetare.
- Riorganizohet mësimi i besimit islam në shkollat shtetërore, emërohen për të dhënë mësim hoxhallarët më të nderuar dhe mësuesit më të devotshëm.
- Nxiten familjet shkodrane që djemtë e vajzat të ndjekin shkollat e të gjitha kategorive.
- Fillon një traditë e bukur botimesh fetare islame, sidomos në shtypshkronjën “Ora e Shkodrës”, ku edhe botohet revista “Zani i Naltë”, organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar.
- Ka një lëvizje interesante të intelektualëve shkodranë në shërbim të fesë e të kulturës fetare.
- Ka një lëvizje të gjerë kulturore, fetare dhe kombëtare.

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste, Salih Efendiu internohet në Gjirokastrë. Lidhur me këtë fakt z. Adem Hodo shkruan: "...Në lëmin kombëtar, me zaptimin e Shqipërisë më 7 prill 1939, qe vënë në shenjë nga zaptonjësit dhe u internua në kalanë e Gjirokastrës për një kohë relativisht të gjatë".⁴

Periodha gjatë okupimit fashist zgjon te Salih Myftia shpirtin luftarak dhe e kalon atë nga një besimtar me Kur'an në dorë në një atdhetar dhe me pushkë në krah organizon rezistencën nacionaliste shqiptare, duke u bërë një nga inspiruesit më të dalluar të luftëtarëve të lirisë e duke u vënë plotësisht në shërbim të çështjes kombëtare.

Në prag të ardhjes në fuqi të pushtetit komunist në Shqipëri, Salih Efendi Myftia me zemër të lënduar mori rrugët e mërgimit për të mos u kthyer më kurrë në atdheun e tij të dashur, për të cilin jetoi e punoi gjatë gjithë jetës së tij pothuajse shekullore.

Largimi nga atdheu për Salih Myftiun nuk kishte kuptimin e shpëtimit, por kishte për qëllim vazhdimin e luftës së pandërprerë antikomuniste dhe rikthimin e lirisë së humbur popullit të shumëvujtur shqiptar, luftë të cilën e vazhdoi deri në minutat e fundit të jetës së tij.⁵

Në rrugën e mërgimit filloi një etapë tjetër e veprimtarisë fetare dhe politike të Salih Myftisë. Që në ditët e para kur ishte në kampin "Grumo" të të mërguarve shqiptarë në Bari, edhe në kushte të vështira morale e të një hidhërimi të thellë, ai më 28 nëntor 1944, Ditën e Flamurit, organizon me të gjithë emigrantët shqiptarë një ceremoni atdhetare dhe fetare. Më pas nga Bari e internojnë për dy vjet në një zonë tjetër, Rexhio Emilia.⁶

⁴ Hodo, Adem, Fjala e rastit në vdekjen e Sali Myftisë, gazeta "Atdheu", (organ i Organizatës Kombëtare "Lëvizja e Legalitetit"-O.K.L.L.), New York, vjeti XXVIII, nr. 2 (53), maj-qershor 1978: 4.

⁵ Mulosmanaj, Hysen, "Koha dhe vepra e tij", gazeta "Atdheu", New York, Vjeti XXVIII, nr. 2 (53), maj-qershor 1978: 4.

⁶ Kupi, Nderim, Intervistë dhënë Radio Shkodrës me rastin e 100 vjetorit të lindjes së Salih Efendi Myftisë, tekstin 11 faqe në dorëshkrim e ruan familja Myftia.

Filloi kështu një periudhë e re në jetën e Salih Myftisë, e ngjeshur me vuajtje dhe të panjohura. Ishte një odise e mirëfilltë. Kaloi nga njëri vend i huaj tek tjetri, nga Italia në Egjipt, Siri e Liban.⁷

Gjatë qëndrimit të tij në Aleksandri jo vetëm që u njoh dhe u çmua nga njerëzit më të lartë të rangut të vet fetar, por u pa kurdoherë me nderime të posaçme dhe në rrethet më të zgjedhura të aristokracisë së vendit e të personaliteteve më të njohura të botës arabe.⁸

Në mërgim që ndër këshilltarët më të afërm të Mbretit Zog dhe njëri që e ndihmoi më tepër në realizimin e lidhjes midis mbretit Zog dhe krerëve të mërgatës politike shqiptare, e njohur si “Marrëveshja e Aleksandrisë”.⁹

Pas një përvoje të hidhur të jetës së mërgimit, që e detyroi atë të kalojë prej një vendi të huaj në tjetrin, më në fund Salih Efendia gjet prehje e paqe në rrethin familjar të djalit të tij, Fuadit dhe të Bashkësisë Shqiptare të Washingtonit në SHBA, deri në ditët e fundit të kësaj jete.

Atje fillon aktiviteti i Salih Myftisë në fushën fetare dhe pa humbur kohë merr iniciativën për themelimin e Qendrës Islame Shqiptare-Amerikane për shtetet New York-New Jersey dhe së bashku me Imam Isa Hoxhën dhe me ndihmën e intelektualëve shqiptarë hapën të parën shkollë fetaro-kombëtare, ku Salih Myftia, edhe pse tashmë në moshë, asistonte në çdo orë mësimi që mbahej.

Ngritja e xhamisë, krijimi i Komunitetit Mysliman për shqiptarët e Amerikës, hapja e shkollës së parë fetaro-kombëtare për fëmijët e shqiptarëve myslimanë të Amerikës, janë dëshmi e një përkushtimi të lartë fetar e atdhetar.

⁷ Vani, Shaban, Udhëheqës shpirtëror i Myslimanëve shqiptarë në Botën e Lirë, gazeta “Drita Islame”, nr. 6, 1992:3.

⁸ Mulosmanaj, Hysen, “Koha dhe vepra e tij”, gazeta “Atdheu” New York, Vjeti XXVIII, nr. 2 (53), maj-qershor 1978: 4.

⁹ Deda, Zef Pashko, “Jeta dhe vdekja e tij”, gazeta “Atdheu”, Organ i Organizatës Kombëtare “Lëvizja e Legalitetit” (O.K.L.L.), New York, Vjeti XXVIII, nr. 2 (53), maj-qershor 1978:3.

Salih Myftia, krahas punës së madhe në fushën e edukimit fetar të shqiptarëve në Botën e Lirë, zhvilloi edhe një veprimtari të dendur politike atdhetare.

Për meritat e tij fetare dhe kombëtare trashëgimtari për fronin mbretëror, Leka Zogu e dekoroi Salih Myftiun me Dekoraten “Kordoni i Madh i Skënderbeut”.

“Urojmë me gjithë zemër Hirësinë e Tij, Salih Myftiun, për dekoratën ma se të meritue me dhe ta mbajë për shumë vjet në gjoksin e Tij krenar, si shpërblim për veprat e Tij të nalta për: Fe, Atdhe, Komb e Mbret”, thuhet në një artikull të gazetës “Atdheu” në SHBA, në vitin 1977.¹⁰

Salih Myftia ndërroi jetë në moshën 87 vjeçare, pas një pune dhjetëra vjeçare si dishepull i atdhetarizmit dhe i Fesë islame.

Gazeta “Atdheu” i kushtoi një numër special kësaj ngjarjeje të dhimbshme. Në ballë të këtij numri shënohej:

*“Ndërroi jetë në New York, më 19 maj 1978. Hirësia e tij Salih Myftija, ish-kryemyfti i Shkodrës dhe i një pjese të Kosovës dhe udhëheqësi shpirtnor i myslimanëve shqiptarë në botën e lirë, njwri nga figurat më të shkëlqyeshme të përpjekjeve fetare kombëtare”.*¹¹

¹⁰ Dekorim i merituem, Gazeta “Atdheu”, nr. 50-51, New York, nandor 1977:1.

¹¹ Deda, Zef Pashko, “Jeta dhe vdekja e tij”, gazeta “Atdheu”, Organ i Organizatës Kombëtare “Lëvizja e Legalitetit” (O.K.L.L.), New York, Vjeti XXVIII, nr. 2 (53), maj-qershor 1978:3; për më tepër shih: gazeta “Drita Islame”, nr. 6, 1992; Luli, Faik; Dizdari, Islam; Bushati, Nexhmi, “Në kujtim të brezave”, Rozafat, 1997.

Dr. Irida HOTI

KUJTIME TË HESHTUNA, RRËFIME FAMILJARE PËR SALIH EFENDI MYFTINË

Së pari, në emër të familjes Myftija dhe të të gjithë nipave dhe mbesave, dua t'i përcjell falënderimet dhe mirënjohjen për organizatorët e kësaj veprimtarie!

Për ne është ndjesi sa emocionuese aq edhe e vështirë, pra të rrëfesh kujtime të heshtuna, të jetuara e të pathëna për gjyshin tonë të ndjerë, Salih efendi Myftinë.

Kur m'u kërkua prej organizatorëve përgatitja e këtij referimi për jetën e tij familjare, ndjeva një emocion shumë të madh, e edhe pak stepje, sepse unë e njoh gjyshin tim përmes rrëfimeve të rrëfyera. Sigurisht se e mora me shumë entuziazëm, duke pasur parasysh tri vajzat e Sali Myftisë që jetojnë, prej 7 fëmijëve e tij, Sadija 94 vjeçare, Hatixheja 84 vjeçare dhe Safetja, nëna ime, 82 vjeçare.

Ky referim është një mpleksje e kujtimeve të tri vajzave dhe dy mbesave, Farida dhe Lejla, të cilat patën fatin ta kalonin fëmijërinë e tyre me




ngrohtësinë e gjyshit në Amerikë, si dhe botimeve që i mbështesin këto rrëfime.

Kujtimet e vajzave të Salih ef Myftisë janë të pakta, sepse e shkurtër ishte edhe periudha që e jetuan me të atin. Nëna ime, nëna Safete ishte vetëm 4 vjeçare, kur ai u largua nga Shqipëria, për të mos e takuar më, për të mos e shijuar përkëdhelinë apo edukimin atëror, të cilën ajo së bashku me 6 fëmijët e tjerë, dy vajzat, Sadijen dhe Hatixhen (të ndjerët Xhevatin, Feridin, Mejremen e Mithatin) morën prej nënës së tyre heroinë, nënës Qamile, dhe u rritën me imazhin e tij, me imazhin e një njeriu të madh, dhe, më e rëndësishmja, me krenarinë se ishin fëmijët e Salih efendi Myftisë, që gëzonte respektin e atyre që e njohën në Shkodër e vende të tjera ku ai jetoi brenda e jashtë Shqipërisë.

Pikërisht duke folur për këtë aspekt nëna ime Safetja kujton kohën kur filloi punën si mësuese në Luf të Pukës, e shoqëruar prej nënës së saj, në vitin 1957; aty është pritur dhe trajtuar me shumë respekt prej banorëve, të cilët e kishin njohur Sali efendi Myftinë: *“Nën hijen e tij u vlerësova shumë”*, thotë nëna ime Safetja.

Në atë periudhë të diktaturës komuniste në Shqipëri ishte e rrezikshme të flitej e të përmendej emri i Sali Myftisë, i konsideruar si armik i regjimit. Megjithatë, siç kujtojnë vajzat e tij sot, nuk ishin të paktë ata që në fshehtësi e besim shprehin admirim dhe vlerësim për figurën e Sali Myftisë, si trashëgimtari i një dinastie hoxhallarësh të përkushtuar ndaj fesë, dijes dhe bamirësisë. Sali efendi Myftija ka qenë brezi i pestë kryemyfti, dhe e ndoqi këtë rrugë me shumë përkushtim.

Këtë e gjejmë edhe në librin *“Në kujtim të brezave”*, ku thuhet: *“Kushdo që kalonte në sheshin e njërës prej lagjeve më të vjetra të Shkodrës “Ndocej”, përballë xhamisë do t’i binte në sy shtëpia e nderuar e Myftijëve. I ka mbetur ky emër, mbasi kjo derë bujare ka trashëguar ndër breza detyrën e nderuar të Kryemyftisë në qytetin mijëravjeçar.”*



Në pemën gjenealogjike të familjes Myftija në librin “Shkodra dhe motet, - Pemë gjenealogjike familjesh shkodrane”, të vitit 1999, paraqiten deri në tri brezni

Ajo për të cilën familjarë dhe të afërt të gjithë tim të ndjerit Sali efendi Myftija flasin me krenari dhe e kujtojnë si një tipar dallues është natyra e tij e paqtë dhe tolerante, e cila reflektohej edhe në marrëdhëniet me komunitetin katolik në Shkodër. Nëna dhe tezet e mia kujtojnë se në kohën kur i ati i tyre ka qenë kryemyfti i Shkodrës, në marrëveshje me drejtuesit e komunitetit katolik, në rastet e festave fetare për bajrame dhe pashkë, kanë lidhur me një varg dritash e flamujsh nga minareja e xhamisë në Fushë Çelë e në Kambanarin e Kishës Françeskane.

Këtë e gjejmë të cituar edhe në artikullin e Zef Pashko Dedës, në gazetën “Atdheu”, të vitit 1978, e edhe në librin “Institucionet islame dhe hoxhallarët e Shkodrës”, të vitit 2005: “Në Shkodrën e vet historike dhe lavdiplote, pamvarësisht nga periudha të zymta e rrethana të turbullta, arrijti ma në fund në kohën e Tij, qi për çdo “28 Nandor” populli i Shkodrës pa dallim të shkojë e të falet së bashku në kishë dhe së bashku në xhami, dhe ndër festa fetare të njenës dhe tjetrës palë, me lidhë me flamuj

të vegjël dhe drita elektrike minaret e xhamive së Fushë Çelës me ato të kishave katolike.”

Bamirësia e Sali efendi Myftisë është një tjetër tipar i tij që ka mbetur në kujtesën e familjarëve. *“Baba ka qenë bamirës”,* thotë nëna ime Safetja, duke treguar se në kohën e Zogut ka strehuar familjen kosovare të Mujo Nikshiqit me 7 fëmijë. *“Ai i ka falë shtëpi me 4 dynym tokë, pranë shtëpisë së tij, i ka vendos në punë burrë e grua, dhe i ka ndihmu edhe për martesën e vajzave të tyre”,* vazhdon rrëfimin nëna.

Po sipas kujtimeve të vajzave të tij, *“Për çdo Ramazan ka ftu për iftar familje të ndryshme. Përveç kësaj, ka vendos në hajat (jashtë shtëpisë) një fuçi 100 litërshe me hardiç. E gjithë lagjja Ndocaj vinte me mbushë enët me këtë pije të shëndetshme e shumë të preferuar prej myslimanëve.”*

Përveçse përkushtimit ndaj fesë, tolerancës e bamirësisë, Sali efendi Myftija, kujtohet sot prej trashëgimtarëve të tij edhe si një njeri i ditur dhe i dhënë shumë pas librave dhe leximit. Në banesën e familjes Myftija deri pak vite pas arratisjes së Sali ef. Myftisë dhe djalit të tij Fuatit ka ekzistuar një fond i madh librash, kryesisht me përmbajtje fetare, në gjuhë të ndryshme, e që u morën dhe u dogjën pas bastisjes së banesës në vitet e para të regjimit komunist. Siç kujtojnë vajzat e tij, në shtëpi kanë pasur qindra libra e Kuranë, të cilat Sali ef. Myftija ua shpërndante besimtarëve.

Ai ishte i afërt, i dashur, i ëmbël me të gjithë, zotëronte një fjalor të pasur dhe kishte kënaqësi të bisedonte me rininë.

Këto pak kujtime janë përcjellë te nëna ime dhe motrat e saj kryesisht prej nënës së tyre, bashkëshortes së Sali Myftisë, Qamiles, e cila ka kaluar një kalvar vuajtjesh me internime dhe burgje... mirëpo nuk është mposhtur kurrë; i ka rritur dhe i ka edukuar fëmijët e saj si një fisnike e burrëshë. *“Ajo grua heroinë nuk ka vdek’ por ka plasë”,* thonë kështu sot vajzat e saj.

Gjyshja Qamile ka vdekur në vitin 1974, ndërsa gjyshi Sali efendi Myftija në mërgim, katër vjet më vonë, në vitin 1978. Siç rrëfejnë sot trashëgimtarët e tyre, *“Ai nuk e ka ditur për vdekjen e nënës, dhe as ne nuk kemi ditur vdekjen e babës. Kena pasë frikë me shkrue.”*

Kujtimet e familjarëve të Sali ef. Myftisë në Shkodër, lidhur me tiparet dhe virtytet e tij, janë shumë të ngjashme edhe me ato të mbesave të tij, Faridës dhe Lejlës, vajzat e djalit të madh, të ndjerit Fuat, i vetmi prej fëmijëve të Sali ef. Myftisë që pati fatin të jetonte më shumë kohë me të atin, për shkak se u arratisën dhe jetuan bashkë shumë vite në emigrim. Faridja dhe Lejla, me banim në Amerikë dhe Itali, në rrëfimet e tyre që më ofruan për këtë referim, e kujtojnë gjyshin e tyre me të cilin kaluan disa vite të fëmijërisë, pra si një figurë me ide përparimtare për kohën në të cilën jetoi.

Faridja shprehet se gjyshi gjithmonë i kishte thënë: *“Mos harro asnjëherë se je shqiptarë, se je shkodrane!”*. *“Dhe unë gjithmonë e kujtoj këtë, sidomos kur takoj shqiptarë të tjerë”*, thotë Feridja. Faridja, duke kujtuar gjithashtu natyrën bamirëse të gjyshit, thotë se në shtëpinë e tyre në Amerikë, kur jetonin me gjyshin, kishte gjithmonë shumë njerëz. *“Në Ramazan dyert e shtëpisë ishin të hapura për ata që nuk kishin”*, kujton Faridja.

Ndërsa mbesa tjetër, Lejla, rrëfen aspektin edukativ që ka marrë prej gjyshit Salih ef. Myftisë: *“Unë kam mësuar prej tij, që edhe pse mundet që mos të kesh shumë, ka gjithmonë njerëz që kanë më pak. Kështu që, jep çfarë të mundesh, dhe ndihmoji ata në nevojë!”*, kujton Lejla fjalët e gjyshit.

Një tjetër mbresë e pashlyeshme në kujtesën e Faridës dhe Lejlës është edhe dëshira e tij që shprehte me rastin e vdekjes, që te varri nuk donte lule dhe kurora, por ato shpenzime ishte më mirë të shkonin për xhaminë që ai drejtonte në Nju Jork. Dhe siç ato rrëfejnë: *“Në ditën e varrimit të tij ndodhi një fenomen i çuditshëm për ne që e dinim dëshirën e tij; kamioni me lule e kurora humbi rrugën dhe nuk mbërriti dot te varri i tij.”*.

Pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri figura e Sali efendi Myftisë është vlerësuar nga shteti dhe institucionet vendore në Shkodër. Me shumë gëzim dhe emocione është përcjellë prej familjarëve dhe të afërmeve të Salih ef. Myftisë dekorimi i tij prej presidentit Bamir Topi, dhe në vitin 2011 nga Këshilli Bashkiak Shkodër akordimi i titullit “Qytetar nderi i Shkodrës” - pas vdekjes.



Dekorata "Qytetar nderi i Shkodrës"

Këtë të fundit, nëna ime Safetja e ka në një kornizë të madhe në murin e dhomës së saj, dhe e ruan si relik të çmuar; mbase thotë fjalë të pathëna me babanë e saj, të cilin e deshi tepër po në heshtje.

Kujtimet e heshtura po flasin edhe sot, në këtë ditë kur ai përsëri po kujtohet, po vlerësohet, po nderohet, dhe të gjithë ne, edhe brezi më i ri (nipa e stërnipa), ndihemi krenarë.

Pasi i mblodha këto rrëfime të tri vajzave dhe të dy mbesave të Salih ef. Myftisë, mendova me vete:

Vallë, m'i kanë thënë të gjitha?! Vallë, a ua kanë rrëfyer edhe atyre, se sa i madh ishte ai njeri?! Nuk e di... Edhe këtë herë përgjigjja është një përgjigje... pa fjalë.

Jam më se e bindur se janë shumë e shumë fjalë të pathëna. Se janë shumë e shumë rrëfime që flasin edhe sot, me heshtje...

Mirëpo, jam gjithmonë krenare, si gjithë pasardhësit e Salih efendi Myftisë!

I përjetshëm qoftë kujtimi për të!

Bibliografi:

- Bala, S., Institucionet islame dhe hoxhallarët e Shkodrës, “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2005.
- Bushati, H., Shkodra dhe motet, Vëllimi II Shkodër, 2015.
- Bushati, H., Shkodra dhe motet, - Pema gjenealogjike e familjes shkodrane, Shtëpia Botuese “Idromeno”, Shkodër, 1999.
- Deda, Z. P., “Hirësia e tij, Salih Myftija, ish-kryemyfti i Shkodrës dhe i Kosovës, dhe udhëheqësi shpirtëror i myslimanëve shqiptarë në botën e lirë”, gazeta “Atdheu”, maj-qershor, 1978, VJ. XXVIII, Nr. 2 (53).
- Luli, F.; Dizdari, I.; Bushati, N., Në kujtim të brezave, Shkodër, 1997.
- Saraçi (Mulleti), F., Kalvari i grave në burgjet e komunizmit, Tiranë, 2013.
- Kujtime nga Safete Myftija (e bija e Salih efendi Myftisë).

Dr. Sadik MEHMETI
Instituti Albanologjik

ELITA INTELEKTUALE ISLAME NË SHKODËR NË KAPËRCYELL TË SHEKULLIT XX

Kumtesën time, në këtë Tryezë shkencore, të organizuar nga Instituti për Humtime dhe Studime Islame (IHSI), kushtuar jetës dhe veprës së hoxhës, immit dhe veprimtarit të çështjes kombëtare shkodranit Salih efendi Myftisë (1891-1978), e kam titulluar me një titull paksa gjithëpërfshirës *“Elita intelektuale islame në Shkodër në kapërcyell të shekullit XX”*, ndonëse, mbase edhe më mirë, do t’i kishte ndenjur dhe do të kishte ilustruar gjithë atë që synohet të thuhet titulli *“Elita intelektuale islame në Shkodër në kohën e Salih efendi Myftisë”*. Sidoqoftë, konsideroj se personaliteti i Salih efendi Myftisë, nuk mund të vështrohet veçan dhe meritueshëm në qoftë se nuk do të vështroheshin dy faktorë përcaktues dhe më me ndikim në formimin e personalitetit dhe veprimtarisë intelektuale dhe atdhetare të Salih efendiut.

Faktori i parë është ndikimi i drejtpërdrejtë i traditës kulturore të vendlindjes së tij - Shkodrës, traditë kjo e kultivuar për shekuj të tërë, kurse



*Salih efendi Myftija i Riu
(1891-1978)*

faktori i dytë është ndikimi i myderrizëve nga të cilët mori dije e mësimi Salih efendiu.

Prandaj pa njohjen, qoftë edhe kalimthi, të traditës kulturore të Shkodrës në kapërcyell të shekullit XX, më pastaj pa njohjen e historikut dhe të veprimtarisë në radhë të parë të institucioneve arsimore islame të Shkodrës dhe myderrizëve të tyre, nuk do të arrijmë të kuptojmë më mirë veprimtarinë dhe përcaktimin e mëpastajshëm fetar dhe kombëtar të Salih efendi Myftisë.

Themi kështu edhe sepse mendojmë se nuk mund të njihet e të vlerësohet, Salih efendiu – myderrizi i medresesë së Shkodrës, myftiu i Shkodrës dhe i prefekturës së Kosovës, e më pastaj edhe veprimtari i çështjes kombëtare kudo që jetoi, pa e njohur studentin Salih efendiu të birin e Adem efendiut të birit të Salih Efendisë së Madh (Plaku), dhe assesi nuk mund të njihet studenti Salih Myftija pa njohur veprimtarinë fetare dhe orientimin politikë të paraardhësve të tij (që po ashtu vinin nga elitat intelektuale shkodrane) dhe të profesorëve të tij.

Prandaj, themi me bindje, se Salih efendi Myftija (i Riu) u kalit dhe u formua si intelektual dhe si kombëtar pikërisht në kohën sa ishte studentë në *Medresenë “Mahmut Pasha”* të Shkodrës, në këtë institucion arsimor islam kombëtar që ka dhënë një kontribut jashtëzakonisht të madh në përgatitjen dhe formimin fetar dhe kombëtar të të studentëve të saj.

Shkodra në kohën e Salih efendiut (të Riut) ndërkaq, ka qenë një ndër qytetet me të pasura me një traditë kulturore e fetare dhe një ndër përfaqësueset më tipike të një qendre kulturore, në të cilën tradita fetare dhe tradita kombëtare shqiptare janë zhvilluar aq harmonishëm mes vete në të gjitha format e vetëdijes shoqërore, që e bënë këtë qytet një qendër veçanërisht të rëndësishme të trashëgimisë kulturore shqiptare, e gjithë kjo si-domos falë themelatave e vakëfeve të krijuara nga oxhaku i Bushatlinjve¹.

Me themelimin e shkollave, bibliotekave dhe duke qenë edhe vet intelektual dhe mecen të dijes e të shkencës, Bushatlinjtë u bënë nxitës dhe

¹ Më gjerësisht për Familjen e Bushatlinjve, shih: Hamdi Bushati, *Bushatllinjtë*, Tiranë 2003; *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, vëll. I, Tiranë, 2008, f. 341-343.

motor lëvizës të arsimit e të edukimit të përgjithshëm të Shkodrës dhe faktori kryesor për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të saj.

Një ndër investimet më të rëndësishme, mbase edhe më i rëndësishmi, që e bëri kjo familje fisnike në Shkodër, është ndërtimi dhe vakëfimi i “*Medresesë së Qafës*”², të cilën e ndërtoi veziri *Mehmet Pashë Plaku*, në gjysmën e shekullit XVIII. Kjo medrese meqë ishte ndërtuar në krahun e djathtë të rrugës së lagjes Qafë, në dokumente dhe në literaturë do të njihet me dy emra Medreseja e “*Mehmet pashë Plakut*” ose “*Medreseja e Qafës*” dhe punoi deri në vitin 1925.

Pak kohë pas të atit dhe sipas shembullit të tij, Kara Mahmut Pashë Bushati³, që është djali i dytë i vezirit Mehmet Pashë Plakut të sipërpërmendur themeloi një numër të madh të institucioneve fetare, arsimore, sociale e kulturore. Pranë medresesë, e cila njihet me disa emra, si “Me-

² Është ndërtuar nga veziri Mehmet Pashë Plaku – Bushati-Shkodra. Nuk i dihet viti i saktë i ndërtimit, por duke iu drejtuar kohës se kur sundoi si vezir ky vakëflënës, në vitet 1757-1775, korrespondon që edhe medreseja të ketë filluar punën brenda këtij harku kohor. Medreseja ka qenë ndërtuar në krahë të djathtë të rrugës së lagjes Qafë, në fund të kalasë Rozafa, në majë të një kodre. Sipas Hamdi Bushatit, medreseja paraqitet dykatëshe, me dimensione 30x15 metra. Ajokishte 11 dhoma, më e madhja prej të cilave shërbente si xhami. Kishte banjën dhe saranxhën e ujit, për mungesë të ujit të pijshëm. Me radhë ishin salla e studimit që quhej ders’hâne, një dhomë e myderrizëve, e cila quhej selamhâne. Disa dhoma ishin të caktuara për mësim, kurse disa të tjera për fjetjen e nxënësve që banonin aty. Në këtë medrese dhanë mësim një numër i madh i dijetarëve shqiptarë dhe nga Bota islame, dhe nxorri shumë ixhâzetlinj. Punoi si medrese deri në vitin 1925. Sot kjo medrese nuk ekziston. (Hamdi Bushati, *Shkodra dhe motet*, vëll. I, Shkodër, 1999, f. 88).

³ Kara Mahmut Pashë Bushati-Shkodra, (1749 ose 1754? – 1796) - Është djali i dytë i vezirit Mehmet Pashë Plakut -Bushatit. Ka themeluar një numër të madh të institucioneve fetare, arsimore, sociale e kulturore. Pranë medresesë, e cila njihet me disa emra, si “Medreseja e Pazarit”, medreseja e “Kara Mahmut Pashës”, Medreseja e Mahmut Pashës”, “Medreseja e Merqezit (Qendrës) dhe “Medreseja e Poshtme”, ka themeluar edhe një bibliotekë, me një fond të madh të dorëshkrimeve dhe librave të botuar. Medreseja gjendej pranë Xhamisë së Madhe të cilën e xhami e kishte ndërtuar i ati i tij, Mehmet Pashë Plaku. Kjo medrese ka qenë dykatëshe me një numër të konsiderueshëm të dhomave të mësimi dhe të fjetjes. Xhami, medreseja dhe biblioteka, formonin një kompleks në trajtë kuadrati; bashkë me sheshin në mjedis, ku ishte edhe bunari me ujë të pijshëm. Kjo medrese sot nuk ekziston. (Hamdi Bushati, *Shkodra dhe motet*, vëll. I, Shkodër, 1999, f. 90-91).

dreseja e Pazarit”, Medreseja e “Kara Mahmut Pashës”, “Medreseja e Mahmut Pashës”, “Medreseja e Merqezit (Qendrës)” dhe “Medreseja e Poshtme”, ka themeluar edhe një bibliotekë, me një fond të madh të dorë-shkrimeve dhe librave të botuar. Medreseja gjendej pranë Xhamisë së Madhe të cilën xhami e kishte ndërtuar i ati i tij, Mehmet Pashë Plaku.

Një pinjoll tjetër i kësaj familjeje fisnike e bujare shkodrane, veziri *Mustafa pashë Bushati*⁴, duke dashur që të ngrejë lartë autoritetin e medreseve që kishin themeluar të parët e tij dhe si mecen i dijes dhe i shkencës që ishte, me të kuptuar për aftësitë, kualifikimet dhe autoritetin intelektual që posedonte në Stamboll Salih efendi Ibrahim Shkodrani (Plaku) me rrënjë nga Kraja⁵, e solli atë në vendlindje dhe emëroi myderriz në Medresenë e Pazarit. Në të vërtetë, Salih efendi Ibrahim i sipërpërmendur jo vetëm se u emërua myderriz në këtë medrese dhe jo vetëm se nga Stambolli solli një bibliotekë të pasur, por me punën dhe angazhimin e tij dhe me planprogramet e aplikuara sipas metodave të medreseve të famshme të “Fatihut” në Stamboll, që ishin në rangun e fakulteteve, arriti që arsimin në Shkodrën e kësaj kohe ta ngrejë në një nivel tjetër. Se çfarë njohurish zotëronte dhe çfarë dije kishte ky myderriz, më së miri tregon epiteti të cilin ia dhanë studentët, kolegët, intelektualët dhe bashkëkohanikët e tij duke e cilësuar me emrin e popullarizuar *Salih Efendija i Madh*, aq sa ky emër u bë edhe emri zyrtar i tij, me të cilin përmendet edhe nëpër dokumente dhe më të cilin vazhdon edhe sot e kësaj dite të

⁴ Mustafë Pashë Bushati (1796-1860), sundimtari i fundit i dinastisë së Bushatlinjve. Erdhi në fuqi më 1812 dhe nga atëherë e deri në fund ndoqi politikën tradicionale të Bushatlinjve për autonomi të pashallëkut të Shkodrës. La disa themelta. Ishte dashamirë dhe përkrahës i dijes dhe i shkencës.

⁵ *Salih Efendija i Madh (? – 1866)* – lindi në lagjen Ndocej të Shkodrës. Mësimet e para i mori në mektebin e lagjes, kurse të mesmet i vazhdoi në Medresenë e Qafës po në Shkodër. Studimet e larta i mbaroi në Stamboll. Në vitin 1831 u emërua myderriz po në Stamboll. Mirëpo, me insistimin e vezirit Mustafë Pashë Bushatit, kthehet në vendlindje dhe filloi punën si myderriz në Medresenë e Pazarit të Vjetër, ku nxori shumë ixhâzetlinj, ndër ta edhe Jusuf ef. Tabakun, Hasan ef. Podgoricën, Ahmet ef. Kalajën etj. Shquhej për dije dhe autoritet. Dha një kontribut të çmuar në jetën fetare arsimore të Shkodrës me rrethinë. Vdiq më 1866 dhe u varros në varrezat e lagjes Ndocej. Është i ati i myftiut të Shkodrës Adem Vehbi efendiut (*shih*) dhe gjyshi i myderrizit të Shkodrës, Tahir efendi Myftiut (*shih*).

kujtohet ndër njerëz. E pikërisht ky Salih Efendija i Madh, që i dha vulë arsimit në Shkodër dhe që ndërroi jetë në vitin 1866, është gjyshi i Salih efendi Myftisë tonë (të Riut) që e ripërtërirë emrin e gjyshit të tij.

Medresetë e Shkodrës prandaj, në saje të nivelit të lartë intelektual të myderrizëve të tyre, shquheshin edhe në Stamboll. Shumë studentë të medreseve të Shkodrës regjistroheshin pa asnjë pengesë për të vazhduar specializimet në “Medresetë e Fatihut”.

Mbështetur në plan-programet mësimore të këtyre medreseve, si dhe në nivelin mjaft të lartë profesional e intelektual të profesorëve që jepnin mësim në to, këto medrese krijuan një shtresë intelektuale fetare e akademike të admirueshme, madje edhe përtej hapësirave shqiptare e deri në Stamboll. Në medresetë e Shkodrës janë kopjuar, komentuar e krijuar vepra të shumta, fushash dhe disiplinash të ndryshme fetare, shkencore, e letrare, përfshirë edhe letërsinë shqipe me alfabet arab, dhe luajtën rolin e qendrave kulturore e kombëtare shqiptare, ku u edukuan fetarisht dhe kombëtarisht disa gjenerata; këto medrese kanë shërbyer si vendtakim i shumë ideologëve patriotë e prijësve atdhetarë dhe nga aty kanë dalë edhe iniciativat për mbrojtjen kombëtare dhe për rezistencën e rreptë ndaj politikës antishqiptare malazeze. Kujtojmë këtu kontributin dhe rolin e tyre aktiv në jetën politike e patriotike jo vetëm për Lëvizjen Kombëtare, por edhe për mbrojtjen e Shkodrës nga malazeztë në periudha të ndryshme, pastaj si prijës dhe anëtarë të Degës së Lidhjes së Prizrenit, firmëtarë të protestës së shqiptarëve dërguar Kongresit të Berlinit etj.

Në këto medrese dhanë mësim dhe nga aty dolën breza të tërë dijetarësh, si: *Daut Boriqi dhe vëllai i tij, Shefqet Boriqi, Jusuf ef. Tabaku*, djali i tij *Abdullah ef. Tabaku*, *Hasan ef. Podgorica*, *Haxhi Idriz ef. Boksi*, *Hafiz Abdurrahman ef. Begu i biri i Osman Dervish Begut*, i derës së bushatlinjve, *Hafiz Halit ef. Beg Bushati*, *Hafiz Hasan ef. Haxhi Osman Aga - Lohaj*, *Haxhi hafiz Ibrahim Kaduku*, *Hafiz Jusuf ef. Kaduku*, *Ahmet efendi Kalaja* e shumë të tjerë përmendja e të cilëve do të shkonte gjatë⁶.

⁶ Më gjerësisht për jetën dhe veprën e këtyre dijetarëve, shih: Shih: Sadik Mehmeti – Hatixhe Ahmedi-Ramadan Shkodra, *Dijetarët shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912)*, sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman, Prishtinë, 2020, f. ?????;

Mirëpo, me këtë rast nuk mund të mos i përmendi edhe dy personalitete të rëndësishme të Shkodrës së kësaj kohe dhe më vonë, të cilët morën mësim në “Medresenë e Qafës” dhe në “Medresenë e Pazarit”, u bënë myderriz të tyre dhe më pastaj edhe u shquan në udhëheqjen e institucioneve dhe patën një veprimtari të begatë në fushën arsimore dhe kulturore dhe të cilët janë shumë të rëndësishëm për këtë vështrim tonin, sepse edhe patën ndikim vendimtarë në formimin intelektual të Salih efendi Myftisë (i Riu) e për të cilin po bëjmë fjalë.

Ata janë *Adem efendiu i biri i të sipërpërmendurit Salih Efendisë së Madh (Plakut)* (gjyshi i Salih efendiut tonë) dhe *Tahir efendiu i biri i Adem efendiut* dhe vëllai i Salih efendiut tonë.

Në të vërtetë, të dhënat që po i paraqesim këtu për këta dy personalitete të shquara të dijes e të kulturës jo vetëm në Shkodër, janë nxjerrë nga dosjet e tyre personale në gjuhën osmane që ruhen në *Arkivin e Meshihatit të Lartë Osman të Stambollit*⁷, e të cilat së bashku me kolegët Hatixhe Ahmedi dhe Ramadan Shkodra i kemi hulumtuar dhe më pastaj edhe i kemi deshifruar, përkthyer e trajtuar në veprën “*Dijetarët shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912), sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman*”⁸, nga ku edhe këto të dhënat po i paraqesim në vazhdim.

- *Adem efendi Salih efendiu i Madh* - U lind më 18 mars 1851 në lagjen Ndocej të qytetit të Shkodrës ku banonte kjo familje. Pasi krye shkolllën fillore e kreu në mektebin e xhamisë së mëhallës së tij, studimet i vazhdoi në “Medresenë e Qafës” të myderrizi fort i njohur Hasan efendi Podgorica⁹, tek i cili ndoqi mësimet deri në lëndën/nivelin “Mulla Xhâ-

Hamdi Bushati, *Shkodra dhe motet*, vëll. I, Shkodër, 1999, f. 88); Smajl Bala, *Institucionet islame dhe hoxhallarët e Shkodrës*, Shkodër, 2005; Grup autorësh, *100 personalitete shqiptare të kulturës islame (shek. XIX-XX)*, Tiranë, 2012.

⁷ Arshiv Meşihat-i Aliyye-i Osmaniyye, me numrat e dosjeve 4918, përkatësisht dosja me nr. 4919. Këto dokumente në formë digjitale ruhen edhe në *Arkivin e ISAM-it (Türkiye Diyanet Vakfı İslam Arştlmaları Merkezi)*, më numër të njëjtë të dosjeve.

⁸ Shih: Sadik Mehmeti - Hatixhe Ahmedi-Ramadan Shkodra, *Dijetarët shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912), sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman*, Prishtinë, 2020.

⁹ Hasan Hysni efendi Podgorica (1830-1901) – lindi në Podgoricë. Studimet i kreu në Shkodër, në Medresenë e Qafës, te myderriz Salih efendi i Madh. U emërua myderriz

mî”¹⁰. Në këtë kohë, myderriz Hasan efendiu ndërroi jetë dhe në vend të tij erdhi profesori “dersiâm” i Shkodrës, haxhi Selim efendiu. Kështu që Adem efendiu u transferua në rrethet mësimore të tij dhe i ndoqi mësimet deri në fund të veprës nga logjika “Tasdîkât”.

Për t’i plotësuar studimet e tij, shkoi në Stamboll dhe hyri në rrethet mësimore të profesorit të njohur, Shevket efendi Stambolli, tek i cili ndoqi mësimet deri në lëndën e apolojetikës islame. Pas kësaj, u kthye në vendlindje dhe hyri në rrethet mësimore të myderrizit hafiz Mehmet Seid efendiut, tek i cili me të përfunduar lëndët e parapara me programin e ixhâzetit, e mori edhe diplomën.

Menjëherë pas diplomimit, si kuadër i përgatitur që ishte, u angazhua myderriz në “Medresenë e Qafës”, ku arriti t’i nxirrte me ixâzet dymbëdhjetë studentë të tij.


Në vitin 1892 u emërua anëtar i Komisionit të Administratës Qendrore të Vilajetit të Shkodrës, ku qëndroi deri më 30 mars 1905. Ndërsa ishte në këtë detyrë, në vitin 1904, ndërroi jetë myftiu i Shkodrës, Jusuf ef. Tabaku. Kështu, më 30 mars 1905, me përzgjedhjen unanime të parisë dhe ulemave të Shkodrës dhe me dekret të lartë nga Stambolli, Adem efendiu u emërua myfti i gjithë Vilajetit të Shkodrës.

Me qëndrimet e tij si myfti u shqua dhe ishte i vendosur në mbrojtje të vendit, si ndaj presioneve të jashtme, ashtu edhe të brendshme. Ai u tre-gua patriot i vërtetë me rastin e rrethimit të Shkodrës nga forcat aleate malazeze dhe serbe (28 tetor 1912 - 23 prill 1913), kur i kërkuan që të dorëzohej Shkodra. Ai protestoi dhe nuk pranoi.

në Medresenë e Pazarit të Vjetër në Shkodër. Nxori shumë ixhazetlinj, ndër ta edhe Hafiz Ali Riza ef. Ulqinakun, hafiz Halit ef. Bushatin, mulla Veli ef. Anamalin etj. Shërbeu edhe si imam në Xhaminë e Begas. Ishte pjesëmarrës edhe në ngjarjet politike të kohës dhe një nga firmëtarët e protestës së shqiptarëve dërguar Kongresit të Berlinit, më 15 qershor 1878. Ka lënë në dorëshkrim disa vepra. Vdiq në Shkodër më 1901.

¹⁰ “Mullaxhamia” është gramatikë e gjerë e gjuhës arabe dhe zhvillohet në gjuhën arabe. Njihet sipas emrit të autorit *Mulla Abdurrahman Xhamiu* (Mevlânâ ‘Abdurrahmân b. Ahmed el-Xhâmî, vd. 898/1492). Titulli i saktë i kësaj vepre është “*el-Favâid ed-Di-jâijje*”. “*Mullaxhamia*” në të vërtetë është komentim i veprës së Ibn Haxhibit në fu-shën e sintaksës së gjuhës arabe.

Në veprën *“Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)”*, Tiranë, 2000, të Sejfi Vllamasit, autori, duke analizuar gjendjen në Shkodër gjatë Luftës Ballkanike, mes tjerash, shkruan: *“...mbi kontradiktat e vjetra dhe të reja që kishin krijuar anarki në Shkodër, si Esati (Toptani-vër. jonë) dhe xhonturqit që zhvillonin një aktivitet të madh për të kthyer situatën në favor të vetin, të tezave të xhonturqve për “Bashkimin e Shqipërisë me Turqinë”, Myftiu i Shkodrës, Adem Efendija, iu përgjigj Beqir Grepenesë: “Ne Turqinë s’mundëm me e mbajtë kur e kishim këtu e jo ta biem prapë. Një pretendim i tillë na skandalizon përpara opinionit botëror”*.



Tahir efendi Myftiu

Adem efendiu nuk pranoi as propozimin tjetër që iu bë nga Riza beg Kopliku e hfz. Durro Begu për të dorëzuar Shkodrën. Falë këtij refuzimi të Adem ef. Myftisë, ky propozim dhe kjo iniciativë dështuan.

Adem efendiu qëndroi në pozitën e myftiut të Shkodrës deri në qershor 1914, kur vendin e tij e zuri djali i tij, Tahir efendiu. Adem efendi, ndërroi jetë në vitin 1919¹¹ dhe pas vete la tre djem të cilët ndoqën rrugën e tij: Tahir efendiu, Halil efendiu dhe Salih efendiu tonë.

- *Tahir efendi Salih efendiu i Madh*, u lind më 23 maj 1872. Pasi kreu shkollën fillore në mektebin, mësimet i vazhdoi në Shkollën e Mesme të Administratës (rushdije-i mylkije) të Shkodrës, të cilën e mbaroi me sukses të lartë më 1885.


¹¹ Më gjerësisht për Adem efendiu, shih: Sadik Mehmeti - Hatixhe Ahmedi-Ramadan Shkodra, *Dijetarët shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912)*, sipas dokumenteve të Mehshahit të Lartë Osman, Prishtinë, 2020, f. ?????; Smajl Bala, *Institucionet islame dhe hoxhallarët e Shkodrës*, Shkodër, 2005, f. 16-18.

Studimet i vazhdoi në rrethet mësimore te myderrizi dhe i ati i tij njëkohësisht, Adem efendiu. Për t'i plotësuar studimet, shkoi në Stamboll dhe në kompleksin e “Fâtihut” u regjistrua në grupin e studentëve të profesorit të leksioneve publike (“dersiâm”), haxhi Zejnulabidin efendi nga Allasonja, tek i cili në vitin 1900 e mori edhe ixhâzetnâmenë e përgjithshme. Gjithashtu, mori ixhâzet edhe nga fusha e së drejtës së trashëgimisë islame te myderrizi Sherif ef. nga Amasija, i cili, më 1899, ia dha edhe diplomën e veçantë për këtë fushë.

Në vitin 1903 u kthye në Shkodër dhe u emërua myderriz në Medresenë e “Mehmet Pashës”. Këtu ligjëroi lëndët: logjikën, jurisprudencën islame, metrikën dhe rregullat e gjuhës perse.

Në vitin 1910 u emërua anëtar i Komisionit Arsimor të Drejtorisë Arsimore të Shkodrës.

Në vitin 1914 emërohet kryemyfti i zonës së Shkodrës, në vend të babait të tij, Adem efendiut. Në këtë detyrë qëndroi deri në vitin 1923. Në vitin 1929, me dekret mbretëror nga Zogu I, emërohet përsëri kryemyfti i Shkodrës, ku qëndroi deri në vitin 1930. Tahir efendi Myftija ndërroi jetë më 25 qershor 1930.



Si përfundim, mund të themi se Salih efendi Myftija (i Riu) u rrit dhe u edukua fetarisht dhe kombëtarisht në një familje intelektualësh dhe në një qark kulturor jashtëzakonisht aktiv. Salih efendiu me dijen dhe veprimtarinë e tij s'do mend se do të bëhej pjesë e këtij qarku kulturor dhe një nga anëtarët më të denjë të tij, deri kur ky Qark kulturor shumë karakteristik dhe i veçantë, e mbylli ciklin e tij, si pasojë e vendosjes së sistemit të ri dhe të krijimit të rrethanave të reja pas Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

Literatura:

- Hamdi Bushati, *Bushatllinjtë*, Tiranë 2003.
- *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, vëll. I, Tiranë, 2008, f. 341-343.
- Hamdi Bushati, *Shkodra dhe motet*, vëll. I, Shkodër, 1999.
- Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmed, Ramadan Shkodra, *Dijetarët shqiptarë në Perandorinë Osmane (1880-1912)*, sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman, Prishtinë, 2020.
- Smajl Bala, *Institucionet islame dhe hoxhallarët e Shkodrës*, Shkodër, 2005.
- Grup autorësh, *100 personalitete shqiptare të kulturës islame (shek. XIX-XX)*, Tiranë, 2012.

Akademik Muhamed MUFAKU

**KONTRIBUTI I SALIH EF. MYFTISË
NË RIGRUPIMIN DHE ORGANIZIMIN
E MËRGATËS ANTIKOMUNISTE
NË LINDJEN E MESME (1947-1965)**

Më lejoni që në fillim ta falënderoj Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame pranë Bashkësisë Islame të Kosovës për organizimin e kësaj tryeze shkencore për figurën e njohur fetare e kombëtare Salih efendi Myftisë (1891-1978), i cili e ka merituar qëmoti jo vetëm një tryezë shkencore, por edhe më shumë. E vërtetë është se Salih efendi Myftija u nderua dhe u dekorua në raste të ndryshme, në fillim në mërgim, e më vonë edhe në Shqipërinë demokratike, dhe u prezantua në shkrime të ndryshme, mirëpo vërtet ende kemi një boshllëk për një periudhë të rëndësishme të jetës dhe të aktivitetit të tij fetar e kombëtar në Lindjen e Mesme (1947-1965), i cili kontribut nuk përmendet fare, ose shënohet vetëm me disa rreshta.¹ Prandaj, kam shpresë se me këtë kumtesë dhe me këtë tryezë t'i kushtohet më shumë interesim atij, për ato “vite të mjeçulluara” që meritojnë një monografi ose një temë magjistrature nga një studiues i ri, në bazë të burimeve siriane e egjiptiane të kohës.

Personaliteti i Salih Muftisë (1891-1978) përmbledh dy figura që u formuan në saje të zhvillimeve historike të kohës, përkatësisht si hoxhë Salih Muftija, që u shqua si drejtor i Medresesë së Re në Shkodër, dhe si

¹ Mexhid Yvejsi, *101 Personalitete fetare- atdhetare, kulturore-letrare*, Prishtinë (Instituti për Shkencat Islame *Ibn Sina*) 2013, f.62-66; 100 Personalitete shqiptare të kulturës islame, botimi i dytë, Tiranë (Komuniteti Mysliman i Shqipërisë) 2013, ff.213-216.

Myfti i Shkodrës (1931-1939), po edhe si atdhetar gjatë okupimit fashist apo edhe si aktivist anti-komunist në mërgatën shqiptare në Lindjen e Mesme (1947-1965) dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (1965-1978).

Salih Myftija u lind në Shkodër në një familje të njohur fetare, ku e kreu medresenë, e më vonë shkoi në Vlorë, për të përvetësuar më shumë dituri të myftiu Vehbi Dibra.² Me reformimin e arsimit pas stabilitetit të Shqipërisë, më 1920, në Shkodër u themelua Medreseja e Re, me program të ngjeshur laik-fetar, në krye me Salih Myftijën, e cila u bë qendër e rëndësishme arsimore, pasi drejtori S. Myftija “tërhoqi klerikë të mirënjohur”. Në vitin 1931 u emërua kryemyfti i zonës së Shkodrës dhe të Kosovës (që përfshinte Kukësin, Hasin, Krumën dhe Tropojën), punë që e kreu deri më 1939.³ Me pushtimin e Shqipërisë më 7 prill 1939 u paraqit figura atdhetare e Salih Muftisë, pasi u arrestua si kundërshtar dhe u internua në Kalanë e Gjirokastrës. Si pasojë Salih Myftija u shndërrua në një figurë atdhetare, duke apeluar dhe duke organizuar rezistencë.⁴ Në këtë kontekst Salih Myftija mori pjesë në themelimin e partisë “Lëvizja e Legalitetit”, në krye me Abas Kupin, më 21 nëntor 1943, ku do të mbetet figurë e shquar deri në vdekje.

Në vjeshtë 1944, me paraqitjen e rrezikut të sundimit komunist, Salih Myftija si shumë atdhetarë të tjerë, u detyrua të largohet nga vendi, duke kaluar në Itali, e që ishte atëherë ishte nën kontrollin e aleatëve. Në fillim u vendos përkohësisht në kampin Grumo, në Bari, kurse më vonë kaloi në kampin Reggio Emilia, ku u grumbulluan shumë politikanë e ushtarakë shqiptarë, duke kaluar aty dy vjet, deri në vitin 1947.

Në atë kohë u bë kthesë në mërgatën shqiptare, sidomos me kalimin e mbretit Ahmet Zogu nga Londra, ku jetonte si person privat me shpenzimet e veta⁵, e në Kajro ku u trajtua si mbret legjitim dhe iu dha në dispozitim Ambasada shqiptare e paraluftës, situata shkoi ashtu që Kajroja u

² Sali efendi Myftia, *personalitet i shquar fetar dhe kombëtar*, Zani i Naltë, Tiranë 7.01. 2020.

³ Hamdi Bushati, *Shodra dhe motet*, vëll. 2, Shkodër (Idromeno) 1999, ff. 224-225.

⁴ Sali efendi Myftia, *personalitet i shquar fetar dhe kombëtar*.

⁵ Yveysi, 101 personalitete, f.264.

shndërrua shumë shpejt në qendër të rigrupimit të mërgatës dhe të organizimit të rezistencës shqiptare antikomuniste në rajon.



Ç'është e vërteta, ShBA-të dhe Britania e Madhe, gjatë Luftës së Dytë Botërore e injoruan Ahmet Zogun, për shkak të zotimeve të tyre ndaj Greqisë dhe Bashkimit Sovjetik. Kështu që, Londra refuzoi ta pranojë Zogun si mbret në *ekzil*, sikurse të tjerët në Evropën e mesme; madje ia kushtëzuan qëndrimin e tij në Londër si person privat, me moslejimin e asnjë veprimtarie a deklarate politike.⁶ Mirëpo, me fillimin e Luftës së ftohtë më 1946 dhe shpërthimin e luftës civile në Greqi (1946-1949), mbreti Ahmet Zogu parandjeu ndryshimet që do të vijonin në rajon, dhe e pa të udhës shpëtimin e elitës politike-ushtarake nga kampet e refugjatëve në Itali, ku jetonin në kushte të rënda. Këtë e arriti duke e shfrytëzuar miqësinë e tij

⁶ Më shumë për qëndrimin e Zogut në Londër dhe kufizimet e aktivitetit të tij shih: Neil Rees, *Mërgimi mbretëror: mbreti Zog dhe mbretëresha Geraldina*, përktheu Xhevat Lloshi, Turanë (United Bible Societies) 2011.

me shtetarët arabë (mbreti egjiptian Farukun, mbretin jordanez Abdullahun, kryetarin sirian Shukri Al Quvatli etj.), që t'i pranojnë këta refugjatë në vendet e tyre. Këta burrështetas shprehën gatishmërinë që të afrojnë ndihma financiare për këtë elitë shqiptarë, madje mbreti Faruk ofroi anije që t'i transportonte shqiptarët nga Italia deri në portet e vendeve arabe.⁷ Ç'është e vërteta, kjo iniciativë ishte pjesë e një vizion largpamës të Zogut, sipas të cilit ai me sjelljen e elitës politike-shqiptare në vendet arabe, dhe me ndihmën e tyre, mund të përgatitej për çlirimin e Shqipërisë nga regjimi komunist, siç dëshmonte mbretëresha Xheraldinë, e cila që e pranishme në shumë biseda të Zogut me krerët shqiptarë dhe shtetarët arabë.⁸

Për këtë mision mbreti Zogu e dërgoi në Itali kryeadjutantit e tij, Hysen Selmanin, në verë të vitit 1947, për t'u takuar me elitën politike-ushtarake shqiptare në kampet e refugjatëve, me qëllim që të formohej një komitet kombëtar prej të gjitha partive, e që do të merrej me organizimin e dërgimit të refugjatëve shqiptarë për në vendet arabe, mirëpo që *de facto* u bë bërthamë e një komiteti politik (Shqipëria e Lirë), i cili që do të formohej më 1949. Kështu, në këto takime me përfaqësuesit e partive politike në kampet e refugjatëve na paraqitet Salih Myftija, si përfaqësues i legalitetit në takimin e mbajtur në kampin Reggio Emilia, më 7 shtator 1947, me Hysen Selmainin, në të cilin morën pjesë rreth 100 persona, kurse më 17 shtator 1947 u mbajt takimi për t'i aprovuar anëtarët e "Komitetit të refugjatëve", e që sipas fjalëve të Hiqmet Delvinës, ky takim "mori rolin e komitetit politik që të afroje gjithë kontributin dhe sakrificat për hir të interesave të larta të atdheut". Në krye të këtij komiteti ishte Mithat Frashëri (me propozim të Zogut), kurse si anëtarë pasojnë Salih Myftija, Ernest Koliqi, Ali Këlcyra, Koço Muka, Dr. Qemal Jusufati, Rakip Frashëri dhe Vasil Andoni.⁹

⁷ Hysn Selmani, *Nga notimet e Zogut I Mbretit të shqiptarëve*, Tiranë 2008

⁸ Pjesa e këtij libri që ka të bëjë me Lindjen e mesme u botua në arabisht në Bejrut më 2015:

من مذكرات ملك ألبانيا أحمد زوغو في مصر ١٩٤٦-١٩٥٥ ، ترجمة وتقديم محمد م. الأرنؤوط ، بيروت (جداول) ٢٠١٥ ، ص ٤٩-٥٠.

⁹ Selmani, *Nga notimet e Zogut I-Mbretit të shqiptarëve*, botimi arab, ff.70-71.

Më t'u kthyer në Aleksandri, që u bë selia e Pallatit Mbretëror, Hysen Selmani informoi mbretin për formimin e Komitetit për refugjatët, dhe u vendos të fillojë aksioni për ardhjen e tyre. Kështu, më 22 tetor 1947 arritën me anije në Aleksandri anëtarët e komitetit, në krye me Salih Myftinë. Pasi u takuan me mbretin Zog, anëtarët e komitetit, në krye me Salih Myftinë, pasi Mitat Frashëri për arsye objektive nuk erdhi, shkuan në Siri, ku u takuan me kryetarin e Republikës Shukri Al Quvatli. Sipas Hysen Selmanit, anëtarët e komitetit “ishin të kënaqur me atë që e dëgjuaam prej kryetarit, mirëpo nuk ishin të kënaqur me sjelljen e “autoriteteve”, sepse refugjatët e arritur në Damask nuk e ndjenin veten mirë, sepse nuk u siguroa puna atje, ndonëse në mesin e tyre kishte inxhinierë, profesorë, agromomë etj.”¹⁰

Këtu vlen të përmendet se gjatë qëndrimit të tij në kampet e refugjatëve në Itali Hysen Selmani u takua edhe prijësit e Grupit Kosovar, në krye me Xhafer Devën, Xhelal Mitrovicën dhe Tahir Zaimin, si dhe me Salih Myftinë, si përfaqësues i Legalitetit. Me shkuarjen e anëtarëve të Komitetit për refugjatët në Damask, në krye me Salih Myftinë, në tetor 1947, dhe takimi i tyre me kryetarin sirian Shukri Al Quvatli, Salih Myftija u akreditua që t'ua paraqesë autoriteteve siriane listat me emrat e refugjatëve shqiptarë që dëshironin të shkonin në Siri, dhe t'ua merrte dokumentet e udhëtimit që pranoheshin nga autoritetet siriane. Kështu, gjatë qëndrimit të tij në Damask erdhën, në këtë mënyrë, krerët e Grupit Kosovar: Xhafer Deva, Rexhep Krasniqi dhe Tahir Zaimi, të cilët në fillim të vitit 1948 e nxorën edhe gazetën *Bashkimi i Kombit*.¹¹

Siç shihet nga burimet, Salih Myftija kishte mbetur një kohë në Damask, për të sjellë më shumë refugjatë shqiptarë nga kampet e Italisë. Me atë autoritet që e kishte ai në atë kohë ia paraqiti ministrit të Brendshëm sirian listat me emra të atyre që dëshironin të vinin në Siri, duke kërkuar që ata të pajiseshin me dokumente udhëtimi, që pranohen nga autoritetet siriane, dhe kjo ndodhi. Kështu, në një kërkesë që e kemi në dispozicion, Salih Myftija e paraqet një liste me rreth 100 figura të elitës civile e ush-

¹⁰ Po aty, f.83-84.

¹¹ Selmani, *Nga notimet e mbretit Zog I*, botimi arab, f. 86.

tarake shqiptare që dëshironin të shkonin në Siri, me një notë në arabishte të pastër, me dorën e tij, që e lut ministrin që “këta të poshtëshënuar në listë të shpejtohen me dhënien e dokumenteve të udhëtimit, sepse kanë më shumë nevojë për to”, duke e nënshkruar në fund si “Myfti i Shqipërisë”.¹² Ai mbeti për një kohë në Damask, për ta përcjellë gjendjen e refugjatëve shqiptarë atje. Sipas kujtimeve të djalit të tij, Dr. Fuad Myftija, i cili edhe e shoqëronte në Damask, ai tanimë kishte lidhje të mirë me presidentin sirian Shukri Al Quvatli. Kështu që, ai e përshkruan gjendjen e rëndë të refugjatëve shqiptarë, të cilët gëzonin njëfarë ndihmë nga qeveria, si dhe shton e thotë se qeveria siriane nuk kishte mjete të mjaftueshme, për çka edhe “nuk u realizuan premtimet në disa raste”.¹³ Megjithatë, në sajë të lidhjes së tij me presidentin sirian, ai kishte autoritet që t’ua dërgojë refugjatëve shqiptarë në Itali dhe në Greqi dokumentet e udhëtimit që pranoreshin në Siri, sipas marrëveshjes me autoritetet siriane. Kështu që, në nëntor të vitit 1947, në Pallatin Mbretëror në Aleksandri arriti një letër prej myftiut Salih Myftija, e cila vinte nga Damasku, ku tregohej se koloneli Fiqri Dina u paraqit nga Greqia me kërkesë që të vinte në Siri me 700 refugjatë shqiptarë nga Greqia, dhe pyeste: “A t’ua dërgojmë dokumentet e udhëtimit që i pranojnë autoritetet lokale këtu, apo t’ua kërkojmë që mos të vijnë, në bazë të urdhrave të mëparshme?”¹⁴.

Përgjigjja ishte negative, pra për shtyrjen e ardhjes, sepse mbreti Zog me një parashikim e pa se rajoni po futej në tensione si pasojë e përleshjeve midis arabëve dhe hebrenjve në Palestinë, sepse me ardhjen e refugjatëve palestinezë në Amman e Damask autoritetet lokale nuk ishin më në gjendje t’i përmbushin premtimet për refugjatët shqiptarë. Prandaj, mbreti Zogu filloi të konsultohet me Organizatën Ndërkombëtare për Re-

¹² Idriz Lamaj, *Xhafer Deva në dritën e letrave dhe zbulesa të tjera të mërgatës*, New York 2002, f.8.

¹³ Dokumenti në fjalë është nga arkivi i Shefqet Gavuqit(1918-2020),që atëherë ishte përfaqësues i Mbretit Zogu në Siri për çështje të refugjatëve, që ma la në dispozicion më 2010 për ta përgatitur Kujtimet e tij në arabisht, u botuan në Bejrut 2011.

¹⁴ Fuad Myftia,intervistë me Dalip Grecën,"Illyria" New York 20 shkurt 2007.Me këtë rast D. Greca ia dërgoi mikut Elez Osmani materialin "bruto" që realizoi me Fuad Morinën, i cili ma dërgoi një kopje për çka e falwnderoj.

fugjatët (IRO), e themeluar më 1947, për transportimin e refugjatëve shqiptarë nga Lindja e Mesme në vende të tjera, sikurse ishin ShBA-të, Kanadaj dhe Australia.¹⁵

Mirëpo, me kalimin e kohës gjendja e refugjatëve shqiptarë në Damask u keqësua me ardhjen e refugjatëve palestinezë dhe mungesën e mjeteve financiare qeveritare siriane për ta. Kështu, më 15 janar 1948 në Pallatin Mbretëror në Aleksandri erdhi një letër prej intelektualit Salih Myftija, në emër të Komitetit për refugjatët nga Damasku, në të cilën ankohej për gjendjen atje: “Tani erdhën në Siri më shumë se 2000 refugjatë palestinezë, dhe nuk dinë ç’të ofrojnë për ne. Ne kemi 500 refugjatë shqiptarë në gjendje të rëndë. Ekselencia e tij, presidenti Shukri Al Quvatli nuk kursen interesim për ne, por ata nuk kanë më mjete në buxhet për të shpenzuar. Ju lutemi ndërmerrni diçka urgjentisht!”.¹⁶ Si pasojë, mbreti Zogu u takua atë ditë me z. Peterson, përgjegjësin për refugjatët në Evropë në IRO, i cili u zotua se për refugjatët shqiptarë do të siguronte strehim në Nju Zeland, Australi, Kanada etj.¹⁷

Gjatë qëndrimit të tij në Damask, në vitet 1947-1948, Salih ef. Myftija kishte edhe përgjegjësi politike, si një ndër krerët e partisë së Legalitetit. Në mesin e refugjatëve shqiptarë në Damask vepronin tri parti kryesore: e Legalitetit, Balli Kombëtar dhe Grupi Kosovar. Përveç Grupit Kosovar, që e kishte udhëheqjen në Damask (Xhafer Deva, Rexhep Krasniqi, Tahir Zaimi), partia Legaliteti kishte prani të mirë. Në një foto të asaj kohe kemi “grupin e Degës së Legalitetit në Damask”, i cili grup përfshinte gjithsej 26 anëtarë, burra e gra.¹⁸

Pasi IRO arriti t’i transportojë shumicën e refugjatëve shqiptarë nga Damasku dhe t’i vendosë në vendet e tjera (Nju Zelandë, Australi, Kanada e ShBA), Salih Myftija u kthye në Aleksandri, ku vazhdoi të shërbejë si këshilltar i mbretit Zog dhe si anëtarë i Këshillit Mbretëror, bashkë me

¹⁵ Zef Pashko Deda, *Jeta dhe vdekja e tij*, Atdheu,nr.2(53),New York maj-qershor 1978, f.3.

¹⁶ Fuad Myftia,intervistë me Dalip Grecën,"Illyria" New York 20 shkurt 2007

¹⁷ *Nga notimet e Zogut I-Mbretit të shqiptarëve*, I, f. 119-120

¹⁸ *Një jetë në shërbim të kombit shqiptar-Kujtime mërgimi*, ff. 66-74.

Mehdi Frashërin, Hiqmet Delvinën, Musa Jukën, Mustafa Krujën, Hysen Selmanin, Qemal Mesarjen, Omer Beqirin, Ago Agajin e Bajezit Boletinin. Këshilli Mbretëror u formua pasi mbreti Zog u vendos në Aleksandri, dhe mbledhje kohë pas kohe, për t'i shqyrtuar ngjarjet kombëtare.¹⁹

Në këtë kontekst, qëndrimi i Salih Myftisë në Aleksandri në vitet në vijim (1948-1955) kishte rëndësi për atë moment historik: pajtimi i krerëve politikë shqiptarë në mërgim, për ta formuar një komitet politik (në vend të qeverisë në ekzil), e cila do t'i përfaqësonte shqiptarët në rrethanat e reja të Luftës së ftohtë. I vetmi që e përmendi kalimthi kontributin e Salih Myftisë për këtë iniciativë të madhe ishte Zef Pashko, në fjalën e tij me rastin e vdekjes së Salih Myftisë. Kështu, duke treguar meritat e tij, ai tha se *“në mërgim që ndër këshilltarët më të afërm të mbretit Zog, dhe njeri që ndihmoi më tepër në realizmin e lidhjes midis mbretit Zog dhe krerëve të mërgatës politike shqiptare, e njohur si “Marrëveshja e Aleksandrisë”*.”²⁰

Ç'është e vërteta, Protokolli ose Marrëveshja e Aleksandrisë më 12 gusht 1948 ishte një kthesë me rëndësi, pasi opozita politike-ushtarake shqiptare antikomuniste u shpartallua më 1944-1945, dhe u nda në disa parti politike në kampet e refugjatëve në Itali, Greqi, Turqi etj. Në atë kohë (1947), Salih Myftija shërbente si përfaqësues i partisë Legaliteti (në kampin Reggio Emilia në Itali), dhe në sajë të autoritetit që kishte në mesin e elitës politike-ushtarake shqiptare ai edhe arriti t'i afrojë partitë dhe grupet politike shqiptare, që ta pranojnë ftesën e mbretit Zogu dhe të mbledhen në Aleksandri, në gusht të 1948. Në këtë mbledhje u takuan përfaqësuesit e katër partive (Legaliteti, Balli Kombëtar, Blloku Kombëtar Indipendent dhe Grupi Kosovar). Pas shumë mbledhjeve u arrit “Besëlidhja”, që u shpall më 12 gusht 1948, që hapi rrugën për themelimin e Komitetit Shqiptar “Shqipëria e Lirë”, më 1949, me një krah politik në krye me Mithat Frashërin dhe një krah ushtarak në krye me Abaz Kupin,

¹⁹ Më shumë për krerët e Legalitetit në Damask në atë kohë shih: Dosja sekrete e UDB-së- Emigracioni shqiptar 1944-1953, Prishtinë (Koha Print) 2004, f.50, 567,569,570.

²⁰ Gwen Robyns, *Geralinda shqiptare- Biografi e autorizuar*, përktheu Zhilda Dervishi, Tiranë (UET) 2012, f. 151.

që merrej me rekrutimin dhe stërvitjen e vullnetarëve shqiptarë dhe hedhjen e tyre në Shqipëri gjatë 1950-1951, me ndihmën e shërbimeve sekrete amerikane dhe britanike.²¹

Mu për këtë Salih Myftija gëzonte një autoritet në Pallatin Mbretëror në Aleksandri, përkatësisht në familjen mbretërore, sa që nipi i mbretit Zog, Skënder Zogu, në kujtimet e tij, e quan si “*Myfti legjendar*” dhe “*monarkist të zjarrtë*”²². Në ato vite Salih Myftija shërbente si këshilltar i mbretit Zogu për lidhje me rrethin egjiptian, e sidomos me rrethin fetar mysliman. Kështu, në shkurt 1950 mbreti Zog e vizitoi Az’harin me Salih Myftinë, ku u pritën prej Shejhut të Az’harit, në krye të stafit, i cili e përshëndeste mbretin me një fjalë rasti, duke u fokusuar në “marrëdhëniet vëllazërore midis popullit shqiptar dhe popujve myslimanë në Lindje”. Pas kësaj fjale mbreti shëtiti nëpër hapësirat e universitetit, e që edhe në atë kohë në mesin e studentëve kishte edhe studentë shqiptarë, ndërsa më pas e vizitoi Muzeun Islam, dhe në fund iu nda një mirënjohje e lartë.²³ Pa dyshim se prania e Salih Myftisë me autoritetin e tij fetar shërbente mirë në promovimin e Zogut në Lindjen e Mesme, si mbret legjitim i cili po luftonte për çlirimin e vendit të tij nga sundimit komunist.

Mirëpo, ambiciet e Zogut u tkurrën më 1951, me dështimin e “Operacionit të madh”, dhe më 1952, me grushtshtetin ushtarak kundër mbretit Faruk, i cili ofronte çdo ndihmë të mundshme për mbretin Zogu gjatë viteve 1946-1952. Me suprimimin e mbretërisë në Egjipt, në qershor të vitit 1953, autoritetet e reja egjiptiane vendosën mbylljen e Ambasadës Mbretërore Shqiptare në gusht të vitit 1953. Me ardhjen e kolonelit Gamal Abdulnaser në krye të pushtetit, filluan presionet kundër mbretit Zogu, duke përfshirë një fushatë të kurdisur në shtyp kundër mbretit, i cili ishte në krizë materiale për shkak se mbulonte shpenzimin e elitës shqiptare që

²¹ Për shumë detaje për formimin e KSH "Shqipëria e Lirë" dhe operacionet ushtarake për "çlirimin e Shqipërisë prej regjimit komunist" që dështuan për shkak të një tradhëtie shih: Nicholas Bethell, *The Great Betrayal- The Untold Story of Kim Philby's Biggest Coup*, London (Hodder & Stoughton) 1984, pp.59-62.

²² Skënder Zogu, *Një jetë në shërbim të kombit shqiptar-Kujtime mërgimi*, Tiranë (Green Tech) 2017, ff. 60-74.

²³ Po aty, ff. 60-74.

kishte mbetur atje²⁴, dhe kështu vazhdoi deri kur u largua nga Aleksandria, më 28 korrik 1955, për të udhëtuar drejt Francës me shpurën e tij.²⁵

Pas largimit të mbretit Zog në Aleksandri, mbetën disa figura shqiptare, në mesin e të cilëve ishte edhe Salih Myftija, mirëpo tani në kushte të reja, pasi regjimi i ri egjiptian e njohu Republikën Popullore të Shqipërisë. Sipas kujtimeve të djalit Fuad Myftija, i cili më 1958 u largua për në ShBA, më pëlqimin e të jatit, Salih Myftija kishte vazhduar të punojë si profesor në shtëpi, ku i vinin studentë për mësim, ose në ndonjë kolegji, deri kur edhe vetë ai u largua për në ShBA, më 1965²⁶. Për fat të keq, kjo fazë (1955-1965) e jetës së Salih Myftisë në Egjipt është më e mjegullt, dhe kërkon më shumë gjurmime për ta ndriçuar.

²⁴ Selmani, *Nga notimet e Mbretit Zog I*, botimi arab, ff.146-147.

²⁵ Po aty, f.184-186

²⁶ Dr. Fuad Myftia, intervistë me Dalip Grecën, material i ruajtur te Elez Osmani.

Ismet A. Qazim Al BAHITI

DROMCA KUJTIMESH RRETH SHKËLQESISË SË TIJ SALIH MYFTIJA NGA FËMIJËRIA IME NË EGJIPT

Shkëlqesia e tij kishte formuar një grup të ngushtë shokësh e miqsh të tij, sikurse ishin kolonel Xhemajl Leqini, po edhe të tjerrë atdhetarë, të cilët përbënin bërthamën e rezistencës kundër fashizmit, qyshkur Italia fashiste e poshtoi Shqipërinë, në krye me fashistin Benito Musolinin, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Okupimi fashist ia solli Shqipërisë edhe një të keqe tjetër, paraqitjen e celulave të para komuniste në territorin e saj. Për këtë arsye shkëlqesia e tij, Sali



Myftija, vendosi të largohej përkohësisht nga Shqipëria, në një vend më të sigurt, nga edhe do ta intensifikonte edhe më shumë rezistencën kundër këtyre dy ideologjive.

Sali Myftija, Allahu e pastë mëshiruar, atëbotë kishte bashkëshorten, tre djem dhe katër vajza, dhe shumë prej farefisit të tij, meqë ishin familje e madhe dhe me autoritet. I bindur se një gjendje e tillë nuk mund të zgjashte gjatë, ai vendosi të udhëtonte për në Egjipt. Ai në këtë udhëtim e mori vetëm djalin e tij të vogël, Fuadin, dhe së bashku me shokun e tij të jetës, kolonelin Xhemajl Leqini, i cili ishte edhe bashkëluftëtar i tij, ia mësynë Egjiptit. Në këtë udhëtim atyre iu bashkuan edhe një grup atdhedashës,

dhe me një anije të vjetër, nga Shkodra ia mësynë detit Adriatik. Largimi i tyre nga Shqipëria në asnjë mënyrë nuk mund të quhet ikje, përkundrazi, fillim i një rrugëtimi të gjatë dhe fillim i një rezistence aktive kundër fashizmit dhe komunizmit, tani nga një vend më i qetë, deri në çlirimin e popullit shqiptar, i cili atëbotë po përjetonte vuajtje e mynxyra të papara, nga kaosi dhe gjendja e paqëndrueshme që e kishte kapluar tërë Shqipërinë.

Shkëlqesia e tij, bashkë me bashkëshoqëruesit e tij, kishin vendosur t'ia mësynin Egjiptit, sepse aty kishte kërkuar strehim edhe mbreti shqiptar, Ahmet Zogu i parë, i cili ishte vendosur në Aleksandri, së bashku me bashkëshorten e tij Xheraldinën dhe djalin e tyre të vetëm, Leka Zogun e parë, i cili ende nuk e kishte mbushur një vit nga lindja. Mbreti i atëhershëm i Egjiptit, me rrënjë shqiptare nga loza familjare e themeluesit të Egjiptit modern, Mehmet (Muhamed) Ali Pashës, Faruku i parë, ua kishte dhuruar atyre një rezidencë madhështore në Aleksandri, që nga aty të kryenin detyra me rëndësi kombëtare për Shqipërinë.

Me të arritur në Aleksandri, shkëlqesia e tij, Salih Myftija, iu bashkua mbretit Ahmet Zogu, të cilin tash e tutje do ta shoqëronte në çdo vend. Ai shumë herë, së bashku me mbretin Zogu, po edhe vetë, është takuar me babanë tim (Allahu e pastë mëshiruar, meqë ne atëherë jetonim në Kajro). Ai kishte takime të rregullta edhe me koloninë e madhe shqiptare që jetonte në Kajro në atë kohë, e ndër këto takime spikasin takimet me studentët e shumtë shqiptarë që studionin në Universitetin e Az'harit, me bursa studentore nga Qeveria e Mbretërisë së Egjiptit.

Unë personalisht e kam takuar atë disa herë në vitet e pesëdhjeta, dhe kemi shumë foto të përbashkëta familjare me të dhe me shqiptarë të tjerë të famshëm në Egjipt, sikurse ishin: Nexhmedin Qoralia, i cili ishte i afërt i Aziz Izet Pashës, i cili ishte në përcjellje të drejtpërdrejtë të mbretit Faruk; ai kishte një rezidencë të madhe në kuartin e njohur të Zemalikut, (një lagje e njerëzve të pasur dhe e pushtetarëve më të mëdhenj të Egjiptit). Kësaj ndërtese, pasi kryetari i atëhershëm i Egjiptit e kishte pranuar Qeverinë komuniste të Enver Hoxhës, ia kishin vënë syrin qeveria shqiptare, duke e përvetësuar atë dhunshëm, pasi kishin detyruar trashëgimtarët e Aziz Izet Pashës që të hiqnin dorë nga ajo shtëpi, në favor të qeverisë komuniste të Shqipërisë, e cila ndërtesë më pas u transferua në Ambasadë të

Shqipërisë me pronësi të përhershme.¹ Pas kësaj grabitjeje të pashembullt, Nexhmedin Qoralia u detyrua të shpërngulej nga Egjipti për në Mbretërinë e Arabisë Saudite, me ndihmën e babait tim, Akif Qazim El Bahitit.



¹ Pas rënies së komunizmit në Shqipëri Ambasada shqiptare në Kajro është shitur në vitet e '90-ta, nga ana e Qeverisë së Shqipërisë, në një proces të mbështjellë me korrupsion. – (Sqarim i përkthyesit S. B.).

Gjatë verës, sa herë që e vizitonim Aleksandrinë, takoheshim me shkëlqesinë e tij, Salih Muftinë dhe me djalin e tij Fuadin, i cili, me sa mbaj mend unë, ishte ortak me një person tjetër në një restorant të njohur ushqimor, dhe meqë ishte i njohur për ushqime, shkonim shpeshherë aty.

Diku në korrik të vitit 1965 shkëlqesia e tij, Salih Myftija, së bashku me të birin Fuadin emigroi për në Amerikë, më saktësisht në Nju York. Djali i tij Fuadi, me të arritur atje, ishte punësuar në kompaninë prestigjioze të aeroplanëve “Pan American”, dhe në të punoi gjatë, deri në shuarjen e asaj kompanie.

Kolonia e madhe shqiptare e Nju Yorkut dhe e rrethinës e mirëpritën shkuarjen e Salih Myftisë atje, ndërkohë që Salih ef. Myftija iu përkushtua thirrjes islame dhe ligjëratave, si dhe takimeve të panumërta, derisa u shpërngul pranë fqinjësisë së Allahut, me 19 maj 1978, në moshën 87 vjeç. E tërë jeta e tij ishte përpjekje titanike për interesa të atdheut të tij, Shqipërisë, të cilin kurrë nuk e harroi.

Për nga natyra ai ishte i hareshëm dhe gazmor, dhe më kujtohet që qe-shte me zë kur dëgjonte ndonjë batutë prej ndonjë shqiptari në Egjipt. Unë ndonëse isha i vogël, më kujtohet kur ai vinte në Kajro, dhe të gjithë së bashku kur shkonim ta vizitonim teqenë “El Megavri”, e cila gjendej në kodrën e “Mukattamit”, në lagje e Kajros, përballë xhamisë së Muhamed Ali Pashës, në të cilin kompleks gjendet edhe kalaja e Salahuddin Ejubit.

Në vitin 1967 hirësia e tij erdhi në Arabinë Saudite, për ta kryer obligimin e haxhit, e ndërkohë edhe ne e patëm lëshuar Egjiptin, sepse qeveria e Naserit i kishte halë në sy shqiptarët e mbetur në Egjipt. Hirësia e tij erdhi si mysafir në shtëpinë tonë në Xhide. Unë sapo isha kthyer nga studimet në Londër, dhe më kujtohet se ishte korriku i viti 1966, dhe e mbaj mend fare mirë se si në vitin vijues unë dhe babai im e patëm shoqëruar Salih ef. Myftinë derisa e përfundoi ceremoninë e haxhit, dhe po ashtu më kujtohet se pas haxhit si pati ndenjor mysafir te ne edhe për disa ditë të tjera. Pas kësaj ai u kthye në Nju York, dhe që nga ajo ditë më nuk më ka rastisur ta shohë apo ta takoj të nderuarin Salih ef. Myftinë. Megjithatë, babai im kur ishte në vizitë në ShBA, për t’u takuar me koloninë shqiptare atje, dhe e kishte takuar hirësinë e tij, e ndër të tjerash ishte ta-

kuar edhe me mikun tjetër të tij të ngushte, Imam Vehbi Ismailin, në Michigan.

Për fat të keq, për shkak të kohës së ngushtë nuk kam arritur ende t'i hap disa kuti në të cilat i ruajmë kujtimet familjare, e në të cilat gjenden edhe foto të shumta me Salih ef. Myftinë dhe me shqiptarët e Egjiptit. Këto kuti i kemi mbyllur, dhe janë bartur nga shtëpia në Riad për në atë në Xhide, pas vdekjes së babait tim. Së shpejti do të udhëtoj për në Stamboll, pas një kohe të gjatë, rreth 32 muajve, për shkak të pengesave të udhëtimit që i shkaktoi virusi Corona-19. Nga Stambolli e kam më të lehtë të vij në Kosovë, dhe të sjell disa nga këto kujtime.

Edhe njëherë kërkoj ndjesë që nuk arrita ende t'i siguroj fotot dhe dëshmitë e veprimtarisë së bujshme të Salih ef. Myftisë në Egjipt, Allahu e pastë mëshiruar, ashtu siç lutem që i Madhërishmi t'i mëshirojë edhe të gjithë të vdekurit prej myslimanëve! Dhe, në fund, Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ju të gjithë!

Xhedë, 29.06.2022

Dr. Adnan HAJDINI

SALI MYFTIJA NË KUJTIMET E NJË MUHAXHERI

Takimi im i parë me udhëheqësin tonë shpirtnor, Sali Myftija ka qenë kur unë isha në moshë shumë të re, kur unë isha vetëm 9 vjeç, në vitin 1949. Ndodhi në Damask të Sirisë, në shtëpinë e gjyshit tim nga ana e nënës, Muharrem Aliut/Alushit. Myftiu u dërgua prej mbretit Zog, nga Aleksandria e Egjiptit, në krye të një delegacioni të shqiptarëve të shquar në mërgim, mes të cilëve Ali Këlcyra, Dr. Kemal, E. Koliqi dhe Vehbi Frashëri. Ma vonë kuptove se qëllimi i vizitës së Sali Myftisë, i cili ishte në krye të delegacionit në Siri, kishte qenë për të ndihmuar në vendosjen e disa prej refugjatëve të rinj shqiptarë që i kishte pranuar Siria.

Unë isha shumë i vogël për të kujtuar ndonjë gjë rreth tij, përveç çallmës së tij të pazakontë që e mbante në kokë, në krahasim me ato që mbanin imamët sirianë.

Në vitin 1959, pasi e mbarova shkollën e mesme dhe e kalova provin kombëtar, duke dalë një prej 50 studentëve ma të mirë, mu ofrua një bursë e plotë me studiu në universitetin e Aleksandrisë, në Egjipt nga Republika e re e Bashkuar Arabe e Sirisë dhe e Egjiptit.

Babai im ishte shpërngulur nga Kosova, për shkak të dhunës serbe. Unë jam lindur dhe rritur në Siri, me një ndjenjë të fortë për çdo gjë shqiptare, dhe duke pasur lidhje kryesisht me familjen dhe miqtë shqiptarë. Kështu që, ishte shumë normale për mua për me pyet dhe për me gjetën shqiptarë sapo mbërrina në Aleksandri. Nuk më kujtohet se si e gjeta saktësisht Sali Myftiun, i cili ishte në Aleksandri. Ai jetonte jo shumë larg vendit ku banoja unë. Ndoshta u lidhem nëpërmjet xhamisë, apo përmes

ndonjërit prej shqiptarëve të Kosovës që kishte një restorant të njohur në pjesën ma të mirë të qytetit në MAHATET AL RAML.

Më ftoi në banesën e tij, dhe më shërbeu çaj apo kafe, si asht zakoni i një mikpritësi të madh. Çdo fundjavë ai ftonte profesorë të ndryshëm nga departamenti i Letërsisë arabe të universitetit, dhe më ftonte edhe mua që të marr pjesë.

Ai fliste arabisht, vetëm gjuhën letrare (fus'ha), rrjedhshëm, ma mirë se çdo profesor. Siç më kujtohet, asnjëri prej tyre nuk mund të bënte një bisedë pa e përzier me dialektin popullor (amije) egjiptian të arabishtes. Unë kam qenë gjithmonë i ftuar në këto raste, sepse isha edhe në gjendje me zhvillua biseda në arabishten letrare, rrjedhshëm sikurse ai, dhe kjo e gëzonte dhe e bënte atë krenar, dhe ai u thoshte profesorëve, se ja, Adnani asht 100% shqiptar, dhe e shihni se si mund të flasë në arabishten letrare.

Edhe pse ai e studioi Kuranin, Hadithin dhe Jurisprudencën Islame, për t'u ba një nga imamët ma të ditur në çështje fetare, me të vërtetë ai ishte ndryshe; i veçantë në krahasim me shumicën e dijetarëve fetarë që kam njohur. Ai e kishte mësuar poezinë arabe, dhe recitonte poezi nga kujtesa; poezi nga të gjitha epokat e letërsisë arabe, që nga koha paraislamë, e xhahilijetit (e injorancës), e deri te ato të ditëve moderne, dhe në të gjitha zhanret. Unë kurrë nuk e kam pyet, po zhvillimi i dijes së tij në këto fusha duhet të ketë qenë me iniciativën e tij dhe jashtë shkollimit të tij formal fetar. Gjithashtu ai dinte shumë fjalë të urta folklorike apo tregime me interes të përgjithshëm. Besoj se arsimimi i tij në fusha te përgjithshme e dallonte atë nga çdo dijetar apo imam tjetër fetar.

Ai ishte tolerant dhe i kuptueshëm për dallimet e njerëzve në sjelljen e tyre, dhe kurrë nuk e gjykonte askënd nëse ata nuk faleshin apo nuk e kryenin ndonjë nga ritualet e adhurimit fetar. Besoj se arsyeja ishte sepse ai e kishte kuptuar vërtet thelbin dhe qëllimin e fesë në përgjithësi, dhe të Islamit në veçanti, në jetën tonë të përditshme. Ndryshe, për shembull, disa prej hoxhallarëve shqiptarë në Siri, të cilët kishin një arsimim shumë elementar islam, dënonin një të ri për refuzimin e vënies së fesit (kësulës) në kokë. Axha im i madh, në fakt, nuk ishte hoxhë, nuk e pati çuar djalin e tij, Jahjanë në shkollën e mesme, sepse ajo shkollë nuk kishte kërkesë për mbulesë të kokës.

Sali Myftiun e kam ftuar për darkë në banesën time, dhe atë në shumë raste. Atë e kisha si babanë tim, baba, mentor dhe mik. Atij iu dha mundësia të jepte mësim-vaiz në xhaminë e lagjes së tij.

Zhënjimi i tij ma i madh kur ka jetuar në Egjipt ishte se shumica e njerëzve të thjeshtë, me të cilët duhej të merrej, sikurse shitësit e ushqimeve, ose njerëzit që merreshin me shërbime, nuk mund të komuniknin me të në arabishten letrare.

Ai fliste shpesh për djalin e tij Fuadin, që jetonte në Nju Jork, dhe për familjen e tij. Fuadi e kërkonte që ai të shkonte në ShBA, dhe të bashkoheshin me të, veçanërisht mbasi shumë shqiptarë qenë largua nga Aleksandria.

Në vazhdim do ta theksoj edhe një rast tjetër që m'u kujtua, e i cili ka të bëjë me kohën kur ishim në Siri. Në atë kohë presidenti i Sirisë ishte Shukri Kuvatly. Siria sapo ishte çliruar nga pushtimi francez. Presidenti i Sirisë e njihte shumë mirë karakterin shqiptar, dhe kishte pasur një eksperiencë unike me një shqiptar, i cili i ishte bashkuar rezistencës kundër pushtimit francez. Kuvatly kishte qenë plagosur në një pritë, dhe të gjithë të tjerët ishin largua, pra e kishin lanë vetëm. Shqiptari kishte qenë i vetmi që kishte qëndruar me të, dhe e kishte çuar të plagosur në shtëpinë e tij, në Damask.

Ky president dhe kryeministri i Sirisë u patën ofruar refugjatëve shqiptarë, që kishin ikur nga komunizmi, të vendosen pranë kufijve të rinj me Izraelin. Qëllimi i tyre ishte të krijonin një zonë mbrojtëse. Mirëpo, përgjigjja nga delegacioni që drejtohej prej Sali Myftiut ishte jo. Nuk jam i sigurt se a ishte kjo një direktivë e mbretit Zog, apo ishte një qëndrim nga vetë delegacioni dhe refugjatët që kishin ardhur, e të cilët nuk kishin interes të rekrutoheshin për të bërë një luftë tjetër; ata kishin në plan të ktheheshin në vendin e tyre, për të luftuar kundra regjimit komunist. Kështu që, delegacioni dhe refugjatët shqiptarë e refuzuan këtë ofertë. Si pasojë, Komisioni i Refugjatëve i Kombeve të Bashkuara erdhi dhe i ndihmoi refugjatët shqiptarë të Sirisë, që të vendoseshin në shtete të tjera. Në Siri refugjatët qenë strehuar përkohësisht në Tegenë e Sulltan Selimit, e cila asht në qendër të Damaskut. Unë dhe vëllai im i madh i vizitonim rregu-

llisht, dhe u dërgonim ushqime. Të vetmit emra që mbaj mend janë ata me të cilët luanim futboll, si Mexhid Dibra, Akil Derani dhe Arif Peza. Ata na merrnin me luajt me ta, dhe me na e mësu futbollin. Sikurse e dini, në atë kohë unë isha shumë i ri, e vëllai dhe kushërinjtë shkonin me ta në një fushë futbollit në skajin jugperëndimor të Damaskut, ku ishte komuniteti kristian, dhe e mbaj mend se një herë, gjatë lojës, Mexhid Dibra më goditi shumë keq me top në fytyrë.

Ma vonë refugjatët shqiptarë u larguan dhe u shpërndanë. Dikush në Kanada, dikush në ShBA, e dikush edhe në Australi. Nuk mendoj se ndonjë prej atyre kanë emigruar në Brazil. Pas disa vitesh, pikërisht në vitin 1963, mbas diplomimit tim në Universitetin e Aleksandrisë, u ktheva në Siri, në Damask, ku fillimisht punova në një punë shteti. Mbas një viti e gjysmë m'u dha një bursë nga qeveria italiane, për një vit në universitetin e Barit. Ky ishte studim pasuniversitar për agrikulturë në vendet mesdhetare.

Pas 3 muajsh mora vesh se në Damask kishin plasur protesta, ku ishin arrestuar shumë demonstrues, duke i përfshirë edhe miqtë e mi, e edhe dajën Ibrahim. Ibrahim asht vëlla me Shuajb Arnautin. Ibrahim u arrestua, e edhe unë isha në listën e ma të kërkuarve për t'u arrestuar. Për këtë, me kërkesën e qeverisë siriane, m'u ndërpre bursa. Nuk kisha zgjidhje tjetër përveçse me qëndru në Itali, apo me shku diku tjetër, sepse në asnjë mënyrë nuk mund të kthehesha në Damask; do të më arrestonin sapo ta vija këmbën në aeroport. Çfarë të bëj? - e pyeta veten.

I kam shkruar një letër Sali Myftisë, i cili tashmë ishte në Nju Jork Siti me djalin e tij, Fuadin. E pyeta për mendimin e tij, mbasi ai ishte i informuar për çështje të emigracionit. "Ku mendoni se duhet të shkoj?", - e pyeta. Ia përmenda Libinë, që kishte nevojë për mësues; Arabinë Saudite, që kërkonte punëtorë, dhe paguante shumë mirë, dhe mora përgjigje prej Sali Myftisë, dhe mbasi më pyeste mbi gjendjen time, më shkruante këto fjalë: "Bir im! Mos humb kohë me vendet arabe! Mos shko në asnjë nga vendet arabe. Apliko për me ardhën në ShBA! Ky asht vendi më i mirë në botë, dhe po ju tregoj pse. Kur isha në Egjipt, njerëzit qeshnin me mua pse unë e mbajsha çallmën ndryshe prej imamëve tipikë egjiptian apo

imamëve të vendeve të tjera arabe. Kur shkoja me ble sende në dyqane ushqimore, disa njerëz më përqeshnin. Këtu, kur eci në rrugë, nuk shoh asgjë tjetër përveçse respekt edhe prej njerëzve të zakonshëm.”. Kini parasysh se Mithat se Sali Myftiu nuk jetonin në një lagje të shtrenjtë të Manhatan-it. Banonin në rrugën De Lancey, në një apartament shumë modest. Pra, shkurt, fjalët e Sali Myftisë ishin, “Eja në Amerikë!”.

Pas kësaj fillova me pyet rreth e rrotull se si mund të emigroja në ShBA. Fillimisht i pyeta disa nga kontaktet e mia shqiptare, sikurse ishin Mentor Çoku, me të cilin kam pasur lidhje të mira, pasi e kam pas ndihmuar me një projekt në Romë, për ndërtimin e një xhamie. Mentor Çoku tha: “Po pse nuk aplikon?”, - dhe me lidhi me profesor Ernest Koliqin. Ai më tha se Koliqi njihnte dikë në zyrat e refugjatëve të Kryqit të Kuq të Kombeve të Bashkuara, e ndoshta ai mund të më ndihmonte. Pasi u takova me profesor Koliqin, dhe ai ma dha emrin e asaj zonjës, shkova në zyrën e saj, dhe ia tregova historinë time, si dhe i thash se dëshiroja të aplikoja si refugjat politik për në ShBA. Ajo më tha se zyra e saj ishte për refugjatët që ikin nga vendet komuniste. Unë i thashë se për momentin Siria ishte socialiste, dhe regjimi ishte ma i keq se vendet komuniste, dhe se isha shqiptar. Kështu që, pas pak kohësh përfundova në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pas uljes, në shtator të vitit 1965, në aeroportin JFK, aty ishte Sali Myftiu dhe Fuadi. Fuadi ishte personi i parë që më ka takuar te hoteli ku qëndroja unë kur arrita në Nju Jork. Kam qëndruar një motmot në Nju Jork, dhe gjatë kësaj kohe e vizitoja Sali Myftinë rregullisht, pothuajse çdo javë, sa herë që mundesha. Ai me të vërtetë kishte një vend të veçantë në zemrën dhe shpirtin tim. Më pëlqente me e dëgju dhe me mësu prej tij, nga mençuria dhe urtësia e tij.

Ai ishte intelektual shumë i dijshtëm, shumë inteligjent, dhe kishte kujtesë të habitshme. Megjithatë, ishte i thjeshtë dhe i përlurur. Ai komunikonte me këdo, në çdo nivel, dhe shumë herë kur unë shkoja për vizitë, takohesha aty edhe me shumë shqiptarë, punëtorë të thjeshtë, të cilët e vizitonin, dhe unë dëgjoja diskutimet e tij dhe mënyrën se si i shtjellonte bisedat kur donte me i bindë njerëzit për një ide apo për një koncept. Ai

ishte shumë i afrueshëm dhe mikpritës. Ai ishte shumë mendjegjerë dhe i përshtatshëm me njerëzit, dhe kurrë nuk zemërohej për asgjë, edhe sikur njerëzit ta shqetësonin ose ta fyenin, apo edhe sikur ta fyenin inteligjencën e tij.

Mbas një viti shkova në Universitetin Cornell, për studime pasuniversitare, me i vazhdu studimet e mia për nutrition dhe biokimi.

Disa herë e kam ftuar Sali Myftiun me më vizitua në Ithaka, NY. Nuk e mbaj mend nëse pata shku me e marrë, apo erdhi me autobus; ndoshta e kam marrë unë. E dija se në Ithaka ai do të kënaqej me ajrin e pastër dhe me natyrën e bukur të zonës.

Duhet ta njohësh qytetin Ithaka të Nju Jorkut, për ta vlerësu gëzimin që e ndjeu Sali Myftiu sepse erdhi aty; një natyrë e bukur me gryka, ujëvara, male të vogla dhe liqene, që asht në rajonin e liqenit Finger, pranë liqenit ma të madh, që quhet Cayuga... Ka shumë parqe të bukura, e edhe varrezat janë të bukura. Ndonjëherë ne shkonim me shëtit, dhe na duhej me i kalu varrezat, për me shkua nga pika A, në pikën B, dhe derisa shikonte përreth, më tha: “Dëgjo, biri im! Po ecim në këtë vend të bukur, e po mendoj se na myslimanët punojmë kaq shumë dhe përpiqemi shumë të shkojmë në parajsë, në Xhenet, e amerikanët nuk duhet të bajnë asgjë. Ata e kanë gjetun këtu; jetojnë si në xhenet.”. Kurrë nuk e harroj atë gjë që ai ma tha. Ai ishte shumë i lumtur tu marrë frymë në një vend me peizazh të mirë e ajër të pastër.

E njëjta gjë më pati ndodhur edhe në ditën e parë kur pata mbërritur në Universitetin Cornell, në Ithaka të Nju Jorkut. Më kujtohet se, sapo u regjistrova në konviktin e maturantëve, dola jashtë, dhe qëlloi të ishte një ditë e bukur e me diell. Pasi u shtriva gjatë gjithë mbasdites, në mes të një lëndinë të madhe me bar dhe me pemë të mëdha, e ndieja se veç doja me marrë frymë me ajër të pastër, larg qytetit të Nju Jorkut, ku pata banu një vit.

Një të premtë, bashkë me Sali Myftinë, shkuam me u fal në Cornell University, te Unioni Studentor. Aty ishte një dhomë speciale ku faleshim studentët myslimanë. Sali Myftiu e mbajti hytben në gjuhën arabe, dhe e udhëhoqi namazin. Pastaj u mblodhëm rreth tij me bisedu. Ma vonë u

kërkoi studentëve me lexu pjesë nga Kurani. Ai i korrigjonte për gabimet që bënin, pa e pas Kuranin në dorë, nga kujtesa e tij. Ma në fund kërkoi që edhe unë të lexoj, dhe lexova pa ba asnjë gabim. Ai u tha studentëve që ishin të gjithë të diplomuar nga Arabia Saudite, Egjipti, Afrika e Veriut dhe Iraku: “A e shihni se Adnani asht shqiptar, dhe e lexon Kuranin ma mirë se kushdo prej jush?!”. Ai ishte shumë atdhetar, dhe përpiqej me nxjerr në pah ma të mirën e shqiptarëve, në mënyra të ndryshme.

Pas diplomimit, kalova dy vjet në post-doktoratë, dhe pastaj dhashë mësim në Universitetin Cornell. Ma vonë fillova punë në Fort Wayne, Indiana, dhe më kujtohet se kur ai ndërroi jetë, unë fluturova për në qytetin e Nju Jorkut, për të marrë pjesë në funeralin dhe varrimin e Sali Myftisë, në Nju Xhersi. Atë ditë të gjithë u pikëlluam, mirëpo luteshim për shpirtin e tij. Edhe sot e kujtoj me mall, dhe lutem për shpirtin e tij. Këto janë disa nga kujtimet e mia, nga përvoja ime, për alimin e shquar, për Myftinë tonë.

Pensilvania, mars 2023

Shënim nga prof. Elez Osmani

Më 18 mars 2023, Dr. Mit'hat Gashi propozoi një takim me një “Arnaut” nga Sirija, dhe na ftoi që ta takonim. Mysafiri vinte nga Pensilvania e largët, ndërsa unë e mora Dr. Muhamed Mufakun nga Conektiket, dhe shkuam në Nju Xhersi, kurse Mit'hati, që një-hej prej kohësh me të, erdhi me zonjën e tij. Dr. Adnan Hajdini dhe Dr. Muhamed Mufaku ishin lindur në një lagje të Damaskut, mirëpo nuk njiheshin personalisht, ndonëse të dy, dinin për familjet e tyre. Pas u prezantuam dhe filloi muhabeti, pata befasinë e parë. Të dy “aranautët” flisnin dhe bënin muhabet në gjuhën shqipe, edhe pse të lindur në Damask. Për Dr. Mufakun e dija, sepse ka jetuar dhe punuar në Prishtinë, e për Dr. Adnanin, nuk dija asgjë. Ky e kishte ruajtur theksin dhe gjuhën aq bukur, sa mendoje se je diku në fshatrat e Vitisë. Duke bërë muhabet, i tregova se e kemi mbajtur një tryezë shkencore për Sali Myftiun. Ai më tha se e kishte njohur, dhe se e kishte pasur mik. Dhe e luta t'i dërgojë

kujtimet tij për të, në Institutin e Studimeve Islame në Prishtinë, ku asht duke u përgatitur libri me kumtesat nga tryeza shkencore. Me dëshirë dhe pa ngurrim ai e bëri, dhe i jemi mirënjohës.

Adnan Hajdini ka lindur në Damask të Sirisë, më 22 gusht 1940. Pas mbarimit të arsimit fillor dhe të mesëm, në vitin 1959, mori një bursë qeveritare për studime në universitetin e Aleksandrisë, në Egjipt. Aty i përfundoi studimet universitare në degën e agrikulturës. Në vitin 1964 mori një bursë njëvjeçare nga qeveria italiane, për studime pasuniversitare në universitetin e Barit, në Itali.

Në shtator të vitit 1965 mori vizë si refugjat politik, dhe emigroi në ShBA. Garancinë për të emigruar në ShBA ia bëri Komiteti Shqipëria e Lirë, kryetar i së cilës ishte Rexhep Krasniqi. Pas një pune njëvjeçare si teknik laborator në Nju Jork, fitoi një bursë kërkimore dhe mësimdhënieje nga universiteti Cornell, në vitin 1966, ku e kreu edhe masterin MS dhe doktoratën PhD në biokimi dhe nutricion. Më pas punoi dy vjet të tjera në Universitetin Cornell, ku u mor edhe me studime kërkimore.

Në 1973 filloi punë në industrinë e ushqimit në Central Soya në Fort Wayne, Indiana.

Gjatë karrierës së tij ka punuar edhe në Madrid, Spanjë, në 1979, për 2 vjet, dhe në Bangkok, Tajlandë, për tri vjet. Në 1984 u punësua nga Carnation Company, në Los Angeles, CA, si drejtor i sektorit të nutricionit dhe hulumtimeve. Në vitin 1990 u kthye në lindje të ShBA-së, në Pensilvania, dhe punoi derisa doli në pension, në fund të vitit 2020.

Babai i tij, Islam Hajdini, ka qenë vetëm shtatë vjeçar në vitin 1912, kur u largua nga shtëpia e tij, nga Vitia e Kosovës. Ai emigroi me prindërit, tre vëllezërit dhe dy motrat për në Turqi, nëpërmjet Shkupit dhe Selanikut. Fillimisht u vendosën në Turqinë jugore, Kilis, dhe u përpoqën me u marrë me bujqësi për disa vjet, në një tokë të keqe, joproduuese. Më pas migruan në Damask të Sirisë. Babai i tij u martua me Sabrije Muharrem Alushin, e cila në vitin 1926 kishte migruar me familjen nga Shkodra e Shqipërisë.

Elez OSMANI

PËR PJEKJA E SALIH MYFTISË PËR ÇËSHTJEN FETARE E KOMBËTARE NË MËRGIM

Në gjysmën e dytë të shekullit XX zhvillimi i jetës fetare islame të shqiptarët në Amerikë mori nismë të mbarë. Këtë e fuqizoi ardhja e imam Vehbi Ismailit, imam Isa Hoxhës dhe e Salih Myftisë, i cili ishte myfti i Shkodrës dhe i prefekturës së Kosovës. Këta e vazhduan traditën nga vendlindja e tyre, aty ku përgjatë shekujve kontributi i imamëve dhe i hoxhallarëve të shquar ishte domethënës. Në drejtim të edukimit të brezave me besimin në një Zot të Vetëm, me dije të gjithanshme, me përkushtim për jetë në harmoni dhe tolerancë ndër fetare, këta e mbështetën vullnetin e tyre për të shërbyer në të mirë të atdheut edhe pse larg tij.

Hoxhallarët e Shkodrës, vazhdimisht kanë predikuar të ruhet dhe të forcohet harmonia në mes të tri përkatësive fetare të shqiptarëve. “Nuk dihet ndonjë hoxhë që të këtë këshilluar popullin kundër besimit katolik-kristijan”¹. Përkundrazi, klerikët pa dallim feje, kanë bashkëpunuar në mes vete me një mirëkuptim të mirëfilltë.

Imam Vehbi Ismaili, në parathënien e Mevludit të Idriz Lamajt, botuar në Nju Jork, sjellë një moment interesant nga kjo traditë, kur thotë: “Festimin më madhështor që e kam parë në jetën time, ishte me rastin e Mevludit; që ishte mbajtur në Shkodër, në vitin 1935... Ceremonia ishte organizua prej të ndjerit Salih ef. Myftija, myfti i Shkodrës dhe i prefekturës së Kosovës, dhe u krye në Sheshin e Xhamisë “Fusha e Çelës”. Minarja e

¹ Hamdi Bushati, “Shkodra ndër mote”, Shkodër “Rozafat”, 1998, f. 595.

xhamisë ishte e lidhur me Kambanoren e Kishës Françeskane të Shkodrës, me një dritë elektrike, ku lexohej: “MIRË SE ERDHE RESUL I PRITUN!” Banda e Bashkisë luajti disa pjesë të bukura muzikore, dhe mandej Salih ef. Myftija, e mbajti një fjalim të shkëlqyeshëm mbi jetën e profetit.”² Çdo studiues e ka të vështirë ta dallojë ndonjërin nga ajo plejadë. Megjithatë, kësaj radhe e kemi ndarë mendjen të merremi me Salih Myftinë, sepse edhe ky i takon brezit të atdhetarëve, intelektualëve, politikanëve dhe fetarëve që u ndoqën, nga regjimi komunist, u burgosën, u internuan dhe u detyruan të largohen nga atdheu.³

Salih ef. Myftija, ishte një personalitet i çmuar, fisnik në pamje, (siç thonë ata që e njohën), me njohuri erudite në kulturë, pra, një figurë me botëkuptim të formuar e nën ndikimin e disa kulturave, burrë i vërtetë shteti, orator dhe organizator i përkryer, i cili i bënte vend vetes në të gjitha mjediset shoqërore dhe vendet ku ai jetoi pjesë të jetës së tij.

Kush e ka njohur, dhe kush është marrë pak a shumë me biografinë e tij, sigurisht se edhe e ka të qartë se jeta e Salih ef. Myftisë ishte një provë e gjallë durimi e besimi, vullneti e përpjekjeje të pareshtura jetësore për jetë a vdekje. Regjimet e pushtuesve të huaj, po edhe regjimi komunist shqiptar, e internuan, e burgosen, e keqtrajtuat, mirëpo nuk ia thyen idealin e tij për një Shqipëri të lirë, prandaj nuk arritën ta përkulnin. Besimin në Zot, nuk mundën t’ia shuanin. Përkundrazi, vuajtja dhe emigrimi ishte një sprovë për të, madje në pjesën më të madhe të jetës së tij.

Në fletoren e shënimeve të tij, faqe 71, ka shkruar: “*doemos jena në dimër, por duhet durim, se e kemi selametin afër, përpara*”. Kurse në faqen 68, shkruan: “*Kasavetet dhe telashet, me kanë se i nxijnë teshat, nuk do të shifshim kënd me të bardha*”.⁴

Salih Myftija, lindi në shekullin e trazirave e të përpjekjeve për mëvetësi, në vitin e largët 1891, gjë që nënkupton se ishte bashkëkohës i ngjar-

² Idriz Lamaj, ”Mevludi” Valdon pres, Nju Jork, 1982, f. 9.

³ Shih më gjerësisht gazetatat komuniste të kohës: “Jehona e Shkodrës”, f. 1, 12 kallenduer, 1944, dhe “Koha e re”, në ballinë, 14 fruer, 1945! Të dyja ishin organ i Frontit Nacional Çlirimtar të prefekturës së Shkodrës.

⁴ Fletorja është në Bibliotekën e Institutit të Studimeve Islame në Prishtinë.

jeve më të rëndësishme kombëtare, siç ishte Pavarësia e Shqipërisë, që është njëra ndër ngjarjet më madhore të atyre viteve, dhe po ashtu edhe ngjarja më e dhimbshme, sepse gjysma e atdheut mbeti jashtë kufijve administrativë të shtetit shqiptar, ngjarje që, me sa duket, gjithmonë la varrë në shpirtin e tij.

Salih Myftija rrjedh nga familja e ndershme atdhetare dhe fetare e derës së Myftijve të Shkodrës, të cilët lanë gjurmë të pashlyera jo vetëm në historinë e Shkodrës, por edhe në atë kombëtare në përgjithësi, duke u bërë pjesë afatgjate e kujtesës popullore. Kjo familje nuk karakterizohet vetëm me një personalitet. Dera e tyre, ndër breza, nxori figura të shquara atdhetare dhe intelektuale. Dera e tyre ka qenë dhe është përherë kontribuuese në çështjet me karakter fetar e kombëtar, dhe ka nxjerrë liderë të hershëm të Komunitetit Mysliman në Shkodër dhe më gjerë.

Babai i tij ka qenë i arsimuar me mësimet e fesë në shtëpi, prej vëllëzërve të tij dhe prej gjyshit. Kjo ishte trashëgimi familjare. Për më tepër, në kodrat e Tepes, në qytetin e Shkodrës, kishin edhe një medrese, që ishte pronë e familjes Myftija. Mësimet fetare dhe të gjuhës arabe Salih Myftija i ka marrë në shtëpi. Ai ishte njëri prej shqiptarëve që e ka zotëruar arabishten me themel. Salih Myftija është emëruar Kryemyfti i Zonës së Shkodrës dhe Kosovës prej mbretit Zog, më 1929, pas vdekjes së axhës. Axha tjetër ishte avokat, kurse gjyshi, Adem efendiu, ka qenë një prej fetarëve më të njohur në komunitetin shqiptar të Shkodrës.

Në fillim të viteve të '40-ta, njëra nga bibliotekat më të mëdha të Shkodrës ishte biblioteka e familjes Myftija.

Jeta e Sali efendiut përfshin jo vetëm të gjitha ngjarjet e rëndësishme të Shqipërisë, siç u tha më sipër, por edhe të emigracionit shqiptar në Itali, në Egjipt dhe në Amerikë, ku me veprimtarinë e tij fetare dhe atdhetare ka lënë gjurmë të pashlyeshme, sepse ishte dëshmitar dhe pjesëmarrës aktiv në ngjarjet më të rëndësishme të kohës.⁵

Më 14 janar të vitit 1931 Salih Myftija emërohet Kryemyfti i Zonës së Shkodrës. Emërimi i Hirësisë së tij bëhet me Dekretin nr. 19, të mbretit Zog, dekret që është firmosur edhe prej kryeministrit Pandeli Evangjeli

⁵ Illyria, 20 shkurt 2007; Intervistë e Fuad Muftisë dhënë Dalip Greces.

dhe ministrit të Drejtësisë. Pak kohë më vonë juridiksionit të Salih efendisë si Kryemyfti, përveç Prefekturës së Shkodrës, i shtohet edhe Prefektura e Kosovës, që përfshinte zonën Kukës, Krumë, Has, Gjakovë (Tropojë). Kjo ishte një detyrë me rëndësi jo vetëm për shtrirjen e gjerë, por edhe për vetë problemet administrative, fetare, kulturore dhe ekonomike. Këtu është me rëndësi të theksohet se këtë detyrë Sali ef. Myftija e kreu me përkushtim të veçantë, dhe u shqua si një drejtues i aftë e kompetent.⁶

Kujtime nga dr. Fuat Myftiu, i biri i Salih Myftiut

“...Unë them se Salih Myftija, babai im, është ndër të parët, që në maj të 1939 u pushua nga puna si myfti, detyrë që s’kishte të bënte fare me politikë. Ai u arrestua ndër të parët prej fashistëve italianë, dhe është internuar në Gjirokastrë. Arsyeja e këtyre masave ka qenë se ishte shqiptar dhe përkrahës i regjimit mbretëror, me bindjen se vetëm mbretëria mund t’i japë shpresë, mund t’i sillte popullit shqiptar atë që meritonte, lirinë, demokracinë. (...) Kur ka shkuar në Gjirokastrë, gjirokastritët e shihnin babanë duke kaluar nëpër rrugët e qytetit, mirëpo kishin frikë prej italianëve ta përshëndesnin, ngase ishte i internuar. Një ditë prej ditësh babai doli me prefektin. Një person, Muzafer Shehu, të cilin fatkeqësisht e vranë komunistët, tregtar në Gjirokastrë, i thotë se kishte kohë që e shihte sa herë që kalonte poshtë e përpjetë. Mirëpo, tani që po e sheh se po shëtit me prefektin, dyqani dhe shtëpia e tij ishte si e tija. Ato fjalë Muzaferi i mbajti deri atë ditë që babai u kthye nga internimi.

Babai, sa ishte gjallë, më tregonte se në atë qytet ishte një teqe, ku shkonin shumë miq e shokë. Një ditë shkoi një hoxhë, i cili mbante në dorë një gazetë fashiste. Babai, që ishte antifashist, i thotë se nuk bënte mirë që vinte në teqe me atë gazetë, sepse e komprometonte.

- Myfti efendi, - i thotë ai, - ti nuk e di se çfarë halli kam unë.
- Çfarë halli?

⁶ Dekreti Nr. 19, dt. 14 Kallnuer (janar) 1931, ruhet në arkivin e familjes Myftija. Kurse, Hamdi Bushati jep një datë tjetër, 28.X.1930 -31.V.1939. Në: “Shkodra ndër Mote”, f. 597.



- Unë kam një djalë vagabond, një djalë që s'meriton të jetë djali im, komunist, e mua më duhet, dashje pa dashje, t'i marrë gazetën e fashizmit, që mos të kenë dyshim tek unë.

- E kush ishte ky djalë? Ky ishte Enver Hoxha, kurse hoxha që mbante gazetë fashiste ishte i ati i tij.

Në ndërkohë, Fuat Myftija tregon detaje edhe se si kishin kaluar nga Italia në Egjipt: "Më 1947, ishim në kampin e Rexhio Emilias, kur mbreti Zog ftoi nacionalistët shqiptarë, partitë dhe organizatat politike, në një mbledhje në Aleksandri. Ky komision drejtohej prej babait, që ishte si udhëheqës i Legalitetit në kampin në Itali, dhe, edhe si fetar, mbreti Zog dinte ta nderonte. Ky komision shkoi në Aleksandri, së bashku me ata të Ballit Kombëtar, ku ishin edhe Ali Këlcyra, Koço Muka (që gjendej në Egjipt), Mustafa Kruja (që ishte në Aleksandri) etj. Mustafa Kruja ka qenë kundërshtar i Zogut qysh në kohën e Nolit. Duke e parë situatën që ishte krijuar në Shqipëri, gjatë okupimit, si dhe avancimin që kishin bërë

forcat komuniste, këtij i ishte mbushur mendja se vetëm mbreti Zog mund ta shpëtonte Shqipërinë.”⁷.

Ngjarjet e pakëndshme për atdheun dhe situata e ndërlikuar politike kushtëzuan veprimtarinë e tij nga një fetar me dinjitet në një veprimtar politik aktiv.



Hysen Mulosmani thoshte se 7 prilli (1939), Salih Myftiu e bëri që petkun fetar ta zëvendësonte me petkun atdhetar: “Me Salih efendiun përjetuam vuajtjet e kampit dhe hidhërimin e mërgimit. Qëndruam në kampe për disa vjet, deri kur u hapën rrugët për të emigruar në disa kombe të botës. Salih efendiu shkoi në Lindjen e Mesme, kurse i biri i tij, Fuati, së bashku me të shoqen, erdhi në Amerikë, dhe është vendosur në Nju Jork. Kohë më vonë erdhi në Amerikë edhe vetë Salih efendiu, dhe qëndroi tek i biri.”.

⁷ Po aty.

Familja e Salih Myftisë është nga të parat e Shkodrës, kurse ai vetë ka qenë myfti i Shkodrës dhe i Kosovës, titull të cilin e ruajti me dinjitet kudo që ndodhej dhe nën çdo rrethanë. Ai ishte, gjithashtu, edhe një nga eksponentët e Lëvizjes së Legalitetit, brenda dhe jashtë Shqipërisë.⁸

Gjatë qëndrimit të tij në Aleksandri, jo vetëm që ishte njohur dhe ishte çmuar prej njerëzve të rangut më të lartë fetar, por ishte kurdoherë i nderuar edhe në rrethet më të zgjedhura të aristokracisë së vendit, si dhe nga personalitetet më të njohura të botës arabe.

Në këto kontakte të nivelit të lartë, ai asnjëherë nuk kishte harruar ta theksonte çështjen e lirisë kombëtare, duke u përpjekur gjithnjë që për popullin e kombin tonë të krijonte sa më shumë miq, përkrahës dhe dashamirës.

Në mërgim, ka qenë ndër këshilltarët më të afërt të mbretit Zog i Parë, si dhe ka qenë njeriu që kishte ndihmuar shumë në realizimin e lidhjes midis mbretit Zog dhe krerëve të mërgatës politike shqiptare, e njohur si “Marrëveshja e Aleksandrisë”.⁹

Duke folur për mbresat nga njohja me Salih Myftinë, z. Nderim Kupi ka shkruar: “Ai ishte shumë i përgatitur, sa që qysh në atë kohë ka dhënë mësim edhe në Universitetin e Kajros.”¹⁰

Rrëfimin e vazhdon, Dr. Fuad Muftiu: “Babai nuk kishte probleme, dhe kishte shumë miq. Shumë studentë universitarë, të cilët babai i mësonte në shtëpi, vinin vazhdimisht, madje edhe nga 7-8 studentë së bashku.”

Kurse, Imam Vehbi Ismaili, në një libër të tij shkruan edhe këtë: “Kur ishim në Kajro, erdhën disa egjiptianë, doktorë e inxhinierë, diku ishin 4-5 veta, që të takoheshin me mua. Njëri prej tyre më pyeti:

- A je shqiptar?
- Po, - iu përgjigja unë.
- A e ke njohur filanin?

⁸ Xevat Kallajxhiu, gazeta “Dielli”, June 16, 1978, Boston Mass., USA f. 3.

⁹ Prenotimet e mbretit Zog, Hysen Selmani, Tiranë.

¹⁰ Intervistë e Nderim Kupit dhënë për Radio Shkodrën. Teksti ruhet te familja Myftiu. (Nuk kam mundur ta verifikoj këtë të dhënë, ndonëse e pohon edhe Imam Vehbi Ismaili dhe Dr. Fuadi. Ka gjasë se ky ka mbajtur mësim në xhami

- Po, - i thashë. Po, ju ku e keni njohur?
- Ne na mësonte gjuhën dhe filozofinë arabe dhe filozofinë e Kuranit,
- kishin treguar ata egjiptianët.

Imam Vehbiu kishte kryer Medresenë e Tiranës, kurse babai ishte njëri prej atyre që i firmoste diplomat. Me të atin e Vehbiut babai im kishte miqësi. Ai ka shkruar një libër, ku thoshte se ishte habitur se si një shqiptar në Egjipt, në gjuhën arabe, i mëson arabët, inxhinierët, doktorët. Këtë punë vetëm Salih ef. Myftija ka mundur ta bënte.¹¹

Fuadi tregon edhe për historikun e ndërtimit të xhamisë së Parrucës. Me ndërmjetësimin e babait, xhamia e Parrucës u ndërtua në vitin 1937.

Kujtimet e Imam Isa Hoxhës për ardhjen e Sali Myftiut në Amerikë

Më 8 korrik të vitit 1965 ishte përhapur lajmi se hirësia e tij, Salih Myftija, nga Egjipti do të zbriste në portin e Nju Jorkut, me vaporin Queen Ana Maria, në mënyrë që të qëndronte aty pranë të birit, Dr. Fuad Myftija dhe nipit të tij, Zijajt. Ne e pritëm me gëzim, si udhëheqësin tonë fetar më të shquar në Botën e Lirë.

Ardhja e tij në Nju Jork është pritur me entuziazëm të madh prej bashkatdhetarëve, pa dallim. Ndër bashkatdhetarë të besimit mysliman, pa dyshim, ngjalli një shpresë të madhe, ndërsa tek unë bindjen e plotë se së shpejti do të kishim mundësi t’ia fillonim një vepre të madhe: Organizimit të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Nju Jork dhe Nju Xhersi.

Thënë të vërtetën, unë u ndjeva shumë i lumtur kur ai pranoi ofrimin e bashkëpunimit tim për organizimin e sotëm: Qendrën - Xhaminë tonë dhe shkollën fetare për të vegjlit, po në të. Suksesi i këtij organizimi, është kryesisht i Salih Myftisë, i cili jo vetëm gëzonte nderimin dhe admirimin e gjithë shqiptarëve, por edhe, si atdhetar i madh, si fetar i bindur dhe si njeri i veprimit e vetëdije, sonte secilin pjesëtar të Komunitetit tonë, me

¹¹ Intervista e Dr. Fuadit dhënë për Dalip Ndrecën, botuar te Illyrija e Nju Jorkut, më datë 20 shkurt 2007. Autori i saj, Dalip Ndrecë, tashmë i ndjerë, ma pati dërguar materialin ashtu, “bruto”, për ta plotësuar me të dhëna për figurën e Salih ef. Myftisë.

vullnet të mirë e punë të përbashkët, mund ta printe në kryerjen e veprave të mëdha fetare e kombëtare.”¹²

Kujtimet e Kolonel, Xhemal Laçi për ardhjen e Sali Myftiut

Myftija i Shkodrës ishte larguar nga Shqipëria 21 vjet më parë. Ai kishte jetuar në Egjipt 12 vjet. Ditën kur kishte ardhur në Amerikë, një shumicë e konsiderueshme bashkatdhetarësh kishin dalë për ta pritur në port disa orë më herët. Ata ia përcollën përshëndetjet dhe i uruan mirëseardhje në Amerikë, në emrin e kolonisë sonë. Me këtë rast, për ta pritur hirësinë e tij, kishin dalë shumë personalitete, në mesin e të cilëve edhe Dr. Rexhep Krasniqi, kryetar i Komitetit “Shqipëria e Lirë”, z. Mexhid Dibra, sekretar i Komitetit “Shqipëria e Lirë”, z. Haxhi Xhilaga, kryetar i Këshillit të Vatrës, zotërinjtë e tyre, Hamza Drini e Muhedin Haxhiu, përfaqësues të Komitetit “Lëvizja e Legalitetit”, i përndershmi, Isa Hoxha, z. Neki Babani, dhe shumë e shumë bashkëqytetarë të tjerë, si dhe familja e tij.

Nuk dëshiroj të zgjatem me aktin mallëngjyes, kur plaku me mjekër të bardhë, i lodhur nga vuajtjet e emigrimit, përqafonte shqiptarët një nga një, duke i falënderuar për nderimin e tyre. Hirësia e tij kishte ardhur të qëndronte përgjithnjë në Amerikë, si shqiptarët e tjerë të ikur nga persekutimi komunist, e që janë strehuar e mirëpritur në këtë vend të lirë dhe bujar.

Kolonia shqiptare e Amerikës sot fuqizohet jo vetëm me një kler që përfaqëson denjësisht islamizmin shqiptar në mërgim, por dhe me një atdhetar e udhëheqës të rezistencës kundër okupatorëve të Shqipërisë. Ardhja e hirësisë së tij në Shtetet e Bashkuara e fuqizoi koloninë shqiptare me një personalitet moral e fetar të lartë, sepse këshillat dhe udhëheqja e tij fetare e kombëtare ishte shumë e nevojshme. Myftija, gjatë gjithë kohës që shqiptarët e kanë njohur, nuk ka predikuar tjetër përveç vëllazërimit, atdhedashurinë, moralin fetar dhe shoqëror, bashkimin dhe pajtimin mes shqiptarëve kudo që janë.¹³

¹² Imam Isa Hoxha, gazeta “Atdheu“, maj - qershor 1978, f. 1.

¹³ Kolonel, Xhemal Laçi, “Dielli”, më 11 gusht 1965, Nju Jork.

Përkujtimi për Nolin

Salih Efendiu, porsa kishte arritur në Nju Jork, dhe ende pa pushuar mirë, ishte ftuar në një përkujtim për Nolin, (i cili kishte vdekur më 13 mars të vitit 1965, në Floridë, që do të thotë pesë muaj para se të arrinte Salih Myftija në Nju Jork). Organizata Pan shqiptare “Vatra”, në tetor të vitit 1965, e fton për të marrë pjesë në një tubim rasti, e ai ndihet i nderuar dhe i përgjigjet ftesës duke shkuar dhe duke iu drejtuar të pranishmëve me një fjalë rasti, ku përveç tjerash tha: “Në çastin kur qindra shqiptarë, janë grumbulluar për ta përkujtuar njërën ndër figurat ma të shndritshme që ka prodhuar raca shqiptare, hirësinë e tij Fan Nolin, jam i lumtur që m’u dha rasti t’i them dy fjalë; jua përkujtoj se në vitin 1962 “Vatra” më ftoi të marr pjesë në kremtimin e 50 vjetorit të Lindjes së saj, e që ishte edhe 50 vjetori i Indipendencës sonë kombëtare, mirëpo fati dhe largësia e vendit nuk e përkrahën dëshirën time të marr pjesë në atë festim gëzimi. Kurse sot gjendem para jush, për me përkujtua një humbje të pazëvendësueshme, humbje që nuk asht vetëm për “Vatrën”, ose për Kishën Ortodokse Shqiptare, ose për miqtë e partizanët e jetës së tij politike; kjo vdekje asht një humbje e madhe për Shqipninë e përbashkët, për shqiptarët, pa dallim feje, ideje e krahine. Vdekja e At Nolit, udhëheqësit shpirtnuer t’Organizatës “Vatra”, kryetarit të Kishës Ortodokse Shqiptare n’Amerikë, poetit, shkrimtarit, dhe politikanit, krijoi një boshllëk në radhët e sotshme shqiptare.

Vëllazen shqiptarë! Vdekja asht një ligj hyjnor. Ajo nuk merr parasysh dhimbjet, as damet që ia sjell familjes, atdheut apo njerëzimit. Asaj nuk i shpëton askush. Ata që bahen të pavdekshëm, janë veprat dhe kujtimet e mira, me të cilat njeriu kalon në histori, e Fan Noli ka kalue në historinë shqiptare dhe asht rreshtue me herojt dhe krijuesit e Rilindjes sonë kombëtare. Herojtë nuk qahen, ata ndiqen dhe bahen shembuj për brezin e ardhshëm.

Me këtë besim e kujtim po e mbyll periudhën e jetës së hirësisë së tij, Fan Nolit, tu iu drejtu të Madhit Perëndi, së bashku me ju: “O Zot i Madh, i ynë, o Fuqploti Perëndi! Në këtë ditë asht mbledh e grumbullue një numër i madh shqiptarësh për me t’u lut Ty për shpirtnat e atyre që u banë

fli për të mirën e Shqipnisë dhe të popullit shqiptar. Gjithashtu, të lutem ty, o Zot i Madh i ynë, që t'i mbrosh nga çdo rrezik Shtetet e Bashkuara t'Amerikës, që asht i vetmi shtet në mbrojtje të lirisë e të demokracisë, dhe me aq vrull i ka hap krahët dhe ka strehu mijëra shqiptarë, tue ua dhanë mundësinë me jetue si njerëz të lirë në një shtet të lirë! Amin!"¹⁴



Salih Myftija, çdoherë ishte aktiv edhe në përpjekjet e shqiptarëve për çështjet madhore të kombit. Do të nënvizojë këtu një moment kur, ai merr pjesë në Kongresin e parë të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, në mërgim, në Nju Jork, më 26-27 nëntor të vitit 1966, kur kryetari i Kongresit, z. Xhafer Deva, iu lut hirësisë së tij, Salih ef. Myftija, që ta marrë fjalën dhe të bëjë lutje fetare të përshtatshme të rastit. Salih efendi Myftija aty e mban këtë ligjëratë: “Z. kryetar! Të ndershëm delegatë dhe të dashtun bashkatdhetarë, ju falënderoj ngrohtësisht që pata fatin me marrë pjesë në këtë Kongres historik, dhe për rastin që me jepet që t’i drejtohem këtij Kongresi. Asht një kënaqësi shpirtnore, e një detyrë morale dhe kombëtare, për të gjithë shqiptarët, dhe veçanërisht për personin tim, që në rastin e këtij Kongresi të parë në mërgim, me u gjetë në mes jush, delegatë të Kongresit. Prezenca ime në gjinin tuaj paraqet një kuptim dhe sentiment simbolik, tue sjellë para syve periudhën në të cilën pata nderin me kenë Kryemyftija

¹⁴ Gazeta: “Atdheu”, tetor 1965, f. 5.

i Shkodrës dhe i Kosovës, në një kohë kur Shqipnia kishte lirinë dhe ishte e pamvarun, por ishte me kufijtë e saj te caktuem me padrejtësi prej Fuqive të Mëdha Evropiane. Megjithatë, bashkimi i Kosovës me Shqipninë për ne shqiptarët e Shqipnisë së 1913-s asht dhe do të jetë objektivi kryesor për çdo aktivitet politik, në çdo kohë dhe çdo vend. Përderisa të zhduket zgjedha e barbarizmit sllav-komunist, që peshon randë mbi supet e popullit të Kosovës. Kosova djep i shqiptarizmit, në të kaluemen e ka shkruar historinë me gjakun e dëshmorëve të vet kundër sundimit të huej dhe për një Shqipni Ethnike, e që po e vazhdon edhe sot. Qëllimi për të cilin ranë dëshmorë burrat e saj ma të mirë asht sot ma i gjallë se kurrë. Për të nderue dhe respektue atë gjak të dëshmorëve, për t'i mbajtur premtimet me realizue andrrën shekullore të Shqipnisë Ethnike, pjesëmarrja juej në këtë Kongres, paraqet një provë të gjallë, mbasi ju e kuptoni mirëfilli randësinë e këtij Kongresi për një Shqipni Ethnike të ardhshme. Jam krejtësisht i bindur se vendimet e jueja historike, përpuqen me mendimet e popullit shqiptar në përgjithësi.

Për këtë qëllim, po i drejtohem të madhit Perëndi, me një lutje: “O Zot i Madh i ynë, Perëndi i Plotfuqishëm, të lutemi përvujtënisht, na i prano lutjet tona! O i Madhi Perëndi, e pranojmë që jemi me të meta dhe karshi Fuqisë Tande nuk jemi asnjë send! O i Madhi Perëndi, na i drejto mendjet tona në të mirë, na i dëlir zemrat tona! O i Madhi Perëndi, Ju e dini ma mirë se liria dhe pavarësia e Shqipnisë ka humb tash për tash, dhe ju lutemi t'i drejtoni përsëri shqiptarët e ndershëm dhe patriotë në rrugën e bashkimit për rifitimin e një Shqipnije Ethnike me Kosovën e Çamërinë! Amin!”¹⁵

Në Nju Jork Salih Efendiu iu përvesh punës, së bashku me shumë të tjerë, për ta themeluar një qendër islame shqiptare në atë qytet, ku do të sigurohej jo vetëm një vend për ta falur namazin, por edhe një vend për t'i mësuar fëmijët mbi fenë dhe gjuhën shqipe. Ëndrra e tij u realizua më në

¹⁵ “Kongresi i Parë i Lidhjes së Prizrenit në Mërgim” f. 8. Printed in USA by Waldon Press. INC N.Y.C. 1966.

fund: më 12 nëntor të vitit 1972 u bë inaugurimi i Xhamisë së Re në Nju Jork, kurse Salih Efendiu e kishte prerë shiritin..¹⁶

Ai, me aftësitë e tij ishte bërë inspirim dhe udhërrëfyes për punën e mëtejshme të këshillit provizor. Kongresi i Parë, i mbajtur më 16 maj të vitit 1966, unanimisht e kishte zgjedhur kryetar shpirtëror dhe kryetar nderi të Qendrës Islame. Me ndihmën e intelektualëve shqiptarë më pas u hap edhe e para shkollë fetare-kombëtare, ku Salih Myftija, përkundër moshës që kishte, nëpër vapë e nëpër të ftohtë, asistonte në çdo orë mësimi që mbahej.

Ngritja e xhamisë, krijimi i Komunitetit Mysliman për shqiptarët e Amerikës, hapja e shkollës së parë fetare-kombëtare për fëmijët e shqiptarëve të Amerikës, janë dëshmi e një përkushtimi të lartë fetar e atdhetar të tij. Në veçanti, më 12 nëntor të vitit 1972, që ishte një ditë tjetër gëzimi dhe krenarie për shqiptarët e Nju Jorkut - Nju Xhersit, pasi pas shumë përpjekjeve dhe sakrificave, në tokën e lirë të Xhorxh Vashingtonit, u realizua ëndrra e besimtarëve myslimanë, njëherazi e të gjithë shqiptarëve të mërguar, inaugurimi i Xhamisë Shqiptare.

Reporter i gazetës “Atdheu” përshkruan edhe atmosferën festive të asaj dite të shënuar: “Që në orët e para, pasdite, njerëzit filluan të vijnë grupe-grupe, disa prej tyre të veshun me kostume kombëtare, që linin të kuptohej se ky ishte një tubim krenarie për të gjithë shqiptarët e mërguem në këtë trevë. Me këtë rast, pasi çdo gjë ishte gati, kryetari Qendres, Z. Kumbarçe, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje, ia dha hirësisë së tij, Salih Efendi Muftija, gërsërët e bardhë, për ta prerë shiritin, të cilin e mbajshin dy nxënës të shkollës fetare-kombëtare shqipe të Nju Jorkut.

Kryetar Nderi i kësaj Qendre ishte udhëheqësi i shquari, hirësia e tij, Salih Myftija, ndërsa imami i kësaj Qendre ishte i përndershmi, iman Isa Hoxha, i cili për 10 vjet rresht i shërbeu komunitetit shqiptar me dinjitet dhe pa asnjë shpërblim.¹⁷

¹⁶ Xevat Kallajxhiu, gazeta Dielli, June, 16. 1978, Boston Mass, USA, f. 3.

¹⁷ Musli Mulosmani, gazeta “Atdheu”, mars - prill 1973, f. 3.

“Këtë ngjarje e përcollën duke qenë aty: reporteri i “Zërit të Amerikës” në Washington z. Joseph Paskal, korrespondenti i “Nju Jork Tajms”, si dhe drejtori për punë ballkanike z. E. Robert Kessle, si dhe korrespondenti i “Daily News”, z. Jacob”¹⁸

“Të vetmet gjëra që munguan dje, ishin malet e thepisura të vendlindjes së tyre dhe një myezin që do të thërriste besimtarët në lutje nga një minare, kur myslimanët shqiptarë të Nju Jorkut dhe Nju Xhersit, hapën xhaminë e tyre të parë këtu. Xhamia është në 1325 Albermale Road, në seksionin Flatbush të Brooklyn, dhe përmes ndërtesës së adaptuar në komunitetin kryesisht hebre dhe italian, nuk ka minare. Të devotshmit u gëzuan, sikurse Myftija i Madh Shqiptar në Botën e Lirë, 80-vjeçari, Salih Myftija, që e preu shiritin...”¹⁹

Si e njohën të tjerët Salih Myftiun

Salih Myftija ishte fetar i devotshëm, fisnik i shquar, atdhetar i rrallë dhe i përvuajtur, i cili edhe në minutën e fundit të jetës së tij u dallua për kthjelltësi ndjenjash, shpirtmadhësi e zemërgjerësi, durim e shpresë. Ai ishte shembull i gjallë virtytesh për t’u ndjekur, siç pohojnë ata që e kanë njohur, ata që kanë punuar dhe që kanë jetuar me të. Fatmirësisht në Nju Jork, ende ka njerëz që punuan me të dhe e njohën për së afërmi. Me disa prej tyre edhe kemi pasur rastin të bisedojë.

Prandaj, në vazhdim po e sjellim bisedën me Qazim Mustafanë, i cili ishte anëtar dhe kryetar i Këshillit të xhamisë në Bruklin, dhe i cili e ka njohur Myftinë që ditën nga dita e parë kur ai migroi në ShBA. Për më tepër, ai thotë se e ka pasur edhe vendës, sepse edhe familja e tij ishte me origjinë nga Kraja.

Qazim Mustafa tregon se Salih Myftija gjithmonë këshillonte duke thënë se kur të shkohet në xhami, të kihet kujdes, të harrohen kundërthëniet partiake, politike dhe racore. Ai ishte i prerë në këto pika. Mirëpo, ai ishte edhe i afërt, e jo mendjemadh. Kur ai ishte në mimber, në hytbe të

¹⁸ Revista “Përpykja e jonë”, nr.4, 12. November 1972, f. 134, Nju Jork.

¹⁹ Nju Jork Times.

xhumasë, tërhiqte vëmendjen dhe i të bënte për vete tërë masën, me përmbajtjen e fjalëve të tij, të shprehura ngadalë, qartë e me plot kuptim. Prandaj, ishte e vështirë që mos t'i merrej këshilla. Ai ishte optimist, dhe thoshte se një ditë do të faleshim edhe në Shqipëri, edhe pse tashti ishte e ndaluar nga regjimi komunist. Ajo ditë erdhi, por ai nuk e priti.”²⁰

Kujtimet e Osman Osmanit për Salih Myftiut

Salih Myftinë e njoha që nga viti 1968, atëherë kur erdha në Amerikë. Ai kishte ardhur në Nju Jork tre vjet para meje. Me një rast të festës së Bajramit të Vogël, e kishin marrë arabët një sallë hoteli, në 34 street në Manhattan, për ta falur Bajramin. Unë shkova aty me plot emigrantë të tjerë shqiptarë. Kur shkova aty, e pashë një hoxhë me shall dhe xhybe, si-kurse ishte uniforma e një hoxhe te ne. I kishte hije, dhe dukej mjaft i përgatitur. Ky ishte Salih Efendiu, i cili e fali namazin dhe e mbajti hytben e Bajramit. Unë u befasova, dhe i pyeta disa shqiptarë se kush ishte ky hoxhë që po printe edhe para arabëve, e disa më thanë se ishte ish myftiu i Shkodrës dhe i Kosovës. Iu afrova, dhe me gëzim të madh ia urova festën. Më pyeti nga isha, e unë i tregova se isha nga Kosova, se ai ma ktheu duke më thënë: “Eh, ajo është përherë në zemrën time.”. Që nga ajo ditë me të dhe me djalën e tij Fuadin u bëmë miq.²¹

Ndërsa, **Ndrec Gjergji**, sekretar Administrativ i Legalitetit, thoshte: “Ne shpesh e vizitonim Myftinë, edhe katolikë, edhe myslimanë, ndërsa për një Bajram shkuam me Bardhok Ndreun dhe disa të tjerë për urime. Ne nuk flisnim, por e ngacmonim atë për të biseduar, sepse kishe lezet ta dëgjoje. Ai tërë jetën e kishte interesante. Ai ishte një mbretëror i devotshëm, dhe kishte bërë shumë punë për Legalitetin dhe mbretin. Por, shpesh tregonte disa ngjarje, si thoshte ai, më të veçanta. Kështu, pasi na shërbeu me ëmbëlsirat e Bajramit, e filloi bisedën: “Më thirri një ditë mbreti Zog, pasi parlamenti shqiptar e kishte aprovuar heqjen e ferexhesë, dhe unë isha kundër, dhe mendova se do të më kërkonte falje, apo shpreh-

²⁰ Bisedë e zhvilluar në Nju Jork, më 8 maj 2022.

²¹ Deklaratë e dhënë në Nju Jork, më 15 mars 2020 E.O.

te keqardhje. Shkova me gëzim. Pasi hyra dhe u përshëndeta, m'u drejtua naltëmadhnija e tij, mbreti Zog, dhe më tha: "Myfti efendi, e more vesh se parlamenti shqiptar votoi për heqjen e ferexhesë?". - "Po", - ia ktheva, - "Unë e di se ti je atdhetar i shquar, besimtar i dalluar dhe mbretnor i devotshëm, dhe për të gjitha këto ke dhënë prova, prandaj në emër të këtyre, ti do të shkosh në Shkodër, dhe nesër, për festen e Bajramit, do të dalësh me shoqen tënde, ajo pa ferexhe, me e festua Bajramin!". Kjo më befasoi. U shtanga, humba i tëri. Vetëm kur më pyeti përsëri: "A je dakord?", - e mora veten. "Po", - i thashë. Më pëlqeu apo nuk më pëlqeu, unë e aprovova. Këtë e bëra për Shqipëri.". Ne na thoshte mos të dorëzoheshim dhe mos të ligështoheshim, sepse atdheu kërkonte sakrifica të mëdha. Ai na mbushte me optimizëm, na e mbante moralin, na ofronte dhe ruante kompaktësinë në Komunitet, pavarësisht dallimeve fetare, krahinore, apo partiake."²²

Vitet e fundit të jetës së Sali Myftiut

Vitet e jetës, vuajtjet e shumta në mërgim, ndarja nga fëmijët dhe e shoqja dhe dënimet e internimet kishin lënë pasoja të paimagjinueshme në personalitetin e Sali ef. Mysftisë. Mirëpo, mbi të gjitha, ishte mosrealizimi i ëndrrës së tij për Shqipërinë Etnike plagë që e kishte lodhura prej kohësh.

Ai, në një telegram që ia dërgoi kryetarit të Bashkimit Demokrat Shqiptar, z. Isa Elez Ndreut, më 30 korrik të vitit 1974, nga Nju Jorku shpreh molisjen shëndetësore. "I dashtun z. Ndreu! Kam marrë letrën tuej të datës 5, të vazhduesit, me anën e së cilës më ftoni të marrë pjesë në Kuvendin e Bashkimit Demokrat, e që do të mbahet në Firencë, në shtatorin e ardhshëm. Fatkeqësisht, gjendja shëndetësore dhe distancat e largëta nuk më lejojnë të jemi pranë jush dhe bashkatdhetarëve tanë, në punimet e Kongresit, por me anën e kësaj letre vij me dërgua urimet e mija ma të përzemërta për një sukses të plotë, i bindun se diskutimet dhe vendimet e marra do të janë të frymëzueme kurdoherë në interesin e naltë të Atdheut

²² Bisedë me Ndrec Gjergjin, Sekretar administrativ i Legalitetit, Long Island, më 22 mars 2022.

dhe të Popullit Shqiptar. Tu e përfundue me kaq, ju dërgoj përshëndetjet dhe të falat e mija të përzemërta, si juve, ashtu edhe Këshillit Drejtues Provizor, si dhe të gjithë bashkatdhetarëve prezent në atë Kuvend. Miqësisht, i jueji Salih Myftija. Nju Jork, 30 korrik 1974!”²³

I biri, Fuadi rrëfen: “Ditët e fundit të jetës së tij ndihej i lodhur, mirëpo mendjen e kishte të freskët. Vinin njerëz për ta vizituar pa ia nda. Një nga rastet e shumta ishte edhe kur kishte ardhur imam Isa Hoxha me Qazim Mustafën. U gëzua dhe filloi muhabetin me ta. Në bisedë e sipër ai ua tha atyre: “Vdekjen e kemi afër, prandaj kur të vdes unë, kam dëshirë me m’i ba tri gjana: të më vishni me qefin, të më mbuloni me dërrasa, e jo me sanduk, dhe mos të më sillni kunora lulesh!”. Imam Isai e pyeti: “Për dëshirën e dytë, a e ke pa nëpër qitape, se është e ndaluar me hy në dhe me sanduk, sepse nëse nuk na lejon rregulli i varrezave, nuk mundemi të ta plotësojmë atë dëshirë?”. – “Jo”, - i tha babai, - “nuk është haram, por dëshirë imja.”. Fuadi tregon, se nuk mundën t’ia plotësonim dëshirën e dytë dhe të tretë. Të dytën nuk na lejonin rregullat e varrezave. Ndërkaq të tretën sepse nuk kishte pasur mundësi t’u thoshte njerëzve që mos t’i sillnin kurora. Ishte një pjesëmarrje masive e popullit. Prandaj, në shtëpinë e funeralit erdhën shumë kurora. Një kamion ishte mbushur me kuro-ra, mirëpo, për përmbushjen e amanetit të fundit, e ndihmoi Perëndia. Në atë kohë nuk kishim JPS, dhe shoferi i kamionit me lule e kishte humbur rrugën, dhe nuk kishte ardhur fare në varrim. Përfaqësuesi i funeralit ua shpjegoi rastin të pranishmëve, duke kërkuar falje, ndërsa ne që e dinim amanetin e tij u gëzuam që Allahu ia plotësoi dëshirën.”²⁴

²³ Kuvendi i parë në mërgim, i Bashkimit Demokrat Shqiptar, Firencë, Itali, më 6-7-8 shtator 1974. Nën editimin e Lec Shllakut, “Koha jonë”, Poste restante 109 Bd. Murat-Paris 100, Francë.

²⁴ Deklarate e Fuad Myftiut dhënë autorit, E. O., Quens, 2005.

Përveç gazetës “Atdheu”, pothuajse të gjitha gazetatat në gjuhën shqipe që botoheshin në Amerikë e shënuan vdekjen e tij, e ndër to po i zëmë në gojë: “Dielli”, “Shqiptari i lirë”, “Lidhja e Prizrenit”, po edhe shumë të tjera. Nga gazeta “Atdheu” janë shkëputur pjesë të folësve të ndryshëm me rastin e ndarjes nga jeta të Salih Myftisë, sepse ai ishte një figurë poliedrike:

Zef Pashko Deda

“Salih Myftija ishte udhëheqës dhe përfaqësues organizatash dhe partish politike, shoqatash kulturore dhe patriotike, por në jetën dhe në shpirtin e tij, Fe e Komb shkonin çift, pa ia zanë kurrë vendin njëra-tjetrës. Ai ishte udhërrëfyes i denjë në punë fetare sa ç’ishte prijës i pashoq dhe pionier i shumë veprimtarive kombëtarë, kurdo që vendi u gjet në rrezik”.²⁶

Hysen Mulosmani:

“Dita e sotme është një ndër momentet më të vështira të jetës sime, sepse në emër të Organizatës Kombëtare “Lëvizja e Legalitetit”, për t’i dhënë përshëndetjen e fundit, dal para trupit të ftohtë të një atdhetari të madh dhe të panjolla, të një fetari të dedikuem dhe të një besimtari në Fuqinë e të Madhit Zot, si dhe të idealeve të larta kombëtare. Vepra e kryer prej tij, në të gjitha fushat e përpjekjeve tona, po edhe emri i tij, do të shkruhet me shkronja të arta, do të qëndrojë lart e me krenari në altarin e kombit. Më dridhet zemra, kur jam i vetëdijshëm se fjalët e mia sot janë aq të varfra dhe në pamundësi ta përshkruajnë siç duhet jetën dhe veprat gjigante të myftiut tonë të nderuar, i cili po ndahet prej nesh, duke na lënë si jetimë, të vetmuar, po edhe për krye të gjitha ankimeve tona. Megjithatë, nuk na mbetet gjë tjetër përveçse të pajtohemi me dëshirën e të Madhit Zot, që më në fund vendosi që besimtarin e Tij ta marrë pranë Vetes. E ne, përsëri i jemi mirënjohës të Plotfuqishmit, që për afër një shekulli e kishim si dhuratë prej Tij, prandaj sipas veprave që ka kryer, ka mbetur

²⁶ Zef Pashko Deda, Gazeta “Atdheu”, maj-qershor 1978, f. 2, Nju Jork.

dhe do të jetë një legjendë e pavdekshme dhe simbol lirie për brezat e ardhshëm.”²⁷

Ruzhdi Daka:

“Banorët e qytetit historik të Shkodrës përgëzoheshin dhe mburreshin me ju, si pasqyrë ndjesish më të pastra fetare e kombëtare. Në mërgimin tonë të hidhur keni dhanë kurdoherë shembullin më të mirë të njeriut të urtë, të durueshëm dhe të arsyeshëm. Në kampet e të ikurve politike shqiptarë në Itali, me të mërguarit tanë në Aleksandri, këtu në Amerikë, po edhe kudo ku shkeli këmba jote, keni lënë shembullin më të bukur, kujtimet më të paharruara, si dhe këshillat me vlerë e të përhershme. Biseda që zhvilloje me të gjithë, gjithmonë e gjithkund, ishte e ëmbël, e qetë dhe e gëzueshme. Ndër trevat tona dhe hidhërimet e mërgimit shqiptar ti ishe bërë shtyllë e pathyeshme durimi e qëndrese, gurrë e pashtershme besimi e shprese, për kthesa të reja e rrokullisje motesh më fatbardha për fe, atdhe e njerëzimin mbarë.”²⁸

Dr. Rexhep Krasniqi:

“...I ndjeri Salih Efendi, nuk ka qenë vetëm një udhëheqës i shquar fetar i Shkodrës sonë të paharrueshme, por edhe një atdhetar i dedikuar, i cili me përgatitjen e tij të përsosur klasike fetare i ka shërbyer me zotësi, me dashuri dhe me dinjitet të rrallë çështjes fetare, dhe njëkohësisht atdheut dhe popullit shqiptar për shumë vjet. Përkulem me nderim dhe respekt të thellë para trupit të tij, me bindje të patundur se emri dhe vepra e Salih Efendiut, myftisë së Shkodrës, në sheshin fetar e atdhetar, herët a vonë, do të kujtohet me nderime nga populli i lirë shqiptar.”²⁹

Dr. Selaedin Velaj:

“Salih Myftija gjithë jetën e tij ia dedikoi atdheut dhe fesë. Ai me vullnet të hekurt e me mendje të mprehtë dhe atdhedashuri të pashoqe

²⁷ Hysen Mulosmani, Gazeta “Atdheu”, maj-qershor 1978, f. 2-3.

²⁸ Ruzhdi Daka, Gazeta “Atdheu”, po aty.

²⁹ Dr. Rexhep Krasniqi, Gazeta “Atdheu”, po aty, f. 4.

ishte shembull për ne të gjithë, që të punojmë vazhdimisht për lirin e atdheut tonë të mjerë.”³⁰

Sami Çaushaj:

“Ky personalitet nuk është një person ordiner. Fytyra fisnike e Salih Myftisë ka dominuar politikën dhe fenë myslimane shqiptare për më shumë se një gjysmë shekulli, si në Shqipëri, ashtu edhe në migrim. Shqipëria dhe feja myslimane humbet një fytyrë të shkëlqyer, dhe miqtë besnikë, që për 34 vjet në emigracion, jo vetëm e shikonin te Salih Myftija një shqiptar të madh, por edhe një udhëheqës moral e shpirtëror të pazëvendësueshëm. Me humbjen e Salih Myftisë Shqipëria etnike dhe feja islame shqiptare humb një njeri të madh, dhe miqtë e vegjël shqiptare humbin mikun dhe shpresëdhënësin e palodhur deri ditën e vdekjes së tij.”³¹

Dr. Gjon Buçaj:

“Rrethanat e ngjarjeve të atdheut ia sollën fatin të përjetojë internim, jetë mali dhe, më në fund, edhe mërgim, e ditët e fundit i kaloi duke pritur burrërisht ndarjen nga kjo jetë, i rrethuar nga dashuria e të birit, familjarëve, megjithëse i djegur nga malli për vendlindjen. Kush e ka njohur, e kujton si besimtar të bindur, burrë tradite, të ndershëm e me karakter, si dhe armik të vendosur të ateizmit komunist. Kujtimi i veprave të tij të mbara dhe i cilësive të tij të mira urojmë të jetë frymëzim për brezat e ardhshëm.”³²

Ing. Muhamet Cungu:

“Njeriu në këtë botë lind për të vdekur, dhe shumica e njerëzve vdesin dhe shpejt harrohen, e një pjesë mbetet e pavdekshme nga veprat dhe gjurmët që ka lënë. Ndër këta të paharruarit do të mbetet edhe emri i Salih Myftisë, sepse veprat e tij janë të shumta, sikur thanë edhe shumë të tje-

³⁰ Dr. Selaedin Velaj, Gazeta “Atdheu”, po aty, f. 4.

³¹ Sami Çaushaj, Gazeta “Atdheu”, po aty, f. 4.

³² Dr. Gjon Buçaj, Gazeta “Atdheu”, po aty, f. 4.

rët. Mirëpo, ajo më e rëndësishme këtu është krijimi i Qendrës Islame Shqiptaro-Amerikane. Kjo ka qenë përgjigjja më e përshtatshme ndaj Qeverisë së Tiranës, e cila pa përfillur sentimentin e popullit shqiptar, pa respektuar ndjenjat dhe aspiratat shpirtërore të popullit, e shpalli Shqipërinë shtet ateist.”³³

Adem Hodo:

“Ndër shumë të tjera, ajo që e karakterizonte kryetarin e humbur sot ishte afrimi dhe bashkëpunimi me besimet e tjera monoteiste, pasi që të gjitha së bashku janë pjesë të pandara të gjakut tonë vëllazëror. Kur zaptuesit, njëri pas tjetrit, filluan ta thyjnë qafën, dhe kur komunizmi antikombëtar dhe antifetar rritej si kërpudhat e vjeshtës, anë e mbanë vendit, hirësia e tij, Salih Myftija, bashkë me librin e shenjtë Kuranin, rroku pushkën dhe ngjeshi rripin me fishekë. Humbja e tij është humbje për gjithë nacionalizmin shqiptar.”³⁴

Xevat Kallajxhiu:

“Salih Efendiu ishte fetar i dalluar, me sjellje bujare dhe i ruante me rigorozitet traditat e fisnikërisë dhe të mikpritjes shqiptare. Ai ishte i urtë dhe gojëembël me të gjithë, se e kishte shpirtin e butë, të zhuritur nga malli për familjen, për Shkodrën, për Shqipërinë. Ai u mbajt kurdoherë i fortë. Salih Efendiu nderohej pothuajse prej të gjithë shqiptarëve. Salih Efendiu ishte më i shkuari nga mosha në radhët e njerëzve të emigracionit shqiptar të pas Luftës së Dytë Botërore, por megjithëkëtë, deri në ditën e fundit të jetës së tij, ai nuk e humbi as fjalën e as mençurinë. Nuk e humbi as edhe ndjenjën e humorit të hollë. Nuk ka dyshim se mungesa e tij do të ndihet për një kohë të gjatë.”³⁵

Për meritat e tij fetare dhe kombëtare, trashëgimtari për fronin mbretëror, **Leka Zogu, e dekoroi Salih Myftinë me Dekoratën “Kordoni i Madh i Skënderbeut”.**

³³ Ing Muhamet Cungu, Gazeta “Atdheu”, po aty, f. 4.

³⁴ Adem Hodo, Gazeta “Atdheu”, po aty, f. 4.

³⁵ Xevat Kallajxhiu, Gazeta “Dielli”, 16 qershor 1978, Boston Mass., USA, f. 3.

Gazeta “Atdheu” shkruan: “Dekorim i merituar”. Gjatë një kalimi që pati Madhënia e Tij Leka I - mbreti i Shqiptarëve, korrikun që kaloi në Vashington dhe Nju Jork, i shoqnuem nga kolonel Xhemal Laçi, përfaqësues i tij në ShBA, Dr. Fuad Myftija, sekretar i përgjithshëm i OKLL-së dhe z. Abedin Mulosmanaj, drejtor i gazetës “Atdheu”, i bani një vizitë në spital hirësisë së tij, Salih Myftisë, me të cilin rast i akordoi dekoratën e “KORDONI I MATH” të Urdhnit të Skënderbeut, për meritat e nalta që hirësia e tij ka në fushën e përpjekjeve tona fetare-kombëtare. Gjesti i sovranit tonë është një dëshmi e pamohueshme për kujdesin që ka për figurat e shkëlqyeshme të përpjekjeve tona kombëtare. Urojmë me gjithë zemër hirësinë e tij, Salih Myftijnë, për dekoratën më se të merituar, dhe ta mbajë për shumë vjet në gjoksin e tij krenar, si shpërblim për veprat e tij të larta për fe, atdhe, komb e mbret!”³⁶

Në Shqipëri u deshën vitet e demokracisë që emri i këtij burri të shquar të kombit tonë të nderohej e të vlerësohej. Për këtë **ai u dekorua prej presidentit të Republikës me medaljen “Pishtar i Demokracisë”**.

E përfundojmë këtë shkrim në përkujtimin e një figure siç ishte Salih Myftija, i cili fe e atdhe i vuri mbi çdo gjë. Këtij binomi i shërbeu me vendosmërinë më të madhe dhe me vetëmohim gjatë gjithë jetës së tij gati shekullore. Për bashkatdhetarët e tij, pa dallim, ai derdhi energjitë më të zgjedhura të mendjes dhe të veprimit, fali ndjesitë më fisnike të zemrës dhe të shpirtit, dhe kështu, me të drejtë, u llogarit një patriot i madh dhe një udhëheqës shpirtëror, një prej më të çmuarve dhe më të nderuarve që pati populli ynë.

Nju Jork, 2022

³⁶ Gazeta “Atdheu”, nr. 50-51, Nju Jork, nëntor 1977.

Sabri BAJGORA

ANALIZË E TRI FLETOREVE NË DORËSHKRIM, TË SHKRUARA NGA DORA E SALIH EF. MYFTISË

Abstrakt

Në ditët e sotme, ende nuk kemi një përfytyrim real rreth vlerës së mirëfilltë të shumë dorëshkrimeve të çmueshme, që vazhdojnë të qëndrojnë të pastudiuara nëpër bibliotekat apo koleksionet private. Sigurisht, shumë prej njerëzve ndoshta edhe nuk janë të vetëdijshëm se çfarë thesari i madh fshihet në to. Ndoshta për faktin se një koleksion dorëshkrimesh mund t'i duket syrit tonë thjesht vetëm si një grumbull fletësh të pluhurosura dhe të padobishme. Mbase kjo gjendje e mjerueshme e shumë dorëshkrimeve, ka qenë shkaku i zhdukjes së pakuptimtë të shumë vlerave kolosale të dijetarëve tanë përgjatë shekujve. Por, në rastin konkret, kur bëhet fjalë për disa dorëshkrime të myftiut të Shkodrës dhe një pjese të Kosovës, Salih ef. Myftisë, njërit prej figurave më të mëdha historike fetare dhe kombëtare, për fatin tonë të mirë, janë ruajtur disa fletore të tij në dorëshkrim. Këto fletore të ruajtura me kujdes, nga periudha të ndryshme kohore, përshkruajnë vuajtjet e një njeriu, i cili pjesën më të madhe të jetës e kaloi larg familjes, fëmijëve dhe larg atdheut, gjithnjë duke punuar që të kthehej sërish në të, për ta çliruar nga zgjedha ateiste-komuniste.

Në këtë kumtesë, do të analizojmë në pika të shkurtra, tri fletore në dorëshkrim, të mbushura me shënime të vlefshme nga dora e Salih ef. Myftisë, të shkruara gjatë qëndrimit të tij në Siri, Egjipt dhe ShBA.

Fjalët çelës: *Salih ef. Myftia, fletore, dorëshkrim, mërgata, , etj.*

Tri fletoret në dorëshkrim, që iu dhuruan bibliotekës së IHSI-së në nëntor të vitit 2021, nga nipi i Salih ef. Myftisë, z. Ahmet Hoti, me ndërmjetësimin e veprimtarit tonë të çmuar në SHBA, prof. Elez Osmanit, paraqesin një pasuri të madhe të trashëgimisë sonë islame. Pikërisht për këtë arsye, do të përpiqem që të zhytem në thellësitë e shkrimeve që gjenden në to, për të bashkëndjerë emocionet, vuajtjet dhe kalvarin jetësor nëpër të cilin kishte kaluar myftiu i nderuar.

I brumosur me ndjenjat e atdhedashurisë, të cilat i kishte trashëguar nga familja e tij e nderhme, e i fuqizuar edhe me ndjenjën fetare nga kolosët më të mëdhenj të fesë në Shqipëri, si haxhi Vehbi Dibra e të tjerë, ai ishte pozicionuar me trup dhe me shpirt kundër pushtimit të Shqipërisë nga italianët, ashtu siç ishte edhe më i zëshëm kundër ideologjisë komuniste që kishte filluar të instalohej dhunshëm në mesin e një pjese të popullatës në Shqipëri.

Pas largimit të Mbretit Zog nga Shqipëria, Salih ef. Myftia, si njëri ndër njerëzit më të afërt të tij, ishte në krye të një grupi intelektualësh dhe atdhetarësh, që me sugjerimin e Mbretit, lëshuan Shqipërinë, për ta organizuar nga jashtë rezistencën e armatosur.

Salih ef. Myftia, duke qenë i bindur se pushtimi italian nuk do të zgjaste, e për të mos i lënë hapësirë ideologjisë komuniste të instalohej në Shqipëri, la atdheun dhe ia mësyu mërgimit, duke lënë pas në Shkodër bashkëshorten me fëmijë, djem dhe vajza. Me vete mori vetëm djalin e madh Fuadin, i cili më vonë do të shkollohej dhe do të doktoronte në Itali, për të qenë në shërbim të legalitetit dhe të çështjes kombëtare, deri në vdekje.

Salih ef. Myftia kur u largua nga Shqipëria, me vete mori vetëm disa libra, që i kishte parë si të domosdoshme t'i kishte pranë vetes. Por, për t'ia lehtësuar vetes dhimbjen e mërgimit, ai filloi të shkruante shënime personale, pjesë të ligjëratave fetare, si dhe shkresa zyrtare, në disa fletore, të cilat tashmë i kemi në Arkivin e IHSI-së. Për të pasur qasje më të lehtë në analizën e tyre, i kemi shënuar ato me numra, 1, 2 dhe 3, dhe nga shënimet nëpër to, do të shohim dromca të historisë dhe të veprimtarisë së tij të bujshme fetare dhe kombëtare.


Për të bërë një analizë të detajuar të tri fletoreve në dorëshkrim nga Salih ef. Myftia, duhet të shqyrtojmë disa aspekte kryesore: përmbajtjen, stilin e të shkruarit, dhe kontekstin historik dhe kulturor.

Pikërisht, duke u nisur nga këto premisa, shohim se fletoret e Salih ef. Myftisë, kanë një vlerë të madhe në shumë aspekte. Nëpërmjet tyre do të gjejmë copëza nga historia dhe kultura, që flasin për periudha të ndryshme kohore, si dhe për zhvillimet kulturore, sociale dhe politike të një periudhe të caktuar.

- Këto fletore na ndihmojnë edhe në dokumentimin e periudhës historike dhe të rrethanave që e kanë detyruar autorin të largohet nga vendlindja e tij. Dorëshkrimet e tij janë dokumente të rëndësishme historike që ndihmojnë në rindërtimin e ngjarjeve dhe përvojave të asaj periudhe. Ato ofrojnë një perspektivë të drejtpërdrejtë dhe autentike mbi jetën dhe mendimin e një intelektual shqiptar në mërgim.
- Në to do të gjejmë tema të ndryshme fetare, si tematika nga Kurani, hadithi, tefsiri, historia islame, filozofia, etj.
- Në këto dorëshkrime hasim po ashtu shkrime nga gjuha dhe letërsia arabe, të cilat tekste të përshkruara nga Salih ef. Myftia, janë burime të pasura për studiuesit e gjuhës dhe letërsisë, pasi ofrojnë mundësinë për të studiuar gjuhën dhe stilin e të shkruarit të autorëve të kohës.
- Në dorëshkrimet e Salih ef. Myftisë, në shumë raste hasim edhe përshkrime të ndjenjave personale, përvojave dhe sfidave të autorit nga jeta e mundimshme në mërgim. Këto fletore, ofrojnë një dritare unike për të analizuar jetën e individëve që kanë përjetuar largimin nga atdheu.
- Në fletoret e Salih ef. Myftisë, gjejmë edhe shkrime në gjuhën shqipe, që kanë një peshë të veçantë në ruajtjen dhe promovimin e kulturës dhe gjuhës shqipe në mërgim. Kjo është një sferë tjetër e studimit në këto fletore, sepse në to shohim një prej mënyrave për ta ruajtur identitetin kombëtar dhe për të lidhur brezat e rinj me trashëgiminë e tyre etnike.

FLETORJA NR. 1

Në **Fletoren nr. 1**, ashtu siç do të shohim nga përmbajtja më e detajuar, janë përmendur lajme të shumta, si dhe ligjëratat të shkurtra me karakter fetar, por shumë të dobishme. Po përmend disa prej tyre shkurtimisht:



Që në fillim të fletores, shihet qartë se Salih ef. Myftia, duket se ka mbajtur shënime të përpikta nga një takim i rëndësishëm me qeveritarë arabë, me gjasë të Egjiptit, (në vitin 1947), e të cilat lajme të shkurta, pastaj ia ka përcjellë Mbretit Zog, meqë ishte këshilltar dhe njëri ndër bashkëpunëtorët më të afërt të tij. Në faqen e parë, që në rreshtin e parë thotë:

“Në këtë mbledhje të gjithë u pajtuan unanimit, për të gjitha çështjet të cilat u parashtruan në tryezën e bisedimeve dhe të diskutimeve, dhe se rezultatet e kësaj marrëveshjeje, do të publikohen së shpejti...”

Pastaj pason një fjali falënderuese dhe mirënjohëse nga ana e tij, që ua shpreh delegacionit në fjalë, kur thotë: *“Më lejoni t’ua shpreh mirënjohjen time ndaj jush, sepse sado që të flas, është e pamundur t’ju falënderoj ashtu siç ju e meritoni...”*

Salih ef. Myftia i njoftonte ata se: *“Ballkani është sikur një fuqi baroti, e cila mund të eksplodojë në çdo çast”*, e pastaj bën një krahasim të tillë edhe me Lindjen e Mesme, duke përmendur krizën e Palestinës, sepse ato vite siç duket kanë qenë vitet e krizës së thellë, para shpalljes së shtetit hebre në Palestinë.

Në lidhje me këtë problem serioz ndërkombëtar, ai tash mbase po e njoftonte Mbretin Zogu I, se: *“Mbreti Abdullah kishte lëshuar urdhrin, për t’u futur në Palestinë, për ta shpëtuar atë nga okupimi hebrenj.”*¹

Në faqen e dytë të kësaj fletoreje vazhdon me disa tituj apo mendime të shkëputura si:

- “Ne, pavarësisht dallimeve në mjete dhe qëllime, takohemi te një qëllim i vetëm.”
- “Ruajtja e pavarësisë është më e vështirë se fitimi i saj.” Ai me këto fjalë, sikur ta përshkruante gjendjen e shumicës së vendeve islame dhe arabe sot.
- “Libani, që prej 25 vjetësh po edhe prej kohësh të lashta, importon për nevojat e tij ushqimore dhe të tjera nga Siria.”
- “Nëse ke një mendim, ji i vendosur në të.”
- “Detyra kombëtare kërkon që në kohë të vështira të jemi një zemër dhe një dorë e vetme.”

¹ Shih fillimin e fletores nr. 1.

- “E urrej të zbuloj sekretin e dikujt që ma ka besuar.”
- “Mos më thuaj çfarë dua të dëgjoj, por më thuaj çfarë duhet të dëgjoj.”

Pas këtyre lajmeve të shkurtra dhe të disa mendimeve apo fjalëve të urta, ai fillon me shkrimin e pjesëve të shkëputura të temave të ndryshme islame. Në këtë fletore, gjejmë fillimin e historisë së Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s., në pika të shkurtra, duke filluar nga lindja e tij, fëmijëria e tij e hershme te fisi Beni Sa’d, pastaj udhëtimi i tij i parë në Sham, udhëtimi i dytë në Sham, tashmë si një i ri i rritur, martesë me Hatixhen r.a., ndërtimi i Qabesë etj. Në këtë fletore po ashtu hasim edhe përshkrime të tjera të jetës së përditshme të Pejgamberit a.s., se si i vizitonte edhe tregjet, duke thënë se ai nuk ishte pejgamber që të qëndronte vetëm brenda shtëpisë, përkundrazi, ai ishte kudo i pranishëm me sahabët e tij, në çdo segment të jetës, përfshirë edhe tregtinë, të mbjellat, bujqësinë etj.

Siç duket, disa nga këto shënime i ka përshkruar nga revista “*Livaul Islam*” nga numri i parë i saj, prill, 1956.

Pastaj në këtë fletore hasim në shkrime të shkurtra fetare me këto tematika:

- *Një qasje e veçantë mbi ushqimet e shëndetshme gjatë Ramazanit, me këshilla të mjekëve mbi atë që duhet të konsumojë agjëruesi dhe mënyra e të ushqyerit.*
- *Një kapitull mbi motivet që çojnë në martesë.*
- *Një kapitull mbi rregullat e mbajtjes së mjekrës, duke cituar fjalët e juristëve myslimanë nga libri “Fikhu sipas katër shkollave juridike”.*
- *Një kapitull i rëndësishëm mbi shkrimin dhe autorët.*
- *Një diskutim mbi konceptin e abrogimit (nes’hit) në Kuran.*
- *Hadithe të shumta dhe përfitimet e nxjerra prej tyre.*
- *Një shembull i dobishëm: “Ai që të jep diçka të hidhur për të të shëruar, është më i mirë se ai që të jep diçka të ëmbël për të të sëmurur.”*
- *Një artikull të titulluar “Njeriu planifikon, por Zoti përcakton.”*

Në përfundim të pothuajse secilës temë, ai ka mbajtur shënime se prej cilit libër, apo cilës revistë i ka përshtuar, siç është rasti me revistën “*Al-Azh’ar*” të vitit 1376 h. etj.

Diku kah mesi i fletores, në mënyrë shumë koncize ka folur për ixh-tihadin dhe dispozitat sheriatike rreth tij, pastaj hasim përsëri disa shkrime rreth historisë së Pejgamberit a.s., tash duke folur për hixhretin e tij në Medinë.

Myftiu i nderuar, siç duket këto shënime i ka shkruar enkas për vete, e mbase të njëjtat ua ka shpjeguar njerëzve të tij të afërt, sepse në fletoren e tij të parë i ka shënuar me radhë edhe të gjithë kalifët e dinastisë Benu Umejje (Emevite), duke filluar me Muavije ibën Ebu Sufjanin, e deri tek i fundit prej tyre Mervani.

Pastaj krejt ka fundi i fletores, ka përshtuar nga revista “*Shubbanul muslimin*”, nr. 8, të vitit 1957, rreth ideve dhe qëndrimeve të Abas Akkadit.


Si përfundim, për shënimet e gjetura në këtë fletore, mund të themi se në të janë shkruar kujtime personale të Salih ef. Myftisë, reflektime intelektuale dhe përfitime të ndryshme shkencore, krahas një numri të madh lajmesh dhe vendimesh politike, ekonomike dhe mjekësore. Kjo e bën atë të ngjashme me një ditar të pasur me informacione dhe përvoja të një intelektualit të kalibrit botëror.

FLETORJA NR. 2

Në **Fletoren nr. 2**, siç ne e kemi emërtuar, e cila është pa kopertina, po ashtu hasim shkrime dhe shkëputje nga lëmenj të ndryshëm fetarë, p.sh., nga historia islame, nga hadithi, tefsiri, fikhu, akaidi etj. Ndër të tjera, kemi gjetur shkrime nga Muhamed Abduhu, nga Abas Akkadi etj., të cilët shpeshherë citojnë mendimet e Xhemaluddin Afganit, për një reformë në shoqërinë e atëhershme islame. Shkurtimisht, do t’i përmendim disa nga titujt e kësaj fletoreje:


- *Në fillim, një kapitull mbi prejardhjen dhe vlerën e Pejgamberit a.s.*
- *Hadithe të Pejgamberit a.s. dhe përfitimet e nxjerra prej tyre.*

- Rreziqet e bidateve dhe bindja e gabuar se përfitimi i njeriut nga gjërat varet nga perceptimi i tij ndaj tyre.
- Një përfitim mbi arsyen pse disa xhenaze janë të lehta dhe të tjera të rënda.
- Çështje të fikhut mbi rregullat e namazit në xhemat, për gratë.
- Rreziku i gënjeshtërs mbi Pejgamberin a.s. dhe nevoja për ta verifikuar vërtetësinë e haditheve.



Kjo fletore, po ashtu përmban interpretime fetare, biografi-sire, fikh dhe histori islame. Ndër këto tema do të veçonim:

- *Kuriozitete dhe përfitime të shumta gjuhësore.*
- *Një kapitull mbi epokat historike të gjuhës arabe dhe letërsinë e saj.*
- *Një kapitull mbi mençurinë dhe mënyrat e zgjuara për t'u shpëtuar situatave.*
- *Një artikull mbi “Gratë në Islam”, botuar në gazetën “El Islam” në Paris.*
- *Një artikull mbi “Metoda islame për edukimin e shijes së mirë” nga prof. Mahmoud Lutfi Abd el Karim.*
- *Një kapitull mbi disa fetva të rëndësishme.*
- *Një biografi e shkurtër e dijetarit Muhamed Abduhu.*
- *Një studim mbi rregullat e namazit të teravive.*



Ajo që ma tërhoqi vëmendjen në këtë fletore është një përmbledhje e thukët rreth çështjes së “*Krijimit të Kuranit*”, e cila fitne u përhap në mesin e myslimanëve që nga koha e kalifit Me’mun, i cili përkrahte mendimet e muteziles. Ai përshkruan debatet e ulemave dhe sidomos qëndrimin e Ahmed ibën Hanbelit, i cili qëndroi stoik në mbrojtjen e akides së pastër të Ehli Sunetit dhe Xhematit, ndonëse u persekutua nga pushtetarët e atëhershëm.

Në këtë fletore po ashtu kemi hasur edhe në disa poezi arabe, të cilat i ka shënuar me strofa, sepse siç duket, Salih ef. Myftia ka qenë edhe njohës i mirë i poezisë dhe përgjithësisht i gjuhës dhe letërsisë arabe.

Pothuajse krejt kah fundi i fletores e hasim edhe një shkrim të dobi-shëm nga sfera e tefsirit me titull: “*Mrekullia më e madhe në suren “Err Rrum*”, nga dr. Muhamed Mahmud es Selamuni, artikull i marrë nga revista “*Mexhel-letu-l Islam*”, 21 safer, 1383 h.

Në fletoren e dytë, në margjina të fletëve, na ka ndodhur të hasim emra të personaliteteve të ndryshme, nga bota arabe dhe islame, ndër të cilët do të përmendim, Umer Mahmud Muntesar, ministër i Drejtësisë në Qeverinë e Libisë, në Bejdaë.

FLETORJA NR. 3

Ndërsa në **Fletoren nr. 3**, që është më e madhja në format, me koptina të forta, faqet i ka kryesisht me numra, dhe në të shënon edhe emri Salih Myftia. Ai i ka shënuar numrat deri në faqen 128, e pas kësaj nuk i ka shënuar më, deri në fund të fletores. Kjo fletore përmban kryesisht artikuj të botuar nëpër revista dhe gazeta të ndryshme të kohës. Ndër të tjera do të veçonim:

- *Përfitime shkencore të rëndësishme nga “Historia e Imam Taberit”.*
- *Disa hadithe dhe thënie të sahabëve.*
- Biografi të disa prej sahabëve të mëdhenj si *Omer ibën Hattabi, Ebu Hurejra, Abdullah ibën Zubejri* etj.
- Një përmbledhje e shkurtër mbi jetën e dijetarit *Ibën Kajim el Xhevziijj*.

- Një artikull mbi “*Kuptimi i Islamit dhe besimi i hebrenjve*” nga Abdulrahman al Merzuku.
- Një artikull mbi “*Teorinë rreth jetës në planetët e tjerë, në dritën e arsyes dhe fesë*”.
- Një artikull “*Kalorësi i kurejshëve në luftë*”.
- Një kapitull mbi “*Mrekullitë e Kuranit*”.
- Një artikull mbi “*Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja si shkak i përmirësimit të shoqërisë*”.
- Pjesë nga libri “*Letërsia dhe politika*”.
- Një kapitull i rëndësishëm mbi “*Ndëshkimi i atyre që vonojnë namazin*”.
- Një kapitull mbi “*Hebrenjtë në librat e tefsirit*”.
- Një studim mbi “*Librat e tefsirit dhe autorët e tyre*”.
- Një kapitull mbi “*Jeta e Profetit Ibrahim a.s.*”
- *Çfarë duhet të thuhet në lutjet për të sëmurin.*
- *Poezi të rëndësishme.*
- Një studim mbi “*Therja e kafshëve nga jomyslimanët*”.
- *Diskutim mbi rregullat e synetllëkut.*
- Një kapitull mbi *faljen e mëkateve.*
- *Studim mbi lutjet.*
- *Një kapitull rreth mrekullive të profetëve (Ibrahim, Muhamed dhe Isa, paqja qoftë mbi ta).*
- *Emrat e bukur të Zotit.*
- *Biografi e shkurtër e Ibrahim ibën Ed’hemit.*
- *Informacione mbi ditën e Ashures dhe vlerën e saj.*


Në këtë fletore, kah fundi do të gjemë edhe disa fraza në anglisht, dhe këto siç duket janë shënimet e tij pas arritjes në ShBA, dhe janë hapat e parë të tij të mësimi të gjuhës angleze.

Në faqet e fundit, ai ka shënuar disa emra dhe numra telefoni të disa personave, institucioneve të ndryshme, si fjala vjen: Qendra Islame në Uashington, emra të veprimtarëve të Legalitetit dhe të bashkëpunëtorëve në luftën e tij kundër pushtetit komunist, pastaj emra veprimtarësh të Legalitetit si: Ali Klisura që jetonte në Itali, Adnan Ajdini një shqiptar i li-

ndur në Damask, nga familja me rrënjë nga Vitia e Kosovës. Dr. Adnani ishte mik i madh i familjes Myftia, ndonëse në Damask ishte ende fëmijë, por e kishte mbajtur mend, pastaj u takua me të sërish në Aleksandri e pastaj përfundimisht në SHBA, ku u shpërngul edhe vetë. Salih ef. Myftia Dr. Adnanit, të cilin e donte shumë, ia ka dërguar një letër, duke iu drejtuar me fjalët “Biri im!”, letër e cila gjendet e ruajtur në fletët e kësaj fletoreje, e të njëjtin emër me adresë, por tash në ShBA, e hasim në kopertinën e fundit të fletores. Pastaj e hasim emrin e Xhelal Mitrovicës, njëri ndër prijësit e grupit kosovar të Legalitetit.

Pastaj e gjejmë emrin e një Camellini Franco, nga kampi Reggio Emilia në Itali, më tutje telefonin e motrës Adrianës në Milano, emrin dhe adresën e dijetarit: shejh Hasen Muhamed Mahluf nga Egjipti, shejh Ahmed Abdulbaki nga Libia, adresën e xhamisë shqiptare në Brooklin, adresën e z. Ing. Muhamed Tevfik Ahmet, kryeredaktor i një reviste islame në Kairo, emrin dhe adresën e dr. Abdul Reuf, nga Qendra Islame në Massachusetts, Uashington, etj.

Karakteristikë e kësaj fletoreje, është se në të gjenden 2-3 shkresa të shkruara në shqip, njëra ka të bëjë me Pavarësinë e Shqipërisë, njëra me



rastin e një manifestimi kombëtar në Kishën Katolike Shqiptare në ShBA, dhe tjetra është lutja për ndaljen e luftës në Vietnam.

Së pari po e japim tekstin e plotë rreth shkrimit të tij rreth Ditës së Pavarësisë së Shqipërisë:

“O Zot i math i ynë të falet ty sot and e kand Shqiptari për mirsinë qi pate me i dhuru Shtetit tonë independencen Shqiptare me 1912. O Zot i math të falet ty mërgata shqiptare për mshiren e


madhe qi pate me radhitë dhe komin tonë në mes atyne komeve qi kan fitu lirinë e pamvarsinë e tyne.

O i madhi Perendi të asht mirnjoftsi ty i tanë populli Shqiptar për udhëzimin dhe flaken shendritse qi drejtove mendën dhe zemrat Shqiptare kah Vlona kreshnike që 59 vjet ma parë dhe të njajten kohë i dhe forcë e kuraje herojtë komtarë Ismajl Qemal bej Vlonsë me shpalosë flamurin komtarë flamurin Kuq e Zi flamurin e Skender beut në Vlonen kreshnike me 28 Nandor 1912.

Nonse² re të zeza kan mbulu persri Shqipnin ton të dashtun e të shtrejtë, nonse liriya e pamvarsija janë zhdukë nga trulli i atdheut tonë nga durte mizore të disa personave qi kan mishnu një ideoloxhi shtypse e lirisë e mohuse e fes, të lutemi ty o i madhi Perendi qi të drejtosh persri Shqiptartë e ndershëm në rrugën e bashkimit dhe të bashkohen për fitimin e lirisë e të pamvarsisë për krijimin e Shqipnisë e lirtë me Kosovë e Çamri.”³

Në një shkresë tjetër në gjuhën shqipe, që ndodhet në fletoren nr. 3, e gjejmë edhe këtë letër falënderimi për ftesën që i ishte bërë me rastin e dhjetëvjetorit të themelimit të Shoqatës Katolike Shqiptare në Amerikë, ku para qindra të pranishmëve ai kishte thënë:

“Zotni Krytarë i Përndritshmi dom Zef, të dashtun bashkatdhetarë e ndi për detyrë të falenderoj komisjonin prega-



² Ndonëse.

³ Shih fletoren nr. 3, f. 125 (Numrat në fletore janë numra që i përdorin sot arabët. Sqarim yni: S.B.).

ditsë⁴ për fiesën qi më kan ba me rastin e dhjetvjetorit⁵ të themelimit Shoqatsë Katolike Shqiptare Amerikane, e cila nën udhëheqjen e Dom Zefit ka gjetë personin ma të përshtatshëm për ta drejtu kët Shoqatë në parimet fetare e komtare.

Të gjithë e dini të dashtun bashkatdhetar Shoqata fetar kanë punu në të kalumen dhe do të punojn dhe në të ardhmen për binomin e pandamë qi asht fë e atdhe.

Sot ma tepër se kurr duhet të përpiqemi në ket drejtim pa marë parasyshë besimet e ndryshme qi përbajnë komsinë tonë.

Duhet të punojmë për një Shqipni të lirë të cilën ta mbretnojnë ata lirina qi sot i janë mohu atdheut tonë, mbi të gjitha lirija fetare.

Fenat nuk na kan da, por na kan bashku nën emnin Shqiptarë.


Tu përfundu ju uroj suksese ma të mëdha dhe lus Zotin qi në vitin e ardhmë festat fetare e komtare ti festojmë në atdhen tonë me një Shqipni të lirë etnike me Kosovë e Çamëri.”⁶

Shkresa tjetër në shqip, ka të bëjë me një lutje të përbashkët të komuniteteve fetare në Amerikë, rreth përfundimit të luftës në Vietnam, ku ndër të tjera thuhet:

⁴ Përgatitore.

⁵ Dhjetëvjetorit.

⁶ Shih fletoren nr. 3 (Shih faqen 163, e cila nuk është e shënuar me numra, por ne i njehsuam nga faqja 125, sqarim yni, S.B.).



“Ty o Zoti ynë ty të falemi sot në këtë faktore që patë mirsinë me ndritshu mendën dhe me i zbut zemrat e udhëheqsve të shtetve të implikume në konfliktin e induqisë dhe me inspiratën tane me prurje ma në fund paqe e qetsi në Vietnam.”

Të falemi ty o i madhi Perendi që me mshirën dhe fuqinë tande të pa kufishme po shofim sot fillimin e marimi e një konflikti për dhet vjet me rall ka pasë sjllë⁷ vdekje e të vrarë në popullin e pa fajshëm të Vitnamit nga epshi anti njerzurë i disa elementave të pa përgjegjësi të pa respekt e pa ndisina njerzore..

⁷ Sjellë.

Te jena mirnjoft ty o i madhi Perendi për vetinat morale e materjale me të cilat ke mushë Presidentin e Shteteve të bashkume dhe popullin amerikan qi diti me luftu e me sakrifiku kur qe nevojaq, duke mprojtë lirinë e pa mvarsinë e Vitbamt dhe të njajtën kohë me u ulë më tryzen e paaqes për ti dhan fund konfliktit qi kishte dermu nergjegjen e paster te popujve lirinhashtsë.

Per ulemi para madhnise tande o i madhi Perendi dhe nga thelli i zemres tone te drejtojme lutjet tona qi paqja e arritun në Vitnam te jete nji paqe e perjetshme. keshtu gjaku dhe sakrificae e bame ne mrojtjen e parimeve hyjnore te lirise e te pa mvareshise mos te shkojne kot.

Te njajten kohe te drejtohem ty o i madhi Perendi qi paqja e liria te mrrine ne skanje e adriatikut ne shpirtin e ne zemrat e popullit shqiptar, qi per tridhet vjet me rallë nuk janë në gjendje me tu drejtu na per faltoret e tyne pse udhheqsjat e soçem ju kan nalu që do te drejte njerzore në kto momenta e eforije per prospektive e paqe.”⁸

Siç shihet nga fundi i kësaj lutjeje për Vietnamin, ai i shtyrë nga atdhedashuria, edhe në këtë lutje nuk e harron Shqipërinë, por lutet që paqja dhe liria e shprehjes së lirë të ndjenjave fetare, të arrijë edhe në brigjet e Adriatikut, kur ai i drejtohet Zotit me një zemër të thyer, pse vëllezërit e tij besimtarë në Shqipëri, nuk po mund t’i qaseshin faltoreve-xhamive dhe kishave, për ta falënderuar e madhëruar Zotin e Plotfuqishëm.

Dhe po ashtu, kah fundi i fletores nr. 3, Salih ef. Myftia, siç duket gjatë një darke ku kishin marrë pjesë udhëheqësit shpirtëror të tria besimeve te shqiptarët në Amerikë, ai ka mbajtur një shënim me këtë përmbytje: “*Duanë e darkës e bani i përndritshmi, At Kristo Kosta, i kishës ortodokse shqiptare.*”⁹

⁸ Shih fletoren nr. 3. (faqet 184-185, sipas numërimit tonë, S.B.).

⁹ Shih fletoren nr. 3 (faqe 195, sipas numërimit tonë, S.B.).

Përfundim

Këto ishin disa nga shënimet dhe tematikat kryesore që i hasim në tri fletoret në dorëshkrim, që na kanë ngelur nga myftiu i nderuar Salih ef. Myftia, njëri prej mendjeve më të ndritura fetare e kombëtare të kohës së tij.

Kur përpiqemi të japim një vlerësim final për fletoret e tij, duhet të konstatojmë se jo çdokush mund të futet në mbretërinë e tyre të mister-shme. Këtë mund ta bëjë vetëm ai që zotëron çelësin për arritjen e tyre, e ajo është forca morale, sepse t'i kuptosh dorëshkrimet e tij dhe pasi t'i kuptosh, t'i duash ato, do të thotë ta duash edhe atë që i lanë këto dorëshkrime si kujtim për brezat dhe gjeneratat e ardhshme. Kur i shfletojmë këto fletore, e ndjejmë thellë në shpirt se asnjë fletë e këtyre fletoreve letre nuk na duket e "vdekur". Përkundrazi, fëshfëritja e secilës fletë zotëron një forcë magjike dhe aftësinë për të risjellë sërish në imagjinatën tonë, të gjitha ato ngjarje të bujshme historike, që tashmë kanë ikur në pa kthim.

Dorëshkrimet e Salih ef. Myftisë, përveç të tjerash, kanë edhe një rëndësi të jashtëzakonshme morale, dhe, këtyre fletëve të thjeshta duhet t'u qasemi me një kujdes edhe më të madh, pikërisht për shkak të përmbajtjes dhe koherencës së tyre. Nëpërmjet zbardhjes së këtyre dorëshkrimeve, po bëhet një rikthim i fuqishëm i këtij personaliteti në mesin e shqiptarëve, jo vetëm të besimit islam, ngase Salih ef. Myftia gëzonte një respekt edhe nga besimtarët shqiptarë të besimit katolikë dhe ortodoksë, që jetonin e vepronin në ShBA.

Për fund, duhet thënë se Salih ef. Myftia ishte një kolos i madh i shkrimit dhe i mendimit islam, e gjithashtu edhe një lider i shquar fetar dhe kombëtar. Detyrë jona është që tash e tutje, kur veç i kemi në dorë këto dorëshkrime të çmuara, e gjithashtu edhe dosjen komplet të përpiluar nga sigurimi famëkeq i regjimit komunist të Enver Hoxhës, të përpiqemi ta ndriçojmë ashtu siç e meriton figurën e këtij dijetari të madh. Ne si Institut, të gjitha këto dorëshkrime, do t'ua vëmë në dispozicion studiuesve dhe hulumtuesve që t'u qasen atyre duke i studiuar dhe duke u thelluar nëpër shkrimet që gjenden në to, sepse ato ofrojnë një dritare të drejtpërdrejtë në të kaluarën e popullit tonë.

Dr. Hysen MATOSHI

MUHAMEDI A.S. – MODELI I VEPRIMIT TË SALIH MYFTISË

Për gjithë botën islame, pas librit të shenjtë Kuranit – fjalës së Allahut të Madhërueshëm, syneti i Muhamedit a.s. përbën bazën e fesë. Pejgamberi i fundit është modeli i jetës së secilit mysliman. Kushdo që dëshiron të ecë rrugës së drejtë të besimit mbështetjen e gjen në thëniet dhe praktikën e tij të veprimit. Shumë prej prijësve besimtarë kanë zbatuar ato mësimet e porosit peygamberiane dhe me këtë kanë lënë gjurmë në kohën kur jetuan dhe vepruan. Salih efendi Myftia, me jetën e tij fetare, sociale e kombëtare, është njëri ndër ta.

Hixhreti i Salih efendi Myftisë

Salih efendi Myftia është ndër ato personalitete që kanë kontribuar shumanshëm në jetën shqiptare. Si prijës fetar, në rend të parë, por edhe si politikan që i ka kushtuar vëmendje fatit të përgjithshëm të Shqipërisë dhe të kombit shqiptar. Puna e tij gjatë gjithë jetës, në atdhe dhe në mërgim, është e mirënjohur. Kohët e fundit ka pasur një fokusim të ndriçimit më të gjithanshëm i aspekteve të veprimtarisë së tij, e cila ka qenë jo aq e njohur në opinionin tonë. Deri nga fundi i Luftës së Dytë Botërore shquhej si njëri ndërkryemyftinjë të Shqipërisë, përkatësisht i Shkodrës dhe i Kosovës (fjala është për ato pjesë të Kosovës që i kishin takuar shtetit shqiptar, përkatësisht Kukësin, Hasin, Krumën dhe Tropojën), ku kishte zhvilluar një veprimtari për organizimin e mirëfilltë të jetës fetare, madje edhe përtej përmasës së Kryemyftinisë së tij, duke u bërë ndër personalitetet e

shquara të Komunitetit të asokohshëm Mysliman Shqiptar. Në kohën e tij janë bërë ndryshime të rëndësishme në riorganizimin e jetës fetare në Shkodër e rrethinë, duke bërë që të dëgjohet më shumë zëri i Komuniteti Mysliman, të punohet për infrastrukturën islame, të riorganizohet puna e mësim-besimit, të gjallërohet dimension i jetës kulturore dhe i publikimeve islame. Me një fjalë, jeta fetare e organizuar prej tij, nuk ishte vetëm rrjedhojë e proceseve që vinin nga faktorë të tjerë, ngase ai vetë merrte pjesë aktivisht në formësimin e saj në mënyrë kreative. Duke qenë në afërsi të pjesës së kombit që kishte mbetur nën pushtimin serb, pas bashkimit të pjesës më të madhe të tokave shqiptare me Shqipërinë (e cila ishte në sovranitetin italian) gjatë viteve 1941-1944 dhe riorganizimit të strukturës së Komunitetit Mysliman Shqiptar, ku ishin përfshirë edhe dy Kryemyftinitë e Prishtinës dhe Prizrenit, Salih Myftinë e shohim të angazhohet në mbështetjen e vëllezërve me qëllim të bashkimit që u ishte mohuar me pjesën tjetër të kombit dhe të strukturës së përbashkët fetare të cilës natyrshëm i përkisnin. Kështu, në vizitën që kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar, shkëlqesia e tij dr. Behxhet Shapati, gjatë datave 18.11.1941 - 26.11.1941, ia bëri Kosovës¹ së çliruar nga sundimi jugosllav (serb), përveçse nga kabineti i tij, ai ishte i shoqëruar edhe nga Salih Myftia, i cili i ishte bashkuar delegacionit në Shkodër. Gjatë rrugës, delegacioni ishte ndalur në Shkodër, ku i kishin bërë vizitë selisë së Kryemyftiut të Shkodrës, duke qëndruar edhe si mysafirë të tij. Autori i reportazhit e përshkruan me këto fjalë Salih Myftinë dhe familjen e tij të nderuar: “Mandej është për të përmendur se që të gjithë ramë mysafirë në Shtëpi të Hirësisë së Tij Sali Myftiut në Shkodër. Kjo është një nga shtëpitë më fisnike shqiptare, e përmendur për bujari e për mikpritje. Pas një bisedimi të gjatë e të gjerë rreth problemesh fetare që bajshin prijsat t’onë fetarë në dhomën e pritjes mbi problema fetare të vendit t’onë, u ngritëm të hamë darkën duke u rreshtuarë të gjithë rreth e rrotull një sofre të lulëzuarë, të

¹ Më gjerësisht shih: Sadik Bega, Reportazh mbi vizitën e Kryetarit të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Kosovë, Kultura Islame, e përmuajshme fetare, letrare, diturore, artistike, Organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar, viti III, nr. 3 -4, nanduer – dhetuer 1941, f. 74 – 82.

përgatitur me kujdes me llojë llojë gjellëra, siç i ka hije një shtëpije fisnike si kjo”.² Vizita e delegacionit të Komunitetit Mysliman Shqiptar kishte përfshirë qëndrimin në qendrat e mëdha të Kosovës, si në Prizren, Gjakovë, Pejë, Prishtinë, Ferizaj dhe Gjiilan. Përfundimi i kësaj vizite me domethënie të dyfishtë vëllazërore, kombëtare e fetare, përsëri kaloi kah shtëpia e Salih Myftisë, ku sërisht qëndroi për një natë delegacioni i Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Natyrisht që kontributi i Salih Myftisë do të vijonte edhe pas largimit të tij të detyrueshëm nga Shqipëria, fillimisht drejt Italisë e pastaj në Siri, Liban dhe për të përfunduar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. I vetëdijshëm për rrezikun që sillte ideologjia komuniste që kishte lëshuar rrënjë, ai zgjodhi rrugën e një lloj hixhreti modern, duke lënë vendin e tij Shqipërinë, me qëllim që të ruante identitetin e tij të kërcënuar dhe të mund t’i shërbente kauzës së tij jetësore. Thënë të drejtën këtë rrezik e kishin hetuar qysh më herët edhe dijetarë të shquar shqiptarë të proveniencës islame, sikundër ishin Hafiz Ibrahim Dalliu dhe Hafiz Ali Korça, të cilët e kishin identifikuar komunizmin si të keqen më të madhe për shqiptarët dhe si shkatërrim për mbarë njerëzimin.³ Të dy këta dijetarë që vijuan të qëndronin në Shqipëri, në periudhën e komunizmit, u përdoqën, u dënuan, ndërsa vepra e tyre u ekskomunikua plotësisht. Duke ndjekur modelin e largimit nga vendlindja e nga atdheu, Salih Myftinë fillimisht e gjejmë ndër këshilltarët e mbretit Ahmet Zogu në mërgim, ndërsa më vonë, pasi e kaloi Atlantikun, u mor me jetën fetare të shqiptarëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës deri në vdekjen e tij (1978), duke kontribuar për organizimin e komunitetit shqiptar dhe veçmas të atij islam në këtë vend jetik për fatet e viseve shqiptare. Për një kohë të gjatë, për shtetin shqiptar dhe ideologjinë e tij komuniste Salih Myftia ishte ndër armiqtë më në zë të emigracionit, ndonëse ai nuk pushonte të vepronte për kombin dhe atdheun e tij.

² Sadik Bega, *Reportazh mbi vizitën e Kryetarit të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Kosovë*, “Kultura Islame”, e përmuajshme fetare, letrare, diturore, artistike, Organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar, viti III, nr. 3 - 4, nanduer – dhetuer 1941, f. 75.

³ Për më shumë shih botimet: Hafiz Ibrahim Dalliu, *Grenxat e kuqe të Tiranës*, vjersha, Tiranë, 1915; Hafiz Ali Korça, *Bolshevizma a çkatërrimi i njerëzimit*, Tiranë, 1925.

Viteve të fundit nga autoritete të ndryshme shkencore e kulturore dhe përfaqësues shtetërorë është vlerësuar personaliteti i Salih Efendi Myftisë dhe kontributi i tij për fe e atdhe.⁴ Lënia në harresë e këtij personaliteti për një kohë të gjatë e ka dëmtuar historikun e përgjithshëm të islamit ndër ne dhe e ka varfëruar edhe historinë tonë të përgjithshme kombëtare. Megjithatë, kohët e fundit, vërejmë një interesim në rritje për ndriçimin e veprimtarisë së Salih Myftisë dhe personaliteteve të tjera të shquara fetare të Shqipërisë.

Muhamedi a.s. në një ligjëratë të Salih Myftisë

Një përpjekje e rëndësishme në drejtim të nxjerrjes në dritë të së vërtetës mbi jetën fetare të ne ka qenë edhe Tryeza shkencore “Salih Myftia, personalitet i shquar fetar dhe kombëtar”, që u organizua më 30 qershor 2022 nga Instituti për Studime dhe Hulumtime Islame i Bashkësisë Islame të Kosovës, në të cilën u paraqitën me kontribute 10 studiues të aspekteve të ndryshme të jetës dhe të veprimtarisë së këtij dijetari atdhetar. Në diskutime me njohës të historisë sonë islame lidhur me këtë personalitet, saktësisht nga studiuesi Sadik Mehmeti, mësova për një fjalim të tij të mbajtur më 1936, në shënimin e ditëlindjes së Muhamedit a. s. që u organizua nga Kryemyftinia e Shkodrës. Duke qenë në krye të kësaj strukture, Salih Myftia mbajti fjalën kryesore, në një kontekst më të gjerë aktivitetesh e shënimesh festive, organizuar për nder të ditëlindjes së Pejgamberit a.s. Vlera e kësaj fjale, vërtetësia e fakteve dhe mjeshtëria e ligjërimit, bënë që revista “Zani i Naltë”, organi i Komunitetit Mysliman Shqiptar, ta botonte atë në tërësi, kuptohet duke ia ndajshtuar një pjesë hyrëse që kishte karakter informativ lidhur me shënimin e Mevludit në Shkodër. Pasi që ky fjalim nuk ishte bërë objekt i ndonjë trajtimi nga kumtuesit e konferencës, e pashë të udhës që ta ofroja lidhur me të një vështrim përmbledhës, si ndihmesë që synon të plotësojë sa më shumë portretin jo aq të njohur të Salih Myftisë.

⁴ Enciklopedi: *100 personalitete shqiptare të kulturës islame – shekulli XIX-XX*, botoi Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë, 2012, f. 213 - 216.

Në vitet 30 të shek. XX, sikundër del edhe nga periodiku islam i kohës, në qytete të ndryshme të Shqipërisë, ishte bërë traditë festa e Mevludit, e cila në mjaft raste kishte marrë edhe karakter mbarëpopullor. Revista “Zani i Naltë” pothuajse rregullisht botonte tekste nën rubrikën standarde “*Si u festue Meuludi në Shqipni*”. Në tekstin me nëntitullin “*Rreth Meuludit solemn të Shkodrës*” gjejmë të dhëna për këtë festë të madhe, por edhe fjalimin e plotë të Salih Myftisë.

Pjesa hyrëse është konceptuar si pjesë e pandarë e fjalimit, e cila këtu është në funksion të qartësimit të kontekstit të mbajtjes së fjalimit, duke e plotësuar atë me sjelljen e frymës së përgjithshme të shënimit të Mevludit. Nga teksti mund të kuptohet se kjo pjesë hyrëse do të jetë shkruar nga Redaksia e Revistës “Zani i Naltë”: “*Shkodra, e cila që prej vitit 1932, është hudhë në shesh, për të bá diçka mâ mirë e mâ tepër se bâhej perparandej në kremtimin e festës së Meuludit, edhe në kët vit dijt t’a lëlzojë e t’a kremtojë këtë festë madhnueshme shumë bukur. Komiteti i kryesuem prej Hirsís së tij Kryemyftiut Sali Myftís, duket se në ket vit ka diftue mâ gjallni, qi festa duel edhe mâ madhështore se të tjera vjetë. Edhe njëmend këtë e ka vërtetue kushdo qi ka pasë rastin me adsistue at natë aty. E paraqitnja me rregull, zbukurimi e ndriçimi i vendit, grupi i mirë-stërvitun i këndojsvet të Meuludit e qetsija e mbajtn në mes të mija njerzvet, janë provat e gjalla të një organizimi të peshuem, të cilin Komiteti në fjalë e kish krye mâ së miri.*”⁵

Kjo atmosferë e bukur festive, që e kishte përfshirë qytetin e Shkodrës, e përshkruar me fjalë të zgjedhura e plot ndjenja, gjithsesi se do të plotësohej edhe nga një fjalim i bukur, që, me atë rast, e kishte mbajtur Kryemyftiu: “*Pastaj edhe fjala qi e mbajti Hirsia e tij Kryemyftiu, qe mjaft e bukur e plot vështtrim, fjalë të cilën me këtë rast e pám t’ arsyeshme t’a botojmë në këtë numër*”.⁶

⁵ “Zani i Naltë”, organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar, revistë fetare (merret edhe me filozofi, moral, letraturë komb. E sociologji, viti XI, nr. 6 - 7, qershter – korrik, Tiranë, 1936, f. 170.

⁶ “Zani i Naltë”, po aty.

Fjalimi i Kryemyftiut është shprehje e kapacitetit intelektual e dituror islam nga njëra anë dhe e dashurisë së tij të pafundme për krijesën më të dashur të Allahut, për Pejgamberin a.s. Qartazi ai në këtë fjalë del vlerësues i tipareve të Muhamedit a.s., veçmas i dimensionit të veçantë moral, i cili spikat si njëra ndër karakteristikat e tij më unike, si model i pashembullt i njeriut. Prandaj festa e ditëlindjes së tij, festa e Mevludit, është ndër shënimet që në zemrat e besimtarëve sjell lumturi dhe krenari të madhe për ta. Më tej Salih Myftia e quan fat të madh faktin se po i printe, për herë të pestë me radhë, këtij manifestimi mbarëpopullor, të besimtarëve shkodranë, por edhe të atyre të ardhur nga krahina të tjera të vendit, të cilëve, si prijës i tyre i devotshëm shpirtëror, në shenjë afërsie e nderimi, u drejtohet vazhdimisht me shprehjen “vëllazën”. Duke e lartësuar vlerën dhe rëndësinë tejkohore e tejhapësinore të Pejgamberit a.s., ai do të shprehet që në fillim të fjalimit të tij: *“Për né myslimanët, vëllaznit e mi, H. Muhammedi (Alejhiselam) është i pavdekshëm, mësimet e tij janë të përjetshëm e përkojnë me nevojë të çdo shekulli. Në qoftë se njerëzia deri sod s’ka dijtë t’i shfrytëzojë këta mësimet për të mirën e vet, faji e përgjegjësia, prap janë të sajë.”*⁷

Sipas Salih Myftisë, krijesa më e dashur e Allahut njëjtësohet me të gjitha vlerat islame, duke u bërë përçues i tyre e duke mbetur përherë i pavdekshëm në zemrat e miliona besimtarëve: *“H. Muhammedi (Alejhiselatu vesselam) rron i gjallë ndër zemrat e qinda milionave njerizish, përjetësohet me librin e shejtë Kuranin që është plot dritë e lumni, shejtnohet me historinë e lumnueshme të fazave të ndryshme të jetës së vet dhe me qytetnimin e mrekullueshëm Islam që shndriti fletët e historisë së Pergjithshme për ca shekuj në kohën e vet. Pra ata që duen të njohin mirë H. Muhammedin t’onë e shpirtin e fës Islame, lypet t’i studiojnë mirë këta burime, për në daçin m’u ndriçue me dritën e së vërtetës.”*⁸

Argumentet për fjalët e tij Salih Myftia nuk i kërkon në burime të dijetarëve dhe autorëve të njohur botërorë (përmend si shembull Zhan Zhak Rusonë), për t’i theksuar tiparet e veçanta të Pejgamerit a.s., ngase

⁷ “Zani i Naltë”, f. 172.

⁸ “Zani i Naltë”, po aty.

për të është e mjaftueshme fjala hyjnore, Kurani i madhërueshëm. Sipas Kuranit, Muhamedit a.s. i është përcaktuar shkalla më e lartë e moralit, ai është krijesa që tejkalon secilën veti dhe secilin tipar, ndërkaq Islami, në të cilin thërret, është vetë mirësia.

Më tej, autori i kësaj ligjërate shumë domethënëse, ndalet te misioni që e mori mbi vete Pejgamberi a.s. përballë pengesave të mëdha që, në krye të herës, ia sillte fisi i tij, Kurejshët, të cilët aq shumë e kundërshtuan në këtë përpjekje hyjnore për transmetimin e fjalës së Allahut. Ndonëse ata ia njihnit të gjitha vlerat, me të cilat Muhamedi a.s. u bë i njohur në Mekë e më gjerë, si besnikërinë, karakterin, origjinën familjare, ndershmërinë, konsideronin se ai po fuste përçarje me thirrjen e tij për në Islam. Ndaj, për këtë, i propozuan Muhamedit a.s. që, në rast se hiqte dorë nga misioni i tij, ta shpërblenin me shumë të mira të kësaj bote, sikurse janë pasuria, autoriteti dhe të mira të tjera. Megjithatë, përgjigjja e tij ishte thirrja për në rrugën e Zotit, i cili është Një dhe i Vetëm, sepse si i Dërguar ai e kishte të vetmin mision jetësor që njerëzimin ta nxirrte nga degradimi moral e mjerimi shpirtëror dhe ta vinte në rrugën për të cilën ishte urdhëruar nga Krijuesi i tij.

Pavarësisht mohimit që ia bënin bashkëkohësit e tij, duke e cilësuar me attribute të tjera të logjikës njerëzore, e Salih Myftia në këtë rast përmend epitetet, si gjeni i kohës, diplomat i arritur, psikolog i pashoq e gjeneral i madh, Pejgamber i Zotit nuk prante së thëni: *“Un s’jam tjetër veç një njeri si ju, të cilit i u bâ vahji për me ju thënë se Zoti juaj âsht një i vetun e pra hyni në rrugën e drejtë që u shpje tu Aj.”*⁹

Drejtësia ishte një vlerë tjetër e Pejgamberit a.s., të cilën Salih Myftia e thekson në këtë ligjëratë përmbajtjesore në planin e argumentimit e të hartuar me pasion e dashuri. Ndër tiparet e drejtësisë pejgamberiane është zbatimi i pakompromis i dispozitave kuranore, pa asnjë dallim dhe pa asnjë përjashtim. Pejgamberi a.s. ishte i rreptë edhe ndaj anëtarëve të familjes së tij kurdo që veprimet e tyre nuk ishin brenda kornizës kuranore, ose ishin në kundërshtim flagrant me të. Pejgamberi ynë ishte i tillë, ngase nisej nga postulati moral që të përfillte vetë së pari me përpikëri

⁹ “Zani i Naltë”, f. 177.

urdhrrat kuranorë, duke u bërë udhëzim për të tjerët me praktikën e tij shembullore. Pavarësisht misionit të tillë, që nga Krijuesi nuk iu besua dikujt tjetër, Muhamedi a.s. sillej me modesti si vlerë e lartë morale. Me këtë vlerë, me modestinë, afrinë, e përfundon ligjëratën e tij duke cituar fjalët e Allahut Fuqiplotë: “*S’ka dyshim, o Muhamed se ti, për nga moralin, je në shkallën më të lartë*”.¹⁰

Në përgjithësi, gjuha në këtë ligjërim mbizotërohet nga një gjuhë emfatike e plot ndjenja, në të cilën shpërfaqet dashuria e pamasë e autorit Salih Myftia për Pejgamberin a.s. dhe të cilën dashuri si ndjenjë ai e përçon tek masa e besimtarëve të mbledhur në festën e Mevludit. Kështu, atributet që i gjejmë në këtë tekst, sikundër janë: i pavdekshëm, i përjetshëm, i madh, i shenjtë, i dashtun, i respektueshëm, shpirt i fesë islame, model morali, besnik etj., dalin si rrjedhojë e njohurive autoriale, por edhe si pasion e qëndrim ndaj tërë asaj që e përfaqëson sinteza e të gjithë pejgamberëve të Zotit. Natyrisht, në këtë fjalim, del në pah një gjuhë që mëton ta paraqesë Muhamedin a.s. sa më afër mendjes dhe zemrës së besimtarëve. Për këtë qëllim Salih Myftia ka funksionalizuar, madje edhe duke i përsëritur në vijimësi, shprehjet si: *Muhamedi ynë, Muhamedin t’onë, i dashtuni Pejgamberi i ynë, i respektueshmi Pejgamberi ynë* etj. Po ashtu, ky fjalim përmban edhe tipare poetike, veçori të një gjuhe të figurshme që zbukuron dhe e bën më domethënëse e më artistike fjalën e mbajtur në Mevludin e Shkodrës. E tillë është, bie fjala, shprehja metaforike “ma e bukura kunorë”, si zëvendësim për emrin e Pejgamberit a.s. apo edhe për cilësitë e tij dhe si qartësim i misionit të veçantë të tij ndër të gjithë pejgamberët e tjerë, si i Dërguar i fundit dhe si i Dërguar për të gjithë njerëzinë; pastaj shprehja “*Shpëtimtari i Madh i dy jetve*”, që konsiston në rolin shpëtimtar për njerëzimin që Allahu ia ka dedikuar të Dërguarit të Tij në këtë botë dhe në botën tjetër: shpëtimtar nga errësira e injorancës dhe shpëtimtar në ditën e gjykimit. Përgjithësisht, lidhur me këtë fjalim të veçantë, mund të thuhet se bëhet fjalë për një tekst të shkruar me mjeshtëri dhe dashuri, në të cilin flasin bashkërisht e njëzëshëm

¹⁰ “Zani i Naltë”, f. 178.

mendja dhe shpirti i autorit. Rrallë herë bën vaki që të jenë kaq të harmonizuara aspektet mendimore dhe ndjenjore, sikundër i gjejmë në këtë rast.

Duke përfunduar, mund të themi se Salih Myftia, me jetën e tij në shërbim të fesë e të kombit, në atdhe e në vende të ndryshme të botës, ka dëshmuar se secili njeri, secili prijës fetar mund të bëjë shumë për vendin dhe kohën e tij. Mjafton që në këtë rrugëtim të ndjekë kryeshembullin e dërguar për mbarë njerëzimin, Pejgamberit a.s, synetin e tij.

Bashkim MEHANI

ANALIZË ESTETIKE DORËSHKRIMEVE TË SALIH EFENDI MYFTISË

Ndonëse kur flitet për analizë të veprave artistike në planin estetik na shkon mendja për veprat e paraqitura publike si vepra arti, qofshin ato arkitekturore, skulptura, piktura e grafika, po edhe tek ato vepra artistike pamore që përfshin letërsia, drama, filmi etj., megjithatë fusha e ndikimit estetik në art prek edhe dimensione që mund të kalojnë nëpër duart tona pa u vërejtur e vlerësuar. Kjo sepse “çdo vepër e karakterizuar nga një element i dukshëm estetik mund të çuhet vepër arti”.¹ E, një ndër to është edhe shkrimi i dorës, apo dorshkrimi maniskriptual, i cili përveç përmbajtjes tematike dhe gjurmëve historike e arkivore, paraqet edhe një vlerë të jashtëzakonshme të nivelit estetik. Thënë ndryshe, ne mund ta kuptojmë nivelin kulturor e arsimor të autorit të cilitdo shkrim, e që na e sjellin më pran nesh atë edhe fizikisht e të materializuar, dimension ky jo pak i rëndësishëm për hulumtimin e gjithanshëm të çdo personaliteti që kemi në fokus studimi.

Bukurshkrimi/kaligrafia (*hysn-i hatt*)

Termi kaligrafi, arti i shkrimit të bukur të dorës, mund të rrjedhë nga fjalët greke (*kallos*) “bukuri” dhe (*grafein*) “shkrim”. Ai nënkupton një njohuri të sigurt të formës së saktë të shkronjave - domethënë të shenjave konvencionale me të cilat mund të komunikohet të folurit - dhe aftësinë për

¹ Stefan Çapalik, Hyrje në estetikë, Bard Books, Prishtinë, f. 18.

t'i bërë ato me një renditje të tillë të pjesëve të ndryshme, si dhe harmoninë e përmasave që syri me përvojë dhe i ditur do t'i dallojë si të tilla.²

Nga ana tjetër, termi “hat”, është me prejardhje arabe, dhe ka kuptimin e vijës apo rrugës mes dy pikave të skajshme, e që përdoret për shkrimin e dorës. Kurse “hysni hatt” nënkupton bukurshkrimin apo kaligrafinë.

Një kujdes të madh kaligrafisë ia kushtuan edhe myslimanët. Kjo edhe për shkak të peshës që ka “fjala”, e madje edhe “shkronja”, në shpalljet hyjnore. Në përgjithësi, kishte dy shkrime të dallueshme në shekujt e hershëm të Islamit: shkrimi kursiv, dhe shkrimi kufik, kurse më vonë, me zgjerimet islame dhe pranimin e kulturave joarabe brenda umetit islam, u krijuan edhe tipa të tjerë të kaligrafisë, e që ishin në shërbim të shkrimit të fjalës së Allahut, haditheve të Pejgamberit, a.s., librave, pankarteve, po edhe për përdorim në sfera të ndryshme të jetës apo për nevoja private e shoqërore.

Shpesh është supozuar se procesi i shtypit i dha fund traditës së dorëshkrimeve. Kjo nuk është fare e vërtetë. Për shembull, shumica e librave të mbijetuar në kohë (libra dorëshkrimesh private e luksoze) datojnë nga periudha pas prezantimit të shtypit. Për më tepër, disa lloje botimesh, si partiturat muzikore, shënimet shkencore dhe veprat e tjera të specializuara ose me audiencë të vogël vazhduan të shkruhen me dorë edhe në shekullin e 19-të.³


Me kalimin e kohës, shkrimi i dorës ka marrë rol edhe të dekorimit. Sepse kaligrafia është i vetmi art edhe pamor, edhe verbal. Kështu që, mesazhet e fuqishme të thëna në formën e shkruar bukur tani janë zbërthyer edhe me figuratizimin e shkronjave e të fjalëve, deri në atë masë të zhdukjes së kufirit mes shkronjës/fjalës dhe figurës shprehëse.

Shumë njerëz përgjithësisht besojnë se shkrimi i tyre i dorës mund të ndryshojë çdo ditë, por kjo nuk është edhe aq e bindëse, sepse shkrimi i dorës thjesht pasqyron një gjendje emocionale. Shpesh një ose më shumë nga karakteristikat më të habitshme të shkrimit bëhen të dukshme pas

² <https://www.britannica.com/art/calligraphy>.

³ Po aty.

shikimit të parë. Ndërkohë që, zakonisht, të gjitha këto dorëshkrime “të ndryshme”, pas analizave, rezultojnë pothuajse identike.⁴



⁴ <https://minikar.ru/sq/dengi/analiz-pocherka-po-d-sara-grafologiya-psihologiya-pocherka/>.

Dorëshkrimi kaligrafik është një shenjë e saktësisë, përpikërisë, zhytjes në mendime, ngadalësisë, përkushtimit etj., ngjashëm me përdorimin që artisti ia bën vijës dhe ngjyrës në trajtimin e veprës së tij artistike.

Interesimi për kuptimin e brendësisë së dorëshkrimit i shtyu shkencëtarët edhe deri në themelimin e një shkence të veçantë për të, e që është grafologjia, dije që studion marrëdhëniet midis shkrimit të dorës dhe karakterit njerëzor. Kjo fushë studimore thotë se analiza grafologjike ka një sërë parametrash, e ndër to përfshin edhe drejtimin e shkronjave, pjerrësinë e tyre, vendndodhjen në fletë, shkallën e ngjeshjes së shkrimit të dorës etj.

Origjina e grafologjisë daton në antikitet. Fillimet e saj mund të gjenden në shkrimet e Teofrastit, të Aristotelit, të Dionisit e të Halikarnasit, po edhe te të tjerët.

Nga ana tjetër, edhe kaligrafët, duke kërkuar më shumë nga vetja, krijuan tipa të ndryshëm të shkrimeve, si dhe teknika të llojllojshme e mjete për realizimin sa më të duhur të tekstit. Stilolapsi, kallami dhe furça ende mbeten mjetet themelore të punës për një kaligraf, si mjete të admirueshme, edhe pse niveli i tyre ka shkuar drejt përsosjes përgjatë shekujve.

Edhe te ne, në viset shqiptare, i është kushtuar kujdes i madh edukimit estetik dhe përgatitjes së kuadrove që do ta njihnin bukurshkrimin, në veçanti atë arab e osman. Për një periudhë jo të shkurtër, mbi 409 vjeçare, edhe për tekstin shqip kishim grafemën arabe.

Mejtepet dhe medresetë ishin ato që në plan-programet e tyre, krahas lëndëve fetare e shkencore, kishin edhe lëndën e bukurshkrimit, kështu që kuadrot që diplomonin në to kishin njohuri bazike dhe të avancuara në kaligrafi, sikurse, për shembull:

MEHMET EF. MYFTYZADE (BERATI) 1846, ishte kaligrafist dhe shkruante bukur katër llojet kryesore të shkrimit arab: nes'h, talîk, divânî dhe rik'a.⁵

⁵ “DIJETARË SHQIPTARË NË PERANDORINË OSMANE (1880 - 1912) Sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman”, Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmedi, Ramadan Shkodra, Boton: Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, Shtëpia botuese “Dituria Islame”, Prishtinë, 2021, f. 501.

MEHMET EMIN EF. MYFTIU – RROTLLA. (PRIZRENI) 1852, ka qenë kaligrafist i dalluar. Ky kaligrafinë e kishte mësuar te Rexhep Hulusi ef. Prizreni.⁶

ISMET EF. DOBI (GJIROKASTRA) 1854, i dhënë pas kaligrafisë, fushë në të cilën edhe tregoi talent, e i cili e mësoi edhe shkrimin arab “*syls*” (*thuluth*).⁷

RUSHDI EF. AGUSHI (PRISHTINA) 1876, në lëndën e bukurshkrimit dhe kaligrafisë i mësoi llojet e shkrimit arab “*syls*” dhe “*rik’a*”⁸.

Duke jetuar përafërsisht në këtë periudhë, dhe duke kaluar nëpër dyert e këtyre mejtepeve e medreseve, edhe protagonistin ynë, Salih ef. Myftija, e përcolli deri te ne nivelin e arritjes së atyre gjeneratave në kaligrafi.

Nga ajo që ka arritur deri te ne janë tri fletore të tij, të dimensioneve A5 dhe B5, me vëllim 150 - 200 faqe, me letër ofset, të shtypur me vija të rreshtave, të cilat janë të ruajtura deri diku mirë. Dy nga ato kanë edhe kopertina të forta e të punuara me dorë, me qëllim të ruajtjes sa më të mirë, kurse njëra nuk ka kopertinë, për çka edhe ka ndikuar të jetë e dëmtuar më shumë sesa ty të tjerat.

Nga një shfletim i kujdesshëm, që në faqen e parë mund të vërehet se teksti është, në përgjithësi, në gjuhën arabe, me ndonjë ndërhyrje aty-këtu në gjuhën shqipe. I gjithë dorëshkrimi është autograf, i shkruar nga një dorë, gjë e cila vërehet lehtë nga karakteristikat e grafemave, dhe po ashtu edhe nga ngjyra e pendës dhe e kaligrafit të përdorur.

Shkrimi ka renditjen nga krahu i djathtë, ashtu siç është edhe rregulli i shkrimit arab, dhe kryesisht faqet dhe rreshtat janë mbushur mirë.

Paragrafët janë të ndarë, në shumicën e rasteve, me hapësira mes tyre, gjë që lë kohë për perceptim të temave e nënshtesave të cilat syri i gjen më lehtë.


Gjithashtu vërehet se janë respektuar edhe hapësirat e margjinave imagjinare, madje janë përfillur me një pedanteri prej autorit, ndërsa në anën e djathtë gjithnjë ka një shmangie nga 1 deri 1.5 cm. Kurse, nga ana

⁶ Po aty, f. 150.

⁷ Po aty, f. 540.

⁸ Po aty, f. 64.

e vendlidhjes së fletëve kjo shmangie është edhe më e madhe, gjë që lexuesit nuk i krijon vështirësi në leximin deri te shkronja e fundit e tekstit.



Varësisht nga përmbajtja tematike, kemi vërejtur edhe dy lloje të vendosjes së shkrimit në pozicionin vertikal. Në rastin më të shpeshtë, në përmbajtjen prozaike, teksti është i vendosur në një kolonë, kurse gjatë shkrimit të poezive, teksti ndahet në dy kolona, duke kaluar nga njëra kolonë te tjetra, në të njëjtin rresht, një praktikë kjo e përdorur gjerësisht në shkrimin e poezive në gjuhën arabe.

Kaligrafia që e përdor Sali ef. Myftija është me bazë në stilin “*rik’a*”, kaligrafi e lindur në periudhën e fundit të Perandorisë Osmane⁹, ndërsa aty dominojnë format e theksuara dhe të thyera të shkronjave vertikale dhe të atyre fundore.

Në tekstin që kemi për objekt analize po ashtu kemi vërejtur se aty-këtu janë përdorur edhe vijëzat ndarëse, dhe kjo është bërë ose për të treguar fundin e një teme të caktuar, ose për ta nënvizuar ndonjë pjesë të cilën autori ka dashur ta vërë në theks.

Shkrimi është i njëtrajtshëm brenda fletores, gjë që tregon për qetësinë dhe pedanterinë e treguar deri në finesa shumë të imëta.

Në tekst është përdorur kryesisht ngjyra e kaltër e mbyllët, megjithëse nuk mungon edhe ajo e qiellit, apo edhe ngjyra e zezë. E, në disa raste vërehet përdorimi edhe i lapsit grafit.

Edhe pse duket qartë se Myftija nuk ka synuar të shkruajë për qëllime publikimi, të paktën këto tekste, sepse vërehet në planin semantik se janë kryekëput shënime të tij për përdorim personal, ato janë të shkruara me aq kujdes, sa autori nuk do të mbetej mbrapa shumë mjeshtërve të manus-kripteve që gjenden nëpër arkiva e muze botërorë, vendeve ku vlerësohen dhe ruhen dorëshkrimet për qëllime studimi edhe nga ky prizëm.

Në përgjithësi, vlerësojmë se Sali ef. Myftija e ka zotëruar këtë stil të shkrimit në nivel të shkëlqyeshëm. Kjo vërehet lehtë prej çdo njohësi të fushës, për çka, edhe pse nuk kemi të dhëna të cilat na tregojnë se ku dhe prej kujt e ka mësuar kaligrafinë arabe, ajo që kemi pra vetes flet mjaft për nivelin e edukimit artistik që e kishin myderrizët e kohës së tij, apo edhe kujdesin të cilin e kishin për bukurshkrimin në të kaluarën.

Për fund, mbesim me shpresë se me përkujdesje institucionale do të gjinden edhe materiale të tjera me përmbajtje të dorëshkrimeve të hoxhës së nderuar, e pastaj të studiohen e ndriçohen edhe më shumë veprat e tij, përmes të cilave ai na e përcjell një pjesë të kulturës dhe të artit që kishin hoxhallarët tanë të nderuar, e për të cilin art dhe për të cilët hoxhallarë sot dimë mjaft pak.

⁹ <https://www.almsal.com/post/738163> (23.06.2022).

Dosja sekrete e Ministrisë së Punëve të Brendshme / Drejtoria e Sigurimit të Shtetit*

MINISTRIJA E P. TË MBRENDËSHME
DREJTORIJA SIG. SHTETIT

Nr. regj. 544 337 Kateg. _____

1944

DOSJE FORMULARE

MYFTIU SALI

EMËRI E MBIEMËRI _____
PSEUDONIMI _____

79 = M

Data e hapjes _____
Data e Përfundimit _____

* Në këtë kapitull të revistës po sjellim vetëm disa nga dokumentet e dosjes sekrete për Sali ef. Myftiun, ndërkohë që dosja komplet gjendet në arkivin e IHSI-së.

INVENTARI

Model Nr. 2
TEPER SEKRET

I materialeve që ndodhen në dosjen Nr. 1

Nr. Rend.	Emërtimi i materialit	Prej sa faqe përbëhet	Data që mban dokumenti	Numrat e fletëve në dosje	Vrejtje
1)	Lista e personave që ishin të detyrues	3	shk.	1-3	
2)	" " që janë ngjashëm me dosjen	1	"	4	
3)	" e p.op. që kanë në ngjashmëri dosjen	1	"	5	
4)	Biografija e tij	1	20-X-1949	6	6 fletë bove
5)	Libër fletor	6	28-XII-1957	7-12	
6)	Informim mbi llojin e kriminelit	1	"	13	
7)	Recension	1	"	14	
8)	Biografia bioprof. pinte e famëzuar	7	ndryshuar	15-21	
9)	Prograsti i informimit nga llojshmëri	2	"	22-23	
10)	Informata që flasin për të	4	"	24-27	
11)	Tupelimit me proces	3	"	28-30	
12)	Informata që flasin për Selin	1	19-XII-1949	31	
13)	Vendosja e propozimit	1	15-9-1957	32	
14)	Kështjura e Kështjës	2	28-XII-1957	33	
15)	Informata mbi llojin e kriminelit	2	25-1-1958	34, 35	
16)	Informata mbi kriminelin N. 1	1	7-5-1958	36	
17)	" mbi llojin e kriminelit N. 2	1	10-10-1958	37	
18)	Parashikimi i llojit të kriminelit N. 3	1	5-3-1958	38	
19)	Logjistik " " mbi llojin N. 4	1	20-3-1958	39	
20)	Telegr. N. 167 nga N. 1	1	11-6-1958	40	
21)	Informata mbi llojin e kriminelit N. 1	1	15-6-1958	41	
22)	" " " " N. 2	1	20-7-1958	42	
23)	" " " " N. 3	1	20-7-1958	43	
24)	" " " " N. 4	1	20-10-1958	44	
25)	" " " " N. 5	1	11-10-1958	45	
26)	" " " " N. 6	2	13-5-1958	46-47	
27)	" nga procesi i llojit	1	"	48	
28)	" nga lloji i llojit	1	5-8-61	49	

7 - 2 (6)

BIORGATILJA E SALIU MYFTIJA

Ashte nga Shkodra, Klerik Mysliman. EkspONENTI kryesor i legalitetit ne qarkun e Shkodres. Ne regjimin Zogollian ka qene mik i ngushte i Musa Jukes at-hera Minister i Brendshme. Me tre dhetime e Abaz Kupit dhe me daljen ne skene te legalitetit, ky asht organizatori per krijimin e kesaj organizate ne Shkoder. Ka propaganduar per rikurtimin ne gjendmeri qe ish ne sherbim t'okupatorit. Ka paze lidhje me gjith reaksionaret me marka te ndryshme si ball, Mac, Indipendent etj. Ka mare pjese ne mledhjen ne ashte ba tek Sulgo Beg Bushati nga Gjon M. Gjoni e tjere per formimin e lidhjes se Shkodres. Ne apartallimin e forcave te legalitetit ne qarkun e Shkodres, ka ike n'Itali, ku sot ben pjese ne Komitetin qendror te kesaj organizate.

U shtyp ne 4 kopje.-
Tirane, me 20-10-1945.-

16/5.7. 8 (13)

MBI LEVIZJET E KRIMINELAVE LUFTË SHQIPTAR JASHT SHTETIT


27

MBI LEVIZJET E KRIMINELAVE SHQIPTAR
NGA ITALIJA NE EGJIPT

24

1) Ragip	Prasheri
2) Kogo	Muka
3) Sali	Myftiu
4) Mehmet	Aloni
5) Egëron	Telhaj
6) Nexhat Mehqemeja	
7) Irfan	Oheri
8) Hashim	Kyseni (nga Kosova)
9) Ali	Kelcyra
10) Ernest	Kolliqi
11) Ibrahim Farka	(Ka shkuar me pare nga Italia ne France)

uu - - - - 0 - - - -



(Relacion)
(Zopistin) Relacioni Salit Miftin Shkodra
Eshtë datë 1-1880 ka marrëdhëniet Shkodra
e mëndresës, me profesion jetar ¹⁴ martuar
me Jemijë; Ilet dhe Shkruan Shqip dhe Europisht
gjatë regjimit Zopit e ka simpatizuar
këtë regjim mbasi, vetë nga intereset e pasur
pytetarë, ka pasur simpatizim për në 2 Klerin
mishmanan, ardhjen e jashtëm të Se Ka-
pitrur mirë për siç utha Se ka qenë lidhur
me Zopit. Medaljen e Legalitetit ulidh, ngusht
me këtë, ka përmirësuar lidhur ngusht me Gjoni Marka
gjoni, blusht Leshanasku, dhe Halit Alin -
ka dalur në mal dhe ka mobilizuar popullin në
për të forcuar Legalitetin, ka përmirësuar
lidhje me Misi Janet Engleze = 10

2) SALIH MYETIJA Nga Shkodra, e bënues në Lagjen Hdocej. Eks-
ponenti kryesues i legalitetit në qarkun e Shkodrës. Në regjimin Zogoll
lian ka qenë mik i ngusht i Musa Jukes. Atëherë Minister i Mbrodeshem.
Me tradhëtin e Abas Kupit dhe daljen në skenë të legalitetit ky është
organizatori për krijimin e kësaj organizate ~~kontra~~ në Shkodër. Ka propa-
gandue për rekrutim në gjindermari që ish në shërbim të okupatorit. Ka
pase lidhje me të gjithë reaktionaret në markë të ndryshme si Ball, Nac.
Indip. e t.j. Ka marrë pjesë në mbledhjen që është bërë tek Sulgo Bushati
nga Gjon M. Gjoni e t.j. për formimin e lidhjes së Shkodrës. Ish Komandant
i të gjithë forcave të legalitetit në qarkun e Shkodrës. Me shpërtalli-
min e forcave të legalitetit në qarkun e Shkodrës, ka ike për në Itali.
Anëtar i lëvizjes M.G.L. e sidomos i Partisë Komuniste. 15

27 18 (29)

I n f o r m a t e

Komisioni që është shkruar në Egjipt pranë Lidhjes Arabe dhe Zogut, ndodhet në Siri ku është prit nga Presidenti i Sirisë. Qeveria Siriane ka paraqit në Parlament një projekt ligj për një fond i cili të rrejtë për mirë mbajtjen e Shqiptarëve të emigruar. Si komision ndodhen në Siri: Sali Myftiu, Dr. Qemal Jusufali, Rashid Frasherit, Ernest Koliqi, Koco Muka dhe Ali Kelcyra. Janë takuar dhe me Zogun me të cilin kanë tentuar për formimin e një fronti të përbashkët por deri në sot nuk kanë nxjerrë as një rezultat.

Siria ka pritur që oficeret ka me i marrë në shërbim sidomos ata që kanë dokumenta shkollore, gjithashtu teknikët dhe profesionistat, bëjnë ka me u nda toke. Deri në sot janë marrë në shërbim në ushtri Haxha Drini dhe Mul Bektari.

Emigracioni ka me u bërë më i lehtë në Siri, mbasi është vendosur definitivisht në Itali kanë me marrë pak.

----- 0 -----

Nxjerrë nga raporti Nr. 23/e dt. 10-2-48 i Italisë.-

26 20/3 17 (25)


I N F O R M A T E

Për të siguruar emigrimin Shqiptarë në Egjipt dhe në vendet Arabe të Lindjes së mesme është nisur për në Aleksandri të Egjiptit një kamion i përbërë nga Sali M. Myftia, Ali Kelcyra, Koco Muka, Dr. Qemal Jusufali, Prof. Ernest Koliqi dhe an. Rashid Frasherit dhe Mehdi Frasherit.

Në këtë kamion janë nisur edhe një 20 Shqiptarë të tjerë ndërmjet të cilëve Egerem Telhaja, Sulejman Kryeziu nga Kosova, Kolonel Buletini, nga Kosova, Irfan Oheri nga Kavaja e tjerë. Një 20 Shqiptarë ndërmjet të cilëve dhe ~~komiteti~~ troçkisti Sadik Prantia edhe Major i Policisë Ndue Permarkaj, kanë kaluar kontrabandisht kufirin Italo-Francez kater persona ndërmjet të tyre kontrabandistave, kanë qenë arrestuar nga autoritetet franceze, që i kanë dorëzuar në autoritetet Italiane. Tani këta ndodhen në burgje në Torino.

----- 0 -----

Nxjerrë nga informata: dt. 10-2-48.



RRETHI FAMILJAR DHE BIOGRAFIJA E DISA PJESTARVE
TË FAMILJES SË SALI MYFTIS

(Kriminal Luftë)

- 1) Sali Myftija, kriminal luftë, i arratisur në Itali.
- 2) Fuat " " i arratisur në Itali (djali Sali Myftis)
- 3) Qamile " " e shoqja e cila banon në Shkodër
- 4) Ferit " " I biri, i burgosur për aktivitet pol. në grupet e studentave

- 5) Mit'hat Myftija: I biri ndodhet në Ushtri
- 6) Mame " " E bija " " Shtëpi
- 7) Sadije " " " " " "
- 8) Nezihat " " " " " " Shkollë
- 9) Xhevat " " I biri ndodhet në Shkodër me punë
- 10) Safet " " E bija " " " " Shkollë
- 11) Xhevdet " " I nipi, djali vllajt, banon në Shkodër
- 12) Muhamet " " " " " " " " shërb. Mesazh
- 13) Zeide " " E kunata, banon në Shkodër, shtëpija e...

Këto janë pjestarët e rrëthi familjar i familjes së personit sipërm.

BIOGRAFIJA E FUAT MYFTIS

Fuat Myftija: I biri Salihit dhe i Qamiles, lindur e bënues në Shkodër, vjeç 31, me kombësi e nënshtetësi Shqiptare, me aresim të mesëm i pa martuem, i pa dënuar, i arratisur politik në Itali, vjen prej shtresave të ulëta të qytetit.

Në kohën e zotit Fuat ka vazhduar mësimet. I influencuar prej familjes ka ndie simpati për rregjimin e zotit, por ndonji aktivitet të dukshëm nuk ka treguar, me qenë se atëherë ka pasq-moshm të re.

Gjatë periudhës t'okupacioneve në vendin tonë qëndrimi i Fuatit ka qenë kundër L.Nac.91. dhe pro organizatës trashtare të legalitetit, për të cilën ka punuar aktivisht, mbasi beba i tij Sali Myftiu në këtë organizatë ka qenë eksponent. Për qëndrimin jo të mirë gjatë kësaj periudhe, përpara qirimit Fuatit me baben e tij marrin rrugën e arratisjes jashtë Shtetit në Itali.

Fuat në këtë kohë ka pasq-shoqëri me njëjt person si Adem Kombi (i burgosur), Asim Boksini i vrarë, Faik Amalin i arratisur jashtë Shtetit, Sami Repishtin në burg, Sabri Repishtin i lirë, Nexhi Barbullushin tash në Tiranë (miknesh), Shqip Maten (në burg), Ymer Haverin etjers.

I përmenduri për disa vjet mbas arratisjes ka jetuar në Itali. Tani nuk dijmë se ku mund të jenë.

!-----!

L A J M E R I M.

Me 15_16 udbtra shkova n'Aleksandri, takeva me SALI MUFTIN, me te cilin n'ata nji bashkefjalim e sidomos n'er ceshtjen qe kisha n'arash: true ma n'are. I kerkeva dijeni mbi Abas Kun dhe me tha qe ka shkue N'YORK e ka n'er qellim forcimin e n'artis Legalitetit n'der shtetet e Bashku me me qene se atje jane duke u zhvillue evenimente te rea, e qe sidomos m kthimin e Vatres kundra Tiranes, atje ka shkuar edhe Ali Kelcyra i cili n'er, i qet n'er interesat e n'artis tije. Kish n'jeftim nga i biri i tije qe ish n'Amerik se kryetari i Vatres eshte ne n'lete aktivitet ne faverin e Nacionalizmit e eshte tue zhvillue fjalime e n'negandime kundra komuniz mit e sulmen gjitmen Qeverin e Tiranes.

Mbas ketyre me dha adresen e Mubarrrem Gjokes qe eshte n'rane ish mbretit Zeg ne Canas (France) ne menyrt qe n'ata ndenji send ti shk-ruaj HUSEN Selmanit ose Abas Kun, it. Mbas ketyre me n'jeftoj n'er Adem Heden dhe Faik Bukmirin qe kane shkue n'Amerik nga Greqija, kurse ne Greqi kane tash n'er tash qendron nji fare Mate Lame nga katundet e Vleres ne sher- bim te Amerikanve.

Te dhena nga burimi "NR.I." te dates 20.III.1959

Dak. nga p.O. Toger Enver Milet. Date 4.V.1959

39

L A J M E R I M.

Me 15_16 udhëtra shkova në 'Aleksandri, takova me SALI MUFTIN, me të cilin nata një bashkëfjalim e sidomos për çështjen që kishte parashtrë ma për. I kërkeva dijeni mbi Abas Kuqin dhe me të tha që ka shkue në NY YORK e ka për qellim forcimin e partis Legalitetit ndër shtetet e Bashkuar me me qene se atje janë duke u zhvillue evenimente të reja, e që sidomos m'kthimin e Vatres kundër Tiranës, atje ka shkuar edhe Ali Kelcyra i cili përfaqëson për interesat e partis tije. Kishte njëftim nga i biri i tije që ish në Amerikë se kryetari i Vatres është në plote aktivitet në favorin e Nacionalizmit e është tue zhvillue fjalime e prenegandime kundër komunizmit e sulmen gjithmonë Qeverinë e Tiranës.

Mbas ketyre me dha adresën e Muharrem Gjokës që është rranë ish mbretit Zog në Canas (France) në mënyrë që në nata ndonjë send të shkruaj HYSSEN Selmanit ose Abas Kuqin. Mbas ketyre me njëftoj për Adem Heden dhe Faik Bukmirin që kanë shkue në Amerikë nga Greqia, kurse në Greqi kanë tash për tash qëndron një fare Mate Lami nga katundet e Vlores në shërbim të Amerikanëve.

Te dhëna nga burimi "NR.I." të datës 20.III.1959

Dak nga P.O. Toger Enver Milet. Datë 4.V.1959

43 48

I N F O R M A T E



Zogu mbante kontaktë të shpeshta dhe kishte lidhje të ngushta me Abas Kupin, Yqmet Delvinin, Ymer Beshirin, me ~~balakstet~~ Ali Kelcyren e Koço Muken, me bllokistët Mustafa Krqjen, Ago Agan, Sali Myftiun dhe Irfan Ohrin.



Në vitin 1948 Zogu me inisjativën e vetë u mundueme bashkue të aratisurit kështu që bëri një mbledhje në një hotel të Aleksandris ku morën pjesë Abas Kupi, Yqmet Delvina, Ymer Beshiri, Sali Myftiu për Legalitetin, Ali Kelcyra-Koço Muka për ballin, Ago Agai për Independencën dhe të tjerë. (Faqe 16)

Me të aratisur të adryshëm si Koço Muka, Ymer Beshiri, Sali Myftiu, Irfan Ohri etj, kemi biseduar mbi çështjet politike. Në këtë bisedë neve shprehëm për ardhjen tonë në Shqipëri e kemi pasur tek amerikanët me adhimet e të cilëve shpresonim të rezonim pushtetin për pullorë. Në verën e vitit 1951 Zogu shkoje në Amerikë dhe kur u kthye në Egjipt është takue me M. Krujen, Koço Muken, Sali Myftiun, etj.

U nxuaren nga procesi gjyqësor Zenel Shehut viti 1953 (faqe 15-16)
Dak nga P.O. Kapiten Enver Milet. Datë 18/3/1961

Enver





56 42

I N F O R M A T

Nga burimi jone njoftohemi se ne nji bised me Sali Myftiun ku i fundit i ka dhane kurajo qe ai te mos deshtprohet se punase kur-
betit keshtu e ka, se do te babet diçka me gene se partit tona jane
me teper te bashkueme dhe ne marveshje me Amerikanet.

Te dhena nga burimi

"Nr 2 "

Dak nga P.O.Toger E.M. 1959
Date 20.VII.1959

55.52 60

I N F O R M A C I O N

SALIH MYFTIU, Myftiu i Shkodres, arriti ne New York me vaporet
"Queen Anna Maria".

Myftiu i Shkodres eshte larguar nga Shqiperia 21 vjet me par
prej te cilave ka jetuar ne Egjipt 12 vjet pandërprere.


Nje shumice e konsiderushme bashkeatdhetarësh kishin dale p
ta pritur disa ore me pare ne port, te cilet ishin : Rexhep Krasniqi,
Mehmet Dibra, Haxhi Xhillaga Member Of Vates Board, Hamza Drini e Muhe-
din Haxhija perfaqesues te "Legalitetit", Isa Hoxha, Neki Babani etj.

Sali Myftiu shkoi nga Egjipti per te qendruar pergjithemon i
SHBA. "Kolonja shqiptare sot fuzizohet jo vetem me nje klerik qe perfa-
qeson denjesisht islamizmin shqiptar ne mergim, por edhe me nje patri-
udheheqes te rezistences kunder okupatoreve te Shqiperise".

Me poshte gazeta shkruan:

"Ne Shqiperi Myftiu i Shkodres e pjestar i komunitetit mysl-
man me qender ne Tirane. Qe i njohur ne Shqiperi per kulturen e gjere
islamiqe qe zoteronte dhe si organizator i emancipuar e i cilesuar ne
qarkun e tij. Me 1939 Italia e internoi ate ne Gjirokastr dhe ai u
stergua atje ne tegene e Baba Selimit. Mbasi u liruan nga internimi u
kthee ne Shkoder ku filloi me nje here aktivitetin e tij me nje grup
si Ndoc Caba, Rrok Gera, Xhemal Naipi dhe formoi atje organizaten "Besa
Shqiptare" e cila u shpall ne organizaten kombetare "Lvizja e Legali-
tetit" e cila kerkoi rikthimin e Monarkise shqiptare". Gjat okupacion
Gjerman Myftiu stabilizoi shtabin e tij ne Grumire, ku personalisht
mbykqyrte veprimtarine politike ushtarake. Eshte larguar nga Shqiperia
me 22 Nendor 1944 dhe doli ne Itali ku u muer nga IRO. Ne vitin 1947
u thirr nga Zogu ne Egjipt dhe atje filloi aktivitetin e tij misionar
duke kryesuar nje komitet per sistemimin e Shqiptareve ner shtetet Ar-
be"....."

Nxjere ne forme permbledhje nga gazeta "Dielli"
i Shtator 1965. Nxori Kap I-re Haxhi Cano.





SALI MYFTIJA, MYFTIU I SHKODRËS, NJË NGA EKSPONENTËT ZOGISTË NË QYTETIN
E SHKODRËS, QË KA ORGANIZUE REAKSIONIN ZOGIST NË SHKODËR
GJATË REGJIMIT ZOGIST E LUFTËS N.ÇL.

Kjo fotografi është marrë nga fotografi Dea Jakova me rastin e vizitës së Princeshave (motrave të Zogut) në Shkodër. SALI MYFTIJA, së bashku me një hexhë shkodran, tregoi nga vizita që ka pasur me Princeshave, me rastin e kësaj ardhjeje në tyne në Shkodër. Fotografia është marrë në shkallët e Hotelit ku kanë pasur Princeshat (set Hotel "Turizmi"). Zyrtari që i shoqëson duket se është Shefi i ceremonive të Pallatit të Zogut, që ka ardhur për t'i shoqëruar Princeshat në Shkodër (Setir Martini?).

Edhe ky është riprodhim. Negativi ruhet në Muzeun Popullor të Shkodrës.

Shkodër, më 26 Korrik 1970

Ciceroni i Muzeut:

(Vasil Ilazari)

V. Ilazari

66

FOTOALBUM NGA TRYEZA SHKENCORE “SALI EF. MYFTIJA PERSONALITET I SHQUAR FETAR E KOMBËTAR (1891-1978)”



Hapja e Tyrezës shkencore nga myftiu Naim ef. Tërnavë



Muhammed ef. Sytari – myfti i Shkodrës



Ekspozeu hyrës i drejtorit të IHSI-së, Sabri ef. Bajgora



Erjeta Myftia, mbesa e Sali ef. Myftisë



Kryesia e punës në njërin nga Seancat e Tryezës



Irida Hoti, mbesa e Sali ef. Myftisë



Sabri ef. Bajgora



Elez Osmani



Bashkim Mehani



Dorëzimi i mirënjohjes për familjen e Sali Myftisë



Pasardhësit e Sali Myftisë



Drejtori i IHSI-së me familjen e Sali ef. Myftisë



II

AKTET E TRYEZËS SHKENCORE

“HFZ. FAHRI EF. ILJAZI - (1903-1985) ALIM DHE UDHËHEQËS I SHQUAR I BASHKËSISË ISLAME”



Bashkësia Islame e Kosovës
Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame

TRYEZË SHKENCORE
Me rastin e 120-vjetorit të lindjes

Hfz. Fahri ef. Iljazi
(1903-1985)

- Alim dhe udhëheqës i shquar i Bashkësisë Islame -

8 qershor 2023, Prishtinë



**Fjala e hapjes në Tryezën shkencore
“HFZ. FAHRI EF. ILJAZI -
ALIM DHE UDHËHEQËS I SHQUAR
I BASHKËSISË ISLAME”**



*I nderuari Myfti i Republikës së Kosovës, Naim ef. Tërnavë,
E nderuara familje e hfz. Fahri ef. Iljazit, - i nderuari profesor
Muhamed,
I nderuari kryetar i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, dr. Ajni
Sinani,
I nderuari dekan i FSI-së, dr. Islam Hasani,
Të nderuar anëtarë të Kryesisë,
Drejtore të Drejtorive të Kryesisë,
Të nderuar anëtarë të KD-së së IHSI-së,
Profesorë nga FSI-ja dhe Medreseja,
Të nderuar studiues dhe panelistë të kësaj Tryeze shkencore,*

*Mysafirë dhe kolegë të dashur,
Zonja dhe zotërinj!*

Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame, në kuadër të veprimtarisë së tij të gjithanshme shkencore e studiuëse, përveç të tjerash, në fokus ka edhe punën kërkimore-hulumtuese nga fushat e shkencave islame, si dhe nga kultura dhe trashëgimia shpirtërore e popullit shqiptar.

Nisur nga të gjithë këto objektiva, është nder dhe privilegj i veçantë që sot gjendemi në këtë sallë, për një ngjarje të këtillë shkencore, siç është kjo Tryezë shkencore, e cila i dedikohet një figure kaq emblematike siç është figura e ndritur e alimit dhe udhëheqësit të shquar të Bashkësisë Islame, hfz. Fahri ef. Iljazit.

Të nderuar të pranishëm,

Në këtë vit, mbushen 120 vjet nga lindja e hfz. Fahri ef. Iljazit, njeriut që la gjurmë të pashlyeshme në kujtesën e shumë brezave, njeriut që shpërndau dritën e dijes hyjnore nga Medreseja e Madhe e Gjakovës, nga minberi i Xhamisë së Hadumit dhe shumë xhamive të tjera në anën e Dukagjinit.

Mbase, një eveniment i këtillë shkencor për nder të këtij kolosi, është dashur të mbahet shumë më herët, por ja që Institutit tonë i ra fati ta kishte këtë nder dhe privilegj.

Të flasësh për hfz. Fahri ef. Iljazin dhe për kontributin e tij në ngritjen shpirtërore të besimtarëve dhe sidomos të nxënësve-talebeve, është një punë bukur e vështirë dhe mjaft komplekse, sepse është pothuajse e pamundur të radhitësh në letër virtytet me të cilat e kishte pajisur dhe zburuar personalitetin e tij i Madhi Zot.

Fatmirësisht, në këtë Tryezë shkencore, ende kemi njerëz që e mbajnë gjallë kujtimin për të, dhe nga ata do të dëgjojmë mbresa e kujtime të dorës së parë. Për ne, është po ashtu një nder, që në mesin tonë, në Kryesinë e BIK-ut, kemi edhe nipin e hfz. Fahri efendiut, Fatmir ef. Iljazin, i cili e vazhdon me sukses këtë rrugëtim gjeneratash të familjes së madhe Efendija.

Nga shumë prej gjeneratës së tyre që janë shkolluar nëpërmjet duarve të këtij alimi të madh, gjithnjë kemi dëgjuar fjalë të mëdha, por në fund, të gjithë ata, e ndienin veten të pafuqishëm ta përshkruanin në mënyrë meritore personalitetin e tij të pashoq. Ky alim i madh, së bashku me shokët e tij, ishin sikurse drita nëpërmjet së cilës udhëzohej populli. Fjalët dhe mësimet e tyre dëgjoheshin nga masa, sepse derti i tyre nuk ishte fama, përkundrazi, ata i karakterizonte thjeshtësia, sepse të tillë e kishin vetë jetën e tyre. Fahri ef. Iljazi, jetonte pothuajse një jetë asketi. Zemra e tij ishte e mbushur me çiltërsi e modesti, e nga kujtimet e talebeve për të, thoshin se sytë e tij ishin të mbushur me nurin e thjeshtësisë e përlësisë.

Ah, sa kemi nevojë sot për thirrës të tillë, që kanë këto cilësi dhe përshkrime! Thjeshtësia e një dijetari, në këtë rast e portretizuar në figurën e një alimi të madh, emri i të cilit i tejkaloi kufijtë e vendi tonë, është shenja identifikuese e krenarisë, e respektit dhe e madhështisë së tij. Vlera e këtij alimi buronte nga brendësia e tij. Ai ishte i kompletuar në vetvete dhe kurrë nuk u ndikua nga rrethanat. Prandaj, kujtimi për të, nuk përfundoi me vdekjen dhe ndarjen e tij nga njerëzit, përkundrazi, vepra dhe fjalët e tij, janë rrënjësor thellë në zemrat e besimtarëve, e sidomos te ish-nxënësve të tij.

Unë jam thellësisht i bindur se kjo Tryezë shkencore do të hapë rrugë, që kjo figurë emblematike e myderriz Fahri ef. Iljazit, të studiohet edhe më tepër, dhe të sigurohen dokumente arkivore në ndriçimin e mëtutjeshëm të jetës dhe veprës së tij.

Jemi të vetëdijshëm se në luftën e fundit në Kosovë janë zhdukur mijëra dokumente të së kaluarës sonë, e mbi të gjitha të trashëgimisë shpirtërore islame, por mbesim me shpresë se ndoshta, aty-këtu ende është ruajtur ndonjë gjurmë, në kujtim të këtyre kolosëve të dijes, siç është rasti me hfz. Fahri f. Iljazin.

Ju faleminderit!

Ves-selamu aljekum!

Sabri Bajgora

Drejtor i Institutit për Hulumtime
dhe Studime Islame

**Fjala e Myftiut Naim ef. Tërnavë në Tryezën shkencore
HFZ. FAHRI EF. ILJAZI -
ALIM DHE UDHËHEQËS I SHQUAR I
BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS**



*E nderuar familje Iljazi,
I nderuari drejtor i IHSI-së, Sabri ef. Bajgora,
Të nderuar udhëheqës e drejtues të BIK,
Mysafirë të çmuar,
Studiues e pedagogë,
Të nderuar të pranishëm,*

Kam nderin dhe kënaqësinë që sot jam i pranishëm në këtë Tryezë shkencore të organizuar për të vlerësuar jetën, veprën dhe kontributin e njërit prej personaliteteve, myderrizëve, myftinjve e alimëve më të shquar të Bashkësisë Islame në shekullin e kaluar – hafiz Fahri efendi Iljazit.

Përgëzoj nismën e Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame që në objektivat e tij të punës ka vënë si primare ndriçimin e kontributit të ulemave tanë të mëhershëm, ndër ta edhe për myderrizin dhe alimin tonë të shquar Hafiz Fahri efendi Iljazin. Prandaj, një nismë të tillë nuk kemi se si të mos e mbështesim dhe ta përkrahim pa asnjë hezitim, sepse ky është misioni dhe detyra e Institutit tonë, por edhe obligim i yni në përgjithësi.

Është detyrë dhe obligim i ynë që të njohim pararendësit tanë dhe t'u shprehim mirënjohjen më të thellë, sepse ata në kohë e ditë të vështira e me shumë sfida e pengesa, arritën që me përkushtim, urtësi, këmbëngulje e vizion të qartë të udhëhiqnin Bashkësinë Islame, të themelonin e të organizonin institucionet e saj dhe t'i vinin në funksion për të mbajtur gjallë dhe për të zhvilluar jetën fetare islame e arsimore në vendin tonë.

Në mesin e kësaj plejade të ulemasë sonë, pa dyshim se meritueshëm zë vend edhe Hafiz Fahri efendi Iljazi, për të cilin sot jemi tubuar këtu në këtë Tryezë shkencore.

Të nderuar të pranishëm

Myderriz Fahri efendiu, - me gjithë që jetoi e veproi në kohë të vështira ku ndërrimet e sistemeve shoqërore e ideologjike ishin të shpeshta dhe në të shumtën e rasteve edhe të dëmshme e me pasoja për ne si popull, dhe të cilat nuk ishin aspak dashamirëse për besimet në përgjithësi, e besimin islam në veçanti, - ai falë edukimit të mirë e të drejt që kishte marrë që nga familja disa breza hoxhallarësh dhe i kalitur e formuar nga qaraku i ulemasë së Gjakovës, tërë jetën ia kushtoi misionit për të cilin ishte përgatitur, për din e iman, për fe dhe për të mirën e shoqërisë dhe të vendit, gjithnjë mbi parimet dhe mësimet e Kuranit fisnik, të cilin e kishte mësuar përmendsh që në rininë e tij, tek i ati i tij muhafizi e myderrizi injohur Iljaz efendiu, tek i cili edhe i nisi studimet në Medresenë e Madhe të Gjakovës, për t'i përfunduar me ixhazet në medresenë e njohur "Mehmet Pasha" të Prizrenit para myderrizit, myftiut e dijetarit Hafiz Nysret efendi Galibit.

Pas mbarimit të studimeve në medrese, Fahri efendiu, emërohet myderriz kryesor dhe drejtues i Medresesë së Madhe të Gjakovës, nga ku më pastaj filloi rrugëtimi dhe angazhimi i tij në detyra të ndryshme udhëheqëse e organizative në institucionet e Bashkësisë Islame, qoftë në kuadër të Komunitetit Mysliman Shqiptar me qendër në Tiranë, nga i cili emërohet Myfti i Gjakovës, apo qoftë pas Luftës së Dytë Botërore, ku e gjejmë në strukturat e forumet e Bashkësisë Islame, që nga Këshilli i Gjakovës, Myftinia e Dukagjinit, Kryesia e Bashkësisë Islame, e deri tek forumet qendrore të Bashkësisë Islame në ish-Jugosllavi .

Myderriz Fahri efendiu në të gjitha detyrat, emërimet e angazhimet që iu besuan, tregoi profesionalizëm, përgatitje e përkushtim të veçantë, dhe kjo dëshmohej me besimin e fituar të kolegëve dhe respektin e besimtarëve në mbarë vendin tonë dhe më gjerë.

Aktivitetin e tij prej udhëheqësi e drejtuesi të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myderriz Fahri efendi Iljazit, me përjashtim të periudhës kur ishte myfti i Gjakovës në kuadër të Komunitetit Mysliman Shqiptar, e ka zhvilluar gjatë sistemit monist, pra në një periudhë mjaftë të ndjeshme e delikate për misionin e hoxhës. Prandaj, puna dhe vepra e ulemave tanë që jetuan e vepruan në këtë periudhë, pra edhe Fahri efendiut, meriton vlerësim, respekt e mirënjohje të veçantë, aq më parë kur ata morën përsipër jo vetëm zhvillimin e jetës fetare islame, por edhe konsoliduan, organizuan e themeluan edhe institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës në kuadër të rrethanave dhe kushteve të krijuara në ato kohë.

Të nderuar pjesëmarrës

Meqenëse në këtë tryezë shkencore kemi edhe studiuesit pjesëmarrës me kumtesa, atëherë dhe fjala kryesore u takon atyre për të shpalosur dhe për të dhënë vlerësime më meritore për jetën dhe veprën e Hafiz Fahri efendi Iljazit.

Mirëpo, mua më lejoni t'i rikonstatoj edhe dy-tri gjëra. Organizimi i kësaj Tryeze shkencore për myderriz Fahri efendi Iljazin, edhe njëherë dëshmon vendosmërinë e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, për të vazhduar traditën e saj të nisur vitet e fundit për ndriçimin e asaj

plejade të tërë të ulemave që u shquan ndër vite e dekada për punën e tyre vetëmohuese e këmbëngulëse për të mirën e njerëzimit, të fesë dhe të atdheut tonë.

Kjo Tryezë shkencore, po ashtu dëshmon përmbushjen e premtimit të dhënë nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës se vargut të sesioneve e tryezave shkencore të mbajtura për myderrizët: Haxhi Sherif ef. Ahmetin (2010), Hasan ef. Nahin (2012), Sadri ef. Prestreshin (2013) dhe Bajram ef. Aganin (2014), botimit të përmbledhjeve për ta, do t'u bashkohen edhe sesione, tryeza e konferenca edhe për ulema të tjerë të shquar të Kosovës dhe se jeta, veprimtaria dhe kontributi i tyre i gjithmbarshëm e shumëdimensional do të jenë pjesë e interesimeve tona dhe të studiuesve tanë, sepse ata vërtetë meritojnë më shumë se kaq dhe se ata prore do të kenë vëmendjen dhe vlersimin tonë maksimal.

Në fund, edhe një herë përgëzoj Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame për organizimin e kësaj tryeze shkencore dhe mirënjohje e falënderim gjithë dashamirësve dhe kontribuuesve për ndriçimin dhe vlerësimin e jetës dhe veprës së Hafiz Fahri efendi Iljazit, për shpirtin fisnik të të cilit, ju lus të këndojmë bashkërisht një "Fatiha"!

Ju faleminderit dhe punë të mbarë!

Prof. Muhamed ILJAZI

KUJTIME FAMILJARE

I nderuari Myfti, Naim ef. Tërnavë,

I nderuari drejtor i Institutit, Sabri ef. Bajgorë,

Të nderuar të pranishëm,

Më lejoni që fillimisht të shpreh falënderimet më të përshpirtshme dhe konsideratën më të thellë në emrin tim dhe në emër të familjes sonë, për të gjithë ju si Kryesi e Bashkësisë Islame të Kosovës, e në veçanti për myftiun e nderuar Naim ef. Tërnavë, si dhe për Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame, në krye me Sabri ef. Bajgorën, për punën tuaj madhore që bëni çdo ditë në dobi të Islamit dhe myslimanëve të Kosovës, e në veçanti për ndriçimin e kontributit fetar dhe kombëtar të ulemave dhe hoxhallarëve të trojeve shqiptare, në këtë rast edhe të babait tim, myderrizit, hafëz Fahri efendi Iljazit.

Kujtimet tona familjare, do të ishin të mangëta, nëse nuk do të ktheheshim pak në historikun e familjes sonë, brez pas brezi, ngase vetëm kësh-tu mund ta kuptojmë figurën e babait tonë Fahri efendiut. Nga të dhënat historike është e ditur se të parët tanë erdhën në Gjakovë nga Shkodra, rreth vitit 1690. Myderriz Jahja efendiu dhe i biri i tij myderriz Vejsel efendiu, që të dy të shkolluar në Stamboll, u vendosën në Gjakovë, si thirrës të fesë islame dhe dritës hyjnore, për të përhapur arsimin, edukimin dhe kulturën përmes themelimit të Medresesë së Madhe të Gjakovës, e cila ishte vatra kryesore arsimore, edukative, kulturore, që i dha dritë gjithë Kosovës deri në vitin 1948, kur edhe u mbyll nga regjimi komunist.

Pra, rrugëtimi ynë fillon me themeluesin e Medresesë së Madhe – Vejsel efendiu, i cili ishte edhe myderrizi i parë në këtë Medrese, për të cilën

thuhet se ai vetë e themeloi, në vitin 1707, i ndihmuar dhe i përkrahur nga i pari i Gjakovës atëbotë, Murat begu, djali i Adem Kurt Pashës. Murat begu, në shenjë nderimi për themelimin e kësaj Medreseje i dhuroi myderrriz Vejsel efendiut një libër – dorëshkrim me myhyr, i cili llogaritet të jetë mbase dorëshkrimi më i vjetër në Kosovë.



Fahri ef. Iljazi, me dy djemtë e tij, Muhamedin dhe Aliun

Ndërsa Vejsel ef., në shenjë falënderimi dhe mirënjohjeje për këtë gje-st bujar e fisnik të të parit të Gjakovës, Murat begut, i thuri një poezi atij dhe babit të tij, në të cilën i lutet Allahut që Adem Kurt Pashës, t'ia ruajë djalnin, Murat begun. Këtë poezi e ka përmendur dr. Shefqet Canhasi në librin e tij *“Pishtari i Arsimit e i Demokracisë – Niman Ferizi”*. Kjo poezi, është ndër të rrallat e asaj kohe të largët të vitit 1699, e thurur në gjuhën shqipe.

Do t'i lutem unë Allahut,
Adem Kurt Pashës t'i falë shëndet,
E t'ia ruajë Murat begin,
Që ta pshtojë këtë millet.

Do t'i lutem që Adem Pashës,
T'i falë Allahu aq vjet e jetë,
Gjithë sa ka yje qielli,
Gjithë sa ka n'botë dushk e fletë.

Allah t'lus unë gjynahqari,
Falna m'katet për jetë e mot,
Gjith kah shkel këmbë shqiptari,
Ti bekoje i madhi Zot!

Adem pashë po t'knoj uratën,
Oxhak i parë n'kët Shqipni,
Nuk u lodhe për arkëthatën,
Veç ky popull t'marrë dijeni.

Murat begu, uvill¹ sabahi,
Si fener ti dritë na jep,
Me emër t'vet t'ruajt Allahi,
Që nxore popllin n'selamet.²

¹ Yll (sqarim yni, M. I.)

Të nderuar të pranishëm,

Të flasësh për Fahri efendiun e të mos e përmendësh lozën dhe gjenealogjinë e tij është pothuajse e pamundur. Prandaj kërkoj mirëkuptimin tuaj për ato pak gjëra që përmenda më lart.

Babai im është lindur në vitin 1903 në Gjakovë, në një familje me tradita islame, familje myderrizësh, hafëzësh e hoxhallarësh, nga babai myderriz Iljaz efendi dhe nëna Gjylia. Babai i tij ishte bërë hafëz qysh në moshën 9 vjeçe, ndërkohë që Fahri ef. Iljazi, hifzin e përfundoi në moshën 11 vjeçe, për të vazhduar pastaj mësimet në Medresenë e Madhe në Gjakovë po ashtu pranë babait të tij, deri në moshën 17 vjeçe, kur edhe i vdes babai duke e lënë jetim. Shkollimin e mëtutjeshëm e vazhdoi në Medresenë "Mehmed Pasha" në Prizren, të cilën e përfundoi me sukses, në vitin 1928.

Gjatë shkollimit të tij në Prizren, ishte shumë i përkushtuar në nxënien e dijes. I etur për dije, ai edhe natën mendohej ta bënte ditë. Në lidhje me këtë, kemi kujtimin e myderrizit Tahir ef. Thaçit, (djalë i axhës së Fahri ef.), i cili për këtë kohë të studimeve rrëfen e thotë: "Fahri efendi dallohej prej nxënësve të tjerë për përkushtimin e tij në nxënien e mësimëve. Shpeshherë në mbrëmje, në mungesë të dritave, dilte natën në oborr, dhe poshtë dhomës së mësuesit mësonte nën dritën e qiririt që dilte nga hapësirat mes perdeve të dhomës së mësuesit të tij. Ne flnim natën dhe në mëngjes e gjenim shtratin e tij të paprekur fare, që do të thotë se ai nuk ishte fjetur fare në dhomë."

Pas përfundimit të studimeve me sukses shembullor, përveç diplomës, e fitoi edhe titullin e nderuar dhe të çmuar myderriz, nga komisioni i përbërë prej: myderriz Rexhep efendiut nga Mitrovica, myderriz Atullah efendiut nga Shkupi dhe myderriz Nysret efendiut nga Prizreni.

Pas diplomimit, ai u inkadrua në punë si udhëheqës në Medresenë e Madhe të Gjakovës, duke bërë reforma në plan-programin mësimor. Ai përveç lëndëve aktuale, futi në plan-programin e ri edhe lëndë të reja si: Ilmi Kelamin (apologjetikën), Ilmi Feraizin (e drejta trashëgimore), Filo-

² Dr. Shevqet Canhasi "Pishtari i Arsimit e i Demokracisë-Niman Ferizi", Gjakovë, 2015.

zofinë Islame, Tesavufin Islam, Jurisprudencën Islame, Fizikën etj. Plan-programi i Medresesë së Madhe në Gjakovë i kishte lënë përshtypje edhe Behxhet ef. Shapatit nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, me rastin e vizitës së tij në Gjakovë, i cili pretendoi se këto lëndë duhej të inkuadroheshin menjëherë edhe në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës.³

Kujtimet e mia për babain i ndaj në kujtime të mija familjare (mënyra se si kemi jetuar, bisedat, mësimet dhe këshillat nga ai si prind), pastaj kujtime nga takimet e tij me palë të ndryshme që vinin në shtëpinë tonë, kujtime nga takimet me kolegët e tij imamë dhe hoxhallarë, dhe në fund, thënie dhe histori të ndryshme që i kam dëgjuar nga rrëfimet e të tjerëve për të, e që e përbëjnë pjesën më të madhe të njohurive të mia për babain, pasi siç thotë edhe populli: “Shpeshherë rrethi të njeh më mirë se familja jote.”

Fahri efendiu kishte madhështi, gëzonte respekt te çdo moshë. Të gjithë e njihnin. Fëmijët gëzoheshin kur e shihnin rrugës për në xhami dhe shtyheshin mes vete se kush do t’i fliste dhe ta përshëndeste i pari. I ndjeri, akademik Pajazit Nushi më tregonte se si fëmijë tuboheshin me shokët dhe prisnin kohën kur Fahri efendiu të kalonte pranë dyerve të tyre, që t’i ofronin ujë për të pirë, dhe lumturohej tejmas ai i cili kishte fat ta shërbeninte hoxhën. Nuk ishte qëllimi kryesor ta shërbenim me ujë, thoshte Pajazit Nushi, por dëshira e flaktë që ta shihnim për së afërmi dhe t’i flisnim e të na fliste. Ai ishte shumë autoritativ, madhështor në ecje dhe qëndrim, elokuent i paparë. Ecte i qetë dhe gjithnjë me shikim përtokë, thoshte i ndjeri Nushi.

Babain asnjëherë në jetë sa ishte gjallë nuk e kam parë pa uniformën e hoxhës, verë as dimër. Në rrugë me xhybe e çallme, ndërsa në shtëpi vetëm me çallme. E hiqte vetëm kur vetmohej në dhomën e tij ku edhe lexonte dhe studionte. Nuk e kam parë asnjëherë të rrijë kot, apo pa libër në dorë, me përjashtim kur dëgjonte lajmet e mbrëmjes. I dëgjonte me transistor edhe lajmet nga bota arabe.

Për peripecitë dhe vuajtjet e tij në familje për ta siguruar bukën e gojës, mbijetesën në ato kohë të vështira sidomos për parinë fetare, rritjen

³ Nga Kultura Islame, nr. 3, Tiranë, 1941.

dhe edukimin, shkollimin dhe martesën e gjashtë vajzave dhe dy djemve nga ana e tij si prind, kam shumë për të thënë, por sigurisht që jo sot në këtë Tryezë shkencore.

Në shtëpinë tonë çdo ditë trokitej dera e oborrit nga hallexhinjtë. Shumë prej tyre kërkonin ta ndanin trashëgiminë familjare, disa prej tyre vinin të diskutonin për pajtime e mbaresa të konflikteve të ndryshme.



Xhamia e Hadumit, Gjakovë

Vlen të përmendet një konflikt që kishte ndodhur mes dy familjesh të mëdha: katolike dhe myslimane, për pajtimin e të cilëve ishin munduar të gjithë, përfshirë i gjithë fshati, pastaj edhe Lidhja Socialiste, por pa sukses. Nuk ishin pajtuar as me ndërhyrjen dhe ndërmjetësimin e komitetit. Një ditë, në derën tonë ia behu prifti katolik – Patër Manojlla, dhe kërkoi që ta thërrisnim babain. U takua me të dhe ai i tha: “Fahri efendi, shumë u

munduam në të gjitha mënyrat që t'i pajtojmë, por deri më sot pa sukses. S'na ka mbetur tjetër vetëm ti me ardh."

Babai u arsyetua se është plakur dhe se me shëndet nuk është mirë, por ai insistoi deri sa e bindi dhe me veturë shkuan në fshat. Pas disa orëve u kthyen në shtëpi dhe babai pasi u përshëndet me të, hyri menjëherë në shtëpi. Nga kureshtja e pyeta Patër Manojllen si u bë puna. Ai më tha: "Deshi Zoti e i pajtuam më në fund." Unë këmbëngula ta kuptoj mënyrën se si arritën deri te kjo pikë, kur të tjerët kishin dështuar. Ai u përgjigj decidivisht: "Kur shkuam atje dhe u mblodhën dy familjet, secili prej palëve tregoi versionin e vet se si janë hasmuar mes vete. Pas tyre fjalën e mori Fahri efendiu, i cili foli gjerë e gjatë dhe në fund mu drejtua mua që t'i them edhe unë si prift disa fjalë. Unë, thotë Patër Manojlla, me ngurrim e mora fjalën dhe thashë: "Në kishë e kemi një zile të vogël për shërbimet tona, kurse lart e kemi kambanën e madhe. Nëse flas unë pas teje Fahri efendi, është sikurse me i ra ziles së vogël në kohën kur bie kambana e madhe. A dëgjohet zilja e dorës kur bien kambana?!" Me të dëgjuar këtë, të dyja palët u ngritën, ia zgjatën dorën njëri-tjetrit dhe pajtuan" – tha Patër Manojlla.

Babai përveçqë konsiderohej poliglot (fliste pra rrjedhshëm përveç gjuhës mëmë, edhe gjuhën arabe, perse, turke, serbokroate, osmanishte), ishte i gjithanshëm dhe kishte diapazon të gjerë edhe në shkencat e tjera shoqërore dhe shkencore, përveç anës së tij profesionale.

Në shtëpi, kohë pas kohe vinin studentë për konsulta të përgatitjes së temave të tyre të diplomës universitare. Tre studentë nga qyteti i Gjakovës, historianë të njohur kosovarë (tashmë të ndjerë, emrat e të cilëve nuk dëshiroj t'i përmend), pas përfundimit të studimeve të tyre në Beograd dhe mbrojtjes së temës, u kthyen te Fahri efendiu që ta falënderonin, dhe gjatë bisedës ndër të tjerash, treguan se pas mbrojtjes së temës së diplomës, komisioni kishin mbetur gojëhapur, dhe të mahnitur kishin pyetur se kush ju ka ndihmuar në përgatitje të temës, se sigurisht që studentët nuk kishin aq aftësi. Ata i kishin treguar se personi që iu ka ndihmuar është Fahri Iljazi. Ju drejtohen anëtarët e komisionit, duke ju thënë: "Sigurisht duhet të jetë ndonjë njeri i përgatitur mirë profesionalisht dhe i kualifikuar

në histori.” Jo, thanë studentët, është hoxhë. Komisioni nuk besoi, nuk mund të jetë e mundur që një hoxhë të elaborojë kaq thukët temat tuaja të diplomës.

E ceka edhe më herët që babai gjatë tërë kohës lexonte dhe mbante libra në dorë. Edhe ato rrallëherë kur kam shkuar në zyrë, në librarinë në xhami të Hadumit, e kam gjetur të rrethuar me libra duke lexuar apo diskutuar me imamë të tjerë çështje fetare.

Në çardakun e katit të dytë të Medresesë së Madhe në Gjakovë, çdo ditë pas namazit të ikindisë mblidheshin hoxhallarët e Gjakovës, hapnin qitapët dhe diskutonin mes vete. E pyeta njëherë babain se çfarë kuvenojnë aty. Më tha që i çelim qitapët dhe i diskutojmë çështjet e fikhut. Arrijmë në përfundim të përbashkët të një meseleje të caktuar dhe duke qenë unikë mes vete, në këtë mënyrë e ruajmë edhe xhematin nga ndasitë dhe grupet. Ne mund të kemi mospajtime mes vete, por nuk ekspozohemi te xhemati, dhe uniteti mbretëron gjithnjë në mes të radhëve të xhematit.

Gjate periudhës kur në Medresenë e Madhe shërbeu si udhëheqës dhe myderriz, unë ende nuk kisha lindur. Ngjarjet dhe historitë e atyre viteve i kam dëgjuar nga nxënësit e tij në periudha të ndryshme të jetës, e që sot asnjë prej atyre nxënësve nuk është i gjallë. Kam qenë 5 vjeçar, pra viti 1948, kur sistemi i atëhershëm komunist e mbylli Medresenë e Madhe, me pretekstin se nuk i plotëson kushtet higjienike, dhe kur jam rritur, babai më ka treguar që e ka përjetuar shumë rëndë, aq sa është sëmure keq. Nga mllefi kishte thënë: “Po thonë se feja është e lirë, por fetari nuk është i lirë.” Për këtë thënie vuajti edhe shumë të tjera peripeci.

Në një rast, kur një gjeneratë e nxënësve e përfundoi Medresenë, babai iu kishte organizuar kremtimin solemn. Në atë tubim ai iu kishte thënë atyre: “Unë nuk kam djalë, por ju jeni djemtë e mi, prandaj ju kam organizuar këtë manifestim, ku përveç të tjerash do të ju lë disa porosi që t’i keni në hatër gjithherë: Kur të bëheni hoxhallarë, shkoni në xhami më herët dhe koka le t’ju mbetet mbrapa duke shikuar se a po vjen xhemati, e jo xhematit me i mbet koka mbrapa se a po vjen hoxha; Nuk keni tjetër gjë veçse ta doni, ta ndërtojmë atdheun dhe ta çmojmë njëri-tjetrin; Të

zhvillohemi në pikëpamjen shpirtërore, intelektuale dhe atdhetare; Dituria është arma më e fortë kundër armikut.”

Për sjelljet e tij me nxënësit që i konsideronte si fëmijët e tij dhe që i donte shumë, më duhet të përmend edhe një rast kur një nxënës i dëshpëruar që nuk mund të vazhdonte mësimin për shkak të vështirësisë që kishte hasur në të kuptuarit e mësimëve, kishte biseduar me babain dhe i kishte thënë: “Efendi unë po largohem, nuk mund të vazhdoj më tutje.” E pyet babai: “Pse ke vendosur të largohesh nga Medreseja, cila është arsyeja?” Nxënësi i tha: “Mësimet shumë të vështira për mua, nuk po mund t’i kuptoj e as t’i mësoj, dëshiroj të largohem, s’mund ta shtyjë më.” Pas disa tentativave për ta bindur, dhe duke parë këmbëngulësinë e tij për të ikur, babai i mërzitur i tha: “Po të përcjellë deri te dalja.” Në dalje të Medresesë deri vonë ka ekzistuar një gur katërkëndësh i vendosur në tokë te dera e Medresesë. Ai gur i vendosur prej shekujsh aty, ishte gërryer nga pikat e ujit të shiut, që pikonin nga kulmi i pullazit sa herë që binte shi. Babai e ndaloi nxënësin dhe i tha: “Biri im, shihi këto pika të buta të ujit që bien vazhdimisht në këtë gur të vjetër, e kanë gërryer dhe kanë bërë vrimë në këtë gur që s’thyer dot as me mjete të forta. Por pika e ujit ka arritur ta shpojë. Nëse ti bëhesh i vendosur si pikat e ujit dhe mëson sistematikisht, patjetër që do të korrësh sukses.” Nxënësi e shikoi babain në sy dhe me lot në sy i tha: “Po kthehem dhe po e vazhdoj mësimin, efendi.” Babai më ka treguar që ai nxënës ka arritur ta përfundojë me sukses Medresenë dhe ka vazhduar jetën në shërbim të fesë. Nuk më kujtohet emri i nxënësit.

Për hafëz Fahri ef. Iljazin kanë shkruar dhe kanë thënë se ishte njëri prej hoxhallarëve më të ditur, jo vetëm në Gjakovë, por në gjithë Kosovën. Më 15 nëntor të vitit 1957, kur në Sarajevë u zgjodh Sulejman ef. Kemura kryetar i ri i myslimanëve të ish-Jugosllavisë, përveç delegacioneve vendore ishin prezentë edhe delegacione të vendeve të ndryshme arabe – islame. Ishte caktuar që Fahri efendiu ta lexonte tekstin e betimit (Menshura) në gjuhën arabe.

Në vitin 1963, një delegacion fetar nga ish-Jugosllavia vizitoi Marokun, ndër ta ishte edhe babai, të cilët u pritën nga mbreti Hasani i Dytë, dhe

kur kishte folur babai në gjuhën arabe, pastër, rrjedhshëm, me maturi dhe zgjuarsi, mbreti kishte mbetur i habitur. Kur pas disa viteve, Fadil Hoxha vizitoi Marokun, mbreti Hasan e kishte pyetur: "A e njeh Fahri efendi-un?" "Po, bile jam nga i njëjti qytet"- i kishte thënë Fadil Hoxha. Mbreti Hasan i kishte thënë: "Kam pritur dhe takuar shumë delegacione nga shumë vende të botës, por një kokë si e tij plot urtësi i mjafton vendit tuaj edhe për kryetar."

Ish-anëtari i Akademisë së Shkencave të Kosovës, i ndjeri dr. Ekrem Myrtezai thotë se: "Fahri efendiu ishte personifikim i urtësisë, kuvendues interesant për të gjitha nivelet intelektuale dhe orientimet politike. Njohës i mirë i teologjisë dhe fesë islame, iluminist, patriot, autoritet i pakontestueshëm."

Fahri ef. ka luajtur një rol jashtëzakonisht të madh në parandalimin e shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi, duke mbajtur ligjërata vetëdijesuese dhe duke e këshilluar popullin shqiptar se "Guri në tokë të vet, peshon më rëndë."

Se paria fetare dhe intelektuale e periudhës kolonizuese sllave gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte e rrezikuar për jetë, e vërteton edhe rasti konkret që i kishte ndodhur babait tim në prillin e vitit 1941, kur pushtetarët serbë, të përcjellë nga xhandarmëria serbe, i kishin dërguar për pushkatim në dalje të Gjakovës, rrugës për Prizren, te vendi i quajtur "Ura e Nakaradës". Në momentin që i rreshtojnë dhe bëhen gati për t'i qëlluar për vdekje, erdhi lajmi se gjermanët tashmë ishin afër Gjakovës. Me të dëgjuar këtë lajm, xhandarmëria serbe largohen me vrap, dhe kështu paria e Gjakovës shpëtoi pa u vrarë, bashkë me babain tim në mesin e tyre. Si personalitet i madh që ishte dhe si një figurë e shquar, gjithnjë ka qenë i vëzhguar, i përgjuar nga kundërshtarët që ishin antifetarë dhe antishqiptarë.

Shumë herë është kërcënuar nga UDB-ja, duke i thënë: "Akoma pa zbritur ti prej minberit, ne e dimë se çka ke thënë."

Komunistët, në të njëjtën kohë, përpiqeshin edhe ta përfitonin animin e tij kah ata, për shkak të autoritetit të tij të madh në masë. Babai më kishte rrëfyer për takimet që Fadil Hoxha kishte me të, sepse partizanëve ju

nevojiteshin njerëz të njohur në qytet, të dijshtëm dhe me ndikim, për të agjituar për ta. Unë do t'i cek fjalët e Fadil Hoxhës të marra nga libri i Ekrem Murtezait: “Hynim në shtëpinë e Fahri efendi Iljazit apo, siç i thoshin edhe ndryshe hafëz Fahriut, i cili atëbotë ishte njëkohësisht imam i xhamisë së Hadumit dhe myderriz i Medresesë së Madhe, e cila falë autoritetit të hafëz Fahriut konsiderohej të ishte Al Ahzari i Kosovës, institucion i vetëm në Gjakovë në të cilën është folur shqip, pa u dëgjuar asnjëherë ndonjë fjalë serbe apo sllave. Fahri efendi sa ishte i mençur dhe i dijshtëm, aq ishte edhe hezitues. Ç’është e vërteta kishte arsye, sepse po të na gjenin gjermanët apo italianët, shkonte koka dhe familja. Unë kërkoja që ai të na mbante anën dhe të ndikonte në xhematin e tij”, thotë Fadil Hoxha për të.

Ai nga babai kërkonte që të agjitonte për komunizmin dhe Stalinin. Babai i ishte përgjigjur: “Fadil, i kam dy arsye që nuk mund të bashkëpunojë me ty: E para, ti je djalë i mirë, trim dhe guximtar, i ri, pa familje. Pra, ti e ke lehtë, por unë jam familjar, i kam 6 vajza të vogla. Kjo është njëra arsye që të mos bashkëpunojë me ty; arsyeja tjetër edhe më e madhe është se ti e do Stalinin. Ti Fadil lidhu me anglezët e me Anglinë e me bejlerët e Gjakovës, e atëherë do të bëhem me ty. Stalini është sllav dhe primitiv. Nëse shkel njëherë në vendin tonë, ai kurrë më për jetë e mot nuk kthehet në vendin e tij të ftohtë e të varfër, kurse anglezët janë të kulturuar, demokratë dhe të pasur, ata edhe nëse vinë njëherë, nuk rrinë shumë e kthehen në vendin e tyre të pasur. Ja për këtë arsye unë nuk i dua rusët dhe Stalinin, por anglezët dhe Çerçillin”, më tregoi Fadil Hoxha në vitet e shtatëdhjeta, shkruan Ekrem Murtezai në librin e tij.

Duke treguar për këtë ngjarje, Fadil Hoxha, që atëherë ishte anëtar i Byrosë Ekzekutive, e ktheu kokën anash dhe pak e mbuloi gojën dhe me zë të ulët tha: “Qe besa, si duket kishte pasur të drejtë Fahri efendi”, shkruante në librin e dr. Ekrem Murtezaj për Fadil Hoxhën.

Përveç veprimtarisë fetare, edukative dhe arsimore, babai është marrë edhe me veprimtari kulturore.

Në vitin 1950 e ka bërë transkriptimin në gjuhën shqipe të veprës “Vehbije” (Dhurata) të myderriz Tahir efendi Gjakovës, e shkruar dhe e

botuar në Stamboll, në vitin 1835. Mevludin e Tahir ef. Popovës që këndohet në të gjitha trevat e Kosovës, e ka përmirësuar dhe e ka pastruar nga fjalët e huaja. Ka marrë pjesë në hartimin, përpilimin e doracakut të parë "Ilmihali i Vogël" që është botuar më 1957 nga Kryesia e Bashkësisë Islame në Prishtinë. E ka përfunduar komentimin e sures "Jasin", një vepër e lënë në dorëshkrim nga mësuesi i tij shpirtëror, Sami ef. Drejta nga Vushtrria.

Në vend të përfundimit

Sado të flitet për babain tim, hafëz Fahri ef. Iljazin, mbase fjalët janë të pafuqishme që të shprehin madhështinë e tërë atyre virtyteve që e kanë stolisur dhe zbukuruar karakterin dhe personalitetin e tij. Më gëzon fakti që edhe sot, pas sa e sa vitesh nga shpërngulja e tij në Ahiret, njerëzit i kujtojnë me mall fjalët dhe këshillat e tij. Emri i myderrizit, hafëz Fahri ef. Iljazit vazhdon akoma e kësaj dite të përmendet me pietetet më të larta, si një dijetar dhe personalitet i rrallë, jo vetëm në Gjakovë dhe në Kosovë, por edhe në të gjitha trojet shqiptare, duke qenë i njohur për kontributin e tij madhor madje edhe në Bosnjë.

Rrugëtimin e tij jetësor e mbylli më 19 nëntor 1985 në moshën 82 vjeçe, për të na lënë neve trashëgimtarëve të tij përjetësisht krenarë me të, po edhe të gjithë kolegët e tij hoxhallarë anembanë Kosovës, e mbi të gjitha, qytetin e Gjakovës, ku jetoi dhe veproi deri në frymën e tij të fundit. Allahu na takoftë me të në Xhenetin Firdevs ja Rabbil Alemin!

Ju faleminderit për vëmendjen!

Dr. Sadik MEHMETI
Instituti Albanologjik

TË DHËNA PËR SHKOLLIMIN E FAHRI EFENDI ILJAZIT DHE AKTIVITETIN E TIJ SI MYDERRIZ NË “MEDRESENË E MADHE” TË GJAKOVËS

Në kumtesën tonë do të paraqesim disa të dhëna jetëshkrimore mbi bazën e dokumenteve arkivore të kohës për njërin prej hoxhallarëve dhe myderrizëve tanë që ka dhënë kontribut të shquar në fushën e dijes, arsimit dhe të edukimit islam të ne në shekullin e kaluar – hafëz Fahri efendi Iljazin nga Gjakova (1906-1987).

Në të vërtetë, të dhënat që do t'i paraqesim në vazhdim për Fahri efendiun janë mbi bazën e disa dokumenteve arkivore, të cilat i kemi hulumtuar nëpër arkiva të ndryshme gjatë interesimeve tona për historinë e shkollave dhe të arsimit të ne.

Dokumentet të cilat i kemi marrë në shqyrtim, hedhin dritë për dy periudha kryesore të Fahri efendiut: atë të shkollimit të tij, pra për Fahri efendiun si nxënës dhe student, dhe më pastaj, për Fahri efendiun si myderriz në “Medresenë e Madhe” të Gjakovës.

E kemi bërë këtë ndarje dhe këtë përcaktim, sepse sikurse dihet ambienti ku merr dije një person dhe mësuesit e tij – pra shkolla – mësuesit janë ndër vendimtarët jo vetëm në formimin intelektual të nxënësit, por, me dije qoftë, edhe përcaktues në rrugëtimin jetësor të tij. Në këtë drejtim, po nuk u njohën këto segmente të jetës së Fahri efendiut, atëherë nuk mund të kuptojmë edhe veprimtarinë dhe kontributin e mëpastajshëm të

tij. Fahri efendiu, pati fatin e mirë që të formohej si hoxhë, si myderriz e intelektual që në "Medresenë e Madhe" të Gjakovës¹ dhe më pastaj si student në medresenë e njohur "Mehmet Pasha" të Prizrenit.² Pra, Fahri efendiu, mësoi e studioi në dy institucione arsimore islame që kanë dhënë një kontribut jashtëzakonisht të madh në vetëdijesimin fetar dhe kombëtar të popullatës së këtyre anëve dhe më gjerë. Fahri efendiu ishte produkt i frymës dhe vetëdijes fetare dhe kombëtare të shtresuar dekada e shekuj në këto dy institucione.

Të dhënat që do t'i paraqesim në vazhdim janë të panjohura më parë dhe prandaj mendojmë se plotësojnë jetëshkrimin e hzf. Fahri efendi Iljazit dhe mbase do të ndihmojnë edhe në saktësimin dhe korrigjimin e disa të dhënave të cilat i lexojmë për të.

Atëherë, për çfarë dokumentesh bëhet fjalë dhe ç'të dhënash përmbajnë këto dokumente?

Ndonëse neve më shumë na kanë interesuar të dhënat për shkollimin e Fahri efendiut dhe për punën e tij si myderriz, megjithatë nuk mund ta kalojmë faktin dhe të mos fillojmë me vitin e lindjes së Fahri efendiut. Në të dhënat e botuara deri më tani për Fahri efendiun nga autorë të ndryshëm shkruan se Fahri efendiu ka lindur në vitin 1903.

Mirëpo, sipas një dokumenti të lëshuar e të vërtetuar më 1932 nga Komanda Ushtarake e Rrethit të Prizrenit, i cili ruhet në Arkivin Qendror Shtetëror në Tiranë,³ shkruan se Fahri efendiu ka lindur në vitin 1906, në Gjakovë. Ky dokument – vërtetim, përcillet edhe më një fotografi të Fahri efendiut, e cila fotografi mendoj se këtu prezantohet po ashtu për herë të parë dhe është fotografia e parë e Fahri efendiut dhe në moshën më të re kur ishte ai si myderriz. Edhe në dosjen personale të Fahri efendiut të vitit

¹ "Medreseja e Madhe" ("Medrese-i Atik") e Gjakovës u themelua në dekadën e parë të shek. XVIII, nga pinjolli i derës fisnike të Kurtpashëve – Kryezinjve të Gjakovës, Murad Begu (më pastaj Pasha) i biri i Adem Pashës, në vitin 1707.

² "Medreseja Mehmet Pasha" ose "Medreseja e Bajraklisë", u themelua nga vakëflënësi i madh, Gazi Mehmed Pasha në vitin 1573/4 (981 H).

³ Arkivi Qendror Shtetëror - Tiranë (në vazhdim AQSh), Fondi, nr. 482, viti 1941, Dosja nr. 2, fleta 4.

1968, e cila ruhet në Arkivin e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës,⁴ shënon se ka lindur në vitin 1906.



Duke u mbështetur në këto dokumente arkivore të kohës dhe të tjera, saktësohet se viti i lindjes së Fahri efendiut është 1906 dhe jo viti 1903.

Fahri efendiu pas përfundimit me sukses të dalluar të mektebit, ka mbaruar me sukses “fort mirë” edhe “Shkollën Popullore Shqype” të Gjakovës në vitin 1918, siç dëshmohet nga vërtetimi i nënshkruar nga mësuesi S(al) Morina dhe i vulosur nga zëvendës drejtori I(brahim) Fehmiu, ku shihen edhe lëndët në të cilat Fahri efendiu ka treguar këtë sukses, si më poshtë:⁵

⁴ Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Fondi: Dosjet e nëpunësve, kutia nr. 6, Dosja nr. 21, viti 1986.

⁵ Dokumenti ruhet në arkivin personal të pasardhësve të Fahri efendiut, nga ku edhe është konsultuar dhe një kopje e tij gjendet edhe te ne.

1. Kuran, fort mirë;
2. Fé, fort mirë;
3. Këndim, fort mirë;
4. Gjuhë mësimi, fort mirë;
5. Bukurshkrim, fort mirë;
6. Arithmetikë, fort mirë;
7. Gjeometrië, fort mirë;
8. Histori Natyre e fizikë, fort mirë;
9. Gjeografië, fort mirë;
10. Historië, fort mirë;
11. Dija qytetnore, fort mirë;
12. Kangë, fort mirë;
13. Gjimnastik, fort mirë;
14. Shkolla e vleftës, fort mirë.

primjerak Dvoj

ISLAMSKA VJERSKA ZAJEDNICA U F. N. R. J.
PODRUČJE VAKUFSKOG SABORA ZA NRŠ. U PRISTINI

SLUŽBENIČKI LIST

I. Ime i prezime službenika K. Fahri Rendića

II. Ime oca službenika Iljas

III. Ime i prezime Gjakovë data 19 mjeseca Korrik 1906. g.
u mjesecu Gjakovë grad Kakm na Serbiaš

IV. Zvaničan u ispravu Gjakovë , svaka * NE *

V. Sadržaj svake u
vjerodostojnosti Krye imam

VI. Fotografija službenika svake desete godine.
(Priloge 1-10)

Godine 1968. Godine Godine Godine

Fotografija službenika svake desete godine.



*Faksimile e dokumenteve nga dosja personale e Fahri efendiut
(viti 1932 dhe 1986)*

Krahas këtyre, Fahri efendiu shkollimin e lartë e ka arritur fillimisht në “Medresenë e Madhe” të Gjakovës, para myderrizit njëherësh që ishte edhe i ati i tij hafëz Iljaz efendiut dhe më pastaj e ka përfunduar në Medresenë “Mehmet Pasha” të Prizrenit te myderrizi i njohur Nysret ef. Galipi⁶ tek i cili edhe e ka marrë ixhazetnamenë/diplomën.

Këto të dhëna, përveç dokumenteve të tjera arkivore, vërtetohen edhe në tri ixhazetname/diploma, të cilat Fahri efendiu ua ka lëshuar studentëve të tij ditën e xhuma më datën 29 tetor 1943, përkatësisht studentëve:

- Mustafa, i biri i hafëz Behlulit, të birit të Mustafës, nga Barani i Pejës,
- Muhameti, i biri i Abdurrahmanit – Gashi, nga Peja, dhe
- Hyseni, i biri i mulla Selimit, të birit të Halitit, nga Juniku.

Në këto ixhazetname të cilat i posedojmë, Fahri efendiu, sipas traditës, në cilësinë e myderrizit i jep edhe disa të dhënë për vetveten, të cilat janë me rëndësi për interesimet tona. Aty shkruan se Fahri efendiu e kishte mbaruar hifzin e Kuranit para babit të tij - hafëz Iljaz efendiut të sipërpërmendur, që njëherësh ishte edhe myderriz në “Medresenë e Madhe” të Gjakovës, në të cilën Fahri efendiu kishte filluar të mësonte shkencat që ishin në gjuhën arabe dhe në veçanti kishte studiuar e mbaruar gramatikën dhe sintaksën e arabishtes. Mirëpo, meqë në këtë kohë i ati i tij kishte ndërruar jetë (1920), Fahri efendiu, tregon se studimet i ka vazhduar në Medresenë “Mehmet Pasha” të Prizrenit të myderrizi dhe myftiu i Prizrenit, hafëz Nysret efendiu, tek i cili edhe e kishte marrë ixhazetnamenë/diplomën.

⁶ Hafiz Nysret efendiu lindi më 5 nëntor 1887, në mëhallën “Mehmet Pasha” në Prizren. Është i biri i Galip Agës dhe i Fatime hanëmit, nga Prizreni. Mektebin ibtidai e mbaroi në Prizren, më 12 shtator 1897. Me sukses të shkëlqyeshëm, g.fz. Nysret efendiu mbaroi edhe shkollën e mesme Rushdije të Prizrenit dhe më 28 qershor 1900 mori diplomën. Pas mbarimit të Rushdijes, studimet i vazhdoi në Medresenë “Mehmet Pasha” të Prizrenit, në hallkën (në grupin) e myderrizit hfz. Abdylaziz Efendiut, dhe më 2 korrik 1911, e mori edhe ixhazetnâmenë. Më 30 mars 1912, duke qenë 26 vjeç, u emëruar myderriz i Medresesë “Mehmet Pasha” të Prizrenit ku ka nxjerrë një numër të studentëve të diplomuar. Ndërroi jetë në vitin 1941 në Prizren ku edhe u varros.

Синков. пропущ. Вручье
е Гяковѣс.

Vertetese

L. Fahri Haxhi, Ijas efendiu prej Gjakovet me fe
Muhamed, tue kene 14 vjete vaxhdoj ne vit. shkoll. 1917-18
te VII ~~tin~~ rend te shkoll. popull. shqypse ne Gjakove me cen
"Fort mire", edhe me sjellje "Fort te mire", ku mbas provi-
mit qidha dishtoj ket meritim:

Kuran	Fort mirë
Fe	Fort mirë
Këndim	Fort mirë
Gjuhë mesimit	Fort mirë
Bukureskrim	Mirë
Arithmetikë	Mirë
Gjeometrië	Fort mirë
Hist. natyre e Fizikë	Mirë
Gjeografië	Fort mirë
Historië	Fort mirë
Dija gjytnore	Fort mirë
Kangë	Fort mirë
Gjimnastikë	Fort mirë
Shkollë e vlefës	Fort e mirë

me 15. VII. 1918.

e Misesi i R. VII ^{te}:

S. Moring

Gav. Dreptori:

J. L.
Lehn

*Faksimile e vërtetimit të Fahri efendiut
mbi kryerjen e "Shkollës Popullore Shqype" të Gjakovës (viti 1918).*


Se kur do ta ketë diplomuar Fahri efendiu në Prizren, në këto ixhazet-name natyrisht që nuk theksohet, por se një dokument tjetër, i cili për ne ka rëndësi të shumëfishtë dhe jo vetëm për këtë rast, dëshmon se Fahri efendiu ka diplomuar në vitin 1928.

Në të vërtetë, në një dëshmi (shehâdetnâme) të lëshuar nga myderrizi Nysret efendiu i sipërpërmendur, dëshmohet se Fahri efendiu ka diplomuar më 26 korrik të vitit 1928.⁷ Për më tepër, në këtë dokument tregohen edhe lëndët të cilat i ka studiuar Fahri efendiu deri në diplomim, si dhe notat dhe suksesin që ka arritur.

Sipas këtij dokumenti mësojmë se në këtë kohë në Medresenë “Mehmet Pasha” të Prizrenit, studioheshin 20 lëndë, në të cilat Fahri efendiu ishte vlerësuar me notën maksimale pesë dhe kishte dalë me sukses të shkëlqyeshëm dhe ato lëndë janë:

1. *Kurâni Kerîm*;
2. *Texhvîd (rregullat e leximit të Kuranit)*;
3. *E drejta e Sheriati* (‘Ilmi fikh);
4. *Burimet e së drejtës së Sheriatit* (‘Ilmi Usûli fikh);
5. *Dogmatikë/apologjetikë* (‘Ilmi Kelâm);
6. *Shkenca natyrore-fizikë* (Hikmeti Tabi’iyye);
7. *Teologji* (Hikmeti ilâhiyye);
8. *Logjikë* (‘Ilmi mantik);
9. *Komentim i Kuranit* (‘Ilmi tefsîr);
10. *Shkenca e Traditës* (‘Ilmi hadîth);
11. *E drejta trashëgimore* (‘Ilmi ferâiz);
12. *Matematikë* (Hisâb);
13. *Histori e profetëve* (Tarîh-i enbiyâ);
15. *Metaforë* (‘Ilmi beyân);
16. *Retorikë* (‘Ilmi bedî’);
17. *Kaligrafi* (Hüsn-i hatt);
18. *Bukurshkrim* (Imlâ);
19. *Gramatikë* (‘Ilmi sarf);
20. *Sintaksë* (‘Ilmi nahv).

⁷ Arkivi i Kosovës, *Fondi i dokumenteve osmane*, i pa rregulluar, dokumenti/shehâdetnâmeje e Fahri ef. Iljazit nga Gjakova, viti 1928.



Faksimile e Shehâdetnâmesë së Fahri ef. Iljazit nga Gjakova, ku shihen lëndët që janë mësuar në Medresenë "Mehmet Pasha" në Prizren

Ky dokument i lëshuar nga administrata e Medresesë “Mehmet Pasha” në gjuhën osmane dhe e vërtetuar edhe në gjuhën e administratës së institucioneve të kohës, është me rëndësi sepse tregon se cilat lëndë janë mësuar në këtë medrese në kohën kur Fahri efendiu ishte student i saj, porse ajo nuk tregon se cilat tekste apo vepra do të jenë mësuar aty.

Mirëpo, këtë të dhënë me shumë rëndësi na e jep vetë Fahri efendiu në tri ixhazetnametë/diplomat e sipërpërmendura, ku thotë se në Medresenë “Mehmet Pasha” ai kishte studiuar shkencat tradicionale dhe racionale, me degët dhe disiplinat e tyre dhe në veçanti kishte studiuar tekstet-veprat me komentet (sherh) dhe glosatë (hashije) e tyre, si:

Nga fusha e logjikës kishte studiuar veprën “*Sherh Isagûci*” nga Hamza el Fenari.⁸ Në fushën e akadit veprën “*Sherhu ‘l-‘Akâ’idu ‘l-‘Adûdijje*”, të autorit Xhelaluddîn Devânî dhe të komentuar nga Abdulatîf Harputî.⁹ Më pastaj po në këtë lëndë kishte studiuar veprën “*Sherhi Veleddijje*” të autorit Muhammed Saxhâklî zade.¹⁰ Nga letërsia kishte studiuar veprën “*Muhtesaru ‘l-Meânî*” të Saduddin Taftazaniut.¹¹ Nga jurisprudenca islame veprën “*Multekâ*” të Ibrahim Halebiut.¹² Në lëndën e filozofisë së të drejtës islame veprën “*Sherhi Mirkât*” të Mulla Hysrevit me glosenë e bërë nga Tarsusi.¹³

⁸ “*Fenârî*” - edhe ky është një koment i veprës “*Isagûci*” të Etheruddîn el Ebheriut, të cilin e ka bërë Şemsuddîn Muhammed b. Hamza el Fenârî (vdiq më 834/1430).

⁹ “*Şerhu ‘l-‘Akâ’idu ‘l-‘Adûdiyye li Devânî*” - vepër në gjuhën arabe nga dogmatika, e autorit ‘Aduddîn ‘Abdurrahmân b. Ahmed el-Îcî, vdiq më 756/1355. Kurse komentimin e ka shkruar Muhamed Celaluddîn Devânî (vd. 1502).⁹ K. Dobraća, *Katalog*, I, 409.

¹⁰ “*Veleddijje*” - është libër mbi disputacionin (debatin) për fillestarët. Autor i veprës është Muhamed Saçâklî Zâde, vdiq më 1150/1727”.

¹¹ “*Muhtesaru ‘l-Meânî şerîf*” - është komentim i veprës “*Telhîsu ‘l-Miftâh*”, të autorit Celaluddin Muhamed b. Abdurrahmân el-Kazvînî (vd. më 739/1338). Ndërsa komentimin e ka shkruar Saduddin Mesud bin Omer Taftâzânî (712-793/1312-1390).

¹² “*Multekâ*” - është një nga shkrimet themelore të jurisprudencës islame, i cili në Perandorinë Osmane ka pasur domethënie të burimit autoritativ për njohjen e normave të së drejtës së Sheriatit. Ka qenë shumë i popullarizuar dhe gjatë është përdorur si doracak dhe si libër mësimi nëpër medrese. Veprën e ka shkruar Ibrâhîm b. Muhamed el Halebî (vdiq më 956/1549).

¹³ “*Mirâtu ‘l-Usûl fî şerh Mirkâtu ‘l-Vusûl*”. Këtë vepër dhe komentimin e saj nga lëmi i filozofisë së të drejtës së Sheriatit i ka shkruar, më 875/1470-1471, juristi i njohur Mulla Muhamed bin Feramerz bin Ali, i njohur si Mulla Husrev (vd. 885/1480).

Nga hadithi, veprën *"Eshshifâ bi t'arîfi hukûki 'l-Mustafâ"* të Ebu 'l-Fadl 'Iyâd b. Mûsâ el Jahsubî es Sabti¹⁴. Dhe veprën *"El Mesâbihu 's-sunne"* – të imam Begavîut.¹⁵

Nga komentimi i Kuranit, tefsirin *"Envâru 't-Tenzîl ve Esrâru 't-Te'vîl"* të Imam Bejdaviut¹⁶ etj..



Klasat e Medresesë "Mehmet Pasha" të Prizrenit ku studioi Fahri efendiu (foto. M. Bećirbegović, 1972).

I përmendem këto të dhëna dhe i konsiderojmë si shumë të rëndësishme, sepse përmes tyre mund të kuptojmë më mirë përgatitjen, specializimin dhe orientimin jo vetëm të Medresesë "Mehmet Pasha" në Prizren, por edhe të "Medresesë së Madhe" të Gjakovës në kohën sa ishte myde-

¹⁴ *"Eşîfâ bi t'arîfi hukûki 'l-Mustafâ"* – përmbledhje e thënieve nga profeti Muhamed dhe detyrat e myslimanit për të respektuar atë. E ka shkruar Ebu 'l-Fadl 'Iyâd b. Mûsâ el-Yahsubî es-Sabti (vd. 544-1149).

¹⁵ *"El-Mesâbihu 's-sunne"* – është nga fusha e hadithit (traditës) e autorit Husein b. Mes'ûd el-Begavî eş-Şâfi' (vd. 516/1122).

¹⁶ *"Envâru 't-Tenzîl ve Esrâru 't-Te'vîl"* – është koment i Kuranit i autorit Umer ibën Muhamed ibën 'Ali Ebul-Hayr Nasiruddîn el-Beydavî (vd. më 1286).

rriz Fahri efendiu, dhe më pastaj edhe të studentëve që Fahri efendiu ka nxjerrë me ixhazetname.

Në anën tjetër, kur jemi te saktësimet që kanë të bëjnë me Fahri efendiu, duhet thënë se sipas një dokumenti tjetër që posedojmë, mësojmë se Fahri efendiu është emëruar myderriz në “Medresenë e Madhe” të Gjakovës në vitin 1929, pra pak pas diplomimit, me rrogë vjetore 2000 dinarë.¹⁷

Ndërsa, kur jemi te tri ixhazetnametë e lëshuara nga Fahri efendiu, duhet t’i theksojmë edhe disa të dhëna të tjera që na japin ato:

Aty shkruan se sa ishte në “Medresenë e Madhe” të Gjakovës, Fahri efendiu u laureua me titullin hafëz i Kuranit, tek i ati i tij Iljaz efendiu, i biri i Muhametit, që ishte po ashtu hafëz dhe muhafiz (instruktor i hifzit) dhe kjo duhet të theksohet, sepse kjo tregon se Fahri efendiu rrjedh nga një familje e cila ka nxjerrë disa breza myderrizësh që kanë dhënë mësim në Medrese, duke filluar që nga katragjyshi i Fahri efendiut: Vejsel efendiu, i biri i Jahja efendiut, të cilin në pozitën e myderrizit në këtë medrese e pasoi i biri i tij Ismail efendiu, e pas tij nipi *Iljaz efendiu, pra i ati i Fahri efendiut* (vdiq më 1920).

Në bazë të kësaj, dëshmohet se babai, stërgjyshi dhe katragjyshi i Fahri efendiut kanë qenë nga klasa e ulemave dhe po ashtu edhe myderriz në “Medresenë e Madhe” të Gjakovës, por jo edhe gjyshi i tij, Muhameti. Sepse sikurse të kishte qenë myderriz edhe gjyshi Muhameti, këtë me patjetër dhe në mënyrë absolute Fahri efendiu do ta kishte shënuar e theksuar në ixhazetnametë që i ka lëshuar.

E kur jemi këtu, duhet të theksojmë edhe një të dhënë tjetër. Sikurse dihet, sipas traditës së kohës, fëmijëve u jepeshin nga dy emra. Edhe Fahri efendiu nuk bënte përjashtim dhe ai quhej Muhamet Fahri, sikurse shihet në ixhazetnametë e përmendura. Po ashtu, studentëve nëpër medrese u jepej edhe nga një pseudonim letrar a poetik. Një pseudonim të tillë e kishte edhe Fahri efendiu dhe me të nënshkruhej nëpër dokumente. Pseudo-

¹⁷ Arkivi Qendror Shtetëror - Tiranë (në vazhdim AQSh), Fondi, nr. 482, viti 1941, Dosja nr. 2, fleta 32.

nimi i Fahri efendiut ishte "Rexhai", pra myderriz, hafëz Fahri "Rexhai" ef. Iljazi.



Klasat e "Medresesë së Madhe" të Gjakovë, në të cilat Fahri efendiut mësoi dhe punoi si myderriz (Foto. M. Bećirbegović, 1972)

Një e dhënë tjetër e rëndësishme për ne është edhe fakti se që te tri ixhazetnametë e lëshuara nga Fahri efendiut mbajnë datën 28 tetor 1943, ditë e xhuma, që dëshmon se në këtë ditë "Medreseja e Madhe" dhe Fahri efendiut kanë nxjerrë një brez të diplomantëve/ixhazetlive dhe kjo ditë do të ketë qenë ditë feste jo vetëm për medresenë, por edhe për gjithë qytetin e Gjakovës. Mendoj se kjo është gjenerata e parë e plotë të cilën do ta ketë përcjellë Fahri efendiut që nga fillimi e deri në fund. Sepse kohëzgjatja e studimeve në medrese asokohe ka qenë 12 vjet, që është e përafërt me vitin kur Fahri efendiut do të ketë filluar punën si myderriz në "Medresenë e Madhe". Ai ka mundur të ketë dhënë ixhazetname edhe më herët, porse ata do t'ua ketë dhënë studentëve që do t'i kenë nisur studimet e tyre te myderrizë të tjerë para Fahri efendiut, por që i kanë plotësuar studimet te Fahri efendiut.



Faksimile e faqeve të para dhe të fundit të diplomës/ixhazetnamesë së Behlul efendiu, nga Barani i Pejës, të lëshuar nga myderriz Fahri efendiu (viti 1943)

Të tri këto ixhazetname mbajnë shënimin me dorë nga myderrizi dhe janë të verifikuara nga institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës në vitet e mëvonshme. Mirëpo, ixhazetnameja e Behlul efendiut, nga Barani i Pejës, është më e veçantë, sepse përveç se është e shkruar me shkrimin arab "nes'h" me bojë të trashë, shumë të bukur dhe korrekt, dhe përveç verifikimit dhe nënshkrimit të myderrizit Fahri efendiut, në fund ka edhe vulën e rrumbullakët në gjuhën shqipe të Medresesë, në të cilën shkruan "*Medreseja e madhe e Gjakovës, Mbretinija Shqiptare – Gjakovë*", një e dhënë kjo që tregon se në këtë kohë medreseja ka pasur vulën e saj në gjuhën shqipe dhe se administrata e saj ka funksionuar shqip.

Një dokument tjetër i lëshuar nga Komuniteti Mysliman Shqiptar me seli në Tiranë, dëshmohej se Fahri efendiut është emëruar dhe ka nisur punën si myfti i Gjakovës më 9 maj 1941, e dhënë kjo e rëndësishme po ashtu për saktësimin e jetëshkrimit të Fahri efendiut.¹⁸

Nga sa u tha më sipër mund të përfundojmë se hafëz Fahri efendiut është i biri i hafëz Iljaz efendiut të birit të Muhamedit, të birit të Ismailit të birit të Vejsel efendiut të birit të Jahja efendiut. Ka lindur në vitin 1906 në Gjakovë, nga familje myderrizësh që lidhen me "Medresenë e Madhe" të Gjakovës të themeluar nga Murad begu, në vitin 1707. Pas mësimit përmendsh të Kuranit dhe mësimit të lëndëve gramatikë dhe sintaksë e gjuhës arabe në "Medresenë e Madhe" të Gjakovës dhe meqë i ndërron jetë i ati, Fahri efendiut vazhdoi shkollimin në medresenë e famshme "Mehmet Pasha" në Prizren të myderriz Nysret efendiut, të cilën e mbaron në vitin 1928. Kaq qenë hafëz i Kuranit. Në vitin 1929 emërohet myderriz në "Medresenë e Madhe" të Gjakovës, ku ka dhënë mësim dhe e ka drejtuar atë deri në vitin 1948, kur kjo medrese së bashku dhe me nëntë medrese të tjera ekzistuese në Kosovë, mbyllet nga sistemi i atëhershëm. Fahri efendiut ka nxjerrë disa ixhazetlinj, të cilët më pastaj kanë qenë bartës të jetës fetare islame dhe shoqërore në Kosovë për dekada me radhë. Fahri efendiut në vitin 1941 emërohet edhe myfti i Gjakovës. Pas vitit 1945, Fahri efendiut do ta gjejmë edhe në shumë detyra të tjera me rëndësi në

¹⁸ Arkivi Qendror Shtetëror - Tiranë (në vazhdim AQSh), Fondi, nr. 482, viti 1941, Dosja nr. 2, fleta 32.

jetën fetare dhe organizative të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe më gjerë deri kur edhe ndërroi jetë në vitin 1985.

Para studiuesve që merren me historinë e arsimit në përgjithësi dhe në Gjakovë në veçanti, mbetet një punë për t'u bërë – ndriçimi jo vetëm i punës së myderrizëve të kësaj shkolle deri te Fahri efendi Iljazi si myderriz i fundit i saj, por edhe i numrit të studentëve që kanë dalë nga ky institucion me rëndësi kombëtare.

Burimet dhe literatura:

Të pabotuara:

- Arkivi i Kosovës, *Fondi i dokumenteve osmane*, i pa rregulluar, dokumenti/shehâdetnâmeje e Fahri ef. Iljazit nga Gjakova, viti 1928.
- Arkivi Qendror Shtetëror - Tiranë (AQSH), *Fondi, nr. 482, viti 1941, Dosja nr. 2*.
- *Ixhazetnameja/diploma e Mustafës, të birit të hafëz Behlulit, të birit të Mustafës*, nga Barani i Pejës, e lëshuar në “Medresenë e Madhe” të Gjakovës, ditën e xhuma, më 29 tetor 1943.
- *Ixhazetnameja e Muhametit, të birit të Abdurrahmanit – Gashi*, nga Peja, e lëshuar në “Medresenë e Madhe” të Gjakovës, ditën e xhuma, më 29 tetor 1943.
- *Ixhazetnameja e Hysenit, të birit të Mulla Selimit, të birit të Halitit*, nga Juniku, e lëshuar në “Medresenë e Madhe” të Gjakovës, ditën e xhuma, më 29 tetor 1943.

Të botuara:

- Grup autorësh, *Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane – sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman, 1880-1912*, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2020.
- Mehmeti, Sadik, *Shkollat dhe arsimit në Kosovë (1830-1912)*, Instituti Albano-logjik, Prishtinë, 2019.
- Dobrača, Kasim. *Katalog arapski, turskih i perzijskih rukopisa*, svezak prvi, Sarajevë, 1963.
- Dobrača, Kasim. *Katalog arapski, turskih i perzijskih rukopisa*, svezak drugi, Srajevo 1979.

Sabri BAJGORA

METODA E LIGJËRIMIT NGA MYDERRIZI FAHRI EFENDI ILJAZI

Abstrakt

Ligjërimi në xhamitë anekënd trojeve shqiptare ka luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e ndërgjegjes fetare dhe kulturore të besimtarëve myslimanë. Në mesin e ulemave, kishte shumë të tillë që lanë gjurmë të pashlyeshme në kujtesën e shumë brezave përgjatë shekujve. E, padyshim, kësaj plejade të ulemave të mëdhenj, i takon edhe vetë myderrizi i mirënjohur nga Gjakova, emri i të cilit ishte i njohur pothuajse në tërë hapësirat e trojeve shqiptare, madje edhe deri në Bosnjë. Fahri efendi Iljazi, i lindur dhe i rritur në Gjakovë, një myderriz i shquar i kohës, ishte i njohur për stilin e tij të veçantë dhe metodën inovative të ligjëritimit. Andaj në këtë punim do të synohet analiza e elementeve kyçe të metodës së tij të ligjëritimit dhe ndikimi që ai ka pasur në komunitetin fetar jo vetëm në Gjakovë, por në të gjitha trojet shqiptare.

Fjalët çelës: *Fahri ef. Iljazi, Medreseja e Madhe, Gjakova, ligjërimi, metodologjia, ndikimi etj.*

Hyrje

Fahri efendi Iljazi, i lindur dhe i rritur në Gjakovë, ka jetuar në një periudhë turbulente, kur Islami në Kosovë ishte nën ndikimin e ndryshimeve shoqërore dhe politike. Pas Luftës së Dytë Botërore, Gjakova sikur edhe krejt Kosova, po kalonte një ndër periudhat më të vështira të ekzistencës së saj. Pushteti komunist që u instalua menjëherë pas përfundimit të luftës, duke parë se çfarë ndikimi kishte feja islame në veçanti te besimtarët, në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe shpirtëror të popullatës, kishin filluar me realizimin e planeve të tyre djallëzore, fillimisht për mbylljen e të gjitha medreseve në Kosovë, që vepronin në edukimin shpirtëror dhe kombëtar të popullatës. Veprimtaria e imamëve, e sidomos e ulemave të asaj kohe, iu pengonte atyre, sepse ideologjia komuniste në thelb ishte kundër fesë. Ishte një dogmë e cila po instalohej dhunshëm, për ta zhveshur popullatën nga çdo ndjenjë fetare dhe shpirtërore. Në këto rrethana të ndera, Fahri efendi Iljazi u ballafaqua me presione dhe sfida nga më të ndryshme, dhe pikërisht, ai si drejtor në atë kohë i Medresesë së Gjakovës, u privua që të vazhdonte mësimin e talebeve në atë Medrese, të cilës komunistët përfundimisht ia vunë drynin në vitin 1948, me arsyetimin banal, se gjoja nuk i plotëson kushtet higjienike.

Mbyllja e Medresesë, ishte një goditje e madhe për hoxhën, por megjithatë, ai kurrë nuk u ndal nga ligjërimet e tij në Xhaminë e Hadumit dhe xhamitë e tjera të Gjakovës, pastaj në rrethe të ndryshme të Kosovës, në Prizren, Rahovec, Mitrovicë, Vushtrri, Prishtinë, pastaj në Kumanovë etj.

Ajo që do të mbahet në mend nga ky kolos i mësimave fetare, është se ai në ato kohëra të vështira, mori mbi supet e veta barrën e rëndë të përcjelljes së mësimave fetare te brezi i ri, duke u përpjekur që të mbillte te ta një ndërgjegje të pastër, në përpjekje për ruajtjen e vlerave tradicionale, fetare e kombëtare

Dëshmitë e profesorëve dhe akademikëve më eminentë, siç ishin: akademik Pajazit Nushi, akademik Ekrem Murtezai dhe shumë të tjerë, janë argumenti më i fortë se ai ia doli me sukses misionit të vështirë të edukimit dhe arsimimit islam.

Metoda e ligjërimit nga myderrizi Fahri ef. Iljazi



Kur jemi te kjo pjesë e studimit, duhet të themi me keqardhje, se nuk na ka ngelur ndonjë dëshmi e shkruar nga hytbet e myderrizit të njohur nga Gjakova, sepse siç dihet, gjatë luftës së fundit në Kosovë, është djegur një pjesë e madhe e xhamive të Gjakovës, e së bashku me to edhe libraria e famshme e Hadumit, me plot dorëshkrime të vjetra, ashtu siç ishin djegur me themel edhe Medreseja e Madhe e Gjakovës, me krejt objektet përjellëse, përfshirë edhe librat dhe dorëhkrimet e hoxhës së nderuar, etj.

Për aq sa kemi mundur të kontaktojmë me familjarët, djalin e tij të madh, profesor, haxhi Muhamedin, nipin haxhi Fatmir ef. Iljazin dhe disa hoxhallarë të vjetër nga Kosova dhe nga viset shqiptare në Maqedoni, më saktësisht në komunën e Kumanovës, të cilët kanë prezantuar me dhjetëra herë në ligjëratat dhe hytbet e tij, do të përpiqemi që të krijojmë një imazh të përafërt për metodologjinë e ligjërimit nga myderrizi Fahri ef. Iljazi.

Të gjithë bashkëkohësit, qoftë kolegët apo ish-nxënësit e tij, kanë folur për të me pietetet më të larta, duke e ngritur figurën e tij emblematike në përmasat e një dijetari të madh të kohës, jo vetëm në Gjakovë, por edhe më gjerë, si në Kosovë, në Shqipëri dhe në tërë hapësirat e ish-Jugosllavisë.

Sipas hoxhallarëve të moshës më të shtyrë, që kishin pasur fatin të dëgjonin ligjëratat, derset dhe hytbet e tij, po edhe ndejat nëpër oda, mund të konkludojmë se Fahri efendi Iljazi ishte i njohur për metodën e tij didaktike në përfshirjen e drejtpërdrejtë të audiencës. Ai përdorte një metodologji të qartë dhe të strukturuar, duke ndjekur një qasje hermeneutike dhe

pedagogjike njëkohësisht. Nëpërmjet një stili të thjeshtë dhe të qartë të ligjërit, ai synonte që çdo individ, pavarësisht nga niveli i tij intelektual apo fetar, të mund të kuptonte mesazhin e tij. Kjo qasje përfshinte disa elemente të rëndësishme:

- **Përdorimi i gjuhës së thjeshtë dhe të kuptueshme** – Fahri efendiu përdorte një gjuhë të pastër shqipe, duke shmangur termet e vështira që mund të ishin të pakuptueshme për masën e besimtarëve të rëndomtë të kohës së tij. Përmes një qasjeje të tillë, ai siguroi që mësimet fetare të ishin të qasshme për të gjithë, pavarësisht nivelit arsimor. Kjo vlen sidomos për periudhën sa ishte drejtor dhe mësimdhënës në Medresenë e Madhe të Gjakovës, andaj ish-nxënësit (talebet) sa herë që e kanë përmendur, e kanë ngritur lart figurën, dijen dhe modestinë e tij.

- **Shpjegimi i ajeteve dhe haditheve** – Pa dyshim, kur jemi te kjo pikë, kur bëhet fjalë për shpjegimin e kuptimit të ajeteve dhe të haditheve, shohim se ligjëratat e tij para xhematit, ishin të strukturuar në mënyrë të atillë që çdo ajet apo hadith i përzgjedhur të shpjegohej me thellësi, duke marrë parasysh kontekstin historik dhe interpretimet e ndryshme nga dijetarët klasikë të tefsirit dhe të hadithit. Ky shpjegim nuk mbetej thjesht në nivelin teorik, por shoqërohej me shembuj praktikë që kishin lidhje me jetën e përditshme të besimtarëve.¹

Nga të dhënat e dokumentuara që kemi, shohim se myderrizi Fahri ef. Iljazi, ishte njohës i thellë i komentimit të Kuranit. Alimi i madh i Bosnjës, Fejzullah Haxhibajriqi e ka përmendur Fahri ef. Iljazin si një njohës të thellë të tefsirit dhe të tesavufit. Ndër të tjera ai e ka përmendur faktin se pikërisht Fahri efendiu e ka plotësuar komentimin ezoterik të sures *Jasin*,² të dijetarit dhe alimit të shquar vushtrrias, Sami ef. Drejta, pas vdekjes së tij. Ta përfundosh një sure kuranore në gjuhën arabe, duke iu përmbajtur besnikërisht metodologjisë së mësuesit të tij shpirtëror, Sami ef. Drejtës, me plotësime shkencore edhe në gjuhën osmane dhe persiane,

¹ Për këtë si dëshmi kemi edhe fjalët e djalit të tij profesor H. Muhamed Iljazit.

² Kjo sure është duke u përkthyer nga një grup studiuesish dhe së shpejti do të botohet nga Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame në Prishtinë. (Shënim yni, S.B.).

tregon më së miri thellësinë intelektuale në shkencat kuranore dhe të tesavufit, nga Fahri ef. Iljazi.

Gjatë shpjegimit të ajeteve kuranore dhe haditheve, myderrizi i ndërruar ndiqte disa parime të rëndësishme që pasqyrojnë një metodologji të avancuar, duke ndihmuar audiencën e tij të kuptonte dhe të zbërthente tekstet e shenjta në një mënyrë të kuptueshme dhe praktike.

Një nga pikat kyçe të metodës së tij ishte kontekstualizimi, sepse Fahri efendiu nuk i trajtonte ajetet dhe hadithet si fragmente të shkëputura, por gjithmonë kërkonte të sqaronte rrethanat historike, shoqërore dhe kulturore në të cilat ishin shpallur apo thënë. Për shembull, kur shpjegonte një ajet të Kuranit, ai gjithmonë përpiquej të sqaronte *sebebi nuzulin* (shkakun e zbritjes së atij ajeti), duke sqaruar rrethanat specifike në të cilat një ajet ishte shpallur, duke ndihmuar kështu besimtarët të kuptonin se përse dhe si kishte ardhur një udhëzim apo obligim i caktuar fetar.

Po ashtu, kur i shpjegonte hadithet e Resulullahut a.s., ai shpeshherë përmendte ngjarjet që e kishin shtyrë Pejgamberin a.s. ta thoshte një hadith të caktuar, duke ofruar një pasqyrë të gjerë dhe duke theksuar rëndësinë e kontekstit.

Kjo qasje kontekstuale i jepte besimtarëve një kuptim më të plotë të asaj që u mësohej dhe i ndihmonte ata të mos i interpretonin ajetet apo hadithet jashtë kontekstit, gjë që shpesh çon në keqkuptime ose interpretime të gabueshme.

Në derset e tij, Fahri efendiu mbështetej në burime të njohura klasike të tefsirit dhe shpjegimit të haditheve. Ai tregonte respekt për traditën islame të dijes dhe referencave klasike si Tefsiri i Ibën Kethirit, Tefsiri i Kurtubit, Tefsirul Xhelalejn, Tefsiri i Ebu Su'udit, i Shevkanit, i Hazinit etj. Ai po ashtu preferonte edhe shpjegimin e veprës madhështore të Imam Gazaliut, *"Ihjau Ulumi-d-din"*, e përveç këtyre edhe veprat klasike të hadithit, siç janë: Sahihu i Buhariut, i Muslimit, dhe të tjerëve. Ai përdorte këto burime për të ndihmuar në interpretimin korrekt të ajeteve dhe haditheve, duke pasur parasysh se kuptimet që vinin nga dijetarët klasike ishin të bazuara në studime të gjata dhe të thelluara të Kuranit dhe Sunitit. Por përveç këtyre burimeve, Fahri efendiu gjithashtu i përshtaste këto

mësime edhe me realitetin e kohës së vet, duke mos mbetur thjesht vetëm tek interpretimi literal, por duke ndërtuar ura midis kuptimeve tradicionale dhe aplikimeve moderne.

- **Ndërlidhja me sfidat bashkëkohore** – Një aspekt i rëndësishëm i metodës së Fahri ef. Iljazit, ishte aftësia e tij për të lidhur mësimet tradicionale islame me problemet dhe sfidat bashkëkohore. Ai shpesh trajtonte tema të ndërlidhura me moralin, edukimin e fëmijëve, mbrojtjen e identitetit fetar dhe kombëtar, duke bërë që ligjëratat e tij të ishin të rëndësishme dhe të aplikueshme për shoqërinë e asaj kohe. Shembull për këtë janë vetë familja e tij, djemtë dhe vajzat, të shkolluar, të arsimuar e të edukuar, ashtu siç kërkojnë prej nesh edhe parimet fetare.

- **Qasja ndaj pyetjeve dhe diskutimeve** – Pas përfundimit të ligjëratave, nëpër mexhlise dhe ndeja të ndryshme, Fahri efendiu i jepte përparësi dialogut dhe pyetjeve nga besimtarët. Kjo metodë e hapur kontribuonte në krijimin e një atmosfere të lirë për diskutim dhe shkëmbim idesh, duke e bërë audiencën të ndihej e përfshirë në sqarimin edhe më të thuktë të fesë.

Përfundim

Në përfundim të këtij punimi rreth metodës së ligjërimit nga ana e myderrizit të njohur Fahri ef. Iljazit, shohim madhësinë e një personalitetit të rrallë, i cili dha një kontribut të madh në edukimin dhe arsimimin e popullit shqiptar, qoftë në aspektin fetar, qoftë në ruajtjen e identitetit kombëtar. Nga ajo që u tha më sipër, shohim qasjen brilante të Fahri efendiu në ligjërime, ku ai ofronte shembuj praktikë për mënyrën se si popositë kuranore dhe pejgamberike, mund të zbatohen në situata reale të përditshme, qoftë në marrëdhëniet familjare, në edukim apo çështje morale. Ai gjithmonë i inkurajonte besimtarët që të merrnin parasysh se Islami nuk është thjesht një fe e teorive apo konceptimeve abstrakte, por një fe që ofron udhëzime praktike për jetën. Përmes shembujve konkretë, ai i ndihmonte ata të zhvillonin një lidhje më të thellë me mësimet fetare dhe t'i integronin ato në jetën e tyre të përditshme.

Fahri efendi Iljazi nuk ishte thjesht një predikues, por edhe një lider shpirtëror i respektuar në mbarë Kosovën. Përveç ligjëratave të rregullta në xhami, ai ishte i përfshirë në edukimin e brezave të rinj, duke ndihmuar në formimin e një brezi të fortë intelektual në Gjakovë.

Përveç kësaj, ai u shqua për ndihmën që u ofronte individëve të ndryshëm për të zgjidhur problemet e tyre personale dhe shoqërore. Kjo bëri që ai të fitonte respektin dhe besimin, jo vetëm të komunitetit të tij mysliman, por edhe të komuniteteve të tjera fetare në Gjakovë. Roli i tij si një udhëheqës shpirtëror qëndronte në aftësinë e tij për të udhëhequr përmes shembullit personal, duke ndërtuar ura ndërmjet besimtarëve dhe dijetarëve fetarë.

Krejt në fund, nga të gjitha këto dromca të shkëputura kujtimesh, që kanë mbetur në kujtesën e familjarëve apo ish-nxënësve të tij, mund të themi pa kurrfarë hezitimi se metoda e ligjërimit të Fahri efendi Iljazit është një shembull të cilin duhet ndjekur edhe ulemaja e sotme shqiptare. Aftësia e tij për të përcjellë mesazhe të qarta, për të analizuar tekstet fetare në thellësi dhe për të ndërlidhur mësimet tradicionale me sfidat e përditshme, e kishin bërë atë një figurë kyçe në jetën fetare dhe shoqërore të Gjakovës dhe mbarë Kosovës. Trashëgimia e tij si ligjërues dhe lider shpirtëror vazhdon të ketë ndikim edhe sot e kësaj dite në jetën fetare të qytetit, përse e lusim Allahun e Gjithëmëshirshëm ta ketë shpërblyer me mirësitë e Tij të pakufishme, për kontributin dhe mundin e tij!

Alban DOBRUNA

**FAHRI EF. ILJAZI – KRYETAR
I NËNMYFTINSË SË GJAKOVËS
GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE**

Myderrizi, hafëz Fahri efendi Iljazi ishte njëri ndër hoxhallarët më të ditur në tërë Kosovën. Ai ka shërbyer si imam në disa xhami, e po ashtu ka shërbyer edhe si kryeimam i Gjakovës. Përveç këtyre, ai ka shërbyer edhe në pjesë të tjera të Kosovës, si në Pejë, Istog, Klinë etj.. Ka qenë kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Gjakovës gjatë Luftës së Dytë Botërore, gjithashtu, ka shërbyer në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovë.¹

Në prill të vitit 1941, Shtetet e Bllokut Fashist sulmuan Jugosllavinë, duke e shpërbërë dhe copëtuar atë.² Fatin e saj e përjetuan edhe trevat shqiptare, të cilat qenë nën sundimin jugosllav. Në kuadër të pushtimit nazifashist, viset shqiptare u ndanë në tri zona pushtimi: gjermane, italiane dhe bullgare. Pjesa më e madhe e Kosovës u përfshinë në zonën

¹ Arkivi *Qendror Shqiptar* (më tej: *AQSH*), F. 482, V. 1941, D. 12, f. 41; Mexhid Yvejsi, “Hafizët e Gjakovës – krenaria e Kosovës”, (Gjakovë: EPRO PRINT, 2013), 79-90; Mexhid Yvejsi, “101 personalitete fetare - atdhetare - kulturore - letrare”, (Prishtinë: Instituti për Shkencat Humane “Ibni Sina”, 2013), 348-356; Mexhid Yvejsi, “Në përkujtim të 110-vjetorit të lindjes së dijetarit të famshëm - hoxhës së hoxhallarëve myderriz, hafiz Fahri ef. Iljazi (103-1985)”, *Edukata islame*, 104, (2013), 251-264.

² Xhelal Gjeçovi, “Çështja Kombëtare Shqiptare në vitet e Luftës së Dytë Botërore”, *Studime historike*, 3-4, (2005), 147; Muharrem Dezhgiu, “Kombi shqiptar në planet strategjike të fuqive ndërluftuese gjatë Luftës II Botërore”, *Studime historike*, 3-4, (2005), 160; Lefter Nasi, “Kosova dhe problemi kombëtar në vitet 1941-1943”, *Kosova*, 28, (2006), 213.

italiane të pushtimit.³ Zona tjetër ishte ajo okupuese gjermane. Po ashtu edhe Bullgarisë fashiste i takoi një pjesë e trevave shqiptare.⁴ Ndonëse bashkimi u bë nën kapelën fashiste, prapëseprapë kjo për popullsinë shqiptare në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore kishte rëndësi të madhe historike. Forcat pushtuese vendosën që qeverisja lokale në rajonet e populluara nga shqiptarët duhej drejtuar nga shqiptarët,⁵ ndërkaq gjuha shqipe u shpall si gjuhë zyrtare bashkë me atë italiane. Për herë të parë u rihapën shkolla fillore dhe të mesme në gjuhën shqipe, u legalizua përdorimi i simboleve kombëtare, u lejuan gazetatat shqip, u lejua shënimi i festave shqiptare,⁶ si dhe u realizua bashkimi i komuniteteve islame në një komunitet të vetëm.⁷

Me ndarjen e lartpërmendur, u bë edhe ndarja e re administrative e Bashkësisë Islame në Kosovë, pra ajo që u bashkua me Shqipërinë nën okupimin italian u lidhë me kryeqendrën e re në Tiranë. Në zonën bullgare, organizimi i Bashkësisë Islame mbeti i pandryshuar. Ulema Mexhli-si e Shkupit, e themeluar më 1921, ishte një ndër qendrat e Islamit që për-

³ AQSH, F. 266, Ministria e Tokave të Lirume, f.1-25; Kuadri i Personelit të Nënprefekturave: Dragash, Rahovec, Suharekë, Gjakovë, Istog, Drenicë, Plavë, Cucinjë, Rozhajë, Gjilan, Ferizoviq, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Strugë, Rekë, Carisver (Prespë e madhe); AQSH, F. 266, Ministria e Tokave të Lirume, V. 1943, Nr. 32, f. 2: Koncept Mbretinija e Shqiptare Komisariati i Naltë Civil për Kosovë, Dibër e Strugë. Prizren 29 gen 1943; Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, (Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 1997), 19; Muharrem Dezhgiu, "Përpyjekjet e forcave politike shqiptare për bashkëpunim gjatë Luftës së Dytë Botërore", *Studime historike*, 1-2, (2000), 189.

⁴ Fehmi Rexhepi, "Lufta e shqiptarëve për vetëvendosje e bashkim kombëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore", *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore (Përmbledhje studimesh)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë "Ali Hadri"-Prishtinë, Instituti i Historisë-Tiranë, 2014), 136-137.

⁵ Stefan Karastojanov, "Kosova (Një analize gjeopolitike)", (Shkup: Serembe, 2007), 152.

⁶ Kastriot Dervishi, "Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005", (Tiranë: 55, 2006), 450; Valentina Duka, "Histori e Shqipërisë 1912-2000", (Tiranë: Kristalina-KH, 2007), 213.

⁷ AQSH, F. 482, V. 1941, D. 12, f. 115: Letër e Ministrisë së Drejtësisë, Kryesisë së Komunitetit Mysliman, Tiranë, 27. XII. 1941; Alexandre Popovic, "Islamizmi ballkanik; Myslimanët e Evropës juglindore gjatë periudhës pasosmane", (Tiranë: Dituria, 2006), 53.

fshinte tërë viset shqiptare në Jugosllavi, për t'u reformuar dhe marrë nën kontroll nga shqiptarët pas vitit 1936.⁸ Nën okupimin bullgar, kjo Bashkësi u lidhë me qendrën e Myftinisë Supreme në Sofje. Ndërkaq, në zonën gjermane, përkatësisht nga viti 1942, u lidhën me kryeqendrën e formuar në Novi Sad, që lidhej me Beogradin. Në zonën e administrimit italian në Kosovë u formuan dy qendra të kryemyftinjve: Prizren dhe Prishtinë. Në qendrat e kësaj zone ekzistonin kryemyftinjtë dhe myftinjtë, ndërsa në vendbanimet më të vogla nënmyftinitë dhe xhematët e imamëve.⁹ Gjako-va bënte pjesë në kryemyftininë e Prizrenit.¹⁰



Gjatë kësaj periudhe u bë edhe riemërimi i imamëve. Dekretet e emër-timit lëshoheshin nga kryeqendra përkatëse në Tiranë. Imamët ndaheshin në dy kategori, në shtetërorë dhe privatë. Meqë imamët shtetërorë pagu-heshin me rroga të larta (imami shtetëror në zonën okupuese italiane me-rrte 600, vaizi 400, mësuesi i besimit 500, myezini 400 lekë etj.), imamët

⁸ Qerim Lita, “Shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi 1937-1941 dhe roli i Bashkësisë Fetare Islame në pengimin e saj”, *Zani i Naltë*, 7(160), (2014), 39-43.

⁹ Jusuf Osmani, “Burimet arkivore për veprimtarinë e institucioneve myslimane në Ko-sovë”, *Dituria Islame*, 63, (1994), 40.

¹⁰ *AQSH*, F. 482, V. 1943, D. 23, f. 3: Lista që tregon emrat e komunave të qarkut të pre-fekturës së Prizrenit.

privatë mbaheshin nga kontributet e besimtarëve, por kjo gjë nuk hetohej në veprimtarinë e tyre profesionale.¹¹ Në kuadër të këtij riorganizimi, Komunitetit Mysliman Shqiptar me qendër në Tiranë, me kërkesë të nënprefektit Sulejman Kryeziu, i kërkohej emërimi si myfti në Gjakovë i Fahri Iljazit, i cili kishte filluar detyrën më 9 maj 1941, mirëpo nënprefektura dëshironte dekretimin e tij zyrtar nga Kryesia e Komunitetit Mysliman, pasi e konsideronte atë: *"Nji fetarë i zoti në çdo pikpamje e ma i nderit intelektual i këti qyteti."*¹²

Përkushtimin e tij si fetar dhe intelektual gjatë Luftës së Dytë Botërore e dëshmon edhe angazhimi nga kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Behxhet Shapati, i cili e angazhoi Fahri Iljazin për t'i zhvilluar hetimet për parregullsitë e shfaqura në Myftininë e Gjilanit,¹³ ku Shaip Rexhepi ishte shkarkuar nga pozita e myftiut për shkak të pazotësisë në disa fetva të lëshuara gabimisht. Në vend të tij ishte emëruar Idriz Hajrullahu.¹⁴

Në vazhden e organizimeve dhe emërimeve në kuadër të Bashkësisë Islame, filloi të promovohet aktivisht pjesëmarrja e të rinjve në nivele të ndryshme lokale e regjionale. Kështu, Ismajl Agush Gashi, banues në Gjakovë, i drejtohet me një kërkesë Kryesisë së Komunitetit Mysliman Shqiptar, i cili pasi potencon kualifikimin e tij si i diplomuar në Medresenë e drejtuar prej myderrizit Fahri Iljazit, kërkonte që nëse shfaqet nevoja e emërimit të një nënmyftiu në nënprefekturën e Rahovecit, ishte i gatshëm të shërbente, pasi me këtë vend ishte në kontakt prej shumë kohësh.¹⁵

Po ashtu, përveç lidhjeve administrative, u intensifikuan edhe lidhjet dhe kontaktet ndërmjet prijësve fetarë dhe popullsisë myslimane. Për të

¹¹ Haki Kasumi, *"Bashkësitë fetare në Kosovë"*, (Prishtinë: Instituti i Historisë së Kosovës, 1988), 11.

¹² *AQSH*, F. 482, V. 1941, D. 12, f. 30: Letër e Sulejman Kryeziut, Kryesisë së Komunitetit Mysliman, Gjakovë, 26. VI. 1941.

¹³ Aliriza Selmani, *"BI e Gjilanit gjatë Luftës së Dytë Botërore"*, *Edukata Islame*, 82, (2007), 82.

¹⁴ *AQSH*, F. 482, V. 1941, D. 12, f. 2: Letër e Bahxhet Shapatit, Idriz Hajrullahut. Tiranë. 19. XII. 1941.

¹⁵ *AQSH*, F. 482, V. 1941, D. 12, f. 75: Letër e Ismajl Alush Gashi, Kryesisë së Komunitetit Mysliman Shqiptar. Gjakovë. 26. XI. 1941.

krijuar një fizionomi më të plotë për vakëfet, xhamitë dhe pasuritë e tyre, si dhe për të fituar një ide të qartë mbi të gjitha problemet fetare që do të rregullohen në të ardhmen, kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Behxhet Shapati, i shoqëruar nga Muharrem Mullahi, Sulejman Bakalli, Hafiz Muhameti, Hasan Tahsini, Vexhëhi Buhara etj., realizuan një vizitë zyrtare në Kosovë, duke u nisur nga Tirana për të përfunduar në Gjiilan. Në vizitën e tyre në Gjakovë, më 20 nëntor 1941, kishin dalë për t'i pritur prijësit fetarë, si dhe të gjitha autoritet qeveritare dhe ushtarake të vendit, përfshirë këtu edhe një numër të madh të popullatës së Gjakovës. Fjalën përshëndetëse të mirëseardhjes e mbajti myderrizi Fahri efendi Ilijazi, ku ndër të tjera tha: *“Shkëlqesi, me arritjen e Personit t’Uaj fort të lartë e të dashur, kjo turmë qytetarësh të Gjakovës së bashku me ata të krahinave të sajë, më kanë ngarkuar t’Ju shpreh mirëseardhjen. Na që të gjithë ndiejmë në zemrat t’ona ngushëllimet më të madha kur shohim pranë nesh personin t’Uaj të lartë, i cili duke marrë parasysh udhëtimin e lodhshëm e të gjatë, denjoi të na vizitojë, pas sa vjet mundimesh, vuajtjesh dhe torturimesh të Kosovës së robëruar. E tërë kjo turmë që ka dale këtu për t’Ju pritë ndien në shpirtin e saj gëzim të madh për këtë vizitë që na bëtë. Tash që na u bashkuam me Mëmën Shqipëri, me të cilën na bashkon gjuha, gjaku, dhe feja, e ndiejmë vetveten më se të lumtur, e sidomos kur shohim pranë nesh Kryetarin e Fesë s’onë, që është një vëlla i ynë, i gjakut e i gjuhës s’onë. Prandaj, Ju shprehim Shkëlqesë dashurinë më të sinqertë, nderimet më të gjalla si edhe çmimet më të zgjedhura, si në emën të Klerit ashtu edhe të këtij grumbulli qytetarësh. Shkelqësi, zemrat t’ona kullojshin gjak për të parë një ditë të realizuar ëndrrën t’onë të madhe, Bashkimin me Mëmën Shqipëri në të gjitha fushat e sidomos në atë fetare e shpirtërore. Por sot që u realizua kjo nuk na mbetet veçse të duamë, të nderojmë dhe të çmojmë njeri tjetrin. Të zhvillohemi në pikëpamje shpirtërore, intelektuale dhe patriotike.”*¹⁶

¹⁶ Sadik Bega, “Reportazh mbi vizitën e kryetarit të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Kosovë; Kryetar i Komunitetit Mysliman në Gjakovë”, *Kultura islame*, 3-4, (1941), 80.

Me këtë rast, kryetari i Komunitetit Mysliman, Behxhet Shapati, shprehu konsideratat e tij për mikpritjen e parisë dhe të popullatës së Gjakovës, duke vlerësuar: *"Të nderçëm zotërinj, i prekur thellësisht për mikpritjen që patët nderin të më bëni, ju shpreh të gjithëvet me gjithë zemër e me gjithë shpirt falënderimet e mija më të zjarrrta. Na ishim të ndarë prej njeri tjetrit vetëm me trup ndërsa shpirtërisht ishim tërësisht të bashkuar."*¹⁷

Më pastaj, delegacioni nga Tirana vizitoi Medresenë e Gjakovës, ku u prit nga një numër nxënësish të kësaj Medreseje. Kryemyftiu i zonës së Tiranës, Muharrem Mullahi, foli me një gjuhë të mprehtë mbi vëllazërimin myslimanë shqiptarë. Këtij iu përgjigj menjëherë myderriz Hasan Islami (Hasan ef. Nahi A.D.) duke përshkruar vuajtjet e popullit të Gjakovës gjatë kohës së pushtuesve serbë, ku ndër të tjera potencoi se si malazetë kishin grabitur tokat shqiptare, e sidomos në Gjakovë. Kryetari i Komunitetit, Behxhet Shapati, foli përsëri duke këshilluar për të zënë udhën e mbarë, ngase kështu do të qetësoheshin edhe shpirtat e atyre që ranë dëshmorë për atdhe e për fe. Më tej, Shapati, ishte shprehur se duhet të përparojmë në mënyrë që të meritojmë të trashëgojmë vlerat morale dhe patriotike të atyre burrave, që lanë eshtrat e tyre dhe që e lyen çdo pëllëmbë të këtij vendi me gjak për të na dhënë lirinë, që po e shfrytëzojmë sot. Në fund ai porositi: *"Le t'i a dimë vleftën asaj."*¹⁸ Po atë ditë, në mbrëmje, në Medrese, kryetari i Komunitetit bisedoi për çështjet fetare me një ndër hoxhallarët më në zë të Gjakovës, Asim ef. Luzhën, mbi kurset fetare, mbi ligjet fetare në fuqi, mbi çështjet që kanë të bëjnë me imamet, si dhe mbi problemet e 150 studentëve që kishin studiuar në Medresenë "Isa Begu" në Shkup. Shumë prej këtyre studentëve, pasi Medreseja është mbyllur, kishin shkuar nëpër gjimnaze. Ata biseduan edhe për zgjerimin dhe reformimin e Medresesë së Përgjithshme në Tiranë, në të cilën do të gjenin strehë disa nga këta studentë. Populli gjithashtu kërkonte mësues që t'u përshtateshin shkollave fillore të atjeshme. Këta më-

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Po aty.

sues duhet t'u dhënë një hov të shpejtë gjeneratës së re, si nga pikëpamja kombëtare ashtu edhe jo fetare.

Ditën e nesërme, më 21 nëntor 1941, pak para se të faleshin në xhami-në kryesore të Gjakovës “Hadumit” apo siç e quanin ata “*faltore madhështore të Gjakovës*”, myderrizi Fahri ef. Iliazi mbajti një predikim të bukur, kurse hytben e këndoi Asim ef. Luzha me një melodi të këndshme. Pas faljes së xhumasë, delegacioni u kthye në medrese, ku u shtrua një drekë, me ç'rast u njohën edhe me programin mësimor të medresesë, së cilëve ju bënë përshtypje disa mësimet si në: filozofi, etikë, jurisprudencë islame etj., të cilat sipas tyre duhet të vihen edhe në Medresenë e Përgjithshme në Tiranë. Delegacioni përfundoi vizitën në Gjakovë për vazhduar në qytetin e Pejës.

Fahri ef. Iljazi, i pasur me dije fetare, atdhetare dhe kulturore, i cili kishte shërbyer dekada me radhë për ruajtjen, kultivimin dhe zhvillimin e traditave islame, për shkak të respektit dhe influencës që gëzonte në popull gjatë Luftës së Dytë Botërore, u kontaktua edhe nga komunistët, që ishin njëra ndër forcat kryesore që e udhëhiqnin Lëvizjen Antifashiste në Kosovë. Komunistët gjatë luftës bënë përpjekje që të përfitonin sa më shumë njerëz të njohur, të dijsëm dhe me autoritet dhe ndikim, andaj personalisht krerët më të lartë të LNC-së në Kosovë, Fadil Hoxha¹⁹ dhe Mehmet Hoxha,²⁰ e kishin ftuar në lëvizje, por ai i kishte refuzuar, duke i qëndruar besnik bindjeve të tij fetare.

Bashkësia Islame e Gjakovës, të cilën e udhëhiqte Fahri efendiu dhe aktivitetet e saj fetare në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, filluan të merrnin tatëpjetën, sepse qendra e Luftës Nacionalçlirimtare e Kosovës ishte në qytetin e Gjakovës. Të rinjtë, të brumosur me idetë komuniste në shkollat e Shqipërisë, në qytetet si: Tirana, Shkodra dhe Elbasani, u kthyen në vendlindje për zhvillime të vrullshme të luftës antifashiste. Këto ide ishin shumë të ashpra ndaj Bashkësisë Islame në Gjakovë, duke e cilësuar

¹⁹ Ekrem Murtezai, “*Fadil Hoxha siç e njoha unë*”, Prishtinë: Shtëpia botuese “Libri shkollor”- Prishtinë, 2011, f.125.

²⁰ Ismet Shaqiri, “*Më kujtohet... II: Përgatitjet për Konferencën themeluese (8)*”, Rilindja, Prishtinë: E hënë, 16.XI.1981, f.10.

veprimtarinë e tyre si primitive dhe të prapambetur, gjë që më vonë, solli edhe mbylljen e Medresesë së Vogël më 1947, me myderrizin e fundit, Jahja efendi Bakallin.²¹

Periudha në fund të Luftës së Dytë Botërore ishte e vështirë edhe për popullatën gjakovare. Lufta për çlirimin e vendit nga pushtuesit fashistë nuk solli ndryshime në statusin e shqiptarëve të Kosovës dhe të tokave të tjera në përbërje të Jugosllavisë, por vetëm solli ripushtimin e saj. Madje ndaj tyre u shtua më shumë shtypja nga shteti policor i Serbisë. Atyre iu mohuan të drejtat nacionale dhe shoqërore, mirëpo në rrethana të tilla, dijetarët myslimanë nuk mbetën duarkryq, por shfrytëzuan potencialet e tyre si intelektuale, njashtu edhe njerëzore, për t'i dalë krah popullatës së pambrojtur shqiptare. Kjo ishte preludi i një periudhe shumë të vështirë për fenë islame jo vetëm në Gjakovë, por edhe në tërë Kosovën, ku për më tepër se gjysmë shekulli, në viset shqiptare, u sfidua nga ideologjia komuniste. Sistemi shtetëror i cili u instalua, pengoi zhvillimin, ruajtjen dhe përhapjen e fesë ndër gjeneratat e reja. Por megjithatë, populli dhe të devotshmit, i ruajtën dhe i kultivuan vlerat e saj deri në ditët e sotme.

²¹ Krasniqi, *"Aspekte kulturoro-historike të Gjakovës..."*, 29.

Akademik Feti MEHDIU

**FAHRI EFENDI ILJAZI DHE MEVLUDI
I TAHIR EF. POPOVËS NË KUJTESËN
E NJË MEDRESISTI**

Të nderuar pjesëmarrës dhe mysafirë të pranishëm, paçi faqen e barë për këtë pjesëmarrje në përkujtim të Fahri efendi Iljazit!

Kam kënaqësinë dhe privilegjin e veçantë që ta përshëndet familjen e hafëz Fahri efendiut. Do ta veçoja këtu profesor Muhamedin, ngase e kam pasur profesor të Evolucionit organik sa isha nxënës i Medresesë. Respekt dhe shëndet të mirë për ju profesori Muhamed! E miku im i çmuar dr. Ali Iljazi, gëzofte kënaqësinë e Allahut në Xhenetin Firdeus!

Fjalën time në këtë Tryezë e emërtova “**Fahri efendi Iljazi dhe mevludi i Tahir ef. Popovës**”. Jo rastësisht i vura këto dy figura balle për ballë. Arsyeja e parë është se mevludi i Tahir ef. Popovës ishte shkaku kryesor që unë ta takoja për herë të parë në Prishtinë, në vitin 1964, një personalitet sikur që ishte Fahri efendi. Më pas, kam pasur nderin që të jem në shërbim si imam gjatë muajit Ramazan në Gjakovë, të cilin shërbim e administronte pikërisht Fahri efendi.

Arsyeja e dytë është Tahir ef. Popova, me mevludin e tij, me shkrimin që shkruhej dhe lexohej në tri kontinente (Azi, Afrikë dhe Rumeli - Evropë), ani pse qarqet politiko-kulturore shqiptare, njerëzit që shërbeheshin me atë shkrim i llogarisnin si analfabetë, përkundër faktit se kjo vepër me

këtë shkrim, deri në vitin 1965, i shërbeu popullit shqiptar që ta ruajë dhe ta kultivojë lidhjen e tyre me jetën e Pejgamberit Muhamed a.s..¹

Kur duhej ta konfirmoja pjesëmarrjen time në këtë Tryezë me rëndësi, e cila ripërtërinë kujtesën e brezave për parinë e figurave islame të shqiptarët, e më konkretisht tek ata të Kosovës, u ndala pak e fillova të mendojë se prej nga t'ia filloj. Zgjodha momentin e takimit tim të parë me Fahri efendiun. Ai moment lidhet ngushtë me mevludin e Tahir ef. Popovës. Ky mevlud, ishte i vetmi – me sa e di unë – që lexohej në gjuhën shqipe në Kosovë, por që shkrimi ishte shkrim arab, i pasuruar edhe me tri shkronja të alfabetit pers, e të cilat alfabeti arab nuk i ka (p, ç, zh).

Ishte viti 1964, kur paria islame e Kosovës kishte formuar një grup pune që këtë mevlud ta transkriptonte me shkronjat latine që i përdor gjuha shqipe, duke filluar nga Abetarja e Sami Frashërit, e botuar në Stamboll e deri në ditët e sotme. Më vonë e kam kuptuar se në krye të atij grupi ishte Fahri ef. Iljazi, për faktin se ky ishte dalluar nga mesi i brezit të vet për njohuritë dhe përdorimin e drejtë të gjuhës shqipe.²

Këta kanë ardhur disa herë në Medrese, ku mbanin takime pune në lokalet e Medresesë së Ulët. Vinin disa hoxhallarë, që nuk mund t'i kujtoj emrat e tyre. Rastisi që mulla Rashit ef. Osmani, i cili na ligjëronte lëndën e fikhut dhe kaligrafisë – husnihatt (bukurshkrim), ta sillte në klasën tonë Fahri efendiun, në klasën tonë që ishte ballë për ballë me zyrën e Drejtorisë së Medresesë. Këtë ditë e kam në mendje sikur ka ndodhur sot.

Sapo kishim falur namazin e drekës dhe dolëm nga xhamia. U ndalëm pak para xhamisë, kureshtarë të dinim se kush janë këta hoxhallarë. Kisha dëgjuar emrin Fahri Efendija i Gjakovës, dhe si figurë e kisha identifikuar, sipas ngjyrës së përhintë të xhybes dhe vetëm kaq. Doli edhe Fahri efendiu, me xhyben ngjyrë hiri dhe shallin tradicional. Na dha selam dhe kalimthi nga hodhi një vështrim duke na pyetur: Si jeni djemtë e mi, si po kaloni?, dhe shkoi në zyrën e drejtorit.

¹ Mevludi i hafëz Ali Riza Ulqinakut ishte transkriptuar më herët nga i biri i tij hafëz Saidi, por, përdorimi i atij Mevludi në hapësirën e Kosovës nuk kishte shtrirje të gjerë.

² Kështu na flisnin mësuesit tanë në Medrese, Hasan efendi Nahi dhe mulla Rashit ef. Osmanit.

Kur hymë në klasë – aty përballë zyrës së drejtorit – kishim mësim me mulla Rashit ef. Osmanin. Ishte ora e bukurshkrimit, hyri mulla Rashiti së bashku me Fahri efendiun dhe zunë vendin përpara nesh.

Mulla Rashit efendiu kërkonte nga ne që kjo orë e mësimi të fillonte me një fjalë të urtë a të ngjashme, të shkruar në dërrasën e zezë. Atë ditë, dikush nga ne e kishte shkruar *“Ashti i huj nuk i dhemb askuj!”* Fahri efendiu i hodhi një sy dërrasës së zezë, e pa këtë shkrim dhe pëshpëritën diçka me mulla Rashitin. Mulla Rashiti pyeti: “Kush e shkroi këtë?” Dikush e konfirmoi, por për Fahri efendiun, rëndësi kishte përmbajtja – porosia që përçonte kjo fjalë e urtë tek opinionin.

“Shumë mirë! A ka ndokush çka i shton, mos ka ndonjë lëshim...”, duke iu referuar rreshtit të parë, në bankën e parë. Dikush bëri përpjekje të ndryshojë sadopak, por nuk ishte e mjaftueshme. Fahri efendiu iu drejtua mulla Rashitit, si e kërkonte rendi, ngase ai ishte arsimtari, e Fahri efendiu mysafiri. *“Efendi, a më lejon të shtojë edhe unë diçka?”* *“Po, sigurisht, me gjithë dëshirë!”* – iu përgjigj mulla Rashiti.

Unë mendoj – vazhdoi ai – ashtu siç ishte ai, i heshtur në bisedë, se më drejtë do të duhet të ishte: *“Ashti i huj nuk i dhemb gjithkuj!”* Mulla Rashiti e falënderoi ngrohtësisht dhe na e shpjegoi tërë klasës, se dikujt i dhemb, nuk mundet të mos i dhemb askujt.

Fahri efendiu ndenji edhe pak me ne dhe ne, me ngitje në këmbë e tërë klasa – kështu veprohej për respekt – e përcollëm Fahri efendiun.

Grupi punues, siç thuhet në botimin e vitit 1965 të këtij Mevludi, *“asht shqyrtue nga ana e një komisioni të posaçëm teologësh i caktuem prej Këshillit ekzekutiv të Shoqatës së “Ilmijes”...dhe u lejue për shtyp me vendimin Nr. 1118/1-65 datë 15-XI-1965”*. Në vitin 1965, Mevludi i Tahir ef. Popovës bëhet i lexueshëm për brezin e viteve të pas Luftës së Dytë Botërore, tashmë i ndarë nga shkrimi arab.

Me sa e di unë, në hapësirën shqiptare të mbetur nën pushtetin e Jugosllavisë, ky Mevlud është teksti i dytë pas Ilmihalit, në gjuhën shqipe

me shkronja shqipe, me përmbajtje islame – jeta e Pejgamberit Muhamed a.s..³

I njëjti Mevlud është ribotuar disa herë në Prishtinë e gjetiu, me pak apo aspak ndryshime nga botimi i vitit 1965, por deri tani, asnjëherë nuk më ka rënë ndonjë informatë se kush ishin anëtarët që e përbënin “...Komisionin e posaçëm teologësh...”, të cilin e kishte caktuar Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës “Ilmije”.

Mendoj se puna e atij Komisioni meriton dhe mbetet obligim i studiuesve të literaturës islame që të hidhet dritë mbi këtë rrugëtim të kultivimit islam në hapësirën tonë. Sikur që duhet, sipas mendimit tim, edhe një studim më i thellë i mevludeve në gjuhën shqipe, i cili do të sillte dritë për autorësinë e tyre, kush është autori dhe kush është përkthyesi konkret.

Unë, nga shprehjet e mulla Rashit Osmanit dhe të Hasan ef. Nahit, e kam formuar bindjen se Fahri ef. Iljazi ishte në krye të grupit punues, sepse ata thoshin se Fahri efendiu e zotëron gjuhën shqipe më mirë se gjithë ne. Sa për kureshtjen tuaj, do ta përmendi edhe faktin se botimi i këtij mevludi në vitin 1965, në kopertinën e tij e ka Xhaminë e Çarshisë, të montuar jo korrekt. Minarja e xhamisë që është në anën e djathtë, aty ka dalë në anën e kundërt.⁴

Kur i qasemi me kujdes rrjedhës së botimit të mevludit në gjuhën shqipe me shkronjat shqip, arrimë në përfundim se botimi i mevludit në vitin 1965, i cili u përgatit “...nga ana e një komisioni të posaçëm teologësh i caktuem prej Këshillit ekzekutiv të Shoqatës së “Ilmijes”, ka shërbuer si mbështetje dhe ndihmesë e rëndësishme për botimet e mëvonshme. Të përmendim këtu kalimthi se në vitin 1967, u botua i njëjti mevlud në Ankara,⁵ në vitin 1991, nga Biblioteka Myslimane Shqiptare u botuan në

³ Shih: Ramadan Shkodra – Aziz Pireva, “Bibliografi e botimeve islame në gjuhën shqipe në Kosovë, 1957-1997”, Prishtinë, 1998.

⁴ Shih: “Mevlud”, Prishtinë, 1965, 27 faqe. (Botim i Shoqatës “Ilmije” për Republikën Socialiste të Serbisë në Prishtinë, 1965).

⁵ Mevludi Sherif në gjuhën shqipe, Ankara, 1967. Në faqen 20 shënon: Zejnullah Ozjashar, 1967. Ky e ka riprodhuar këtë Mevlud me shkronjat arabe, për të cilin nuk kemi mundur ta gjejmë vitin e botimit, sepse në fund shënohet vetëm kjo: Zejnullah ibni Jashar.

koleksion pesë mevlude në gjuhën shqipe,⁶ kurse në vitin 2002, në Shkodër u botuan koleksionet e mevludeve në gjuhën shqipe, ku radhiten njëzet mevlude,⁷ pa i përfshirë këtu edhe ribotimet e disahershme në Prishtinë.⁸

Përkundër faktit se për mevludin në gjuhën shqipe janë publikuar deri më tani disa qasje të rastit, sikur që ishte edhe Sesioni shkencor “Mevludi tek shqiptarët”,⁹ madje edhe disa teza magjistrature,¹⁰ sipas mendimit tim është i nevojshëm një studim i thelluar, nga i cili do të dilte rezultati se nga njëzet mevlude që prezantohen me 20 autorë, sa prej këtyre janë përkthim apo të ndikuar nga ndonjë gjuhë dhe sa janë që mund të trajtohet si krijime origjinale, të motivuara nga respekti ndaj Muhamedit a.s. dhe jetës së tij.

Në pamundësi që t’i marrë në shqyrtim të gjitha këto tekste, kam konstatuar se Zejnullah Ozjashar apo Zejnullah Jashari dhe Idriz Lamaj,¹¹ nuk janë autorë mevludesh. I pari vetëm e ka përgatitur ribotimin e Tahir ef. Popovës në Ankara, ndërsa i dyti e ka përkthyer mevludin e Reshad Kadiqit nga serbokroatishtja.¹²

⁶ Këtu janë mevludet e autorëve: hafëz Ali Ulqinaku, hafëz Ali Korça, hafëz Abdullah Zembllaku, Tahir ef. Popova dhe Faredin Osmani.

⁷ Përgatitur nga Faik Luli dhe Islam Dizdari. Në këtë botim, përveç pesë mevludeve të përmendura në botimin e Detroitit më 1991, përfshihen edhe 15 mevlude, dhe sipas kronologjisë janë si vijon: Hasan Zyko Kamberi, Ismail Floqi, Shefki Hoxha, sheh Ahmet Shkodra, Zejnullah Jashari, hafëz Ibrahim Dalliu, Idrim Lamaj, Ilmi Velu, Shefqet Kraja, Jonuz Metani, Ferit Vokopola, Xhemal Shehu, Mevludi çam, Islam Çelebi – Nekovci dhe Mehmet ef. Salihu.

Nëse këto tekste i nënshtrohen një studimi dhe analize më të hollësishme, me siguri se disa prej tyre nuk do të mund t’i qëndrojnë kriterit dhe konceptit që ka Mevludi. Këtu gjenden tekste që drejtpërdrejt ose tërthorazi u referohen personaliteteve të tjera dhe që nuk i dedikohen Pejgamberit Muhamed a.s., si f.v. Mevludi Ali, e ndonjë tjetër.

⁸ Mevludi i Tahir ef. Popovës, pas vitit 1965, është ribotuar në Prishtinë edhe në vitet 1984, 1994, 2007 etj.

⁹ Përmbledhje kumtesash nga Sesioni shkencor, Prishtinë, 22 prill 2009, fq. 280, hfz. Ali Korça, Mevludi – e lemja e Pejgamberit, Prishtinë, 1992; Hasan Kaleshi, Vepra – 1, Shkup, 1996. Përgatiti: Feti Mehdiu, Prishtinë, 2022 etj.

¹⁰ Bahtije Gërbeshi, “Mevludet në kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2011, fq. 198.

¹¹ Idriz Lamaj, “Mevludi”, Nju Jork, 1982.

¹² Rešad Kadić, “Mevlud”, Sarajevë, 1969, fq. 62.

Për mevludin e Mehmet ef. Salihut, të cilin e kam shqyrtuar personalisht në dorëshkrim, për çka i jam mirënjohës autorit (pastë mëshirën e Allahut!), lirisht mund të shprehem se është tekst original.

Kujtimi tjetër që më lidh me Fahri efendiun ka të bëjë me praktikën shumë të dobishme që zbatohej në vitet kur unë kam qenë nxënës i Medresesë, më 1960-1967, kur gjatë muajit Ramazan, shkonim nëpër vende të ndryshme me detyrë të imamit.

Pasi kisha ndërruar dy-tre vende në këtë detyrë, në Shalë të Bajgorës, në fshatin Gumnishtë, te Hysejnovit në odën e Kadri Hysenit, te Mehmetovit në odën e Mehmet Shasivarit, në Drenicë në fshatin Llapushnik, në lagjen Patërkë në odën e Ramë Thaçit dhe Sadik Metës, në vitin 1966 dhe 1967, fati më hodhi në Gjakovë, aty ku në krye të Bashkësisë Islame vepronte Fahri efendiu.

Aty kalova dy Ramazane, njërin në Devë dhe tjetrin në Gjakovë, në Mejtepin e Halil efendiut, në mëhallën e Gecit. Shërbimi im si imam Ramazani në Devë ishte një përvojë e veçantë, për faktin se ndodhesha buzë kufirit – vija e fundit me Shqipërinë – gjë që në ato vite kërkonte vigjilencë të posaçme në komunikim me rrethin ku veproje.

Në Gjakovë kjo kishte tjetër kuptim. Unë shërbeja si imam në një xhami, ani pse në të nuk falej xhumaja. I thoshin Mejtepi i Halil efenisë, ku përveç namazit të teravive, shërbeja si imam edhe për kohët e tjera të namazit. Aty isha i rrethuar me xhematli të qytetit, me njerëz të shkallës së lartë intelektuale, njerëz me meritat të theksuara të fushës politike, kulturore e patriotike.

Aty e takova babanë e Emin Durakut, vëllain e Remzi Pulës, babanë e Ali Rrahmanit (Aliu ishte solist i dalluar i asaj kohe, të cilit ia ndërprisnin mikrofonin në koncertin te stadiumi i vogël i boksit, afër Kino Rinisë). Ky i fundit vinte shpesh në kohë të namazeve dhe tregonte respekt ndaj meje.

Fahri efendiu më njihte shumë mirë, falë prezantimit që më kishte bërë h. Mustafë ef. Dervisholli, i cili shërbente si imam në xhaminë "Mahmut Pasha", por edhe si sekretar dhe arkëtarë i Vakëfit. Aq më tepër më respektonte si imam i Devës, prej nga i kishin ardhur informatat për dety-

rën time si imam, në kullën e Rustem Abdullahit dhe të Adem Qerimit. Haxhi Mustafa kishte zgjedhur për mua Devën për t'ua falur teravitë. Deva kishte miqësi me haxhi Sadri Rexhën në Gjakovë, me Golajt etj.

Kur mora vendimin - aktin me shkrim, lejen zyrtare - për këtë shërbim në këtë vend, një ditë para se të fillonte Ramazani, Fahri efendiu kishte caktuar takim me të gjithë imamët e Ramazanin, të cilët vepronin nën Këshillin e Gjakovës. Pasi na i drejtoi disa këshilla me karakter të përgjithshëm - disa ishim nxënës të Medresesë - por kishte edhe imamë të tjerë, që aktivizoheshin vetëm në Ramazan në ato vende ku nuk kishte xhami por që kishte xhematë të devotshëm që e prisnin me padurim agjërimin e Ramazanit, me mua u ndal pak më gjatë.

Më vonë e kam menduar këtë, ngase asokohe as nuk më ka shkuar mendja, se ai kishte pasur për qëllim që unë ta kuptoja seriozitetin e pozitës së imamatit në kufi me shtetin shqiptar. Fahri efendiu sa për inkurajim më thoshte “*efendi*”, ndonëse unë si një nxënës Medreseje vetëm se isha në rrugë për “*efendi*”. “*Efendi*” - mu drejtua, “ti do të shkosh imam në Devë. Deva është xhamatë i mirë, prandaj Mustafë efendiu ka propozuar që ti të shkosh në Devë. Sigurisht se do të kalosh mirë, ky fshat është buzë kufiri” – këtë e theksoi në mënyrë të veçantë, por kulla e Rustem Abdullahit¹³ dhe oda e Adem Qerimit¹⁴, kanë pasur emër gjithmonë.

“*Për hair Ramazani, Zoti na e bëftë kabull!*” – kjo ishte porosia e Fahri efendiut në vitin 1966 kur më drejtoi për imam Ramazani në Devë.

Allahu e shpërbleftë me Xhenetin Firdevs!

Ju faleminderit!

¹³ Kulla e tij ishte caktuar zyrtarisht vendi se ku do të faleshin teravitë, një objekt i dalluar në Davë, në katin e sipërm, me shkallë nga ana e jashtme. Mixha Rustem, një burrë i moshuar, me ankesa të mëdha nga ishijasi, por që kurrë nuk e shprehte këtë brengë para nesh. Ne e kuptonim këtë, prandaj rrallëherë ndaleshim pas faljes së namazit.

¹⁴ Ishte konaku i dytë ku kam qëndruar kohë më të gjatë se në shtëpitë e tjera. Respektin ndaj meje nga kjo shtëpi, mund ta ilustruj me faktin se djali i bacës Adem, Azgani, ka ardhur dy herë të më vizitojë në Medrese.

Elez OSMANI

FAHRI EF. ILJAZI (1903-1985) NË KUJTESËN TIME

Secili njeri, në memorien e tij, ruan kujtime të veçanta, të cilat nuk veniten fare. Unë asnjëherë nuk do ta harroj takimin e parë me alimin e shquar Fahri efendi Iljazin. Ishte qershori i vitit 1969, kur së bashku me gjyshin tim, hoxhën e fshatit Molliq, shkuam në Myftidare (Këshillin e Bashkësisë Islame në Gjakovë). Posa gjyshi trokiti në derë, na u lajmërua një zë burri. “Urdhëroni!” Hymë brenda, duke u përshëndetur me selam. Na pritë me një mikpritje të përzemërt një mesoburrë, diku në të 60-ta, ashtu siç i ka hije një profesor me një ish-nxënësi të tij. “Bane mirë që u ndale për një kafe mulla Tahir” – i tha Fahri efendiu. “Sot kam ardhur me punë” – ia ktheu gjyshi. Sidoqoftë, për hair na qoftë.

“Ky tha është nipi im, duke u drejtuar nga unë, dhe tha e kam sjellë, së bashku me dokumentacionin e tij, ngase ka dëshirë të regjistrohet në Medrese.” Një gëzim dhe një buzëqeshje përshkroi fytyrën e myderrizit dhe befas përqendroi vëmendjen tek unë. “Prej nga e kemi?” “Nga Morina, i Hoxhajve, është djali i vajzës, nipi im.” Ai u gëzua shumë, sa që i shkëlqeu edhe fytyra. Më përkëdheli dhe më përqafoi. I tha sekretarit të Këshilli, Mustafë ef. Dervishollit, lajmëroje Prishtinën, se më në fund edhe ne kemi një kandidat. “Çfarë suksesi ka?” e pyeti gjyshin. “Të shkëlqyeshëm” – ia ktheu. “Ky është i pranuar” – na tha. Kjo gjë më bëri mua të gëzohem, dhe atë moment asnjëherë nuk e harroj, ashtu sikurse edhe alimin e shquar, i cili ma komunikoi lajmin.

Unë nuk e dija se isha kandidati i vetëm nga Gjakova në ato vite që do të shkoja në Medrese. Më duket se kjo situata ma shtoj simpatinë, jo ve-

tëm te kryetari, por edhe në tërë Këshillin. Andaj, kur udhëtoja për në vendlindje, shpesh ndalesha për ndonjë muhabet të shkurtër, teksa atij iu bëhej qejfi.

Fahri efendi Iljazi llogaritet si personalitet i shquar për atdhedashurinë,¹ për ndjenjat e thella fetare, për shpirtin e iniciativës dhe guximit qytetar, për erudicionin e thellë si hoxhë dhe intelektual, por edhe për prirjet e tija të theksuara sufiste.²

Figura e tij fetare, atdhetare, kulturore dhe arsimore është e lidhur ngushtë me traditën e shquar në Gjakovë, të krijuar nga mendimtarët dhe patriotët e shquar të shekullit të kaluar, mes të cilëve, Hasan efendi Nahi, Hasan efendi Dashi etj.

Myderrizi Fahri efendi Iljazi ishte njëri prej hoxhallarëve më të ditur, jo vetëm të Gjakovës dhe të Kosovës, por ishte një nga më të dalluarit dhe më të shquarit në nivelin kombëtar dhe më gjerë.

Prejardhja familjare

Shkencëtarët që merren me studimin e personaliteteve, theksojnë se në personalitetin e njeriut ndikojnë tre faktorë: rrethi shoqëror, aktiviteti personal dhe trashëgimia gjenetike. Andaj, me plotë bindje mund të themi se këta tre komponentë gjenden edhe në figurën e Fahri ef. Iljazit. Ai rrjedh nga një familje e njohur gjakovare, prej së cilës, ndër shekuj kanë dalë shumë intelektualë, dijetarë, myftinj, myderrizë, hafëz, hoxhallarë, atdhetarë etj. Trungu gjenealogjik i kësaj familje është treguesi më i qartë dhe më bindës për traditat e shquara, të krijuara brez pas brezi.

¹ Kultura Islame.

² Prof. Fejzullah Haxhibajriç nga Sarajeva në librin e tij "*Nekrolozi*" ndër të tjera thotë: "Sipas meje, e them me plotë bindje se hafëz Fahri efendiu është njohësi më i madh i tesavufit dhe jurisprudencës islame në Ballkan. Nuk e ka njohur dhe komentuar Ibën Arabiun më mirë se ai askush në Ballkan."



Fahri ef. Iljazi lindi në vitin 1903, në Gjakovë. Është djali i myderrizit, hafëz Iljaz efendiut, i cili ishte djali i myderrizit, hafëz Muhamed efendiut, i cili ishte njëri nga pesë djemtë e Yvejs efendiut, që të gjithë hoxhallarë të njohur dhe të nderuar: Muhamed efendiu, hafëz Ismail efendiu, hafëz Muhamed efendiu, Jahja efendiu dhe Hysein efendiu.³ Yvejs efendiu, babai i pesë hoxhallarëve të shquar, ka qenë myderrizi i parë në Medresenë e Madhe të Gjakovës, e cila për dekada qe vatër e shquar edukative, arsimore dhe kulturore në atë pjesë të Kosovës.⁴

Shkollimi

Mësimet fillestare, Fahri ef. Iljazi, i kreu në Gjakovë, ku krahas tyre, pranë babait, myderrizit, hafëz Iljaz efendiut, e mësoi përmendsh Kuranin fisnik, dhe në moshën 11 vjeçare mori titullin hafëz, të cilin në moshën 9 vjeçare, e kishte marrë edhe babai i tij, myderrizi Iljaz efendiu. Hafëz

³ Hajriz Demakun, ish-nxënës i hafëz Fahri efendiut, ish-luftëtar i Shaban Polluzhës, ka thënë: Për pushkë e trimëri si Shaban Polluzha s'ka, kurse për ilm, dituni, si hafëz Fahri Efenija i Gjakovës, shtatë breza myderrizë, s'ka asnja

⁴ Mexhid Yvejsi, "Hafizët e Gjakovës".

Fahriu i vazhdoi mësimet në Medresenë e Madhe të Gjakovës, pranë babait të tij, deri në vitin 1920, vit kur ndërroi jetë babai i tij i nderuar. Më pastaj, studimet i vazhdoi në Medresenë "Mehmed Pasha" në Prizren, pranë myderrizit të shquar, Nusret efendi Galibit, i cili ka qenë edhe myfti i Prizrenit.⁵

Veprimtaria dhe aktiviteti

Që nga janari i vitit 1930 e deri në vitin 1948, kur edhe komunistët e mbyllën Medresenë e Madhe të Gjakovës, hafëz Fahri efendi Iljazi, ka qenë myderriz dhe udhëheqës kryesor. Gjatë 18 vjetëve sa shërbeu në Medrese – në të cilën studionin 93 studentë nga të gjitha trevat shqiptare – mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe.

Në vitin 1941, një delegacion i Komunitetit Mysliman Shqiptar me qendër në Tiranë, nën udhëheqjen e dr. Behxhet Shapatit, vizituan Medresenë e Madhe në Gjakovë, e cila udhëhiqej nga myderrizi Fahri ef. Iljazi. "Myderrizi (Fahri ef. Iljazi), së bashku me popullin dhe prijësit fetarë na udhëhoqën për në Medrese, pranë së cilës kishin dalë dhe ishin rreshtuar një tufë studentësh duke na uruar mirëseardhje. Qetësi e gëzim, të një ritmi fetar, konstatuam në fytyrat e tyre. Na çuan në sallën e Medresesë, sallë kjo e shtruar mirë dhe pastër. Këtu gjetëm të gjithë komoditetin për të cilin ka nevojë udhëtari. Këtu pamë edhe programin e Medresesë, të cilin e gjetëm krejt të plotësuar, e sidomos në disa mësim, si në: Filozofi Islame, Etikë, Jurisprudencë Islame etj., të cilat duhej të vihen edhe në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës."⁶

⁵ Po aty.

⁶ Revista "Kultura Islame", nr. 3, Tiranë, 1941



Gjatë periudhës 1941-1944, Bashkësia e Fesë Islame e Kosovës, me insistimin e Tahir Kolgjinit dhe me aprovimin e të gjithë imamëve, në një mbledhje të organizuar në Prizren, nën kryesimin e Abdullah Telakut, mori një formë të re organizimi.⁷ Aty u formuan dy Kryemyftinijtë e saj (Kryemyftynia e Prizrenit dhe ajo e Prishtinës), që do të lidheshin me Komunitetin Mysliman me qendër në Tiranë. Organizimi i saj ishte i ndarë në Kryemyftinijë dhe Nënmyftinijë.

Në krye të këtyre institucioneve qenë vënë personalitetet kompetente, të cilët ishin dalluar përveç të tjerash, edhe në planin kombëtar, ndërmjet dy luftërave botërore, siç ishin myftinjtë: Hasan Islami – Nahi në Prizren, Rexhep Remziu në Prishtinë, nënmyftiu mulla Idris Gjilani në Gjilan, nënmyftiu Ahmet Hasani në Ferizaj, nënmyftiu Fahri ef. Iljazi në Gjakovë etj.⁸

⁷ Elez Osmani. Gazeta “Dielli”, janar 2023, Nju Jork.

⁸ Ramadan Shkodra, “Edukata Islame”.

E veçanta e kësaj periudhe ka të bëjë me faktin se administrata e këtyre institucioneve vepronte ekskluzivisht në gjuhën shqipe dhe dekretimi bëhej nga Tirana. Në këtë kohë, në Kosovë, në mënyrë të lirë dhe haptazi shpërndahej literatura islame nga Shqipëria, siç ishin revistat: *"Kultura Islame"*, *"Zani i Naltë"*, *"Mevludi"* i hafëz Ali Riza Ulqinakut, veprat e hafëz Ibrahim Dallit, veprat e hafëz Ali Korçës, Haki Sharofit, hafëz Abdullah Zëmbllakut etj.⁹

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Kosova, edhe një herë padrejtësisht ndahet nga mëma e saj Shqipëria, dhe u fut dhunshëm nën administrimin e sajës së artificiale, të quajtur Jugosllavi. Me këtë akt, edhe Bashkësia e Fesë Islame në Kosovë, detyrimisht do të ndryshojë qendër, nga Tirana në Sarajevë, dhe që nga viti 1945 deri më 1990, do të veprojë në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame të Federatës Jugosllave me qendër në Sarajevë. Në këto rrethana të krijuara pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, organizimi, funksionalizimi dhe strukturimi në terren nuk ishin sipas vullnetit të popullit, por sipas organizimit të ri politik-shtetëror.

Fahri efendiu nuk mund të qëndronte indiferent ndaj zhvillimit të ngjarjeve që tronditën vendin. Mjedisit ku u rrit dhe u edukua ishte i tillë, ku ngjarjet historike që kishin të bënin me fatet e kombit patën gjetur je-honën e duhur. Ende ishin gjallë sa e sa luftëtarë të Lidhjes së Prizrenit, sikurse edhe ata që kishin marrë pjesë në vrasjen e Mehmet Ali Pashë Magjarit në Gjakovë.

Burrat dhe farefisi i efendiut luajtën rol të dorës së parë në rrjedhat e historisë, andaj ishte e pritshme që Fahri efendiu, pas ardhjes së komunizmit, të ndihej i hidhëruar dhe i zhgënjyer me rrethanat e reja shoqërore dhe politike. Kështu që ai zgjodhi formën më njerëzore dhe më fetare, duke jetuar mes njerëzve, xhematit dhe kuadrove, që ai i donte aq shumë. Me urtësinë, butësinë dhe metodën e një alimi të spikatur, provonte që në gëzimet dhe hidhërimet e tyre, ta kenë bazë burimin e mësimave fetare, sepse, sadopak ato zbusnin zemrat e njerëzve, ua lehtësonin dhimbjet, ua drejtonin dhe ndriçonin rrugën drejt së mirës, së vërtetës, drejtësisë dhe

⁹ Po aty.

mirëkuptimit. Ai udhëzonte drejt rrugës që predikon feja islame, e kjo gjë e bëri atë të dashur për çdokënd. Njëherësh ai u njoh me lidhmëritë që kishte pasur familja e tij me qytetin, fshatrat e Rekës të Malësisë së Gjakovës dhe më gjerë. Gradualisht u njoh edhe me besën, burrërinë, mikpritjen dhe atdhedashurinë e atyre viseve, të cilat do t'i shërbenin përgjatë gjithë jetës së tij.

Veprimtaria e hafëz Fahriu është shumë e gjerë dhe e gjatë. Ai ka shërbyer me përkushtim për më shumë se gjysmë shekulli, ditë dhe natë. Ka shërbyer si imam në disa xhami, pastaj edhe si kryeimam i Gjakovës dhe i një pjese të Kosovës, Dukagjinit, përfshirë këtu Pejën, Istogun e deri në Klinë. Ai gjithashtu ka qenë edhe kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Gjakovës, si dhe shërbeu edhe në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Duke ruajtur dhe transmetuar porositë kuranore, ai gjithnjë ishte pranë popullit, xhematit, nevojtarit, pranë halleve dhe shqetësimeve të njerëzve, e kjo e karakterizonte dhe e veçonte atë. Si kryetar i Këshillit dhe si imam në Xhaminë e Hadumit, ishte i kujdesshëm dhe mirë i përgatitur. Çdo fjali e tij ishte e çmuar dhe e vlerësuar, kështu që dëgjohej me respekt dhe vëmendje të madhe.

Por, si në çdo veprimtari tjetër, edhe aty kishte telashe, mospajtime etj., madje edhe nga hoxhallarët. Diku në vitet 1974-75, siç më ka rrëfyer imami Llukman Geci, i cili ishte imam në fshatin Irzniq, shkuam, thotë ai, “në një mbledhje, ditën e fundit të Ramazanit, për të parë se si kishin kaluar gjatë Ramazanit dhe për t’u përgatitur për festën e Bajramit. Mbaj mend – shton imami – se aty ishin të gjithë imamët e Gjakovës dhe Deçanit. Ishte Jahja ef. Bakalli, Ahmet ef. Berisha, hafëz Idriz ef. Dermaku dhe Idriz Kakruki, i cili sapo ishte emëruar imam në fshatin Drenoc. Ky ishte ndër të parët që nuk e praktikonte medhhebin hanefi, dhe disi me fodullëk i tha kryetarit, Fahri efendiut, “sot është Bajram dhe do ta prishim agjërimin.” Fahri efendi u foli aq butë, aq ëmbël dhe qetë, sa që që të gjithë ne u skuqëm, por imami të Drenocit nuk ia la shenjë. Ishte befasi kur ia shpjegoi në gjuhën arabe se si duhej respektuar udhëheqësi shpirtëror, që në atë kohë ishte Sylejman ef. Kemura, ndërsa krejt në fund i tha

se ne, në këtë rast, nuk kemi gjynahe, por ka kryetari suprem. Idrizi ishte tekanjoz. Aty nuk kundërshtoi më shumë, por kur shkoi në Drenoc, e qiti tupanin dhe e shpalli Bajramin. Kjo gjë ndikoi shumë keq në xhemat. Pas kësaj, në mbledhjen tjetër, ne i thamë, largoje nga puna se po na bënë fitne. Jo, tha efendiu i nderuar, me këto veprime ai largohet vetë.”¹⁰ Po ashtu kishte telashe edhe me format e devijuara të tarikateve, që ishin të shumta në Gjakovë.

Fahri ef. Iljazi – njeri i parimeve

Fahri efendiu nuk koketonte me komunizmin as në një rast të vetë. Profesori i nderuar, dr. Ekrem Murtezai, më ka treguar një ngjarje, se kur po përgatitej për botim monografia “*Gjakova në LNÇ*”, nga dr. Ali Hadri, ky kishte hasur në një dokument, në të cilin shënohej se ulemaja e Gjakovës nuk i kishin përkrahur fare komunistët dhe se ishin kundër tyre.

Në dokument flitej se si me një rast, personalisht vetë Fadil Hoxha, pas Luftës së Dytë Botërore, e kishte lutur Fahri ef. Iljazin, që të dilnin së bashku në qytet, vetëm sa për ta bërë një fotografi, por që Fahri efendiu nuk kishte pranuar. Aliu këtë dokument ia tregoi Fadilit dhe ishte në përgatitje për ta radhitur në libër. Fadili nuk e lejoi dhe ia ktheu. E di shumë mirë ngjarjen, por ai dokument nuk mund të botohet. Ata kanë orientimin e tyre dhe ne tonin.¹¹

Emri i myderrizit, hafëz Fahri ef. Iljazit, si një dijetar dhe si një personalitet i rrallë, njëhej jo vetëm në Gjakovë dhe në Kosovë, por edhe më gjerë. Po e nënvizoj edhe një rast. Në vitin 1963, një delegacion fetar nga ish-Jugosllavia e vizitoi Marokun. Ndër anëtarët e këtij delegacioni ishte edhe hafëz Fahriu. Ata i priti mbreti i Marokut, Hasani i Dytë, dhe kur hafëz Fahriu i foli në gjuhën arabe, pastër, rrjedhshëm, me maturi dhe zgjuars, mbreti mbeti i habitur. Pas disa vitesh, mbreti Hasani i Dytë, e kishte pyetur Fadil Hoxhën, i cili qe në një vizitë zyrtare në Marok: “A e njeh hafëz Fahri efendiu, është nga vendi juaj?” “Po, madje jemi nga i

¹⁰ Bisedë me imamin Llukman Gecin, 74 vjeçar, Llaushë, Skenderaj.

¹¹ Bisedë me dr. Ekrem Murtezain, Prishtinë, 2018.

njëti qytet, nga Gjakova” – i ishte përgjigjur Fadil Hoxha. Mbreti Hasan i kishte thënë: “Një kokë si e tij, plot urtësi, i mjafton vendit tuaj.”¹²

Për urtësinë, mirësinë, efikasitetin në detyrë, sinqeritetin, këshillat e zgjuara dhe ngrohtësinë e fjalëve, ne do ta kujtojmë Fahri efendiun gjithmonë. I tillë ka mbetur në zemrat e të gjithë atyre që e njohën, pra ishte një shembull për të gjithë ne. Andaj, kujtesa e tij jeton në zemrat e njerëzve të ditur dhe të dashur.

Hafëz Fahriu ndërroi jetë në moshën 82 vjeçare, më 19 nëntor 1985. Namazi i xhenazes iu falë në Xhaminë e Hadumit, aty ku shërbeu me shumë përkushtim. Aty edhe u varros.

¹² Mexhid Yveysi, “Hafizët e Gjakovës”.

Esat REXHA

KUJTIMET E MIA PËR HAFËZ FAHRI EFENDIUN

*I nderuari Myfti i Republikës së Kosovës, Naim ef. Tërnavë,
I nderuari drejtor i IHSI-së, prof. Sabri ef. Bajgora,
E nderuara familje Iljazi,
Të respektuar të pranishëm!*

Më lejoni që në këtë Tryezë shkencore, me rastin e 120-vjetorit të lindjes së h.fz. Fahri ef. Iljazit, të ndaj me ju disa kujtime personale me hafëzin, hoxhën, myftiun, myderrizin dhe udhëheqësin e shquar të Bashkësisë Islame, jo vetëm për Gjakovën, por edhe për gjitha trojet shqiptare dhe vendet e botës islame, h.fz. Fahri ef. Iljazin, i njohur si Fahri Efendija.

Kujtimet e para me myderrizin e nderuar i kam që nga fëmijëria ime e hershme, atëherë kur ai vinte për vizita në shtëpinë tonë, te gjyshi im i ndjerë. Në një nga vizitat e tij në shtëpinë tonë, përveç Fahri efendiut me hoxhallarët e Gjakovës, prezent ishin edhe Hasan ef. Nahi dhe hafëz Ismail Hakija. Fahri efendiu i njoftoi të pranishmit se haxhi Sadriu donë me e çua nipin në Medrese. Më thirrën mua, më thanë hajde se po të kërkojnë hoxhallarët. Ndenja një kohë në mesin e myderrizëve, u gëzuan shumë, e më së shumti Fahri efendiu.

Me pamjen e tij fisnike dhe engjëlllore, sjelljen e tij përkëdhelëse dhe qëndrimin e tij burrërorë, ta mbushte syrin, zemrën dhe shpirtin me dashuri për të. Gjakovarët thoshin: “Te kish imoni her, mi pa e me nej me to”. Kur kalonte çarshisë askush nuk e pritke ulur, të gjithë ngriheshin në këmbë në shenjë nderi dhe respekti.



Prezenca e tij në çdo mexhlis burrash, qoftë për gëzime apo për pikëllime, biseda e tij për aktualitetin e kohës dhe karakteri i tij serioz, bënte që ai, natyrshëm ta pushtonte vëmendjen e mexhlisit. Ai ishte një burrë shumë modest. Me një shikim depërtues gjer në brendësinë e dëgjuesit dhe me sjelljen e matur që kishte, të bënte që mos ta harroje dhe që ta takojë përsëri.

Ai ishte kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Gjakovës, e gjithashtu edhe anëtar i Kryesisë së Bashkësisë Islame të ish-RSS-së, si dhe anëtar i Kuvendit Suprem të Bashkësisë Islame të ish-Jugosllavisë. Përveç kësaj, ai, për shumë vite ishte edhe imam në Xhaminë e Hadumit, e cila është xhamia e parë e Gjakovës. Në Xhaminë e Hadumit, që kur kam qenë fëmijë, kemi shkuar me gjyshin e me babanë, zakonisht për net të mëdha si Nata e Kadrit etj., me dëgjuar vaiz të Fahri efendiut. Ligjëratat u mbajtke pas namazit të ikindisë. Xhamia u mbushke përplot. Përveç xhematit dhe imamëve të Gjakovës, vinin edhe xhematli dhe imamë prej fshatrave. Ligjëratat dhe hytbet e tij i dëgjonim me vëmendje, fjalët e tij të ëmbla depërtonin në zemrën dhe shpirtin e secilit, të gjithë qanin me lot.

Si i ri, sa kam qenë nxënës në medresenë e mesme "Alauddin" në Prishtinë, gjatë pushimeve për festa të ndryshme, shkoja për ta falur na-

mazin e xhumasë në Xhaminë e Hadumit. Fahri efendiu i thoshte myezinit: “Shefket, le të bëjë mizinllyk nipi i haxhi Sadrisë!”

Gjatë muajit të Mevludit, në Xhaminë e Hadumit organizohej këndimi i mevludit. Në një rast, si nxënës i Medresesë, mu dha rasti që të këndoje një pjesë në mevludi sherif. Pas përfundimit të këndimit, një pjesë e xhematit e pyetën me habi, se kusht është ky djalë? Hoxha u përgjigj: “Ky është nipi i haxhi Sadrisë, talebe i Medresesë.”

Hafëz Fahri efendiu ka qenë brezi i shtatë i myderrizëve në Medresenë e Madhe të Gjakovës. Unë, si sekretar i Këshillit të BI-së në Gjakovë, i kam përcjell tre breza nga kjo familje: haxhi, hafëz Fahri ef. Iljazin (në fund të karrierës së tij), prej kur unë kam filluar punën 1976-1977; i biri i tij, prim. prof. dr. sci. h. Ali Iljazi, prej vitit 1989-1996; dhe nipi, Fatmir ef. Iljazi, prej vitit 2004-2012.

Pas diplomimit në Medresenë “Alauddin”, u paraqita në zyrën e Këshillit të BI-së për të marrë informata për veprimet e mëtutjeshme për punësim në detyrën e imamatit. Ende e kam parasysh pritjen e ngrohtë që ma bëri Fahri efendiu. Vërehej qartë se ishte i lumtur që unë do të vazhdoja të ndiqja mësimet e fesë, dhe aty për aty më tha që ta shkruaj një lutje për pranim dhe më tha që t’i sillja menjëherë dokumentet e shkollës fillore. Propozimin për emërim si imam në Xhaminë e Honkes ma ka nënshkruar Fahri efendiu, aty ku edhe ai vetë kishte filluar detyrën si imam në atë xhami.

Fahri efendiu (shpirti i pastë rahmet!) ishte figura numër një në Gjakovë. Për çdo gjë, besimtarët e merrnin mendimin e tij; për fejesa, për martesë (p.sh. a bën të miqësohemi me filanin?); për emërtimin e fëmijëve – me ia zgjedh një emër të mirë prej Kuranit etj..

Ai mori pjesë pothuajse në çdo pajtesë gjaku, ngatërresë apo konflikt. E mbaj mend rastin ndërmjet dy familjeve, katolike dhe myslimane. Askush nuk ka mundur t’i pajtojë derisa ka shkuar Fahri efendiu. Pastaj kujtoj një rast të rëndë në fshatin Prilep, rastin e fshatit Rogovë të Hasit, ku ka qenë xhamia e mbyllur për shtatë vjet, aty ishte rrezik për eskalim të situatës etj.. Fahri efendiu ka marrë pjesë edhe në ndarjen e trashëgimisë ndërmjet familjeve, madje shpeshherë ka pas raste kur nuk e kanë pranuar

ndarjen me gjyq dhe kanë thënë se duam të shkojmë te Fahri efendiu. Ai kishte shumë miq e dashamirë, madje edhe pas vdekjes së hoxhës, në shenjë nderimi e respekti, sidomos të hënave, miqtë dhe dashamirët vinin në vizitë në zyrat e Këshillit të BI-së. Pas vdekjes së tij, ka pasur raste kur kanë ardhur me marrë *irtifa* dhe me nda *fetva*, e kur ne ju thoshim se hoxha nuk merret me atë punë, po shkoni në gjykatë, ata na pyesnin, a ka lanë dikë që merret me këto punë? Përgjigja jonë ishte "jo", kurse ata shpreheshin: "Mazamakeq, koka dekë Gjakova. Ne gjykatën e dimë, por deshëm prej Fahri efenisë."

Kur nuk merrte vesh dikush, Fahri efendiu i thoshte: "*Ti je si kersh, ti bërtet në herë, ai, kersh bërtet dy herë!*" ose: "*Ti i lag komt en ujë e ngjitesh melles përpyetë!*" Komunistët i thoshin: "*Fahri efendi, edhe na jemi sikur ju – nuk rrejmë, nuk vjedhim etj.*" "*Po, por e kemi në dallim: "Ju tuti veq kur nuk iu sheh kërkush, e na tutem edhe kur nuk na sheh kerkush..."*"

Ai kishte raporte të mira të mira me të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh besimin, gjuhën, pozitën etj. Ai kishte raporte të mira edhe me prijësit e besimeve të tjera fetare, me tarikatet etj.

Më kujtohet kur ka ardhur kryetari i ri në pozitë, në shenjë respekti, për disa vjet nuk është ulur në karrigen e Fahri efendit. Si sot më kujtohet, kur të hënave dhe të enjteve, në zyrën e Këshillit të BI-së vinin imamët dhe hoxhallarët për të trajtuar mesele të ndryshme fetare, teksa të enjteve i kontrollonin hytбет.

Ishin kohëra të vështira kur punoi dhe veproji hoxha i nderuar. Unë nuk kam ditur t'i vlerësoj, sepse kam qenë shumë i ri, por me kalimin e kohës dhe me fitimin e përvojës, e kam kuptuar rëndësinë e misionit të hoxhës. Për ndikimin e tij te popullata e Gjakovës, flet edhe dita e varrimit, ku në përcjelljen e fundit, përveç popullit, morën pjesë të gjithë hoxhallarët e Gjakovës, hoxhallarët nga të gjitha anët e Kosovës, nga Sarajeva, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva etj.. Të gjithë, i madh e i vogël, i ri e i vjetër, me lot në sy jemi nda nga hoxha i nderuar. Namazi i xhenazes i është falur në Xhaminë e Hadumit dhe aty, në oborrin e kësaj xhamie, ku edhe kishte kryer detyrën e imamet me përkushtim të madh, edhe u varros.

Për nder dhe respekt të mysafirëve të shumtë, Këshilli i BI-së së Gjakovës, shtroi drekë modeste në hotelin “Pashtrik”.

Ishte nder dhe privilegj i veçantë që kam pasur rastin ta takoj dhe ta kem si kryetar, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, hoxhën e nderuar dhe shumë të respektuar Fahri efendiun.

Këto ishin vetëm disa fjalë të pakta që u mundova t’i hedh në letër nga kujtesa ime që ato t’i ndaj me ju, duke qenë plotësisht i vetëdijshëm se fjalët gjithnjë janë të pakta dhe asnjëherë nuk mund ta shprehin ndjesinë reale për punën e vyeshme dhe personalitetin e Fahri efendiut.

E lus Allahun Fuqiplotë që hoxhën tonë ta shpërblejë për mundin, angazhimin dhe sakrificën që në ditët më të errëta ta mbajë ndezur dritën e udhëzimit islam në Gjakovë dhe më gjerë!

Për çdo fjalë të folur e shkronjë të shkruar, Allahu e begatofte shpirtin e atij njeriu të urtë!

Ju faleminderit!

**Fjala e përmbyllëse e Tryezës shkencore
“HFZ. FAHRI EF. ILJAZI -
ALIM DHE UDHËHEQËS I SHQUAR
I BASHKËSISË ISLAME”**

Të nderuar studiues dhe kolegë

Zonja dhe zotërinj!

Pas një dite intensive, aktiviteti ynë me rastin e 120-vjetorit të lindjes së hfz. Fahri ef. Iljazit është në fazën e tij përmbyllëse. Në të vërtetë, ky përvjetor dhe Tryeza shkencore “Hfz. Fahri ef. Iljazi 1903-1985 – alim dhe udhëheqës i shquar i Bashkësisë Islame” nuk do të mbahej pa kontributin e studiuesve tanë pjesëmarrës, të cilët me kumtesat e tyre, secili në fushën e vet, veç e veç, nxorën në pah dhe ndriçuan aspekte të ndryshme lidhur me jetën dhe veprën e këtij personaliteti të mirënjohur.



Ndonëse për një vlerësim më të gjithanshëm dhe më të saktë na duhet më shumë kohë, megjithatë, si Këshill Organizativ, i japim të drejtë vetës që në një vlerësim të përnjëhershëm, të shprehim bindjen për suksesin e këtij aktiviteti.

Tryeza shkencore i zhvilloi punimet e saj në dy seanca shkencore të ndara. Seanca e parë, ishte e karakterit hapës, andaj me fjalën e tij përshëndetëse, Tryezën e nderoi Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë.

Në seancën e dytë u trajtuan çështje të cilat kishin në fokus aspektin historik, kujtimet e veçanta dhe veprimtarinë fetare e udhëheqëse të figurës së hfz. Fahri ef. Iljazit me (gjithsej gjashtë referues).

Pra, përveç katër fjalëve përshëndetëse, kumtimet e tyre i lexuan gjashtë referues dhe po ashtu pati edhe diskutime lidhur me to, të cilat veç sa e begatuan dhe i dhënë karakter edhe më shkencor kësaj Tryeze.

Të nderuar kolegë,

Duke ju falënderuar për kontributin tuaj të çmuar, besojmë se ky aktivitet do të pasohet me shumë aktivitete të tjera të organizuara nga Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame, duke pasur për synim përfundimtar avancimin e kërkimeve në fushën e studime islame shqiptare dhe hedhjes dritë mbi veprimtarinë e bujshme të figurave kyçe në jetën fetare dhe kulturore në vendin tonë.

Para se t'i shpallim të mbyllura punimet e kësaj Tryeze, me shpresën se do të takohemi sërish në përvjetorë dhe në aktivitete të tjera të organizuara nga Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame, më lejoni t'i them edhe dy gjëra:

- Meqë kumtesat nga kjo tryezë do të botohen në numrin vijues të revistës së Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, Këshilli Organizativ, kërkon nga ju që deri më 10 korrik 2023, ta dërgoni versionin për botim të kumtesës suaj.
- Dhe e dyta, më lejoni që në emrin tuaj dhe në emrin e Këshillit Organizativ të falënderojë edhe një herë Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame në krye me drejtorin e tij, **prof. Sabri Bajgorën** dhe sigurisht edhe Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, me

Myftiun Naim ef. Tërnavë në krye, që bënë ç'është e nevojshme dhe na tubuan për të shënuar 120-Vjetorin e kësaj figure të dashur.

Duke qenë mirënjohës ndaj të gjithëve për pjesëmarrje, edhe një herë ju faleminderit dhe mirë u takofshin në aktivitete të tjera!

Valon MYRTA

Anëtar i KD të IHSI-së

FOTOALBUM “HFZ. FAHRI EF. ILJAZI - ALIM DHE UDHËHEQËS I SHQUAR I BASHKËSISË ISLAME”



Hapja e Tyrezës shkencore





Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë



Muhammed Iljazi



Sadik Mehmeti



Alban Dobruna



Feti Mehdiu



Elez Osmani



Esat Rexha



Ramadan Shkodra



Myftiu, Naim ef. Tërnavë, me familjarët e Fahri ef. Iljazit



III AKTIVITETE

U MBAJT KONFERENCA SHKENCORE “XHAMIA TE SHQIPTARËT - HISTORI, MISIION, IDENTITET”



Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame, në mbështetje të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, më 9 dhe 10 dhjetor 2023, mbajti Konferencën Shkencore me karakter ndërkombëtar, me titull “Xhamia të shqiptarët - histori, mision, identitet”, e cila për qëllim kishte vënien në pah të rëndësisë, historisë dhe misionit që ka pasur xhamia si institucion te populli ynë. Në këtë Konferencë, u theksua roli i xhamive, ku përveç rolit në aspektin fetar, të adhurimit dhe të kryerjes së ritualeve, xhamia, u

tha se kishte edhe karakter atdhetar dhe social, duke shërbyer si shkollë e kuvend.

Pas leximit të pjesëve nga Kurani fisnik dhe intonimit të himnit kombëtar dhe atij shtetëror, fjala ishte për drejtorin e Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri ef. Bajgora, i cili ndër të tjera tha se xhamitë te ne tejkaluan rolin e tyre, duke mos u kufizuar vetëm si vende adhurimi. “Përgjatë këtyre shekujve të hapërimit tonë me Islamin si fe, në trojet tona u ndërtuan shumë xhami të bukura e me vlera historike, duke krijuar kështu një peizazh magjepsës fetar, sepse xhamitë, që në fillim të ndërtimit të tyre, e tejkaluan rolin e tyre duke mos u kufizuar vetëm si vende adhurimi, përkundrazi, misioni i xhamive kudo në tokat shqiptare shtrihet përtej madhështisë së tyre arkitekturore. Ato gjatë historisë, ishin vërtet qendra aktive të edukimit dhe ligjërimit intelektual. Brenda këtyre hapësirave të shenjta, dijetarët dhe mendimtarët, nxitën një kulturë të të mësuarit që i kapërceu kufijtë fetarë. Xhamitë nuk ishin thjesht dëshmitarë të heshtur të historisë, por kanë shërbyer si pika qendrore për ndërveprime sociale, ku individët bashkoheshin duke forcuar lidhjet e përbashkëta në mes tyre” – tha ndër të tjera drejtori Bajgora.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, fillimisht përshëndeti dhe përgëzoi punën e Institutit dhe të gjithë referuesve, të cilët me kumtesat e tyre shpalosën pjesë të kulturës dhe identitetit tonë. Ai më pas tha se xhamia është vendi që bashkon të gjitha kategoritë e shoqërisë, duke e quajtur atë institucion, i cili i ka ruajtur vlerat gjuhësore e kulturore të besimtarëve tanë. “Vlen të theksohet në veçanti roli i xhamisë si vend i rëndësishëm social dhe edukativ. Vetë mënyra e hyrjes në xhami dhe kryerja e adhurimeve në të është edukatë dhe kulturë në vetvete, kurse qëndrimi në të është kalitje, përsosje dhe edukim shpirtëror. Xhamia pra ka qenë dhe është vendi që bashkon të gjitha kategoritë e shoqërisë, një institucion, i cili ka ruajtur vlerat gjuhësore e kulturore të besimtarëve tanë. Në ambientet e këtyre shtëpive të Zotit, zunë fill dhe u zhvilluan edhe shumë ngjarje me rëndësi jetike për popullin dhe vendin tonë, duke u vënë kështu në shërbim të çështjes kombëtare. Xhamitë tona u shndërruan në shkolla e kuvende burrash, nga aty dolën dhe i prinë popullit ulema e atdhetarë tanë të spikatur, që u vunë në ballë të proceseve të rëndësishme historike, politike e kombëtare, ku vlen të përmendet se

në xhaminë “Bajrakli” të Prizrenit u mbajt edhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit, e deri te lufta e fundit, ku xhamitë tona u shndërruan në qendra të rezistencës e të mbijetesës sonë” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Një fjalë rasti e mbajti edhe kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, Reisul ulema, Shaqir ef. Fetahi, i cili tha se kjo Konferencë është unike për shkak të qasjes gjithëpërfshirëse ndaj xhamisë. “Kjo Konferencë shkencore po respekton institucionin e shenjtë të Islamit që quhet xhami. Për këtë jam i bindur se gjithë shqiptarët dhe në veçanti për shqiptarët në trojet e tyre për shkak se për herë të parë, institucionit të xhamisë i qasemi nga të gjitha aspektet. Aspektin fetar, etik, shoqëror, social, ekonomi, artistik, letrar dhe në veçanti i qasemi xhamisë si shtyllë e identitetit kombëtarë e që ishte shtyllë në momentet më të rëndësishme. Kjo ka qenë një fuqi e madhe për të kuptuar se shqiptarët nuk janë rastësisht bartës së islamit, shqiptarët prej kohës së ezelit janë të caktuar që të jenë bartës së islamit në Ballkan dhe Evropë.”

Gjatë dy ditëve sa zgjati kjo Konferencë, me kumtesat e tyre u paraqitën mbi 70 studiues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Jordania dhe Egjipti. Pjesëmarrësi në këtë Konferencë ishin: Resul Rexhepi, dr. Faredin Ebibi, dr. Ferid Piku, dr. Valon Myrta, dr. Murtezan Idrizi, dr. Ziber Lata, dr. Abdulla Rexhepi, dr. Iljaz Rexha, dr. Sadik Mehmeti, Ramadan Shkodra, dr. Orges Drançolli, dr. Hysen Matoshi, Zeqirija Ibrahim, Petrit Zeneli, dr. Maksut Xh. Haxhibrahimi, dr. Mehmet Zeki Ibrahim, dr. Besir Neziri, Phd.C. Brunilda Basha, dr. Fahri Avdija, dr. Agron Islami, Tomor Kastrati, dr. Krenar Doli, Migen Matraku, dr. Shinazi Memedi, dr. Jusuf Osmani, dr. Fahrush Rexhepi, dr. Amra Hadžimuhamedović, Ali Bardhi, dr. Ferid Selimi, mr. Sami Isufi, Elza Shipoli, dr. Hatixhe Ahmedi, dr. Adem Zejnullahu, dr. Valon Shkodra, dr. Orhan Bislimaj, dr. Azmir Jusufi, dr. Mead Osmani, dr. Qerim Lita, Hamid Alaj, dr. Selim Selimi, Ejup Ramadani, dr. Behlul Kanaqi, dr. Naser Ramadani, Vullnet Iseni, dr. Genti Kruja, dr. Ermal Nurja, Roald Hysa, Ermal Bega, Elez Osmani, dr. Genc Samimi, dr. Fitim Rifati, Harun Shabanaj, Sabri Bajgora, dr. Sylë Ukshini, Baki Svirca, mr. Ali Sadiku, hfz. Arif ef. Emini, dr. Bashkim Aliu, dr. Sedat Islami, dr. Feim Gashi, dr. Qenan Ismaili, Vedat Sahiti, Besnik Kadriolli, dr. Rexhep Suma, Vahidin Beluli, dr. Shkodran Imeraj, dr. Ibrahim el Bejjumi Ganim,

dr. Fajza Meluk, Akad. Muhamed Mufaku, Bashkim Mehani, dr. Saleh Lamei, Akad. Feti Mehdiu, dr. Isa Memishi, mr. Besim Mehmeti.

Pas përfundimit të pesë seancave paralele të ndara në dy ditë, u mbajt edhe ceremonia përmbyllëse e kësaj Konference, në të cilën pos shumë personaliteteve, mori pjesë edhe kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili ndër të tjerash theksoi: “Ne përgjatë dy ditëve me radhë, jetuam nën urdhrin e të Madhit Zot, i cili para 1400 vjetëve, na urdhëroi që të ndërtojmë shtëpia të Zotit, të përkujdesemi për to dhe që në vazhdimësi të përmendet fjala e Zotit. Andaj falënderoj të gjithë pjesëmarrësit e kësaj Konference, në veçanti studiuesit, të cilët kanë bërë shumë, në mënyrë që kjo Konferencë të dalë e suksesshme dhe besoj që ia kemi arritur qëllimit.” Ai dha porosi edhe për Institutin e Hulumtimeve dhe Studimeve Islame që edhe më tej të vazhdojnë në organizimin e konferencave të tilla, të cilat do të hidhnin dritë mbi shumë gjëra të cilat tashmë i ka mbuluar pluhuri, duke ofruar kështu përkrahjen e vazhdueshme të institucionit të BIK-ut. “Bashkësia Islame e Kosovës edhe më do të përkujdeset për organizimin e tryezave, simpoziumeve dhe konferencave të tilla dhe se ne bashkërisht do t’ia dalim” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Ndërkaq, në emër të Këshillit Organizativ, fjalën përmbyllëse e mbajti dr. Valon Myrta, i cili në pika të shkurtra tregoi për ecurinë dhe mbarëvajtjen e kësaj Konference. Ai tha se konferencat e tilla nuk do të mund të realizoheshin pa pjesëmarrjen e studiuesve dhe referuesve, të cilët, me kumtesat e tyre, secili në fushën e vet, vunë në spikamë dhe ndriçuan fusha të ndryshme rreth xhamive të shqiptarët. Ai para të pranishmëve më pas shpalosi edhe fokusin e seancave të kësaj Konference. “Konferenca i zhvilloi punimet në dy ditë, ku në fokus ishte aspekti fetar dhe kulturor i xhamive, të lidhura me konceptin, rëndësinë, veçoritë, rolin dhe funksionin e xhamive, çështjet nga fusha arkivore dhe arkeologjike, çështje nga fusha e trashëgimisë kulturore në të drejtën ndërkombëtare, si dhe kontributi i xhamive në kultivimin e identitetit kombëtar në trevat shqiptare dhe nëpër botë. Përgjithësisht në fokus të kësaj Konference ishte historiku, roli, arti, kultura, arkitektura dhe trajtimi i trashëgimisë dhe shkatërrimi i xhamive në trojet tona.”

Bajram Zeqiri



Myftiu, Naim ef. Tërnavë



Drejtori i IHSI-së, Sabri ef. Bajgora



Kryetari i BFI të Maqedonisë së Veriut, Reisul ulema, Shaqir ef. Fetahi




Biblioteka e IHSI-së pasurohet me dorëshkrime dhe libra të vjetër dhe të rrallë

Dhurimi i mus'hafe të vjetra

Më 2 maj 2023, Arbër Bajgora dhe Kushtrim Isufi, nëpërmes imanit të xhamisë së Haxhi Veselit në Mitrovicë, Asllan ef. Fazliut, i dhuruan bibliotekës së Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, disa mus'hafe të vjetra.

Drejtori i Institutit, Sabri ef. Bajgora, falënderoi Arbërin dhe Kushtrimin për dhurimin e këtyre mus'hafeve, duke porositur kështu edhe të tjerët që kanë libra të vjetër të trashëgimisë sonë islame që të mos hezitojnë, por t'i sjellin ato tek Instituti, në mënyrë që të ruhen si trashëgimi dhe që nëpërmes tyre të ndriçohet e kaluara e ndritur e hoxhallarëve dhe ylemave tanë.



Dhurimi i librave të vjetra

Më 25 maj 2023, në vazhden e aktiviteteve të dhurimit të librave të vjetër për Bashkësinë Islame të Kosovës, gjegjësisht për bibliotekën e Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, Rejan Ibrahim, me autorizimin e kryetarit të Këshillit të Bashkësisë Islame të Obiliqit, Behar ef, Mjekiqit, dhuroi për këtë bibliotekë disa dorëshkrime dhe libra të ndryshëm të fushave të ndryshme, si fikh, hadith, tefsir, të cilat kanë qenë të hoxhallarëve të vjetër të komunës së Obiliqit.

Drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri Bajgora, vlerësoi këtë hap të qëlluar të Rejan Ibrahimit, të cilin e falënderoi dhe po ashtu apeloj te të gjithë ata që kanë dorëshkrime të tilla mos të hezitojnë por t'ia dorëzojnë Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame.

Vlen të përmendet se këto dorëshkrime janë prej më të rëndësishmëve të cilat janë dorëzuar deri më tani në bibliotekën e Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame.



Takimi me drejtorin e Departamentit për ruajtjen e dokumenteve osmane pranë Arkivit Shtetëror të Turqisë

Më 14 qershor 2023, drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri Bajgora, i shoqëruar nga dr. Besir Neziri, anëtar i KD të IHSI-së, u pritën në një takim pune nga drejtori i Departamentit për ruajtjen e dokumenteve osmane pranë Arkivit Shtetëror të Turqisë për periudhën osmane, z. Mehmet Tashtan.

Në këtë takim u bisedua për mundësinë e bashkëpunimit në mes dy institucioneve në sferën e publikimit të dokumenteve të rëndësisë së veçantë që ndërlidhen me Kosovën dhe institucionet fetare, siç janë xhamitë, medresetë etj.

Drejtori i IHSI-së, Sabri Bajgora, e falënderoi nikoqirin për mikpritjen dhe gatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjellë



Dhurimi i librave të Ruzhdi Emërllahut

Më 18 shtator 2023, drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri ef. Bajgora, ka pranuar për bibliotekën e këtij instituti librat e efendiut Ruzhdi Emërllaut nga Rahovica.

Këto libra i solli djali i mulla Ruzhdiut, haxhi Qenani, i cili shoqërohej nga imami i Rahovicës, Leotrim ef. Asllani.

Këta u mirëpritën nga drejtori i këtij Instituti, prof. Sabri ef. Bajgora, i cili i falënderoi ata, duke thënë se iniciativat e tilla ndikojnë pozitivisht në pasurimin me libra të vjetër të bibliotekës së Institutit. Librat janë të fuqshme të ndryshme, si fikh, akaid, tefsir, hadith, filozofi etj.

Prof. Bajgora, gjithashtu vlerësoi lart kontributin e mulla Ruzhdiut dhe të gjithë ulemasë së Preshevës me rrethinë.

Ruzhdi Emërllahu shërbeu si imam, mualim dhe hatib në Xhaminë e Vjetër në Rahovicë për mbi 30 vjet.



PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	5
I - AKTET E TRYEZËS SHKENCORE “SALI ef. MYFTIA personalitet i shquar fetar dhe kombëtar”	9
Fjala e hyrëse e drejtorit të IHSI-së në Tryezën Shkencore “SALI EF. MYFTIA PERSONALITET I SHQUAR FETAR E KOMBËTAR (1891-1978)”	11
Fjala e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë me rastin e Tryezës shkencore “SALI EF. MYFTIJA PERSONALITET I SHQUAR FETAR E KOMBËTAR (1891-1978)”	15
Fjala e Myftiut të Shkodrës, Muhamed ef. Sytari me rastin e Tryezës shkencore “SALI EF. MYFTIJA PERSONALITET I SHQUAR FETAR E KOMBËTAR (1891-1978)”	21
Fjala e Erjeta Myftisë, mbesa e Sali Myftisë, me rastin e Tryezës shkencore “SALI EF. MYFTIJA PERSONALITET I SHQUAR FETAR E KOMBËTAR (1891-1978)”	23
TELEGRAMURIMI NGA PRINCI LEKA ZOGU II	25
SALIH EFENDI MYFTIA (1891-1978), MYFTI I ZONËS SHKODËR DHE KOSOVË (GJAKOVË) PRIJËS I SHQIPTARËVE MYSLIMANË NË SHBA	27
Dr. Trida HOTI	33
KUJTIME TË HESHTUNA, RRËFIME FAMILJARE PËR SALIH EFENDI MYFTINË	33
Dr. Sadik MEHMETI	41
ELITA INTELEKTUALE ISLAME NË SHKODËR NË KAPËRCYELL TË SHEKULLIT XX	41
Akademik Muhamed MUFAKU	51
KONTRIBUTI I SALIH EF. MYFTISË NË RIGRUPIMIN DHE ORGANIZIMIN E MËRGATËS ANTIKOMUNISTE NË LINDJEN E MESME (1947-1965)	51

Ismet A. Qazim Al BAHITI.....	61
DROMCA KUJTIMESH RRETH SHKËLQESISË	
SË TIJ SALIH MYFTIJA NGA FËMIJËRIA IME NË EGJIPT	61
Dr. Adnan HAJDINI	67
SALI MYFTIJA NË KUJTIMET E NJË MUHAXHERI	67
Elez OSMANI.....	75
PËRPJEKJA E SALIH MYFTISË PËR ÇËSHTJEN FETARE	
E KOMBËTARE NË MËRGIM	75
Sabri BAJGORA.....	99
ANALIZË E TRI FLETOREVE NË DORËSHKRIM,	
TË SHKRUARA NGA DORA E SALIH EF. MYFTISË.....	99
Dr. Hysen MATOSHI	117
MUHAMEDI A.S. – MODELI I VEPRIMIT TË SALIH MYFTISË.....	117
Bashkim MEHANI.....	127
ANALIZË ESTETIKE DORËSHKRIMEVE	
TË SALIH EFENDI MYFTISË.....	127
Dosja sekrete e Ministrisë së Punëve të Brendshme /	
Drejtoria e Sigurimit të Shtetit.....	135
FOTOALBUM NGA TRYEZA SHKENCORE	
“SALI EF. MYFTIJA PERSONALITET I SHQUAR FETAR	
E KOMBËTAR (1891-1978)”	153
II - AKTET E TRYEZËS SHKENCORE	
“HFZ. FAHRI EF. ILJAZI - (1903-1985) ALIM	
DHE UDHËHEQËS I SHQUAR I BASHKËSISË ISLAME” ...	161
Fjala e hapjes në Tryezën shkencore “HFZ. FAHRI EF. ILJAZI -	
ALIM DHE UDHËHEQËS I SHQUAR	
I BASHKËSISË ISLAME”	163
Fjala e Myftiut Naim ef. Tërnava në Tryezën shkencore	
HFZ. FAHRI EF. ILJAZI - ALIM DHE UDHËHEQËS	
I SHQUAR I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS	167
Prof. Muhamed ILJAZI.....	171
KUJTIME FAMILJARE.....	171
Dr. Sadik MEHMETI.....	183
TË DHËNA PËR SHKOLLIMIN E FAHRI EFENDI ILJAZIT DHE	
AKTIVITETIN E TIJ SI MYDERRIZ NË “MEDRESENË E	
MADHE” TË GJAKOVËS.....	183

Sabri BAJGORA	199
METODA E LIGJËRIMIT NGA MYDERRIZI	
FAHRI EFENDI ILJAZI	199
Alban DOBRUNA	207
FAHRI EF. ILJAZI – KRYETAR I NËNMYFTINSË	
SË GJAKOVËS GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE	207
Akademik Feti MEHDIU	215
FAHRI EFENDI ILJAZI DHE MEVLUDI I TAHIR EF. POPOVËS	
NË KUJTESËN E NJË MEDRESISTIT.....	215
Elez OSMANI.....	223
FAHRI EF. ILJAZI (1903-1985) NË KUJTESËN TIME	223
Esat REXHA	233
KUJTIMET E MIA PËR HAFËZ FAHRI EFENDIUN.....	233
Fjala e përmbyllëse e Tryezës shkencore “HFZ. FAHRI EF. ILJAZI -	
ALIM DHE UDHËHEQËS I SHQUAR	
I BASHKËSISË ISLAME”	239
FOTOALBUM “HFZ. FAHRI EF. ILJAZI - ALIM	
DHE UDHËHEQËS I SHQUAR I BASHKËSISË ISLAME”	243
III - AKTIVITETE.....	249
U MBAJT KONFERENCA SHKENCORE “XHAMIA	
TE SHQIPTARËT - HISTORI, MISION, IDENTITET”.....	251
Biblioteka e IHSI-së pasurohet me dorëshkrime	
dhe libra të vjetër dhe të rrallë	257
PËRMBAJTJA.....	261